

Acta non verba
ad honorem David Luka

KËN2

revistë e përvitshme kritike

IV • 2020



Michigan 🌸 🌻 🌼 🌾 🌿 🌸 🌻 🌼 🌾 🌿 🌸 🌻 🌼 🌾 🌿 🌸 🌻 🌼 🌾 🌿 🌸 🌻 🌼 🌾 🌿

KËNS - IV/2020

▪ *revistë e përvitshme kritike* ▪

Botues:

Lisandri & Aristeia Kola

Kryeredaktore:

Aristeia Kola

Zv/kryeredaktor:

Fra Censor Ambrozi

Komisia shkencore:

Adrian Deva, Arben Prendi, Carrie Ann Morgan, Çezarin Toma, Eljon Doçe,
Erenestina Gjergji Halili, Marsel Nilaj, Michael Galaty

Në ballinë:

Hilma af Klint, *The Ten Largest, Group IV, No. 1.*

E-mail:

revistakens@gmail.com

© i veprës: familja Luka.

Botimi i parë: Fiorentia, Shkodër, 2017.

© Këns: L. & A. Kola

Ann Arbor, Michigan

ISSN: 2521-7348



Korrik 2020

DAVID LUKA

Studime gjuhësore

Vëllimi 19



PASURIA GJUHËSORE E KANUNIT
TË LEKË DUKAGJINIT



Revista *Kêns*, në shëjë nderimi për të ndjemin dhe të shtrëjtin, **Profesor David Luka** (1935-2020), tue pasë miratimin e familjarëve të Tij, ka peshue me publikue në këtë numër [IV] një prej veprave—përkatësisht vëllimin 19—të kolanës *Studime Gjuhësore* (I-XX).

Profesori i ndertë, ka bashkëpunue me revistën tonë dhe ka qenë tejet entuziast për konceptimin dhe shkrimet e saj. Fatkeqsisht, largimi i Tij ka prapësue disa projekte bashkëpunimi, të cilat i kemi pasë në fazë konsultative. Publikimi i veprës *Pasuria gjuhësore e Kanunit të Lekë Dukagjinit* [bot. I, 2017], asht një ndër punimet e fundit, që Profesor Luka i ka kushtue Etënve Françeskanë (në këtë rast i referohem mbledhësit e përkujdesësit të *Kanunit*, Át Shtjefen K. Gjeçov), prej të cilëve xûni themelet shkencore. Vepra e mbrame e serisë SGJ [vol. XX], iu pat kushtue Át V. Volajt dhe Át D. Kurtit. Por në këtë seri të SGJ, dhe shumë artikuj shkencorë, shkolla Françeskane xën fokusin ma të konsiderueshëm të pasunisë gjuhësore.

Tue e ditë fort mirë se, libri i shtypun, fusha specifike e gjuhësisë, libraritë dhe bibliotekat e Shqipnisë janë burime relativisht të aksesueshme, menduem se *Kêns* kishte me qenë një opion alternativ për me lexue e studiue produktin e Profesor David Lukës. Aq ma tepër, se kontakti me specialistë, albanologë qofshin mbrenda a jashtë Shqipnie apo qofshin edhe të huej, ditë për ditë ka nevojë me pasë lehtësi përdorimi në formë online. Për këtë mundësi dhe disponim, falenderojmë me zemër të birin e Profesorit, z. Artur Lukën, që pati mirësinë me e pranue propozimin e revistës sonë.

Për një gja jemi të gëzuem, se komuniteti kërkimor në fushën albanologjike, në Universitetin e Michigan-it (Ann

Arbor), po zgjanohet e faktorizohet me ritme të kënaqshme, dhe kështu kjo vepër gjuhësore me fokus KLD ka me u shërbye departamenteve të Antropologjisë, Gjuhësisë apo fushave të ndryshme ndërdisiplinore.

Përvújtnia dhe përpiknia shkencore e Prof. D. Lukës, përkrah përvojës studimore mbi 60-vjeçare, meriton me u paraqitë ‘pa zhibla’ prejse ‘pûna luen shtegun’, dhe me u largue prej një realiteti vendor (shqiptar) për me mbërritë në ‘Gjenacatin’ kulturor.

Me shpresën se një ish-student, i padenjë, i *Fonetikës historike të gjuhës shqipe* dhe i *Historisë së gjuhës shqipe*, ka me u përpjekë me përçue vlera reale në një hapësinë tejllokale, ngaqë beson se kontributi gjuhësor i David Lukës asht fakt dhe një fenomen ma së paku ballkanik. Puna e Tij e çmuetë ka kunorëzue ndihmesën e Proff. Eqrem Çabej, Kolec Topalli apo të ndonji tjetri, të cilët kanë vû sinoret e amshueshme ku do të qarkullojë historia e gjuhës shqipe.

Profesor David Luka, në kushtet e tij jetësore-studimore, zgjodhi një rrugë: *librin*, dhe u ba ‘libër’.

Lisandri Kola

Ann Arbor/MI, mars 2020

PARATHËNIE

1. Atë Shtjefën Gjeçovi ishte produkt i pastër i shkollës françeskane.

Kuvendi i françeskanëve në Shkodër nuk ishte vetëm strehë meshtarësh, por edhe çerdhe njerëzish të ditur e me kulturë. Të zgjedhur që në fëmijëri, ata shkolloheshin me kujdes të veçantë, së pari në vend, e pastaj jashtë shteti. Çdo njëri prej këtyre meshtarëve kishte kryer dy (a më tepër) shkolla të larta; njëren për teologji dhe tjetrën në ndonjë degë të veçantë të shkencave shoqërore apo atyre ekzakste. Duke u kthyer në atdhe pas studimesh të gjata në vende të ndryshme të Evropës, ata sillnim me vete jo vetëm kulturën perëndimore bashkëkohore, por edhe gjuhët përkatëse, të cilat i zotëronin me themel. Në këto kushte, pra, kuvendi françeskan në Shkodër paraqitej si një universitet i vërtetë, ku mund të gjeje studiues në të gjitha fushat e shkencës e të dijes e ku fliteshin të gjitha gjuhët e Evropës. Duke qenë se këta meshtarë françeskanë vinin nga të gjitha shtresat e popullsisë, gjithsesi nga familje të zgjedhura në konceptin e etikës morale të kohës, ata sillnin me vete edhe mendësinë e vendit nga kishin origjinën. Bashkoheshin, pra, te këta njerëz tepër të thjeshtë e për kohën edhe relativisht të varfër, kultura perëndimore me cilësitë më të vyera të shqiptarit, një simbiozë që, e brumosur edhe me ndjenja fetare, farkëtonte personalitete të fuqishme, që të impononin respekt të veçantë. Duke shtuar këtu edhe reputacionin e madh që gëzonin në popull si edhe gatishmërinë për t'i shërbyer atij në çaste kritike pa iu dridhur qerpiku, portreti i tyre plotësohej më së miri.

Tani besoj bëhet e qartë përse revista që nxirrnin këta meshtarë të ditur quhej “Hylli i dritës”, përse ajo kishte si emblemë të saj thënien proverbiale “Ubi Spiritus Domini, ibi

libertas" (= Ku asht shpirti i Zotit, aty asht liriya) dhe përse ajo ishte e - kjo është merita kryesore - vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite: "Votër kulture shqiptare".¹

Gjeçovi ishte pjesë e një katërsheje të goditur françeskanësh, që lanë katër vepra monumentale në themelet e kulturës shqiptare,² dhe që punuan tërë jetën me mish e me shpirt për atdheun e tyre, pa marrë parasysh as vdekjen.

Në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* të vitit 1985 për Gjeçovin shkruhet: "*Zhguni i fratit dhe detyrimet ndaj kishës nuk ia ndërruan dot natyrën e një malësori luftarak, me dashuri të flaktë për atdheun, për popullin dhe për kulturën e tij të lashtë.*"³

Për "*zhgunin e fratit*", ngjyra e të cilit ia errëson sytë Mark Tirtës, autorit të këtij zëri të *Enciklopedisë*, në atë kohë sekretar partie i Institutit të Kulturës Popullore, sot akademik, mund t'i sjell ndërmend këtë pasazh, duke perifrastuar një nen të Kanunit (kush nuk bindet, *e bie në mend katundî*):

Tue naltue veprën e Fishtës, ngrihet në pedestal vepra e pavdekshme e Françeskanëve, që hodhën gurë të randë themeli nën të katër muret e ngrehinës së kulturës kombëtare, kulturë të cilën mandej e zbukuruen imtë me duert e tyne të mësueme e të frymëzueme, që çuen meshë, bekuen, mbajtën penda, dalta, penela apo luejtën shkathtësisht ndër vegla muzikore, drejtuen shfaqje dramatike, nënshkruen fatet e së ardhmes në ngjarje me peshë kombëtare e ndërkombëtare, *firma* e të cilëve asht,

¹ D. Luka, *Ndihmesa e "Hyllit të dritës" për gjuhën shqipe dhe për gjuhësinë shqiptare*, HD 4, 1993.

² Gjergj Fishta "*Lahuta e Malcís*"; Bernardin Palaj, "*Visaret e Kombit*"; Donat Kurti, *Prralla Kombtare*"; Shtjefën Gjeçovi, "*Kanuni i Lekë Dukagjinit*".

³ *Fjalori enciklopedik shqiptar*, Tiranë, 1985, f. 335.

padyschim, e pranishme në çdo fillesë të mbarë për Atdhenë”.⁴

Ngjan që M. Tirta e ka kuptuar gabimin, sepse në *“Fjalorin enciklopedik shqiptar”* të vitit 2008⁵ - thua se nuk kishte kush tjetër të shkruante për Gjeçovin, por vetëm komunistët, të vjetër e të rinj - akad. Marku e hoqi “zhgunin”, por pa bërë asnjë *mea culpa*. Është e tepërt të them se po të mos ishte “zhguni”, nuk do të kishim as “Kanunin e Lekë Dukagjinit”.

2. Atë shtjefën Gjeçovi ishte shkencëtar i madh.⁶

Deri më sot nuk dimë të ketë kryer dikush ndonjë studim për metodën thellësisht shkencore të përdorur nga Gjeçovi të Kanuni. Bile kanë kaluar në heshtje edhe shënimet e tij (nën vijë) pothuaj në të gjitha faqet e librit. Megjithëse Kanuni nisi të mbledhej prej Gjeçovit rreth viteve 1900, aty përdoret metoda

⁴ Ana Luka, *Paraqitje - Heshtimi për inat asht lumni e ardhshme*, te vepra Át Daniel Gjeçaj, *Gjergj Fishta - Jeta dhe vepra*, Shkodër, 2007, f. 6 v.

⁵ *Fjalori enciklopedik shqiptar*, Tiranë, 2008, f. 814.

⁶ Gjeçovi nuk i ndërpreu kërkimet për plotësimin e përmirësimin e mbledhjes së materialit dhe kodifikimin e tij edhe pas botimit të Kanunit. Këtë e tregojnë dy dorëshkrime të lëna në Zym, që më vonë u sollën në Shkodër e që tani ruhen në Arkivin e Muzeut Popullor. Studiuesi prof. dr. K. Ulqini, në artikullin me titull “Dy dorëshkrime të Shtjefën Gjeçovit-Kryeziut”, do të japë një pasqyrë të plotë të përmbajtjes së këtyre dy artikujve si edhe vlerën e rëndësishme që paraqesin, veçanërisht: “1. Në plotësime dhe formulime të ndryshme në krahasim me ato që përmban KLD i botuar më 1933; 2. Në dhënie të disa normave të papërfshira në KLD; 3. Në dorëshkrim jepen mjaft emra informuesish, vendet ku janë regjistruar normat kanunore si dhe koha. Botimi KLD në këtë drejtim ka një mungesë të theksuar; 4. Në terminologjinë e përdorur. Në dorëshkrim njihemi me terma kanuni, që nuk janë paraqitur në KLD; 5. Në përdorimin e folklorit juridik.” (Ulqini *Qytetërim* 129 v.)

shkencore më e përparuar e kohës, ajo krahasimtare. Gjeçovi nuk bën as komente, as interpretime, ai bën vetëm krahasime. Por, meqë shumë studiues të veprës, nuk e kanë njohur si duhet latinishten, këto shënime kanë kaluar pa u vënë re. Gjeçovi përpiqet të gjejë izoglosa të përbashkëta të Kanunit ndër veprat e autorëve latinë, veçanërisht takimet me Kodin e Justinianit, ku në procesin e trashëgimisë ndiqet “lisi i gjakut” e ku përjashtohet vija femërore.

Po ajo që bie në sy është krahasimi që bën Gjeçovi me kode të kohës indoevropiane, punë që deri më sot nuk e ka bërë asnjë prej etnografëve tanë.

Duke folur për vendosjen e kufijve e, veçanërisht për lëvizjen e tyre, Gjeçovi do të shënojë në fund të faqes: “*Oroe*: Kanuni ‘Manava Dharmasastra’ ka shumë pika mbi kufije, qi thue se i kan përbashkënisht me Shqyphtarë t’onë” (KLD 37, shën. nr. 1). Khs. edhe citimin nr. 2 në f. 11 (“Manava Dharmasastra”, Codice di Manu, Libro III Matrimonio, ecc, nr. 33). Khs. gjithashtu shën. nr. 1 në f. 31: “Po u vodh shtëza, bariu do t’a baje me dije të zo’n, ku e kur u vodh, e tjetër detyrë s’i ka” (Kanuni i Manu-it, Li. 8, Zyre gjygtarësh.)

Kemi të bëjmë këtu me një studiues serioz, të besueshëm e për kohën edhe modern.⁷

Në paragrafin nr. 936, ku flitet për vlerësimin e barrës së gruas së vrrarë, e ku Kanuni u jep të drejtën “me çilë të vramen, per me pá pale a pat djalë a vajzë”, Gjeçovi vë shënimin në fund të faqes: “I nipi i Herkulit, Aristodemi, mbreti i Mesanasve (742 para Krishtit) e mbyti të bín dhe e çili, per me

⁷ Në artikullin me titull *Duke gjurmuar “ex libris” Shtjefën Gjeçov*, (botuar në gazetën lokale “Jeta e re”, Shkodër), Kahreman Ulqini, ndërmjet të tjerash, do të shkruajë: “Duke studiuar në bibliotekën ‘Marin Barlketi’ të qytetit të Shkodrës gjatë më se tridhjetë vjetëve, herë mbas here kam marrë në dorë libra të ndryshëm me shënimin ‘ex libris Shtjefën K. Gjeçovi’, ose me firmën e tij. Janë rreth katërdhjetë tituj librash të vendosur në fondet shqip, i huaj, albanologji, ballkanologji e antikuar, kryesisht në gjuhët shqip, italisht, latinisht e kroatisht”.

diptue se ishte i rrëjshem zhgarkimi i dhûnshem, qi u fol prej nji mesanasit, kundra fjeshtsis së vajznis së saj” (“La Grecia”, *M. Pouqueville*, Venezia, 1836. - Assedio d'Itome, pag. 42).⁸

Në faqen 85 të Kanunit, kur flitet për të drejtat e njeriut, e ku thuhet se “Shpirt per shpirt, se duken e falë Zoti”, Gjeçovi vë shënimin nën vijë “- *Animam pro anima ...*”, *Levitiku*, k. XXIV, vv. 18-20 (KLD 85, shën. nr. 2).

Në Bibël, në kapitujt 18-20, që Gjeçovi i shënon për krahasim, shkruhet: “¹⁸ Kush vret kafshën le ta zëvendësojë me një si ajo: jetë për jetë. ¹⁹ Kush t’i shkaktojë varrë ndokujt prej bashkatdhetarëve të vet, le t’i bëhet edhe atij siç bëri ai: ²⁰ të thyerit për të thyera, syri për sy, dhëmbi për dhëmb - çfarë varre i shkaktoi tjetrit, varrë të njëjtë le të durojë edhe ai vetë.”⁹

Dëshira për të zbuluar sa më shumë elemente të vjetra të trashëguara, e ka shtyrë Gjeçovin të bëjë krahasime deri edhe me Biblën. Edhe një bashkëvëlla i Gjeçovit, i arratisur për t’i shpëtuar rrebeshit komunist, bëri me mjetet e tij, penelin e ngjyrat, atë që I. Kadareja do ta përshkruajë aq bukur:

“Lin Delija shkoi edhe më larg, duke kryer një nga ato mrekullitë që mund të ndodhin vetëm në art. Sepse vetëm në art mund të ndodhë që shqiptarët e tij, fytyrat, vallet, tirqit e xhamadanët e qendisur, jo vetëm që çliroheshin nga vetmia, por qëllonte të gjendeshin befas midis ngjarjeve planetare, ato që kishin ndryshuar botën, si ajo që jepet në tablonë e famshme “Hyrja e Krishtit në Jeruzalem... Tabloja e krijuar më 1987 është profetike.”¹⁰

Ky ishte frymëzimi që Delija kishte marrë ndër françeskanët e mëdhenj.

⁸ KLD 89, shën. nr. 2.

⁹ *BIBLA /Besëlidhja e vjetër dhe Besëlidhja e re/*, përktheu dhe shtjelloi dom Simon Filipaj, Ferizaj, 1994, f. 160.

¹⁰ Shiko rev. “Hylli i dritës”, nr. 2, 2010, f. 1.

3. Atë Shtjefën Gjeçovi ishte jurist.

Përzgjedhja e kodifikimi i asaj mase amorfe, që Gjeçovi ka mbledhur për vite të tëra nga pleq analfabetë, por gjithsesi të dalluar për dhënie mendimesh me interes të madh për studiuesin, janë një tregues i qartë se autori i Kanunit ka qenë jurist, bile i dalluar.¹¹ Aq më tepër kur ky vetë ka bërë punë pionieri pa pasur përpara ndonjë gjedhe (përkat. model) ku të mbështetej.

Gjatë gjithë kohës mbas botimit të Kanunit, kjo vepër është bërë objekt studimi nga dijetarë të ndryshëm¹², brenda dhe jashtë vendi.¹³ Me materialin e paraqitur aty janë mbrojtur diploma universitetesh¹⁴ e deri doktoratura.¹⁵

¹¹ K. Ulqini do të shkruajë "... përmbledhja e Shtjefën Gjeçovit, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, është kryevepër e terrenit shqiptar dhe arritje kulmore e përkushtimit të regjistruarit" ("*Kundrime*", f. 7).

¹² Khs. p. sh. S. Popovci, *Marrëdhëniet juridike civile në Kanunin e Lekë Dukagjinit*, Prishtinë, 1971.

¹³ Përveç botimeve të Kanunit në italisht, gjermanisht, anglisht e frëngjisht, që shënon B. Demiraj në artikullin "*Fé dhe Të prëmt e fës në Kanunin e Lekë Dukagjinit*" (f. 120, shën. nr. 2), kemi edhe një përkthim në spanjisht, kryer nga Ernest Përdoda (në vitet 1963-64). Fati i këtij dorëshkrimi nuk dihet, sepse autori nuk ka lënë trashëgimtarë. Në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* (Tiranë, 2008, f. 1109) thuhet se është përkthyer edhe në rusisht.

¹⁴ *Kanuni i Lekës* (Codex Aleksandri) është një studim prej 70 faqesh të daktilografuara me një shtojcë 6 faqesh i paraqitur në vjeshtën e vitit 1921 si punë diplome në Universitetin Mbretëror të Romës me autor Martin Ivanaj (K. Ulqini, "*Kundrime*", f. 51).

¹⁵ Në rev. "Hylli i dritës" (nr. 8-10, 1939, f. 502) shkruhet: "... Profesori i historis së Ligjës n'Universitetin e München, Baroni Claudius von Schwerin, për të cillin unë përkëtheva në Korrik të 1938 vepren 'Kanuni i Lekë Dukagjinit', ka dhënë atë gjykimin e vet mbi këto tagre zakonesh: aj i mban si **Ligjë krejt t'interesantshme "ndoshta më të vjetra ligjë t'Europës"**; me ande do ta botote gjermanisht, tue i shtue edhe skjarime të nevojshme. Por, para se t'i hije kësaj vepre kolosale, i ka ande me dëjtë, se a është botue "Kanuni i Lekë

Do të mjaftonte këtu puna që Universiteti i Lajpcigut i dha Gjeçovit për veprën “Kanuni i Lekë Dukagjinit” titullin *Doctor honoris causa*. Duke u mbështetur në informacionin e dhënë në *Fjalorin enciklopedik shqiptar*, Gjeçovi nuk ka asnjë titull shkencor as nga universitetet tona, as nga Akademia e Shkencave.¹⁶ Ngjan vazhdon ta pengojë “*Zhguni*”!?

4. Atë Shtjefën Gjeçovi ishte gjuhëtar.¹⁷

Gjithçka që shkruhet në Kanun është tërësisht e qartë dhe e kuptueshme. Dhe jo vetëm kaq, por edhe e shprehur me një stil karakteristik, tipar i të folmes së Mirditës.

Kush ka jetuar për një kohë të gjatë në krahinën e Mirditës e dallon menjëherë stilin e Gjeçovit, që ngjason dukshëm me të folmen e vendësve, të cilët përdorin në të tilla raste një mënyrë jo të zakonshme për të shprehur mendimet e tyre,

Dukagjinit”, posë se shqyp, edhe në ndonji gjuhë tjetër. Shi tash, mbas ndodhjeve të mbrame në Shqypni, **do t’ishte një gjâ e randsishme, qi Europa të njofë, se shka ka perftue Kombi i vogël shqyptar per veprimet e mdhá të kulturës ...**”

¹⁶ Në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* (Tiranë, 1985, f. 450) për Kanunin e Lekë Dukagjinit, ndërmjet të tjerash, shkruhet: “... kurse normat e tjera kanë karakter reaksionar, ngaqë mbrojnë pronën private, privilegjet e klasave të pasura e të kishës katolike si feudal i madh e institucion obskurantist, marrëdhëniet patriarkale feudale në familje etj.”

¹⁷ Në shënimet që ka lënë e që ruhen në Arkivin e Shtetit, ai në vitin 1900 shkruan në ballë të njërës prej këtyre fletoreve: “Laç-Sebaste-Kurbin. Fjalë, shprehje popullore, krijime fjalësh të reja” (khs. këtu fjalë të rralla si: *kerlesh, bershê, fjoll, gazhel, katralesh, katrosh, laresk, katrasyll, rrmang* etj.) Në këto fletore ai ka lënë edhe një numër të madh shënimesh për emra njerëzish, emra botanikë, emra orësh e zanash (të mbledhura në krahinën e Kurbinit), një pjesë prej të cilave edhe i botoi në revistën “Albania”. Në këtë revistë, duke filluar nga vitit 1900, Gjeçovi ka botuar 25 shkrime me pseudonimin *Lkêni i Hasit* (shiko W. Kamsi, “Albania” 1897-1909, Bibliografi kronologjike, Shkodër, 2008, f. 122).

gjithherë të kuptueshme, po tani të shoqëruara edhe me mjete artistike. Përmbillet zakonisht mendimi me një shprehje, që nuk lë më asnjë hije dyshimi për atë që duhej thënë.

Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për një logjikë të pakundërshtueshme, për një inteligjencë të pakrahasueshme etj., po për një mënyrë të shprehuri jo vetëm të saktë, jo vetëm artistikisht të goditur, por edhe model sintakse popullore, që duhet marrë si shembull.

Fjala në “Kanunin e Lekë Dukagjinit” është *gur i çmuar*, ajo nuk hidhet *pa kontroll*, përndryshe, po gabove, detyrohesh të *paguash gjobën*. Prandaj duhet të jesh i matur. *Fjala*, pra, kthehet në *gur miliar*, që tregon se nga duhet ecur, po edhe si duhet ecur. Në këtë mes ajo kthehet në një mjet të fuqishëm ekzekutiv. Forca e *fjalës* në këtë “Kanun” është mahnitëse. S’ka asgjë mangu e asgjë tepër. Ka një kursim të tejskajshëm të saj në një ndërtim konciz të përkryer e për t’u pasur zili. Idiomat këtu kthehen në aksioma, të cilat pranohen pa diskutim.

Është merita e Gjeçovit që ka ditur ta sjellë të paprekur në Kanun këtë pasuri të madhe gjuhësore.

5. Atë Shtjefën Gjeçovi ishte edhe arkeolog.¹⁸

Ai që njohës i hollë i objekteve të vjetra dhe këtë punë e kryente me pasion të veçantë. Tregojnë se në vitin 1905 arkeologu gjerman dr. Pal Traeger vizitoi Gjeçovin në Laç të Kurbinut. Në vendin e quajtur “Kodër Bogzë” atë Shtjefni kishte zbuluar një varr të lashtë e aty, ndërmjet objekteve të tjera, kishte gjetur edhe një unazë të vjetër me një mbishkrim. Gjeçovi deshi të merrte shpjegime nga arkeologu gjerman. Arkeologu i huaj nuk dha hollësi për unazën, por e çmoi atë 7 napolona flori. Thonë se Gjeçovi iu përgjegj me njëfarë

¹⁸ W. Kamsi, *Arkeologjia shqiptare dhe vepra e Atë Shtjefën Konstantin Gjeçov-Kryeziut OFM*, Gjeçovi Thesar, f. 80 v. Aty shkruhet, ndërmjet të tjerash: “I pari ndër shqiptarë që ndërmerr gjurmime arkeologjike në Shqipëri.” (f. 85).

përbuzjeje: “Unë desha me dijtë kohën e vjetërsisë, or zotni, po nuk e shes me më dhanë edhe 70 napolona”.

6. Atë Shtjefën Gjeçovi ishte atdhetar i flaktë.

Për të vërtetuar sa më lart mjafton të sjellim këtu një fragment të shkëputur nga një shkrim i atë Pashko Bardhit, bashkëvëllaut, mikut dhe shokut të tij ndër vite.

“Mbasi paten kalue Drinin, tuj kalue një prozhem, kje gjuejt me pushkë, e një plum i rá në krye afër sýnit të djathët. Atà dy vetë të pa armë, që ishin me A. Shtjefnin, iken e, mbasi ky kje rrëxue për tokë, dy gjaksit duelen mballafaqe. Ishin dy vetë veshun si ushtarë, mbas gjase, shi njatà qi i kishin çue lajmin se e thirrte prefekti. Këta, mbasi e shanë A. Gjeçov me fjalë të poshtra, qiten edhe gjashtë herë në të e lanë dekun. Këjo punë ndolli me 14 Tetuer 1929 n’oren 3 mbas mjesditet.”

Ndonësè në rrethe të Prizrenit e të Gjakovës e dijn të gjith se kush janë gjaksit e A. Shtjefnit, me gjith këta na vjen keq, pse nuk rezulton qi atyne u ka hî ferrë në kâmbë për ket punë.

Lajmi i vrasës s’ A. Shtjefnit theku zemrat e gjith Shqypetarvet, pse të gjith e paten dashtë e çmue si letrar të vjefshem e atdhetar të flakët.”¹⁹

Gjeçovi ngjason me rrapet e mëdhenj, që rriten ngadalë, jetojnë gjatë dhe nuk plaken shpejt. Sot këto lloj rrapesh i gjen vetëm ndër varreza, sepse vetëm atje kanë hapësirë të bollshme. Në zona të tjera janë zëvendësuar me “*palma*”!

David Luka

Shkodër, janar 2017

¹⁹ KLD XVI.

BIBLIOGRAFIA

- A. Busetti** = A. Busetti, *Vocabolario italiano-albanese*, Scutari d'Albania, 1911.
- Ashta K. Lek.** = Kolë Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe* I (Shkodër, 1996); II (Tiranë, 1998); III (Shkodër, 2000); IV (Shkodër, 2002); V (Shkodër, 2009); VI (Shkodër, 2011).
- Bashkimi** = *Fjaluer i Rii i Shcypes Përbâm prëie Shocniët t'Bashkimit*, Shkodër, 1908.
- Buzuku Meshari** = “Meshari” i Gjon Buzukut (1555), pjesa I, II, punuar nga E. Çabej, Tiranë, 1968.
- Campanile Introduzione** = Enrico Campanile, Bernard Comrie, Calvert Watkins, *Introduzione alla lingua e alla cultura degli Indoeuropei*, Bologna, 2005.
- Carruba Lessico indoeurop.** = Onofrio Carruba, *Il lessico indoeuropeo della famiglia*, në rev. “Ars linguistica”, Roma, 1998.
- Çabej E. SGJ** = Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore I-VII*, Prishtinë, 1975 v.
- Çabej E. SE** = Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, v. I Tiranë, 1982; v. II Tiranë, 1976; v. III Tiranë, 1987; v. IV Tiranë, 1996; v. V Tiranë, 2014; v. VI Tiranë, 2002; v. VII Tiranë, 2006.
- Demiraj AE** = Bardhyl Demiraj, *Albanische Etymologien*, Amsterdam - Atlanta, GA 1997.
- Demiraj Fé** = Bardhyl Demiraj, *Fé dhe Të prëmt e fës në Kanunin e Lekë Dukagjinit*, botuar në rev. “Hylli i dritës”, nr. 1, 2016.
- DITT Da Lecce** = Biblioteca françeskane “Át Gjergj Fishta” (Kolana e shkrimtarëve françeskanë), Át Francesco Maria da Lecce O.F.M., *Dittionario Italiano - Albanese (1702)*, Botim kritik, me hyrje dhe fjalësin shqip, përgatitur nga Gëzim Gurga, Botime Françeskane, Shkodër, 2009.

- Dizdari Fjalor** = Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005.
- E drejta zakonore** = *E drejta zakonore shqiptare I*, Tiranë, 1989.²⁰
- Fishta Anzat** = Gjergj Fishta, *Anzat e Parnasit*, Shkodër, 1942 (botim i tretë).
- Fishta Lahuta** = Gjergj Fishta, *Lahuta e Malcís*, botimi XV, Shkodër, 2006 (*Fjalori i fjalëve të rralla* 509 v.)
- Fjalë të rralla në veprën e Gjergj Fishtës “Lahuta e Malcís”**, D. Luka, SGJ XIV, f. 69 v.
- Fjalor i fjalëve të rralla, nxjerrë nga përkthimi i librit XXII të “ILIADËS” së Homerit, përkthyer nga Frano Alkaj**, D. Luka SGJ XVII 184 v.
- Fjalor i gjuhës shqipe**, Tiranë, 1954.
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe**, Tiranë, 1980.
- Fjalor i shqipes së sotme**, Tiranë, 1984.
- Fjalor i gjuhës shqipe**, Tiranë, 2006.
- Gazulli Fjalorth** = Dom Nikollë Gazulli, *Fjalorth i ri*, Tiranë, 1941.
- Gjeçovi Thesar** = Át Shtjefën Gjeçovi, *Thesar në hulumtim* (Konferencë shkencore), Botime françeskane, Shkodër, 2015.
- HD** = “Hylli i dritës”, revistë kulture shqiptare, Tiranë, nr. 1, 1993 v.
- Kanuni i Skanderbegut**, Mbledhë e kodifikue nga Dom Frano Illija, Editrice La Rosa, Milot, 1993.
- KLD** = At Shtjefën Gjeçovi, OFM, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, botimi III, Shkodër, 2010.
- Kristoforidhi Fjalor** = Kostandin Kristoforidhi, *Fjalor shqip-greqisht*, përpunuar nga A. Xhuvani, 1961.

²⁰ Për këtë vepër, etnografi prof. dr. K. Ulqini, ndërmjet të tjerash, do të shkruajë: “Rikodifikimi i lëndës së *Kanuni i Lekë Dukagjinit* i Shtjefën Gjeçovit i bërë nga Koço Nova me gjithë komentet e shpjegimet, që e shoqërojnë, ka aq të meta sa duhet konsideruar punë e dështuar.” (“Kundrime” f. 8).

Në fundin e kësaj vepre autori ka shpjeguar 334 fjalë. Mirëpo, një pjesë e madhe prej tyre i përkasin pjesës së dytë (shtojcës).

Luka Anzat = David Luka, *Fjalor i fjalëve të rralla në veprën “Anzat e Parnasit” të Gjergj Fishtës*, në vëllimin “Studime gjuhësore” IX, Shkodër, 2006 (khs. dhe HD 1-2, 2016).

Luka D. = David Luka, *Përpjesëtimi i leksikut të autorëve gegë në Fjalorin e vitit 1980 (Statistikë gjuhësore)*, në “Buletin shkencor” (Seria e shkencave shoqërore), organ i Universitetit të Shkodrës “L. Gurakuqi”, nr. 54, viti XXXIV i botimit, Shkodër, 2004. Khs. gjithashtu edhe D. Luka, *Përpjesëtimi i leksikut të autorëve gegë në Fjalorin e vitit 1980 (Statistikë gjuhësore)*, në vëll. “Studime gjuhësore” IX, Shkodër, 2006 (botim i përmirësuar).²¹

Luka D. Ndhimesa = David Luka, *Ndhimesa e Fishtës për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe*, në rev. “Studime filologjike”, nr. 1-2, 2001 (shiko gjithashtu D. Luka, *Ndhimesa e Fishtës për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe*, në vëll. “Studime gjuhësore” VII, Shkodër, 2002, punim i përmirësuar).

Luka D. Pasurimi = David Luka, *Ndhimesa e Fishtës, Koliqit dhe Camajt për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe (Statistikë gjuhësore)*, në vëll. “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, nr. 22/1, Prishtinë, 2004.

Luka D. SGJ = David Luka, *Studime gjuhësore I* (Shkodër, 1999);

II (Shkodër, 2002); III (Shkodër, 2003); IV (Shkodër, 2003);

V (Shkodër, 1999); VI (Shkodër, 2001); VII (Shkodër, 2002); VIII (Shkodër, 2003); IX (Shkodër, 2006); X (Shkodër, 2007); XI (Shkodër, 2008), XII (Shkodër,

²¹ Shënojmë se, në shkrimin e botuar në *Buletin shkencor* të sipërpërmendur, për pakujdesi të kompjuteristit (ose për ndonjë shkak tjetër teknik), numrat e shënimeve nën vijë nuk korrespondojnë me ata të tekstit, gjë që vështirëson ndjekjen e tyre sipas radhës. Në botimin e kësaj përmbledhjeje ky gabim është ndrequr. Gjithashtu janë ndrequr edhe gabimet e pasaktësitë e tjera, krahasuar me tekstin origjinal.

- 2010); XIII (Shkodër, 2011); XIV (Shkodër, 2012); XV (Shkodër, 2013); XVI (Shkodër, 2014); XVII (Shkodër, 2015); XVIII (Shkodër, 2016).
- Luka D. SHGJ** = David Luka, *Studime për historinë e gjuhës shqipe* (Vepër e zgjedhur), Botime Albanologjike, Tiranë, 2010.
- Luli F. KS** = Fran Luli, *Fjalor dhe shprehje të “Kanunit të Skënderbeut”*, Shkodër, 2005.
- Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar** (1635 - 1912), vëll. III, Tiranë, 1962.
- Meçi Mirdita** = Xhemal Meçi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit (Në Variantin e Mirditës)*, Tiranë, 2002.
- Meçi Puka** = Xhemal Meçi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit (Varianti i Pukës)*, Tiranë, 1997.
- Meyer AS** = Gustav Meyer, *Albanesische Studien*, VI, Wien, 1897.
- Meyer EW** = Gustav Meyer, *Etymologisches Wörterbuch der albane-sischen Sprache*, Strassburg, 1891 (khs. edhe përkthimin shqip: Gustav Meyer, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007).
- Nopça Shqipëria** = Franc Nopça, *Shqipëria: Fiset malësore të Shqipërisë së Veriut dhe e drejta zakonore e tyre*, Tiranë, 2013.
- Omari Marrëdhëniet** = Anila Omari, *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, Tiranë, 2012.
- Priku Vështrim** = Mimoza Priku, *Vështrim gjuhësor rreth fjalorthit të veprës ‘Kanuni i Lekë Dukagjinit’ i Shtjefën Gjeçovit*, te “Gjeçovi Thesar”, f. 94 v.
- Rrota Buzuku** = Justin Rrota, *Monumenti më i vjetri i gjuhës shqype, D. Gjon Buzuku (1555)*, Shkodër, 1938.
- SF** = revista *Studime filologjike*, organ i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë.
- Topalli Etimologji** = Kolec Topalli, *Nga vepra “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”*, SF 1-2, 2011 v.
- Topalli Sist. rasor** = Kolec Topalli, *Sistemi rasor i emrave të shqipes*, Tiranë, 2009.

- Ulqini Terma** = Kahreman Ulqini, *Terma dhe emërtime në “kanunin e Skënderbeut” dhe në “kanunin e Lekë Dukagjinit”, “Kumtari i Muzeut Popullor të Shkodrës”, nr. 2, 1974.*
- Ulqini Struktura** = Kahreman Ulqini, *Struktura e shoqërisë tradicionale shqiptare*, Shkodër, 2003.
- Ulqini Kundrime** = Kahreman Ulqini, *Kundrime etnologjike*, Shkodër, 2007.
- Ulqini Sprovë** = Kahreman Ulqini, *Sprovë për një fjalor të termave të së drejtës popullore dhe të organizimit të vjetër shoqëror, “Kundrime”.*
- Ulqini Elemente** = Kahreman Ulqini, *Elemente të së drejtës popullore në epikën heroike legjendare, “Kundrime”.*
- Ulqini Toponimet** = Kahreman Ulqini, *Toponimet Dukagjini dhe Lekë Dukagjini në një dorëshkrim të Shtjefën Gjeçovit, “Kundrime”.*
- Ulqini Qytetërim** = Kahreman Ulqini, *Qytetërim e traditë popullore në ecurinë e formimit të kombit shqiptar*, Shkodër, 2012.
- Visaret e Kombit**, *Kangë kreshnikësh dhe legjenda* (Botimi II), Mbledhë dhe redaktue nga Át Bernardin Palaj dhe Át Donat Kurti; Botime Françeskane, Shkodër, 2005.
- Xhuvani - Çabej Parashtesat** = A. Xhuvani, E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, në A. Xhuvani *Vepra I*.
- Xhuvani – Çabej Prapashtesat** = A. Xhuvani, E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962 (edhe te Xhuvani *Vepra I*).
- Xhuvani Vepra I** = Aleksandër Xhuvani, *VEPRA I*, Tiranë, 1980.
- Zingarelli Voc.** = N. Zingarelli, *Vocabolario della lingua italiana* (decima edizione), Milano, 1971.²²

²² Në bibliografinë e mësipërme qëllimisht nuk është përfshirë artikulli me titull: *Çështje gjuhësore për tekstin e veprës Kanuni i Lekë Dukagjinit*, i autores Feime Ll. Lipscomb, botuar në përmbledhjen “Kumtesat nga konferenca vjetore e shkencës ‘Java e shkencës’ 2015”, Prishtinë, 2015, f. 337 v. Artikulli në fjalë është konceptuar krejtësisht

gabim. Autorja jo vetëm është e painformuar për sa shkruan, por edhe krejtësisht e papërgatitur për t'i bërë ballë një teme të tillë. Artikulli nuk ka asnjë referencë bibliografike. Autorja shkruan se paska shfrytëzuar “të gjitha variantet e botuara të kësaj veprë”, kur dihet që *Kanuni* i Gjeçovit, pasi është botuar pjesë-pjesë në revistën “Hylli i dritës”, është botuar si vepër më vete në vitin 1933. Autorja e këtij artikulli nuk ka të qartë se Gjeçovi është mbledhësi dhe kodifikuesi i këtij Kanuni. Dhe është krejtësisht e pakuptueshme shprehja se “... autori i drejtohet shtresave të ndryshme të popullit në atë kohë”. Kur u botua Kanuni Gjeçovi nuk jetonte më. Ai kishte plot katër vjet që kishte vdekur, i vrarë pabesisht nga bandat serbe.

Botimi i një artikulli të tillë në një revistë shkencore nuk nderon as revistën, po as dy recensentët e këtij artikulli, profesorët e nderuar Fadil Raka dhe Rexhep Smajli, që kanë dhënë pëlqimin për botimin e këtij shkrimi, i cili nuk informon, por dezinformon, duke qenë në të njëjtën kohë shembull se si nuk duhet shkruar një artikull shkencor.

HYRJE

Kanuni i Lekë Dukagjinit, që paraqet strukturën e vetëqeverisjes së shqiptarëve të Veriut të vendit në mesjetën e vonë, bazohet mbi dy kode. I pari, ai ekonomiku (a materiali), ka në themelin e tij *familjen*, mbështetur te prona (*ama a plangu*) dhe që vihet në lëvizje (a zhvillohet) duke zbatuar në mënyrë rigoroze trashëgiminë në vijë mashkullore (*lisin e gjakut*), ku nuk lejohet për asnjë çast tjetërsimi i *plangut* në vijë femërore. Mbi këtë lëvizje ndërtohen nenet e Kanunit,²³ të cilat duhet të zbatohen gjithsesi në mënyrë të ndërgjegjshme. Kush kërkon të vërë në vend një padrejtësi të bërë ndaj tij, nuk duhet të përdorë në asnjë mënyrë vetëgjygjësinë. Ai do të përpiqet ta zgjidhë çështjen e vet me *pleqnitë* (gjyqet), që nisin që te plaku i pengjeve e deri te Dera e Gjomarkajve. Më përtej nuk ka. Dhe në qoftë se ndokush përpiqet t'i thyejë këto rregulla “*e bie në mend katundi*”.

Kodi i dytë është ai morali, i cili shprehet qartësisht në një kapitull të tërë dhe që shpjegon vlerën e paçmueshme që ka për shqiptarin “NDERA”.

Kanuni i Maleve të Shqypnís nuk e veçon nierin prej nierit. “Shpírt per shpírt se duken e falë Zoti”. I miri dhe i keqi kanë një çmim: Kanuni i mban per burra: “Del i miri prej të keqit e i keqi prej të mirit”. “Në kandár të vet se i cilli peshon katerqind derhêm”. N'i prekët kush kuej në nderë, peng e plak per nderë të mârrun s'ká; Kanûja thotë: në daç, fale; po deshte, laje ballin e vrugnuem.

²³ Kur fjala *Kanun* shkruhet me shkronjë të madhe përfaqëson “Kanunin e Lekë Dukagjinit”. Kur shkruhet me shkronjë të vogël flitet për *kanunet* në përgjithësi.

Nderen seicilli e ká per vedi e nuk mund t'i perzihet kush kuej as me e rrethue me pëgje e me pleq. Dy gisht nderë në lule të ballit na i njiiti Zoti i Madh.

“Ndera e mârrun gjobë nuk ká”. - Ndera e mârrun s'falet kurr.

“Ndera e mârrun nuk shperblehet me gjâ, por a me të derdhun të gjakut, a me të falun fisnikisht (permbas ndermjetsís së dashamirve të mirë).

I korituni ká deren çilë perkah ndera; peng s'shtron, pleq s'mërr, gjyq s'lypë; giobë s'mërr. - Burri i fortë e merr giobën vetë.²⁴

Në vazhdim vjen përmbyllja që shpreh qartë kodin moral të shqiptarit të asaj kohe:

“Ai, të cillit iu muer ndera, xëhet i dekun kah kanûja.”²⁵

I shkëputa këto rreshta drejtpërdrejt prej Kanunit, sepse sado që të përpiqesha, nuk do t'i sillja më qartë e më bukur se aty. E mbi të gjitha të thëna në gjuhën shqipe, tanimë nëpërmjet vetë popullit, që ka ditur ta përdorë këtë mjet mjeshtërisht për të shprehur qartë mendimet e veta.

*

* *

Ne jemi përpjekur në radhë të parë të vëmë në qendër të vëmendjes analizën e kuptimeve të fjalëve që paraqesin konceptet tradicionale shqiptare mbi familjen e farefisën, e gjithashtu të gjithë çështjeve të strukturës organizative të Kanunit, duke u munduar të zbatojmë këtu parimet bazë të etnolinguistikës. Mbi këtë bazë analizohet trashëgimia e pasur

²⁴ KLD 65.

²⁵ KLD 65.

e së drejtës popullore shqiptare e konsakruar te “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, ku familja përbën bazën e kësaj strukture. Duke qenë që rrënjët e Kanunit janë mjaft të thella, ato pasqyrojnë deri në njëfarë mase “palcën etnike të kombit shqiptar dhe të kulturës së tij” ndër shekuj. Meqë Kanuni është në të njëjtën kohë edhe një kod për rregullimin juridik të marrëdhënieve dhe sjelljeve të njerëzve në bashkësitë shoqërore, ai pa tjetër do të kishte ndikimin e vet edhe në terminologjinë e përdorur në emërtimin e këtyre marrëdhënieve. Sa kohë që në shqipe në emërtimin e familjes e të farefisit ruhet një shtresë fjalësh me prejardhje indoevropiane, tregon se familja shqiptare jo vetëm është e lashtë dhe e konsoliduar mirë, në njërën anë, por edhe e vendosur jo vetëm në zona rurale, po edhe në ato urbane, ku do të huazojë shtresën tjetër, po aq të vjetër, atë latinen, dhe ku mungon një shtresë greke me të cilën ajo nuk pati takime intensive.

Nuk është e rastit që etnografi K. Ulqini, në veprën e vet “Struktura e shoqërisë tradicionale shqiptare”, thekson se në embrionin e shoqërisë tradicionale shqiptare qëndron familja, me të cilën ai e sheh të nevojshme të nis strukturën e kësaj shoqërie.²⁶

Sh. Sejdiu vë re se “Sistemi i farefisnisë të shqiptarët ... mbështetet fort në relacione gjenetike. Sipas traditës zakonore ky sistem ndahet në dy vija apo në dy trungje: në atë të gjakut apo patrilinear dhe në atë të tamblit apo matrilinear.”²⁷ Ky përfundim duhet të merret parasysh në çdo studim që kryhet edhe mbi emrat e familjes.

Në përcaktimin e kuptimit të parë a primitiv të një termi etnografik duhet mbajtur mirë parasysh shpërbërja semantike, e cila jo rrallë formon vatra homonimike më vete, që në disa raste i shkëpusin lidhjet me primitivin e tyre. Fjalorët e gjuhës

²⁶ Kahreman Ulqini, *Struktura e shoqërisë tradicionale shqiptare*, Shkodër, 2003, f. 16.

²⁷ *Probleme ...*, po aty, f. 54.

shqipe, duke zbatuar kriteret e veta për rreshtimin e kuptimeve sipas leksemave përkatëse, nuk i pasqyrojnë këto lëvizje leksikore me rëndësi për etimologjinë. Si shembull për këtë mund të sjellim fjalën *am/ë, ~a* “nanë, nënë”. *Fjalori* 1980 nuk e regjistron fare, me gjasë duke e quajtur si fjalë krahinore, me përdorim të kufizuar, dhe e zëvendëson me trajtën e toskërishtes *ëmë-a*.²⁸ Ndërkaq regjistron rrjedhojat e *amë*: *amënor, amësi, amësor*.²⁹ Si fjalë më vete ky *Fjalor* ka rreshtuar *amë-a* me kuptimin “burim, shtrati i një rrjedhe”, duke i njohur kësaj fjale me të padrejtë shtatë kuptime, të cilat etimologjikisht shkojnë me *amë* “nanë, nënë”. Po kështu vepron edhe *fjalori* i vitit 2006.³⁰ Ndërkaq, vetë E. Çabej barazon *ëmë* me *amë* “nënë, mëmë”, duke mos lënë asnjë shteg diskutimi për pasaktësinë e mësipërme.³¹ Një pjesë të këtyre kuptimeve, Çabej i trajton si fjalë tituj, duke u dhënë shpjegim etimologjik nëpërmjet fjalës *amë*. Në të njëjtin pasaktësi ka rënë edhe *Fjalori* i vitit 1954.³² Kristoforidhi³³ veçon *amë -a* (geg.) nga *ëmë -a* (tosk.) dhe i jep si dy njësi leksikore më vete.

Në analizën semantike të fjalës *am/ë, ~a* ne kemi dalluar gjashtë grupe fjalësh³⁴, që formojnë vatra më vete, me një numër rrjedhosh, të cilat vetëm në vështrimin etimologjik ruajnë lidhjet e hershme me primitivin nga janë përfutur.

Ky proces mund të dokumentohet tani me shembuj konkretë: khs. këtu termat etnografikë të formuar mbi kuptimin e fjalës *djalë* të leksikut të përgjithshëm: *djalë* “trim në shërbim të dikujt”, *djalë mbas krenësh* “djalë që shoqëron

²⁸ *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 433.

²⁹ Po aty, f. 28.

³⁰ *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 38.

³¹ SE IV 116 v.

³² *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954, f. 8 e 111.

³³ K. Kristoforidhi, *Fjalor shqip-greqisht*, Tiranë, 1961, f. 39, 97.

³⁴ D. Luka, *Gjashtë etimologji*, në vëllimin “Studime për historinë e gjuhës shqipe” (Vepër e zgjedhur), Botime albanologjike, Tiranë, 2010, f. 428 v.

krenët në veprimtari shoqërore”, *djalë mbas vedi* “roje vetjake”, *djalë zabiti* “(Dukagjin) zaptije që shoqëronte bylykbashin në mal”, *djalë i pajtuem* “roje me pagesë”, *djelm të shkrū* “luftëtarë të paguar në shërbim të tjerëve; mercenarë”. Po kështu *grue gjynahi* “gruaja që mbahej në shtëpi pa kurorë fetare”, *grue e lidhun* “grua gjynahi”, *grue e lshueme* “grua e ndarë nga burri, e divorcuar; grua me thekë të prerë”, *grue e mbajtun mbi kunorë* “gruaja e dytë e një burri”, *grue me thekë të premë* “grua e lëshuar”, *grue e ndalun* “e veja e martuar me njërin nga meshkujt e shtëpisë së burrit të vdekur” etj. Khs. edhe: *plak kanuje*, *plak myhyri*, *plak katundi*, *plak prije*, *plak i parë*, *pleqtë e mdhaj*, *pleq të dytë*, *plak i shënu*, *pleqtë e damit*, *pleq dasije*, *pleqtë e pengut*, *pleqtë e kishës*, *pleqtë e xhamisë*.³⁵

Janë të shumta rastet kur fjalët e leksikut të shqipes e humbasin kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë dhe marrin kuptime të reja, i zgjerojnë apo ngushtojnë këto kuptime, diku-diku edhe i specializojnë ato, duke i kthyer në terma etnografikë. Khs. këtu p. sh. *zjarr-i* “shtëpi, familje”, *mik-u* “familja ose njeriu me të cilin njëra palë ka lidhur krushqí; ka dhënë ose marrë nuse” etj.³⁶

Për huazimet latine në emrat e Kanunit duhet diskutuar medoemos edhe forma e parë e fjalës së huazuar në gjuhën shqipe. Këtu latinishtja klasike të lë në rrugë, sepse dihet që pjesa më e madhe e huazimeve latine kanë hyrë në shqipe nga latinishtja vulgare e nga drejtime të ndryshme. Dihet gjithashtu që takimet e para të ilirëve me Romën (të dokumentuara këto nëpërmjet numizmatikës) kanë zënë fill rreth shek. IV para Krishtit. Ata kanë vazhduar pastaj gjatë luftrave iliro-romake dhe janë shpeshtuar pas pushtimit të

³⁵ K. Ulqini *Terma* 153.

³⁶ Khs. *plak* “i moshuar” me *plak* “i pari i lagjes”; *mal* “vend i lartë” me *mal* “lidhje bashkësisht”; *krye* “kokë” me *krye* “i pari i katundit”; *bark* “pjesë e trupit të njeriut” me *bark* “degëzim i vëllazënisë” (K. Ulqini, *Sprovë*, “Kundrime” 65).

Ilirisë nga Roma. Veçse këtu duhen dalluar dy periudha. E para, që nis rreth shek. IV-I para Krishtit dhe tjetra nga shek. I-IV pas Krishtit. Në ndihmë të këtij periodizimi vjen fonetika historike e shqipes. Dihet se te elementet latine dallohen dy palë reflekse, ato të trashëgimisë indoevropiane (pra huazimet latine pësojnë të njëjtat ndërrime si elementi i trashëguar) dhe, së dyti, ndërrime të reja që u përkasin vetëm huazimeve latine.³⁷

Duhet shënuar gjithashtu se huazimet latine kanë hyrë me shumicë në shqipe pikërisht në kohën e formimit të kësaj gjuhe, në njërën anë, por edhe në kohën e pranimit të kristianizmit si fe e re në ato troje, që padyshim do të sillte jo vetëm koncepte e mendësi të reja, po njëkohësisht edhe marrëdhënie të reja familjare, të sanksionuara tani edhe nga kisha kristiane, e që do të pasqyroheshin pa asnjë dyshim në terminologjinë etnografike të asaj kohe.

Ne kemi shprehur mendimin që “Shqipja u formua si gjuhë ‘bijë’ nga ‘nëna’ e saj ilirishtja në të njëjtat treva në shek. I-IV të erës sonë. Gjatë kësaj periudhe ajo përvijoi tiparet gjuhësore, duke trashëguar nga të gjitha nënsistemet e nënës së saj ilirishte, por duke formuar në të njëjtën kohë edhe tipare të reja që e bënë të dallohet nga ajo. Kushtet historike të asaj kohe (pushtimi romak e në vazhdim dyndjet barbare) e përshpejtuan këtë formim. Në mesjetën e hershme shqipja u fut pak a shumë e kristalizuar në tiparet themelore të saj.”³⁸ Ky përfundim tani ka vlerë edhe për huazimet latine të hyra në këtë kohë nga latinishtja vulgare në shqipe.

Për analizën gjuhësore të këtyre huazimeve latine, që shprehin terma etnografikë, duhet mbajtur parasysh pohimi i mprehtë i E. Çabejt: “Vetëm me anë të një krahasimi midis rumanishtes dhe shqipes arrihet të rindërtohen prej latinishtes

³⁷ Hollësi të mëtejshme te Luka *Stud. gjuh.* V 166 v. me gjithë bibliografi.

³⁸ D. Luka, *Stud. gjuh.* V, Shkodër, 1999, f. 176.

vulgare, populllore, disa trajta e kuptime fjalësh ... që janë vetëm të rumanishtes e të shqipes ...”³⁹

Na ngjan që, për të qenë krejtësisht të sigurt për refleksin e huazimeve të vjetra latine në shqipe, duhet njohur medoemos trajta e parë e tyre në latinishten vulgare. Tashmë dihet që huazimet latine të shqipes paraqesin dy tipe karakteristikash, atyre të Lindjes dhe atyre të Perëndimit. Kënde, vetëm krahasimi me përgjegjëset e tyre në rumanishten, nuk do ta zgjidhte përfundimisht këtë çështje. Do të ishte e nevojshme, pra, të kishim edhe për shqipen listën e trajtave të vjetra, nga të cilat u huazuan këto fjalë të latinishtes.

Ndërkaq duhet vënë re se në kohën e hyrjes së këtyre huazime latine në gjuhën shqipe, kishin nisur edhe në vetë latinishten (vulgare) ndryshime në përbërjen fonetike të tyre, në krahasim me atë klasiken. Për këtë po shkëpusim një shembull nga fjalori.

Dukuria fonetike *i > e* (khs. lat. *viridis viridis* : shq. *i verdhë* etj., por edhe lat. *fides* : shq. *fë*, lat. *vitium* : shq. *ves* etj.), nuk është zbatuar te lat. *virginem*. K. Topalli⁴⁰ mendon se ky shndërrim fonetik nuk i përket shqipes, por është veçori e latinishtes vulgare. Sipas Topallit, shqipja i mori këto fjalë nga një idiomë latine, ku /i/-ja e shkurtër kishte kaluar në zanoren /e/, ose kishte filluar hapjen e saj drejt kësaj zanoreje. Në të mirë të vërtetimit të mendimit të vet, ai sjell faktin që /e/ e dalë nga një /i/ e shkurtër e latinishtes vulgare nuk është diftonguar në shqipe në /je/, ashtu siç ka ndodhur me /e/-në e shkurtër të trashëguar.

Në qoftë se Topalli ka të drejtë, atëherë për fjalën shqipe *virgjen* duhet vendosur një bazë **vérgin-* nga një fjalë e latinishtes mesjetare **verginem*.

Huazimi i termave etnografikë, kryesisht ato që kanë lidhje me familjen e farefisins, nuk është i rastësishëm. Përveç modës (në shqipen e asaj kohe huazohen me shumicë edhe

³⁹ E. Çabej, *Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe*, “Studime gjuhësore” IV, Prishtinë, 1977, f. 262.

⁴⁰ *Sist. zanor* 59 v.

emra njerëzish), duke qenë latinishtja për një kohë të gjatë gjuhë kulture e administrate, shkak për këto huazime duhet të kenë qenë edhe konceptet e reja të këtyre marrëdhënieve farefisnore, të huazuara nga latinët. Por ajo që ka rëndësi është të shënohet se marrëdhëniet e vjetra farefisnore, të konsakruara tani në termat e trashëguara, që ruhen të paprekura që nga lashtësia indoevropiane, tregon se e drejta popullore shqiptare mbeti në thelbin e vet e pacenuar e origjinale. Kjo mbase ishte edhe një ndër shkaqet e mbijetesës së këtij populli të vogël po të lashtë, përballë fqinjëve të vet si rumunët, të cilët e humbën në vazhde të kohëve gjuhën amtare duke e zëvendësuar atë me latinishten.

Sistemi i këtyre normave morale u kristalizua përfundimisht edhe në norma me karakter juridik, norma të pashkruara që transmetoheshin brez pas brezi në trajtën e dokeve, të pasqyruara tani në Kanunin e Lekë Dukagjinit (në të gjitha variantet e tij). Natyrisht këto norma do të konkretizoheshin pa asnjë dyshim me terma etnografikë, duke u trashëguar në vazhden e kohëve.

Ardhja e sllavëve në trojet shqiptare e gjeti të përfunduar këtë proces. Vetëm kështu mund të shpjegohet që ndikimi i sllavishtes në emrat e familjes e të farefisit është i papërfillshëm, për të mos thënë baras me zero.

*

* *

Përcaktimi i vjetërsisë së Kanunit kushtëzohet edhe nga emërtimi: “(Kanuni) i Lekë Dukagjinit”, pra ai duhet të ketë vepruar në kohën kur ka jetuar Lekë Dukagjini. Mirëpo, shumë elemente, që pasqyrohen në të, tregojnë se ky Kanun ka në nenet e veta elemente shumë më të vjetra se kjo kohë. Kanuni pa asnjë dyshim trashëgon jo vetëm doke të vjetra, por edhe fjalë-terma që lidhen me një strukturë administrative të mëhershme, duke nisur që nga lashtësia e deri te administrata e sllavëve të Stefan Dushanit.

Duke gjykuar për emrat e familjes e të farefisit, edhe këto pjesë e terminologjisë të së drejtës popullore shqiptare, kemi arritur në tri përfundime kryesore, të cilat kanë vlerë edhe për trajtimin e termave të Kanunit.

Së pari, në sistemin e emërtimeve të farefisnisë, institucioni i familjes ka qenë i formuar mjaft herët e krahas me të gjithë popujt e tjerë indoevropianë. Specifika e këtij procesi të shqiptarët është se emërtimet më të afërta, ato që shënojnë thelbin e familjes (*atë, amë - ëmë, bir - bijë, vëlla - motër, djalë - vajzë*) janë me burim indoevropian.

Së dyti, huazimet latine në këtë sistem nomenklature i përkasin një kohe më të vonë, ato nuk e zëvendësojnë, por në shumicën e rasteve e pasurojnë atë, duke pasqyruar marrëdhëniet e reja, të krijuara gjatë pushtimit romak.

Pas kësaj kohe gjithçka paraqitet e konsoliduar dhe huazimet e mëvonshme ose nuk pasqyrohen fare në të (huazimet sllave), ose prekin sfera anësore të kësaj nomenklature (huazimet turke).

Së treti, shqiptarët e vazhdojnë jetën e tyre familjare në mënyrë aktive, duke krijuar tani edhe marrëdhënie të reja, që padyshim gjejnë pasqyrim edhe në emërtimet e reja etnografike, të formuara brenda sistemit të gjuhës shqipe e me mjetet e tij, duke pasuruar kështu terminologjinë e familjes, të rrethit familjar e të farefisit.

Ne do të ndalemi dhe të analizojmë në mënyrë shteruese historinë e disa prej huazimeve latine, të cilat pasqyrohen në Kanun. Kalimi i këtyre huazimeve si terma, duke u përfshirë në ritet familjare, tregon se kemi të bëjmë me një zanafillë të hershme të këtij Kanuni, e mbase i asaj kohe kur elementet e huazuara të latinishtes vulgare bëhen edhe fjalë-terma të së drejtës popullore shqiptare.

famull,~i “1. Fëmija që pagëzohej, që qethej a që krezmohej nga nuni...” (*Fjalor* 1980, f. 449). Ky *Fjalor* e jep këtë fjalë si të vjetruar. Aty edhe përdorimi i saj krahinor

“fëmijë i vogël, foshnjë”. Gjithashtu edhe rrjedhojat *famullesh/ë, ~a, famullí, ~a* “njësia më e vogël e organizimit kishtar në një krahinë...”, *famullitar, ~i* “prifti i një famullie”, *famullitar, ~e* “që ka të bëjë me famullinë a me famullitarin...”, *famullor, ~e* “famullitar”. Te Bashkimi 14: *famull, famulleshë, famullí, famullitār*.

Në të folmen e arbëreshëve të Qanës *famull-i* dhe *famullë-a* “famulleshë” (DSH VI 462). Në Falconara Albanese *famul-a* (Camaj 127). Në fjalorin e Da Lecces 671 *famull, fambull, fambullí*.

Në të folmen e Shalës së Bajgorës *famull-i* “fëmija të cilit i bëhet dikush nun ose edhe i posalindur” (Mulaku 160).

Fjala dikur duhet të ketë qenë e mbarë shqipes, sa kohë që ajo, duke qenë e përdorimit të ritit kristian, dëgjohet edhe në Kosovë, duke ndërruar edhe kuptimin primitiv të saj.

E. Çabej mendon se kjo fjalë del për herë të parë te Budi. Po ajo regjistrohët më parë edhe te Buzuku *famull-i* lat. *famulus*, me shpjegimin e K. Ashtës (Lek. I 305) “Buzuku nuk e ka për fëmijën e mbajtur në pagëzim, por për të gjithë pjesëtarët, që i përkasin rrethit të një shërbimi fetar, të një famullitari”, khs. *të gjithë famujet tuve; Meshari IX/2, 13*. Aty edhe *famullí-a* “rrethi i shërbimit fetar të një prifti, por Buzuku e merr si emër të përbashkët për njerëzit, që përfshin ai rreth” (Ashta Lek. I 305); khs. *Zotynë erdh me pām famullinë e vet, Meshari LVIII/1, 181* “Deus visitavit plebem suam” Luca VII, 16.

Te Bogdani del trajta *fambullí-a* (Ashta Lek. IV 167).

Mendimi i përgjithshëm, që zotëron deri më tani, është se *famull-i* i shqipes është huazuar nga lat. *famulus* (khs. G. Meyer EW 99; E. Çabej SE IV 133 me gjithë bibliografi).

krushk, ~u “1. Babai i nuses a secili nga të afërmit e saj ... 2. Secili nga të afërmit e miqtë e dhëndrit që shkojnë së bashku për të marrë nusen” (Fjalor 1980, f. 892). Aty edhe rrjedhojat *krushkamadh, ~i, krushkapar/ë, ~i* “ai që u prin krushqve ...”, *krushk/ë, ~a* “1. Nëna e nuses ... 2. Secila nga dasmoret që

shkojnë së bashku për të marrë nusen ...”, *krushkohem* “bëj krushqi me dikë ...”, *krushk/oj* “bëj krushqi me dikë ...” *krushqar*, ~i “mbles, lajmës”, *krushqí*, ~a “1. Marrëdhënie shoqërore e afërt pa lidhje gjaku, që krijohet ndërmjet dy familjeve kur bëjnë një martesë ...”

Fjalë e mbarë gjuhës. Del së pari te Budi *krushqí-a* “lidhje me anë martese” *mā asndōnjē krushqī s munē banjēnē* R 39 (Ashta Lek. II 221). Te Bogdani (*me*) *krushquem* “lidh krushqi” *hijnē me u krushquem me Kainitat* I I, VII, 7 “cominciarono a parentaro con in Cainiti” (Ashta Lek. IV 218). Te *Kuvendi i Arbënit krushqí-a* me shënimin e K. Ashtës “Krushk është i ati a një nga rrethi i burrit a i nuses në lidhje me anën tjetër, kurse derivati nga shumësi *krushq + i* do të thotë lidhje me anë martese. Për lat. *matrimonium* “*krushqija*” (BSHSH 2, 1979, f. 65). Në të folmen e arbëreshëve të Ejaninës *krushk-u* “prindi i nuses”, *krushkohem* “lidhem me krushqi”, *krushqí-a* “krushqi” (*Trimi e kopilja bën krushqin prëm*) DSH VI 411. Te fjalori i Da Lecces 710 dalin *krushk* “parente per matrimonio”, *krushqí*, (*me*) *krushquem*, (*me u*) *krushquem*. Te *Fjalori arb.-shqip* i K. Kamsit 131 *krushk-u*, *krushqí-a* “martesë, dasmë, krushqí”, *krushqonj* “bëj krushqi”. Te Bashkimi 209 dalin emrat *krushk* e *krushkë* dhe folja *krushkohem*.

G. Meyeri (EW 207) e bie nga lat. *consocer*, por me ndërmjetësinë e një trajte *kuškr* (ruman. *cuscru cuscră*).

Zhvillimi nga *consócer* në *krushk* të shqipes paraqet një numër problemesh që duhen shpjeguar nëpërmjet fonetikës historike të shqipes. Së pari është zhvendosja e theksit në rrokjen e parë të fjala e shqipes. Po që të saktësohet kjo dukuri, duhet pranuar që ky huazim paraqitet i vjetër, atëherë kur shqipja (përk. ilirishtja) e asaj kohe ruante ende theksin në rrokjen e parë të fjalës (khs. Topallin *Diftongjet* 200, 230 v.) Ndryshe nuk mund të shpjegohet një rrudhje e dy zanoreve njëra pas tjetrës nën veprimin e lëvizjes së theksit. Pra *consócer* > **cónsocer* > **kónsokër* > **kónshëkr* > **kóshkr*. Këtë rrjedhë e përligj rumanishtja *cuscru cuscră*. Për shqipen mbetet për t’u shpjeguar si kapërcej *r*-ja nga fundi i fjalës në ballë të saj.

Mbase kemi këtu ndonjë shtrembërim të zakonshëm të fjalës latine, gjithsesi e shqiptuar sipas gjedhes së gjuhës shqipe të atëhershme. K. Topalli (*Sist. bashk.* 87) mendon se tingulli *r* ka lëvizur në drejtim të ballit të fjalës si një anticipim (tërheqje) e tij në drejtim të kundërt. Për të vërtetuar mendimin e vet ai sjell një numër shembujsh, duke përfshirë këtu edhe *krushk* të shqipes nga lat. *consocer*, krahasuar me rum. *cuscu*.

Problemi i dytë është refleksi *o : u* në ballë të fjalës. Topalli (*Sist. zanor* 54, me gjithë literaturën përkatëse) shënon se “Kthimi i zanores /o/ në /u/ gjendet edhe në huazimet e vjetra të shqipes nga greqishtja e latinishtja”, e këtu ai rreshton edhe *krushk* < *consocer*.

Duke gjykuar për karakteristikat e huazimeve latine të shqipes, E. Çabej shkruan “Vetëm me anë të një krahasimi midis rumanishtes dhe shqipes arrihet të rindërtohen për latinishten vulgare, populllore, disa trajta e kuptime fjalësh ...” (SGJ IV 262). “Vetëm për këto dy gjuhë do të pranohet një bazë latine *cónsocer* (rum. *cuscu* shq. *krushk*) përkundrejt bazës *consócer* të gjuhëve të tjera, duke përfshirë aty edhe dalmatishten” (po aty, f. 262).

Në SE V 148 E. Çabej do të shkruajë: “Nga lat. *consocer*, nëpër një shkallë **kushkr* : rum. *cuscu* fem. *cuscră*, dalm. *consegro* etj.” Në vazhdim: “Për shqipen e për rumanishten duhet nisur nga *cónsocer* e lat. ballkanike, për gjuhët romane perëndimorë nga *consócer*.”

Ndërkaq, do të paraqiste interes hulumtimi për të gjetur trajtën e parë të fjalës, atë të një latinishteje vulgare që të kishte vlerë vetëm për shqipen.

kumbar/ë, ~a “1. Ai që merrej si dëshmitar në kurorëzimin e një çifti të ri ... 2. ... nun” (*Fjalor* 1980, f. 912). Aty edhe trajta tjetër *kumbar, ~i*, së bashku me rrjedhojat *kumbari, ~a* “1. Të qenët kumbar ...”, *kumbarisem, kumbarohem* “bëhem kumbarë me dikë ...” Të gjitha fjalët e sipërme kanë shënimin “etnografike”, gjithsesi pra janë fjalë relativisht të vjetra, që lidhen me rite të ndryshme të jetës shoqërore të shqiptarit.

Kjo trajtë del për herë të parë te *Kuvendi i Arbënit* “*kumbar-i*”, e shpjeguar nga K. Ashta (BSHSH 2, 1979, f. 66) prej lat. *compater* (*com pater*), që fjalë për fjalë do të thotë “bashkë me të jatin”. Te *Kuvendi i Arbënit* fjalët *kumbári* e *kumtëri*, kanë një etimologji, janë sinonime në mes tyre, shkruhen në forma të ndryshme “*kumbári ndo kumtëri*” 104, “*e kumparëvet*” 41, “*kompar*” 40.

Në të drejtën popullore shqiptare del kjo fjalë te Kanuni i Lekë Dukagjinit (varianti i Pukës) *kumbari-a* “lidhjet me ritin e kumbarisë me ‘marrjen’ (prerjen) e flokëve” (Meçi 255). Në të folmen e Reç-e-Dardhës së Dibrës *kumār-a* “personi që mban nusen për krahu kur vjen në shtëpi të burrit ditën e martesës” (SF 1, 1965, f. 87).

Në *Fjalorin* e Marko Boçarit del *kumbarë* (HD 3-4, 1996, f. 56). Te arbëreshët e Italisë del trajta *kumpar-i* “kumbarë” (Kamsi *Fjalor arb.-shqip* 134), ngjan fjalë e ndikuar drejtpërdrejt nga italishtja. (Khs. edhe *kumbar-i* te arbëreshët e Kozencës, Camaj *Falconara* 133). Te fjalori i Da Lecces 712 del *kumbār* “compare”, por edhe *kumtër* me të njëjtin kuptim. Te fjalori i Bashkimit 215 dalin emrat *kumar* “compare” dhe *kumarī*.

Kumbarë e shqipes është huazim i ri nga ital. *compare* “1. nun (në pagëzim e në krezmim); kumbarë (në kurorëzim) ...” (*Fjalor it.-shqip* 235). Khs. edhe greq. e re *κουμπάρος* me të cilën shpjegohet trajta e toskërishtes *kumbare-ja*. Khs. edhe G. Meyerin EW 214; gjithashtu E. Çabejn SE V 167.

Kemi dy fjalë të shqipes që vijnë nga një burim roman, së pari *kumtër* nga latinishtja *compater*, e më pas tjetra *kumbarë*, me burim më të vonë.

Edhe te trajta e vonë *kumbarë* duhet të shqyrtohet përse o-ja e ballit të fjalës u ndërrua në *a*; mos paraqet kjo një ndikim të trajtës *kumtër*, apo ndoshta është dukuri edhe e disa huazimeve të vjetra italiane khs. lat. *spodium* shq. *shpuzë*, lat. *ordinem* shq. *urdhër* etj.

kunat, ~i “1. vëllai i gruas (për burrin) ose burri i motrës (për vëllanë e saj) ...” (*Fjalor* 1980, f. 913). Aty edhe rrjedhojat *kunat/ë, ~a, kunatoll, ~i* “kunat”, *kunatoll/e, ~ja* “kunatë”.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del që te Buzuku *kunatë-a* lat. *cognata* (*Elizabeta jot kunatë; Meshari* XIV/2, 33) = “Elizabeth cognata tua” Luca I, 36 (Ashta Lek. I 352). Te Bardhi *kunatë-a* lat. *cognata* “fratria: *kunata*” 27, “fratria soror mariti: *kunata*” 195 (Ashta Lek. III 172). Te Bogdani *kunatë-a* lat. *cognata* (“*kunatët*”) I I, VI, 22 (Ashta Lek. IV 222).

Në “Fjalorin italisht-kroatisht-greqisht-shqip-turqisht” të Julije Bullatoviqit, viti 1693 (HD nr. 5-6, 1994, f. 98), del “Cognato : Cognato “Kunati”; khs edhe Kastrati *Albanologjia* 138.

Në “Fjalorin italisht-shqip” (“*Dizionario Italiano d’Albanese*”) të vitit 1710, që ruhet në manastirin e Grottaferratës nën shenjën *Zoccolanti* 425, fjalët italishte *Cognato* e *Cognata* përkthehen në shqipe përkat. *Cunat* e *Cunata* (f. 7 e origjinalit).

Në *Fjalorin* e Marko Boçarit (HD 5-6, f. 96) jepet togfjalëshi /lotë/ *kunati* (δακρυ κουνιάτου).

Te arbëreshët e Italisë *kunat-i, kunatëz, (i) kunati* (Kamsi *Fjalor arb.-shqip* 134). Në të folmen e Kozencës *kunatë-a* (Camaj *Falconara* 133). Në të folmen e arbëreshëve të Ejaninës *kunāt-a* e *kunatërisht* “në mënyrën e kunatave” (DSH VI 412). Te fjalori i Da Lecces 712 krahas *kunat-i* “cognato”, del edhe *kunatë* “cognata”. Te Bashkimi 216 regjistrohen: *kunat* “cognato”, *kunatë* dhe *kunetī-a* i përdorur në numrin njëjës.

Pranohet përgjithësisht se *kunat* i shqipes është huazuar nga lat. *cognatus* (khs. G. Meyer EW 214; E. Çabej SE V 170). Kjo fjalë paraqet interes edhe për të përcaktuar më qartë rrugën që kanë ndjekë huazimet latine deri sa janë bërë pronë e shqipes, si edhe kohën kur kanë hyrë në gjuhën tonë.

Takimet e para të ilirëve me Romën (të dokumentuara këto nëpërmjet numizmatikës) kanë zënë fill rreth shek. IV para Krishtit. Ata kanë vazhduar pastaj gjatë luftërave iliro-romake dhe janë shpeshuar pas pushtimit të Ilirisë nga Roma.

Veçse këtu duhen dalluar dy periudha. E para, që nis rreth shek. IV-I para Krishtit dhe tjetra nga shek. I-IV pas Krishtit. Në ndihmë të këtij periodizimi vjen fonetika historike e shqipes. Dihet se te elementet latine dallohen dy palë reflekse, ato të trashëgimisë indoevropiane (pra huazimet latine pësojnë të njëjtat ndërrime si elementi i trashëguar) dhe, së dyti, ndërrime të reja që u përkasin vetëm huazimeve latine (hollësi të mëtejshme te Luka *Stud. gjuh.* V 166 v. me gjithë bibliografi).

Te huazimi *kunat* vërehen tani këto dukuri:

Së pari, *ā*-ja (e gjatë) e lat. *cognātus* nuk është reflektuar te fjala e shqipes *o* (khs. p.sh. lat. *trādere* > shq. *truaj* etj.) Sipas K. Topallit (*Sist. zanor* 69) *cognātus* “duket se përfaqëson një shtresë më të vonë, ku /*ā*/-ja e gjatë është ruajtur e pandryshuar”. Këtu është vendi për të përmendur konstatimin e njohur se gjatësia klasike e zanoreve në vetë latinishten ishte në shuarje e sipër në shekullin e parë të erës sonë. Pra, kur fjala latine *cognātus* u huazua në shqipe, ajo nuk e kishte (përkatare e kishte humbur) gjatësinë e *a*-së.

Së dyti, te lat. *cognātus* nuk kemi lëvizje theksi në ballë të fjalës, ashtu siç ngjet te huazimet e tjera latine *consócer* (përkatare. *cónsocer*) > *krushk*; *compáter* (përkatare. *cómpater*) > *kúmtër* etj. Pra, ky huazim nuk mund të jetë i vjetër, dhe jo i një kohe me të sipërmit (shiko te *krushk* e te *kúmtër*).

Së treti, te *kunat* *o*-ja e fjalës lat. *cognātus* është reflektuar në shqipe *u*. Mirëpo dihet se “Kthimi i zanores /*o*/ në /*u*/ gjendet edhe në huazimet e vjetra të shqipes nga greqishtja e latinishtja” (shiko te *krushk*).

Së katërti, metafoia *kunat kunet* (kjo *kunet* te arbëreshët e Italisë, sipas Topallit *Sist. zanor* 138), khs. edhe *kunat* : sh. *kunetër*. Ne kemi arritur në përfundimin se metafoia shfaqet gjithsesi në fjalët vendëse të vjetra, ndër huazimet nga greq. e vjetër dhe ndër shtresat më të vjetra (koha pagane) të huazimeve latine të shqipes. Ndër këto raste ka karakter të mirëfilltë. Më tej, duke nisur te shtresa më e vonë e huazimeve latine (koha kristiane) e në vazhdim, ajo ka karakter analogjik,

sekondar (Luka *Stud. gjuh.* V 52). Te *kunat kunet* (përkat. *cognātus*) mungojnë kushtet fonetike për një metaforë të mirëfilltë (përkat. *-ī-ja* e gjatë e shumësit), prandaj kemi këtu rastin e metaforës me analogji.

Tani, dy rastet e para ($\bar{a} > a$; mungesa e zhvendosjes së theksit) flasin për një huazim të ri të fjalës shqipe *kunat*. Dy rastet e tjera (kthimi /o/ në /u/ dhe metafora $a : e$) flasin për të kundërtën, që *kunat* është e vjetër. Kjo kontradiktë mund të sheshohet vetëm po të pranohet se *kunat* i përket shtresës së dytë të huazimeve latine të shqipes. Sa më lart vërtetohet me evoluimin⁴¹ e kuptimit të *cognatus* “farefis” në lat. klasike, tani edhe “*kunat*” në atë vulgare (khs. ital. *cognato*, spanj. *cunado*, ruman. *cumnat*, shq. *kunat*.)

kushëri, ~ri “1. Djali i xhaxhait, i dajës, i tezes a i hallës ...” (*Fjalor* 1980, f. 928). Aty edhe rrjedhojat *kushrini, ~a* “1. Kushërinjtë ...”, *kushërir/ë~a* “vajza e xhaxhait, e dajës ...”.

Fjalë mbarë gjuhës. Del te Bardhi *kushëri-ni* lat. *consobrinus* “consobrinus, cugino: *kushëri*” 15; “consobrinus, cugino, amuga: *kushëri*” 194; “sobrini: *kushërinj*” 154 (Ashta Lek. III 174 v.). Aty edhe *kushërinë-a* “consobrina, cugina: *kushërina*” 105 (po aty, f. 175). Te Bogdani *kushëri-ni* lat. *consobrinus* “po *bâheshin* (grafik. *banhescine*) do darsmë ndër disa (grafik. *ditso*:

⁴¹ “Il primo è che per certi termini, che hanno significati diversi nelle lingue storicamente attestate, è difficile fissare un significato univoco e preciso a livello d’indoeuropeo; il secondo è che anche i termini di parentela sono soggetti e innovazioni semantiche e formali. Il lat. *cognatus* “consanguineo” sopravvive, sì, nelle lingue romanze, ma con un nuovo significato (innovazione semantica), e in varie lingue celtiche moderne le parentele acquisite per matrimonio sono espresse ormai secondo moduli francesi o inglesi: bret. *tad-kaer* “suocero” calcolato su fr. *beau-père* e gall. *tad-ynghyfraith* calcolato su ingl. *father-in-law* (che, a lora volta, innovano rispetto al. lat. *socer* e all’aingl. *swéor* che continuano l’i.e. **sweKuros*)”, sa më lart te E. Campanile, B. Comrie, C. Watkins *Introduzione* Bologna 2005, f.21.

dissa) kushërinj” II II, I, 15; “*u mbëlodhnë pra gjithë të kushërijt*” II I, II, 16 (Ashta Lek. IV 225).

Në “Fjalorin italisht-kroatisht-greqisht-shqip-turqisht” të Julije Bullatoviqit, viti 1693 (HD nr. 5-6, 1994, f. 98), del “Zerman: Kuscerin “kushëri”; khs edhe Kastrati *Albanologjia* 138. Te fjalori i Da Lecces krahas *kushri*, del edhe *kushërinë* “cugina e cugino”.

Te fjalori i Bashkimit 220 dalin emrat *kushrri* e fem. *kushrinë* si edhe tjetra *kushrinë*.

Ndër të folmet krahinore, te Kanuni i Lekë Dukagjinit (varianti i Pukës) *kushrinë* “të gjithë ata që janë kushërinj nga baba” Në *kushrinë* je në shpë tande (Meçi 255). Te *Fjalori arb.-shqip* i K. Kamsit 137 *kushëri-ri*, *kushëri-u*, *kushërir/ë-a*. Po kështu në krahinën e Kozencës *kushri-ri* (Camaj *Falconara* 133). Del kjo fjalë (*kushëri-u*) edhe në të folmen shqipe të Mandricës (Bullgari) SF 2 1965, f. 162.

Për fjalën shqipe *kushëri* përgjithësisht pranohet rrjedha latine *consobrinus*.

Edhe te ky huazim shtrohen disa probleme të natyrës së fonetikës historike, që kërkojnë shpjegim. Së pari rënia e *b*-së e ndodhur në trup të fjalës. Sipas Topallit, ajo ka rënë “kur ka qenë në trup të fjalës në një grup bashkëtingëllor me një lëngëzore” (aty edhe *kushëri-ri* nga lat. *consobrinus*, *Mbylltoret* 184). Më saktë “grupi me një buzore të zëshme (/br/), në një rrokje të theksuar jonistore, domethënë në fjalë me përbërje jambi a anapesti, është thjeshtuar, duke rënë buzorja” (khs. *kushëri* nga lat. *consobrinus*, *Mbylltoret* 193).

Në grupi /ns/, me spirante të trashëguar, ka rënë hundorja dhe është ruajtur spirantja, e cila ashtu si në rastet e tjera, është kthyer në /sh/, duke vepruar dukuria edhe kur grupi bashkëtingëllor ka qenë në pozicion paratheksor (Topalli *Sonantet* 119). Ndërkaq, mungesa e hundorëzimit te grupi i ballit /-on/ (përkth. *consobrinus*) mund të shpjegohet në kohë, në atë mënyrë që /n/-ja të ketë rënë para se të niste ky proces, i cili pengoi hapjen e /-on/ në diftongun /ua/.

Jemi, pra, para ndërrimeve fonetike të shumta brenda një fjale të vetme, e të vështira për t'u përcaktuar në kohë. Khs. këtu *consobrín/us* > **consobrín-* > **consorín-* > **cosorín-* > **cosërir-* > *kushëri/n/r/-* > *kushëri/i/*. Ndërrimet fonetike sipas radhës: /br/ > /r/, /ns/ > /s/, /o/ > /ë/, /s/ > /sh/, /o/ nistore > /u/, /n/ > /r/.

Në këtë situatë, është vështirë të mendohet një kalim nga lat. *consobrīnus* në *kushëri*, qoftë edhe duke u përligjur në kohë ndërrimet përkatëse të rreshtuara më lart. Na ngjan që për shumë huazime të shqipes nga latinishtja duhet hetuar medoemos trajta e tyre në latinishten vulgare, bazë nga e cila duhet nisur për të shpjeguar prejardhjen e saktë të fjalëve të shqipes. Kjo edhe pse për vetë italishten paraqitet problematike. Khs. ital. *cugino* “figlio d’uno zio o d’una zia” (*cusinus* nel lat. mediev. di Farfa del 1003). Fr. ant. *cosin* (1080), che rissale, attrav. deform. non del, tutto chiarite, al lat. *consobrīnu(m)*, comp. di *con-* e *sobrīnus* “cugino” (der di *sōror* “sorella”) (*Dizionario etim.* 304). Khs, edhe frëngj. *cousin* lat. *co(n)sobrīnus* (Bloch-Wartburg *Dict. Étym.* 165).

E. Çabej SE V 183 do të shkruajë: “Nga lat. *consobrinus*, që rron në një varg gjuhësh romane ... Fem. *kushërirë kushërinë* më fort se lat. *consobrina* është një formim i brendshëm i shqipes.

mik,~u “5. ... *etnogr.* Secili nga meshkujt e familjes së nuses (babai, vëllai etj.) kundrejt njerëzve të dhëndrit ...” (*Fjalor* 1980, f. 1136). Kësaj fjale në këtë *Fjalor* i njihen 10 kuptime e përdorime të ndryshme. Aty edhe rrjedhojat *mik/e,~ja* “femërore e mik”, *mikesh/ë,~a* “femërore e mik”, *mikpremj/e,~a* “mikprerje”, *mikprer/ë,~i* “ai të cilit i është prerë miku në besë”, *mikprerj/e,~a* “prerja e mikut në besë”, *mikpritës,~e* “1. Që pret me bujari miq ...”, *mikpritj/e,~a* “të qenët mikpritës”. A. Xhuvani (SF 2, 1974, f. 169) regjistron edhe një *miknjerëzi-a* “φιλανθρωπία”.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del së pari te Buzuku *mik-u* lat. *amicus* (“miqt e mī e fqinjëtë e mī ù afruon”, Meshari XVI/4, 43

“amici mei appropinquaverunt” *Psalmus* XXXVII 12). K. Ashta (Lek. I 377) shënon: “Budi përdor dhanoren e vjetër e *rekumandoj ... posi miqet i dashunë*” *Speculum* Parathënia 7. Bardhi e ka huazimin latinisht dhe italisht “*amic o mik*” 4. Te Bogdani shkruhet me fenomenin e kushtëzuar *q : j* “për të nderunë e grishunë mijtë” II II, V, 29. Te Kuvendi i Arbënit e gjejmë me një kallëzore të vjetër “*engrite miknë tand*” 70. Aty edhe *mikeshë-a* “*grëshet mikeshatë e fqinjëtë*”, *Meshari* LXXIV/1, 281 “convocat amikas vicinas” *Luca* XV, 9, me shënimin e K. Ashtës: “Ky trajtim fjale gjendet edhe ndër të tjerë si Budi, por te ky me kuptimin e njëres që e don një burrë pa e pasur bashkëshort “*a mos kishnje mbajtunë o mba tashti kund ndonja mikeshë o të dashunë*”, *Speculum* 128 (Ashta, po aty, f. 378).

Te Budi *mik-u* lat. *amicus* “(asht) *miku e ndima jote* (grafik. *mikuendimajote*)” R 74; *mikeshë-a* e *miqësi-a* lat. *amicus* “mik” me shënimin e K. Ashtës (Lek. II 239): “Formohet nga shumësi *miq + sí, të ja banjë* (grafik. *teyabagnie*) *sikur për qishdo miqësi e të dashunë*” S 72. Te Bardhi *mik-u* “*amicus: mik*” 3; “*amice: anmik o mik*” 4; *mikeshë-a* “*amica: mikeshë*” 52; *mikeshëzë-a* “*amica: mikeshëza*” 5; *mikëth-i* “*amiculus: mikëth*” 5; *miqësi-a* “*amicitia: migjësia*” 4, “*simultas: miqësi e rreshime*” 153; *miqësisht* “*amice: miqësisht*” 4 (Ashta Lek. III 198). Te Bogdani *mik-u* “*të huanj prej fqinjëshit e mijshit*” I III, I, 22 “*si facesse prestare ai vicini et amici*”, “*miq e anëmiq* (grafik. *michië e anemichie*)” II, I, IX, 11; *mikeshë-a* “*gjithë e bukura je mikeshë eme e të përlyem ndë ty nuk asht*” II, I, I, 2 “*amica*”; *miqësi-a* “*ka një bashkarë o miqësi*” I I, V, 23; “*miqësi e madhe*” II I, V, 1 (Ashta Lek. IV 253). Te Kuvendi i Arbënit *mik-u* lat. *amicus* “*ngritne miknë*” 70, me shënimin e K. Ashtës: “Kjo trajtë e kallëzores është para trajtës *mikun*” (BSHSH 1, 1980, f. 38).

Në “Fjalorin italisht-kroatisht-greqisht-shqip-turqisht” të Julije Bullatoviqit, viti 1693 (HD nr. 5-6, 1994, f. 98), për ital. “Amico” jepet “*Mic (Michh) (?)* “mik”; khs. edhe Kastrati *Albanologjia* 138.

Në “Fjalorin italisht-shqip” (“*Dizionario Italiano d’Albanese*”) i vitit 1710, që ruhet në manastirin e Grottaferratës nën shenjë Zoccolanti 425, fjalët italishte *Amico* dhe *Amicitia* përkthehen në shqipe përkat. “Micchu” dhe “Micissia” (f. 3 e origjinalit). Në fjalorin e Da Lecces 737 krahas *mik* (*miku i besës, miiku i fortë*), dalin edhe *mikeshë*, *mikteshë* si edhe folja (*me u*) *mikatuem*. Te fjalori i Bashkimit 267 krahas *mik-u* “amico”, del edhe *mikeshë* e *mikneshë*.

Në të drejtën popullore shqiptare, *miku* është një ndër shtyllat e kanusë. Bile, në Kanun, *mikut* i kushtohet një kapitull i tërë, duke përcaktuar gjithçka në lidhje me të, duke nisur që nga “Detyrat e mikut” e “Detyrimet ndaj mikut” e deri te “Përbuzja e atij që iu pre miku”. Përgjithësisht dy janë kuptimet themelore të fjalës *mik*. I pari, *mik* quhet ai me të cilin lidhet krushqi. Në këtë mes me *mik* kuptohet krejt fisi me të cilin është lidhur miqësia. Së dyti, *mik* është edhe mysafiri, qoftë ky i ftuar apo i paftuar. Kuptimet e sotme si p.sh. *mikeshë* “dashnore”, që ndeshen edhe te autorët e vjetër, në të folmet krahinore të vendit nuk njihen fare. Në këtë situatë është me vlerë të dihet se cilat kuptime mori shqipja në kohën kur u huazua fjala prej latinishtes. Sepse edhe në vetë latinishten *amīcus* ka 8 kuptime e përdorime të ndryshme (khs. Vallaurius *Lex.* 59; gjithashtu edhe *Fjalorin lat.-shqip* 33). Tani ngjan që në dy kuptimet e sipërme, për të cilat folëm më lart, shqipja dallohet nga latinishtja. Në punë të semantikës së fjalës, këto dy kuptime mund të quhen “zhvillime të brendshme të shqipes”.

Që nga G. Meyeri EW 278 dihet që *mik* është huazim nga lat. *amīcus*. (Khs. edhe E. Çabejn SE V 344).

mort,~i “vdekje” (*Fjalor* 1980, f. 1167). Aty edhe rrjedhojat *mortalitet,~i* “vdekshmëri”, *mortar,~e* “mortor”, *mortj/e,~a* “vdekje”, *mortor,~e* “1. Që lidhet me vdekjen”, (*i*) *mortshëm* “1. I vdekshëm”, (*i*) *përmortshëm* “1. Që lidhet me ceremoninë e cila bëhet me rastin e vdekjes së dikujt ...”, *përmortshëm* “Në shenjë zie ...” (f. 1452).

Del që te Buzuku *mort-ja* lat. *mors-mortis*. K. Ashta (Lek. I 182) jep këto shpjegime: Fjalën *vdekë-a* ose *vdekje-ja* Buzuku nuk e njeh, por vetëm si folje *vdekunë* “e n ditët së mortsë sanë na përze”, Meshari IX/1, 13; “n mordjet të jetësë glatë na të jemi liberuom”, Meshari XIII/4, 31; “a morte perpetua liberamus” *Oratio*; “n mordjet”, Meshari XVI/2, 41, “in morte” *Psalmus* VI, 6; “ai mort të mirë nukë mund të banjë”, Meshari XXI/3, 63.

Qysh me anonimin e fundit të shek. XV o të fillimit të shek. XVI del kjo fjalë “*mortje(n) mort(ja) e shkel(i)*”. Budi thotë *mort Speculum* 139 dhe *vdekunë Rituale* 174. Bardhi “*e keqe mortja asht*” 31 dhe “*me vdekunë*” 61. Bogdani “*mortja*” I III, I, 22 dhe “*vdekunë*” I I, I, 13. Për herë të parë te *Kuvendi i Arbënit* krahas fjalës “*mordhja*” 24 është edhe emri “*dekë-a*” (“*a janë gati për dekë*”) 14. Por me *d > dh* e shkruan edhe Da Lecce (Gramatika 206) “*ndë ko(h)ë të mordhesë*” dhe “*bdekunë*” (po aty 78). Te fjalori i Da Lecces 740 *morde ~ mort* “*morte*” (*mordeja për të shpejt*). Përmbledhim duke thënë se emri *mort-ja* dhe folja *me vdekunë* dëgjohet nëpër tekste të autorëve të mësipërm, ndërsa si emër *dekë-a* vetëm te *Kuvendi i Arbënit*, i cili në të vërtetë përdor më shumë fjalën *mortja* (Ashta Lek. I 382). Te Buzuku edhe mbiemri *mortar* (mëkat mortar) “*I pari kat mortār ansh të superbja*”, Meshari XXII/1, 65.

Te Budi *mōrt-ja* “1. Vdekje *m perikullit të mōrtsë*” R 10. 2. *me qenë gjukuom mb mōrt*, S 139 (Ashta Lek. II 241). Aty edhe *mortār (murtār)* “*mkat murtār*” S 4. Te Bardhi *mort-ja* lat. *mors-mortis*, ital. *morte* “vdekje”, “*mors: mortja*” 61, “*gjithë jemi të bijtë e mortsë: omnes sumus mortis filij vel unusquisque poculum mortis hibat*” 211; “*horrenda mors est: e keqe mōrtja ashtë*” 21 (Ashta Lek. III 201). Te Bogdani *mōrt-ja* lat. *mors-mortis* “*mōrtja e shtazëve*” I III, I, 22, “*la mortalità della bestie*”; “*kje gjetunë në fill t’ mōrtsë*” I II, I, 4; “*është i denjë për mōrt*” II III, I, 10 (Ashta Lek. IV 257). Aty edhe *mortār* “*i vdekshëm*” “*pendesa të mpkateve mortāre*” I I, V, 7; “*mpkatn mortār*” I I, V, 7. Te *Kuvendi i Arbënit* *morte-ja*, me shënimin e K. Ashtës (BSHSH 1, 1980, f. 39 v.) “Në fjalën hasen ndryshime tingujsh dhe asimilim gjatë fleksionit të saj. Ky huazim shkruhet

mortem 69, por te autorët e vjetër si te Buzuku e Budi shkruhet *mort-ja*. Prej këndej gjindore-dhanorja bën *e mortsë*, ku bashkëtingëllorja e shurdhët *t*, duke u gjetur mes dy tjerave me sonore, u asimilua në shqiptim *e morskë* (“*ndë fill të morskë*” 52). Trajtës *morte* i shtohet edhe një tjetër *morde*, ku *kjo d* u kthye në *dh* “*mordhja*” 24; “*tue kjenë në perikull të mordhesë*” 14; “*in vitae discrimine*” 5. “*e mordhesë*” 13.

E. Çabej dikton këto trajta të kësaj fjale te Buzuku: *mort*, *mortja*, *mordja*, *mordjet*, *mortsë* (SGJ III 380, me gjithë bibliografi).

Fjalë e mbarë shqipes, por më tepër e njohur në rrethet intelektuale e më pak në popull. Ndër të folmet krahinore dëgjohet rrallë. Në Kanunin e Skënderbeut *mort-i mort-ja* “ceremonia e vdekjes, varrimit të dikujt, ditën e vdekjes ose edhe më vonë, kur ka qenë i humbur a i vrarë në luftë” (Luli 28). Në të folmen e Mirditës *morte-ja* “vdekje” e *mortaxhi* “gra ose burra që dijnë të vajtojnë të vdekurin” (DSH IV 112). Te fjalori i Bashkimit 278 *mort-i* “funerale” dhe *mortaar (dekshem)* “mortale”.

Fjala (*i*) *mortshim* “i vdekshëm” dhe tjetra (*i*) *përmortçim* janë neologjizma të krijuara nga Kristoforidhi (Ashta SF 2, 1990, f. 129 e 133).

Në të gjitha trajtat e përmendura më sipër vjen në vështrim në radhë të parë *mort-i* e *mort-ja*, të cilat në thelb janë e njëjta fjalë. Pikërisht dallimi i këtyre trajtave dhe veçanërisht koha e formimit të tyre, a më mirë të themi e veçimit të tyre si njësi leksikore të pavarura, të dala nga një trung i përbashkët, përbën interes studimi.

Fjalori 1980 i jep të dy fjalët (*mort* e *mortje*) me të njëjtin kuptim “vdekje”, ndërsa ai i vitit 1954 bën dallim midis tyre (khs. *mortje-mortja* “1. *mort*; 2. figurë e vdekjes”, f. 323). K. Kristoforidhi 218 rreshton *mort-i* (te Budi *i ap mort*), *mort-ja* (e vjelë te Budi e te Bogdani), *morte-ja* e *mortëje-ja*. Në të folmet popullore khs. *e kam për mort*, ku *mort* ka kuptimin “bezdi”, edhe (*i*) *përmortur* “i vdekur”, në Polis (Haxhihasani DSH V 134).

Etimologjia e kësaj fjale është punë e ditur. *Mort* është huazim nga latinishtja *morte/m/* (shiko p.sh. G. Meyerin EW 287). Problem të diskutuar dhe ende të diskutueshëm përbën forma e saj; më saktë, reflektimi i fjalëve latine në gjuhën shqipe me dy trajta.

E. Çabej (SGJ III 379 v) në kundërshtim me G. Meyerin, Meyer-Lübken, N. Joklin e dijetarë të tjerë mendon se shqipja, ashtu si ka ruajtur neutrat latinë si të tillë, ka ruajtur edhe femëroren e latinishtes (është fjala për reflektimin e femëroreve të së ashtuquajturit lakim i tretë i latinishtes në gjuhën shqipe), të cilat nuk i ka kthyer në mashkullore.

Sipas E. Çabejt (SGJ IV 279, 264) kemi në një periodë të parë të shqipes një *mort* (femërore) me hiferezë të *e-së* fundore, dhe vetëm në fazën më të re të gjuhës kanë kaluar në mashkulloren (nëpër dialekte edhe në femëroren me *-e* ose me *-ë*).

Në SE V 367 E. Çabej do të shkruajë: “Nga lat. *mortem*”. Në vazhdim: “Edhe sot në gjuhën popullore, në veri e në jug, ndihet shpesh *mort mortja*. Forma e vjetër e fjalës u nda më dysh: më një anë me ruajtje të fundorit konsonantik hyri në kategorinë e mashkullores (*mort, morti*, forma e shquar e rrallë), më anë tjetër ruajti gjininë femërore, po duke marrë një *e* fundore, në analogji me femëroret e vjetra më *-e* të tipit *dele, nuse*; kështu u arrit në *morte mortja*, geg. veriore *morde mordja*, me sonorizim të okluzivit në silabë fundore.”

Mendimi i E. Çabejt në parim mbetet i drejtë, por ndërkaq dëshmitë e këtyre tipe fjalësh te autorët e vjetër të shqipes, siç e kemi thënë edhe te fjala *short-i* (shiko te Luka *Stud. gjuh.* IV 201 v.), na duket se nuk e sqarojnë sa e si duhet këtë dukuri. Te Buzuku p.sh. në të njëjtin vend krahas *mort* del edhe *mordje*. Khs. këtu çfarë është shkruar më lart nga K. Ashta për ndryshime tingujsh etj., deri te *Kuvendi i Arbënit*. Te arbëreshët e Italisë kemi *mort-i* por edhe *mortë-a* e *mortje-a* (Giordano 286). Te ato të Kozencës edhe *morte mortja* (Camaj *Falconara* 136).

Duhet shënuar ndërkaq se te i fundmi i autorëve të vjetër gegë, Gjon Nikollë Kazazi (viti 1743) fjala *mort* (khs. *t'morts, prej mortjet*), siç vë re studiuesi i tij, K. Ashta, “i përket grupit të emrave femërorë, që mbarojnë me bashkëtingëllore” (BSHSH 1, 1973, f. 88).

Ne jemi të mendimit se procesi i kthimit nga njëra gjini në tjetrën (përk. gjini femërore, emrat e së cilës mbarojnë me bashkëtingëllore; gjini femërore, emrat e së cilës mbarojnë me *-e* ose *-ë* dhe pastaj gjini mashkullore), është kryer në një kohë relativisht të vjetër, e dy të parat, së paku, para Buzukut. Në të mirë të këtij mendimi flet sonorizimi i *t-së* në *d* te fjalët e tipit *mort* (lat. *mortem*), *gjind* (përk. *gjint*, lat. *gent/em/*) etj., sepse vetëm përdorimi i këtyre fjalëve në gjininë femërore ndikon drejtpërdrejt në ndërrimin e fundoreve, duke dhënë trajtat e reja *morde mordja, gjinde gjindja* etj. Neve na duket se është pikërisht ndërrimi i gjinisë që ka çuar edhe në diferencimin e kuptimit të fjalës *mort*, siç e theksuam edhe më lart (khs. *mort* “vdekje” dhe *morde* “hija e vdekjes”). Ky fakt është shenjë vjetërsie e kësaj dukurie.

Edhe te *mort*, ashtu si te *short*, procesi i kthimit ka kaluar nga femërorja e lashtë (me hiferezë të *e-së*) në femëroren po të lashtë (po kësaj herë e formuar përbrenda shqipes) me *e* dhe *ë* fundore. Sonorizimi i *-t-së* në *-d*, që vërehet edhe te Buzuku, është tipar i sigurt i kalimit të *mort* në femëroren me *-e* ose *-ë* fundore në njëjës të pashquar.

Për përfitim të trajtave të gjinisë mashkullore mund të ketë ndikuar edhe italishtja (khs. *mortar* por në asnjë rast *mordar*).

Duke përfunduar themi se *mort-i* (ashtu si si edhe *short-i*) nuk është trajtë e vjetër e fjalës së huazuar nga latinishtja, por një formim analogjik relativisht i ri, i kryer përbrenda gjuhës shqipe. Ndërsa *mort* (përk. *mortje mortja*) dhe *morde* (përk. *mordja*) paraqesin gjendjen e vjetër të huazimit nga latinishtja.

Problemi i reflektimit në gjuhën shqipe i formës së fjalës latine *mortem* (që hyn në të ashtuquajturat femërore të lakimit të tretë të latinishtes), ka rëndësi jo vetëm për të vënë në dukje

përkimet a ndryshimet me dalmatishten e rumanishten, por edhe për të gjykuar për vendin e elementeve latine të gjuhës shqipe në lidhje me latinitetin perëndimor a lindor.

ndrikull, ~a “1. E shoqja e kumbarës; nunë. 2. Gruaja që ndodhej dëshmitare në një kurorëzim. 3. Nëna e fëmijës, të cilit i priten flokët, kundrejt kumbarës. 4. Gruaja që kujdesej për nusen ditën e dasmës. 5. Grua llafazane...” (*Fjalor* 1980, f. 1221). Aty edhe rrjedhoja *ndrikulli, ~a* “tërësia e ndrikullave”. Të gjitha fjalët e sipërme jepen në *Fjalorin* 1980 si fjalë të vjetra krahinore.

Fjalë e mbarë gjuhës që lidhet më tepër me të drejtën popullore shqiptare. Si e tillë sot pak e përdorur. Del që te Buzuku *ndrikullë-a* lat. *matricula*, me shënimin e K. Ashtës (Lek. I 292) “Ndrikull e quan Buzuku gruan që mban foshnjën në pagëzim” *le të hinjë ndë klisë ndrikulla*, *Meshari* XXV/3, 79. Te Budi *ndrikullë-a* lat. *matricula* “nunë” (“*kumtëritë e ndrikullat*”) R 20 (Ashta Lek. II 248). Te Bardhi del me kuptimin “mamí” “obstetrix: *ndrikulla*” 74 (Ashta Lek. III 211). Te *Kuvendi i Arbënit ndrikullë-a* “quhet e shoqja e kumbarës” (Ashta BSHSH 2, 1980, f. 33). Te *fjalori* i Bashkimit 305 *nnrikull (ndrikull)* “comare”.

Te *E drejta zakonore shqiptare* (f. 520) *ndrikulli-a* “koha e qëndrimit të ndrikullës te kumbara” (*Ndrikullia nuk mund të shtyhet mbi pesë ditë*). Te arbëreshët e Italisë *ndrikul-a* (Kamsi *Fjalor arb.-shqip* 182).

Në letërsinë artistike te *Lahuta* 548 e Fishtës *ndrikull,-a* “nana e fëmí së cillit kumbara i merr flokët”.

Në analizën e prejardhjes së kësaj fjale duhen diskutuar paraprakisht dy çështje. Së pari, të dallohet kuptimi primitiv i fjalës, sepse në shqipen e sotme ajo del me disa kuptime. Ngjan që gjatë kohëve, ndrikulla të ketë kryer p.sh. edhe punën e mamisë, po ky është një ndër kuptimet e dyta të kësaj fjale.

Së dyti, në latinishte nuk kemi një fjalë *matricula*. G. Meyeri EW 321 rindërton një *matricula* (khs. *mater*) duke u

mbështetur tërthorazi te ital. *madrina* (**matrina*), mendim i pranuar edhe nga të tjerë pas tij. E. Çabej, miraton në thelb mendimin e Meyerit. Ai vetë shprehet se “Kemi të bëjmë me një fjalë të gjuhës kishtare që hyri edhe në të folët popullor” (SGJ VI 39).

Ne mendojmë të nisemi nga lat. *mātërcūla* “loke, nënoçkë”. Kuptimi primitiv “nënoçkë” ngjan të ketë kaluar te “ndrikulla”, e cila në çastin e marrjes së flokëve, zëvendëson nënën e foshnjës, duke e mbajtur atë në duar. Mbi bazën e këtij kuptimi të parë më pastaj janë ndërtuar edhe kuptimet e dyta, të cilat i rreshton *Fjalori* 1980.

Në punë të ndërrimeve fonetike, vështirë të pranojmë që trajta fillestare e kësaj fjale të ketë qenë **matricul-*. Së pari, nuk kemi te kjo fjalë një asimilim të pastër të grupit /mt/, i cili ka dhënë /nt/, aq më tepër kur krahasimi bëhet mbi një fjalë të rindërtuar. Do të ishte pak e vështirë që ky asimilim, që paraqitet i vjetër në shqipe, të zbatohet në rastin kur kemi /mat-/ > /mēt-/ > /mt/ > /nt/ > /nd/. Khs. këtu zhvillimin e ngjashëm lat. *amita* : shq. *emtë* ku dukuria e sipërme nuk zbatohet. Është pikërisht ky shkak që na shtyn të mendojmë për një bazë tjetër të kësaj fjale, e kjo vetëm për gjuhën shqipe. Siç e kemi thënë edhe ndër raste të tjera të kësaj natyre, duhet kërkuar trajta e latinishtes vulgare, prej së cilës vjen *ndrikull* e shqipes. Ngjan që kjo trajtë të jetë disi **ntrik-*, prej së cilës, me ndërrimin e njohur *nt* vetëm deri në *nd* (karakteristikë e huazimeve latine të gjuhës shqipe) dhe me prap. -ull- të jetë formuar *ndrikull* (khs. këtu *triskull*, *thumbull*, *zhakull* etj.).

Te *ndrikull* e shqipes, pra, kemi vërtet një huazim latin, po me një rrugë të tërthortë, nga një bazë e latinishtes popullore, e me një prap. -ull, formuar përbrenda shqipes.

nip, ~i “1. Djali i djalit a i vajzës; djali i vëllait a i motrës ...” (*Fjalor* 1980, f. 1266). Aty edhe rrjedhojat *nipash, ~i* “djali i vajzës a i motrës”, *nipç/e, ~ja* “nip me moshë të vogël”, *nipëri, ~a* “tërësia e nipave”, *nipoll, ~i* “nip”, *stërnip, ~i* “djali i nipit ose i mbesës”.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del te Budi *nip-i* lat. *nepos* “(asht) *ndōnji i nipi*” (grafik. *ndoognijnipi*) R 337 (Ashta Lek. II 251). Te Bardhi *nip-i* lat. *nepos* “*nepos: nip*” 65; “*nepos, fratris filius, siue sororis: i nipi i t vëllāt ō sē motrēs*” 135 (Ashta Lek. III 215). Te Bogdani *nip-i* lat. *nepos* “*ky kje Nini i biri i Belit (i) pari regj i Asirit, nipi i Nembrotit*” I I, I, 10 (Ashta Lek. IV 279).

Në të folmet krahinore, te Gazulli (FR 279) *nipça!* (Malësi e Madhe) thirrje: *o nip! Nipash* (prej nipash) *ky është nipash ynë; nipe-ja* (Gruda, Malësi e Madhe), me shënimin “ndikim sllav për “mbesë”; khs. për Shkrel edhe DSH I 317. Në të folmen e Konispolit *nip-i* (DSH V 345). Te arbëreshët e Qanës e të Ejaninës *nip-i* (DSH 474 e 436). Në Bizë (Durrës) *nep-i* “*nip*” (Volaj 122). Në të folmen e Kërrabës *nipoll-i* “*nip*” (SF 3, 1966, f. 114). Në *Fjalorin* e M. Boçarit *nip* (HD 3-4, 1996, f. 57). Te Kristoforidhi 240 *nip-i* me shënimin “lat. *nepos*”. Te fjalori i Da Lecces 756 (*nip /i/*) “*nepote*”. Te fjalori i Bashkimit 299 krahas *nip-i* “*nipote*”, del edhe *nipni-a*, po tani i përdorur në numrin njëjës, ngjan si emër kolektiv.

Analiza e prejardhjes së fjalës shqipe *nip* duhet vështruar gjithsesi në strukturën e emrave të farefisnisë, aty ku mbizotërojnë përbërës semantikë specifikë (seria binare *nip/mbesë*, Sejdiu SSR 64 v.), në njërën anë, dhe lidhjes së gjakut a të tamblit, në anën tjetër. Në të drejtën popullore shqiptare është përcaktuar qartë në një nen të veçantë, me një kryetitull “*Nip e mbesë trugu e bijash*”, ku thuhet: “*Nip trugu*” a “*mbesë trugu*” thirret ai varg mashkujsh a femnash qi rrjedhin prej plangut të babës”. “*Nip*” a “*mbesë bijash*” thirret ai varg mashkujsh e femnash qi rrjedhin prej bijave të martueme” (*E drejta zakonore* 52). Me këtë mënyrë vështirë të diferencohet prejardhja e *nip* nga fjala tjetër kundërvënëse *mbesë*, që gjithsesi mbetet me prejardhje të diskutueshme e të paqartë (shiko te kjo fjalë). Problemi shtrohet: a fjalë vendi e shqipes (Boppi e Kamarda) apo nga latinishtja (Miklosichi e G. Meyeri EW 310). E. Çabej (SE VI 90) shprehet: “Për etimologjinë e fjalës do shënuar se - sikurse e pohojnë sidomos edhe Jokli e Skoku - burimi i saj nga një i.e. *nepot-* ose nga një

dalm.-lat. *nepo* gjuhësisht është barabar i vështirë dhe barabar i mundur”. Vetë E. Çabej pranon se “E sotmja *nip* pas mendimit tonë më fort se nga kallëzorja *nipnë* (G. Meyer, Jokl) rrjedh prej shumësit, ku *i*-ja pas skemës *e : i* (*breg brigje* etj.) kishte zënë vend që moti” (SE VI 91).

K. Topalli (*Sist. zanor* 181), pasi merr në shqyrtim të gjitha rastet e ndërrimit /e/ : /i/, dhe pasi shqyrton me imtësi të gjitha mendimet e dhëna nga gjuhëtarët për këtë dukuri, arrin në përfundimin se në sistemin emëror e foljor shkak i këtij ndërrimi është kudo i njëjtë, veprimi disimilues i zanores /e/ mbi tingullin e temës, që ka të njëjtën përbërje. Tani, në qoftë se Topalli ka të drejtë, atëherë për *nip* të shqipes mund të rindërtohet një trajtë e shumësit *nip/e/*. Në këtë rast fjala do të paraqitej si e huazuar nga latinishtja *nepos*, po gjithsesi nga një trajtë e shumësit (**nep/e/* > **nipe* > *nip*), kryer përbrenda gjuhës shqipe.

Ka të ngjarë që emri *nip* të ketë hyrë në shqipe nga nevoja e vendësve për t’iu përshtatur legjislacionit romak të asaj kohe (në marrëdhënie me nëpunësit romakë të kohës), e kryesisht për vendosjen e trashëgimisë së pronave në kadastrat e asaj kohe. Një dukuri e tillë do të ngjasë gjatë historisë edhe në kohën e pushtimit sllav e turk të vendit.

nun, ~i “1. Ai që mbante foshnjën gjatë pagëzimit dhe që i vinte emrin. 2. Ai që i merrte flokët fëmijës së posalindur, kumbarë. 3. Ai që ndërronte kurorat e dhëndrit e të nuses”. (*Fjalor* 1980, f. 1273). Aty edhe rrjedhojat *nun/ë, ~a* “ndrikull”, *nun/ël, ~la* “gjyshe”, *nunëri, ~a* “1. Të qenët nun ...”, *nunërohem* “zë një nun ...”, *nunos/em* “rrëfhem”, *nunosj/e, ~ja* “veprimi sipas foljes *nunosem*”.

Fjalë e sferës etnografike me përdorim të rrallë edhe sot e kësaj dite. E. Çabej (SE VI 96) mendon se së pari del kjo fjalë te Budi. Te autorët e vjetër *nun-i* del së pari te *Perikopeja Ungjillore* (Ashta Lek. I 102). Ashta e shënon këtë fjalë nga greq. e mesme, e re *vovvós, nunós*. Te dokumenti përdoret me një kuptim të përgjithshëm për “atë shpirtëror”: peshkëv prift,

ndër arbëreshët e Italisë, rrëfyes, meshtar. Në lidhje me kuptimin e fjalës nevojitet të vihet ky shënim se, mbasi lexohej Mateu (kap. XXVII, paragr. 62-66) nga peshkopi o djakoni, atëherë koroja përgjegjte me formulën e përshëndetjes *Εἰς πολλά ἐτη Δεσπότα*, të cilën anonimi e përkthen shqip *σουμβί ἐτι Σότι νουν* “shumë vjetë, Zoti nun” R 14 (Ashta Lek. I 102). Te Budi *nun-i* “*konfesor o nun ke rrëfyhetë*” S 6 (Ashta Lek. II 252). Bardhi e Bogdani nuk e kanë.

Me atë kuptim që e jep Budi dalin fjalët *nunëroj* “dëgjoj të fshehtat si nun (prifti tek i cili rrëfeheshin)” e po kështu edhe *nunëz* me të njëjtin kuptim, *nunis* “flas me zë të ulët”, *nunosem* “rrëfhem ke nuni” që i gjejmë te A. Xhuvani (SE II 1975, f. 162). Te arbëreshët e Italisë *nun-i* “nun, kumbarë”, *nun/ë-a* “statujë e vogël, figurë e pikturuar”, *nunëlj/ë-a* “gjyshe”, *nunëz/ë-a* “kshetëz, floçkë” (Kamsi *Fjalor arb.-shqip* 190). Në të folmen shqipe të Mandricës (Bullgari) *nun-i* e *nun-e* (SF 2, 1965, f. 164). Në krahinën e Krujës edhe llagap familjeje *Nuna*. Në letërsinë artistike te “*Anzat e parnasit*” *nun/ë,~a* “ndrikull” (Luka *Stud. gjuh.* IX 61), khs. *E nunës i thotë “Palokë” êmnin m’i a njitë* (“*Anzat*” 160). Te fjalori i Bashkimit 308 dalin *nun-i*, *nunë-a*, *nunërii* e folja *nunërohem* (*m’u nunëru*).

Dh. Shuteriqi, duke gjurmuar për fjalë të leksikut të shqipes para Buzukut (SF 4, 1981, f. 191), përmend një *Nun-i*, që e ka ndeshur ndër dokumente të shek. XIV (*Nun*) e në vitin 1485 *Nuna*. Siç e kemi thënë edhe për raste të tjera, pohimet e kësaj natyre te Dh. Shuteriqi shpesh janë hamendje të vetë autorit, prandaj duhen marrë me rezervë e me dyshim.

E merr këtë fjalë në shqyrtim E. Çabej (SE VI 95). Pasi analizon mendimet e gjuhëtarëve të tjerë (G. Meyer, Weigand, Pușcariu etj.), ai vetë shprehet: “Në shqipen *nun* ka konkurruar me *kumtër* e me *kumbarë*, e para huazim latin, e dyta element latin hyrë nëpërmjet të greqishtes bizantine, *nun* është një nga ato fjalë të shqipes, për të cilat mbetet e dyshimtë rruga e shtegtitimit, a drejtpërdrejt prej latinishtes në shqipen e

rumanishten, apo edhe kjo nëpërmjet të greqishtes nëpërmjet kishës bizantine”.

Dalja e *nun* që te *Perikopeja e Ungjillit* dhe mungesa e saj te Buzuku, më pas dalja te Budi vetëm për “rrëfyes, confessor” të detyron të nxjerrësh dy përfundime. Së pari, fjala *nun* me kuptimin “rrëfyes” ka hyrë në shqipe nëpërmjet kishës bizantine nga greq. *vouvós*. Më pas kjo fjalë, tani e hyrë edhe nga latinishtja *nonnus*, konkurren me të tjerat *kumtër*, *kumbarë* etj. thjesht për punë të bashkëveprimit (asociacionit), duke qenë fjalë që shprehin përafërsisht kuptime të njëjta.

Trajtat që regjistrojnë Xhuvani *nunëroj* “dëgjoj të fshehtat si nun (prifti tek i cili rrëfeshin)” e po kështu edhe *nunëzroj* me të njëjtin kuptim, *nunis* “flas me zë të ulët”, *nunosem* “rrëfhem ke nuni” janë përzierje (shartim a kryqëzim) fjalësh e kuptimesh (khs. *nun* + *nanuris* > *nunis* etj.), të cilat E. Çabej propozon t’i quajmë “elemente të reja të leksikut” (SE I 103).

nus/e, ~ja “vajza që po martohet ...” (*Fjalor* 1980, f. 1274). Kësaj fjale në këtë *Fjalor* i njihen 5 kuptime e përdorime të ndryshme. Aty edhe rrjedhojat *nusebukur, ~a* “nuselalë”, *nuselal/ë, ~a* “kafshë gjitare ...”, *nus/ël, ~la* “nuselalë, bukël”, *nusëri, ~a* “1. Koha kur gruaja është nuse ...”, *nusërim, ~i* “veprimi sipas kuptimit të foljes *nusëroj*”, *nusërisht* “si për nuse”, *nusëroj* “1. Qëndron më këmbë ... nusja ditën e dasmës ...”, *nusëror, ~e* “që i përket nuses”, *nusëror/e, ~ja* “dhoma e nuses”, *nusëz, ~a* “nuselalë”.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del te Buzuku e *nuseja* n *shtratit së saj*, *Meshari* XLI/2, 113, “sponsa” *Joel* II, 16 (Ashta Lek. I, 392). Te Budi “*dhandërri e nuseja*” R 186 (Ashta Lek. II 252). Te Bardhi “nupta, sposa: *nuseja*” 70; “sponsa, sposa, gelin: *nuseja*” 155 (Ashta Lek. III 216). Te Bogdani “*nuseja*” II III, I, 2 (Ashta Lek. IV 280). Te *Kuvendi i Arbënit*, *nuse-ja* “*stolisunë sikur nuseja burrit vet (= të vet)*” 23 (Ashta BSHSH 2, 1980, f. 36).

Në “Fjalorin italisht-shqip” (“*Dizionario Italiano d’Albanese*”) i vitit 1710, që ruhet në manastirin e

Grottaferratës nën shenjën *Zoccolanti* 425, fjala italishte *Spossa* përkthehet në shqipe “*Nussa*” (faqja 16 e origjinalit).

Ndër të folmet krahinore, te Kanuni i Skënderbeut *nusi-a* “nusní, koha mbas martesës e nuses” (Luli 29). E ka këtë fjalë edhe *Bashkimi* 308. Në të folmen e Vilë-e-Kalisit (Lumë) *nâūsllaik-i* “dhuratat që merrte gruaja që përgatiste nusen” (DSH III 190). Në Kanunin e Lekë Dukagjinit *nuser/é, ~ja* “ndershmëria e femrës” (“*Për një fjalë gojet, për një palaví, qi ia shqyptoi cucës së habitme në punë të vet një i marrë, shqyptari bân rrenim. Nuserenë e vet s’e shet për jetë*” (E drejta zakonore 522). Te arbëreshët e Italisë *nus/e, ~ja* “kukull, nuskë” (GJJ 1, 1989, f. 88). Në të folmen e Shoshit (Dukagjin) *nus/e, ~ja* “dhi e larme e shumë e bukur” (GJJ 3, 1989, f. 88). Te *Fjalori* i Marko Boçarit *nuse* (HD 5-6, 1996, f. 112). Te *Fjalori arb.-shqip* i K. Kamsit (f. 191) *nus/e, ~ja* “nuse”, *nusez, nus/e, ~ja* “bebja e syrit”, *nusëri-a*. Te *fjalori* i Da Lecces 758 *nuse* “sposa”, *nusení, nusezë* (*nusezë me surrat*).

Diskutimi i prejardhjes së fjalës shqipe *nuse* ka nisur herët që me Fr. Boppin (*Über* 513); në vazhdim janë marrë me këtë punë Dh. Kamarda, G. Meyer, P. Kretschmer, H. Pedersen, É. Boisacq, Walde-Pokorny, N. Jokli, Ernout-Meillet, Walde-Hofmann, M. Vasmer, J. Pokorny, S. Pușcariu, K. Sandfeld, C. Tagliavini, O. Wiedemann, F. Ribezzo, E. Çabej (për listën e gjuhëtarëve të sipërm, si edhe për literaturën përkatëse, shiko E. Çabej, SE VI 96 v.). etj., e tash së fundi K. Topalli (*Fërkimore* 57 v).

Arsyeja e pjesëmarrjes në këtë diskutim të kaq dijetarëve në zë për kohën e vet lidhet me dyshimin nëse *nuse* e shqipes është fjalë vendi e trashëgimisë indoevropiane apo huazim nga latinishtja, në njërën anë; ndërsa, në anë tjetër, me refleksin (përk. vazhdimin) e */s/ indoevropiane në /s/ në shqipe, duke qenë *nuse* një ndër të paktat fjalë ku mund të vërtetohet ose jo një dukuri e tillë.

Për prejardhjen indoevropiane të *nuse* është shprehur edhe G. Meyeri, po duke ndërruar mendim disa herë. Sipas E. Çabejt “... G. Meyeri më parë (AS I 75, BB VIII 191) e

vendoste edhe ai te ky grup fjalësh, po në EW 312 e në AS III 212 për punë të *s-së* që nuk shfaqet si *sh*, e shpjegon nga një latinishte **nuptia* prej *nupta* ‘nuse, e martuar’. Te gurra indoevropiane kthehet ndërkaq Kretschmeri ... Ky mendim zotëron tani kudo, duke nisur me G. Meyerin vetë (AS IV 89, V 97) ...” (E. Çabej SE VI 96 v).

Pra, mendimi që “mbizotëron sot kudo” (E. Çabej SE VI 97), e me të cilin pajtohet edhe E. Çabej (E. Çabej SE VI 97), është ai i Pedersenit që *nuse*-n e merr për fjalë vendi, duke e shpjeguar *-s-në* me disimilimin e dy *-s-ve* (**smus-*) (E. Çabej SE VI 97, me gjithë bibliografi).

Kësaj prejardhjeje (a shpjegimi) mund t’i bëhen këto vërejtje:

Së pari, dukuria e disimilimit të dy *-s-ve* duhet të jetë më e hershme se zhvillimet e mëvonshme të *s-së* indoevropiane në gjuhën shqipe (khs. **/s-/ > /h-/*; **/s-/ > /gj-/*; **/s-/ > /th-/* e */s/ > /sh/*. Përndryshe nuk do të kishim disimilim, duke munguar njëra */s/*.

Së dyti, në rastin e mësipërm përfundimi i disimilimit mbetet po **/s/*, e cila, duke qenë më e lashtë se zhvillimet e tjera të sipërpërmendura të **/s/-së* indoevropiane në gjuhën shqipe, do të rigrupohej (përk. përfshihej) në vazhdim me njërin nga rastet e tjera, gjithsesi të mëvonshme.

Së treti, grupi **/sn-/* i periudhës indoevropiane në shqipe ka përfunduar në */n-/*. Kjo dukuri e rënies së */s-/*, siç do ta shohim në vazhdim, ngjet edhe në rastet e tjera kur ky grup del në bashkëvajtje me bashkëtingëllore. Në këtë situatë duhet vështiruar kronologjia e kësaj dukurie në raport me disimilimin **/s-/ ... */s-/ > /s-/* të **smus-*.

Së katërti, disimilimi **/s-/ ... */s-/ > */s-/* të **smus- > nus-*, ngjan të jetë i vetëm e i vetmuar. Ndërkohë kemi edhe dy raste të tjera (indoevrop. **saus-mō* : shqip *tha-nj* dhe **sūs > thī*), që shpjegohen nëpërmjet disimilimit **/s-/ ... */s-/ > /th-/* (Demiraj *Fonologjia* 212, me gjithë bibliografi), (jo */s/*).

Sipas parashtrimit të mësipërm ngjan që G. Meyerin paraprakisht që i një mendimi me Fr. Boppin, që gjen te *nuse*

një fjalë vendi të shqipes, po që më pastaj ndërroi mendim. Por, në vazhdim të studimeve të veta të mëvonshme, iu kthye përsëri versionit të parë, duke u bashkuar kështu me shumicën e dijetarëve, që shihnin te *nuse* një fjalë të fondit autokton.

K. Topalli, duke gjykuar për reflekset e /s/ indoevropiane në shqipe, shkruan: “Ruajtjen e /s/-së së trashëguar Meyeri (BB 8 [1884] 191) e gjen edhe te emri *nuse*, që e merr për fjalë vendi dhe e krahason me ind. e vj. ... Por vetë Meyeri, disa vite më vonë, në Fjalorin e tij etimologjik (EW 312), i ka dhënë një drejtim tjetër burimit të kësaj fjale, duke e marrë për një huazim latin nga *nuptia* ...” (Topalli *Fërkimoret* 58). Pra, K. Topalli, nuk përmend më tej nëse Meyeri i është rikthyer përsëri mendimit të parë, duke mbetur tani edhe ky vetë me këtë prejardhje e duke e miratuar, bile edhe thelluar më tej, se “... në këtë rast, ky tingull ka dalë nga evolucioni i lidhjes /ti/, khs. trajtat e gjuhëve romane, it. *nozze*, engad. *noazzas*, fr. *noces*, prov. *nosas*, kat. *noces* ...” (*Fërkimoret* 58).

G. Meyeri në Fjalorin e vet etimologjik nuk pranon afrimin e *nuse* të shqipes me ind. e vjetër *smušA*, thjesht për punë të refleksit të š-së, sepse në këtë rast fjala e shqipes duhet të dilte *nushë* (š > sh, ā > ë). Përndryshe, në punë të kuptimit, gjithçka dilte e përligjur (*smušA* “nuse”). Kjo e detyron Meyerin të kërkojë një shpjegim tjetër, por që gjithsesi na ngjan që çalon në shumë drejtime. Meyeri tani i sillet lat. *nupta*, duke rindërtuar një **nuptia* për shqipen *nuse*. Në latinishte *nupta* ka dy kuptime: “1. grua, bashkëshorte; 2. nuse”; ndërsa *nuptiae*: “1. martesë, dasëm; 2. bashkëjetesë e jashtëligjshme” (Vallaurius *Lex.* 506; khs. edhe Fjalor lat.-shqip 331). Ndër trajtat e shumta të kësaj fjale në latinishte (khs. *nupta*, *nuptiae*, *nuptialis*, *nuptiarūs*, *nuptūla*, *nupturō*, *nuptūrus*, *nuptus* etj.), bazë për krahasim (përk. huazim) duhej marrë *nupta*, që përligj kuptimin e njëjtë me shqipen *nuse*. G. Meyeri mori *nuptia* thjesht për të përligjur ndërrimin e mundshëm *tī* : *s*. Po ndërkaq nëse për gjuhët e rrjedha nga latinishtja (ital. *nozze*; *Dizionario etimol.* 813, *nozze* vjen nga lat. *nūptiae*, folja *nūbere*, nga një rrënjë *nūber*; fr. *noce* /*Dict. Etimol.* 433/ *noce* vjen nga

lat. pop. **noptiæ*, lat. klas. *nuptiæ*, etj.) gjithçka procedon në rregull si për punë të kuptimit, ashtu edhe për formë, për shqipen zhvillimet fonetike nuk paraqiten tërësisht të përligjura. Në zhvillimin e grupit *-pti-* duhet sqaruar e përcaktuar kronologjikisht *-pt-* > *t* e *fi* > *s*. Në qoftë se merret si ndërrim i parë *-pt-* > *t*, *t*-ja e dalë nga ky grup nuk do të ishte reflektuar më tej në *s*. Përndryshe, në një ndërrim të mundshëm *fi* > *s*, do të detyroheshim të merrnim në konsideratë *-p-në* (**nupsë*), tani në grupin *-ps-*.

Ndërkaq, për reflekset e grupit *fi* në shqipe, duhen marrë parasysh edhe rastet e tjera; khs. lat. *castellum* shq. *kështjellë* (*e* > *je*), te Buzuku *chestieli* (*Meshari* LVIII/2, 181 n *kështjelit së Mërisë* / n *kështjelit së Mërisë* /); te Bardhi *chestiel* (*Dictionarium Latino Epiroticum*, Romæ, 1635, f. 220 / *Aste gna stepij enalte possi Chestiel* / Ashtë nja shtëpi e naltë posi Kështjel /); në toponomastikë *K/ë/shqel*, *Prroj Gurrës K/ë/shqelit*, *Maja e Këshqelthit* etj. Khs. edhe lat. *tegula* shq. *tjegull* (*qegëll*); lat. *rastellu/m/*, në Shkodër me dy trajta: *rrashtjel* e *rrashqel*; lat. *Stephanus* (greq. e mesme *Στέφανος*) shq. *Shtjefën* *Shqefën*, *Shqefër-i* (Konispol) (Luka *Stud. gjuh.* V 125 v me gjithë bibliografi) e deri në *Çefë* (Luka SGJ IV 181).

Në një mbishkrim latin të shek. I shkruhet: “... / *Lupus Primæ l(i)bertus* / *Parthinus ex / Latio coniugi / ...*” (H. Ceka BUSHT SSHSH 1, 1961, f. 104 v). Për këtë rast ne kemi dhënë shpjegimin: “Emri *Latia* i mbishkrimit të Shinjonit të shek. I të e. re identifikohet me *Kodërlaçin*, që ndodhet në anën e majtë të Ishmit, mbi fshatin Mollkuq e që përmendet ndër dokumente që së lashti si fshat i madh (viti 1583). Grupi *fi* te *Latia* (ashtu si te *djall* nga *diabolus*) ka mbetë i pandryshuar në *s* (si te *zanë zërë* te *Diana*) ...” (Luka *Stud. gjuh.* IV 35, me gjithë bibliografi). Këtu vlen për t’u shënuar se kalimi *fi* > *ç* nuk ka ndërmjetëse *q*, si te huazimet e tjera latine, të sjella më lart.

Për sa u tha deri më tani, mbase, mund të vihet në dyshim rrjedha e fjalës shqipe *nuse* nga lat. **nuptia* (përk. *nupta*). Dhe, natyrisht, rastet e dyshimta si ky i sipërmi, nuk mund të

merren si shembuj për të vërtetuar rregulla (përkat. ndërrime) fonetike.

Për analizën (burimin vendës të trashëgimisë indoevropiane) të fjalës *nuse* mendojmë që paraprakisht duhet bërë një rigrupim i atyre gjuhëve me të cilat përqaset fjala e shqipes, duke u nisur si nga kuptimi i parë a primitiv, ashtu edhe nga trajta përafërsisht e përbashkët e tyre.

Ngjan që në indoevropianishte të kemi pasur dy fjalë të përafërta në kuptim (njëra prej tyre “nuse” dhe tjetra “grua e re”), por gjithsesi të dalluara në përbërjen tingullore. Në latinishte p. sh. kemi dy fjalë të dalluara qartë: *nurus* “e re; grua e re” dhe *nupta* “nuse”. Ky dyzim tani përfaqësohet me dy rrënjë indoevropiane. E para, një */s/nur- (khs. sanskrit. *snurha*, lat. *nurus*, gjuhët gjermanike /gjerm. e lartë e vjetër *snur*; nord. e vjetër *snor*/). E dyta, */s/nus- (khs. ind. e vjetër *snusa* /*snusā snuśA*/, greq. e vj. *vuός*, trak. *vōσα*, sllav. e vj. *snoha*). Ndër këto dy grupime shqipja *nuse* ngjan rreshtohet në grupin e dytë. Ndërkaq, baza për shqipen **snusā* duhet eventualisht diskutuar. Grupi *sn-* në shqipe ka përfunduar *n-* (Topalli *Fërkimoret* 26 v). Û-ja e shkurtër dhe e theksuar indoevropiane dihet që ka dhënë po *u*. S e dytë është fërkimore e pazëshme alveolare, e cila nuk është ndërruar në *sh*, por vazhdon si e tillë në gjuhën shqipe. Ā-ja fundore ka përfunduar në -ë. Trajta e parë e fjalës *nuse* duhet të ketë qenë *nusē* (E. Çabej SE VI 97).

Për të vërtetuar vazhdimin (përkat. ruajtjen) ose jo të fërkimores */s/ indoevropiane në gjuhën shqipe, mendojmë që duhet diskutuar së pari inventari i fonemave bashkëtingëllore në gjuhët indoevropiane e mandej vazhdimi (përkat. ruajtja) e tyre në gjuhën “nënë” të shqipes.

Dihet që gjuhët indoevropiane në një shkallë të vjetër të zhvillimit të tyre nuk njihnin fonema shushuritëse (përkat. qiellzore *sh*, Martinet *Econ.* 235 v). Ndërkaq, një *s* me drejtim për t’u shqiptuar si e qiellzorëzuar e ndeshim që në indishten e vjetër (grafikisht /ś/) (te H. Pedersen, KZ 36 /1900/, f. 340. Shiko edhe M. Huld, *BAE* f. 147).

Kjo situatë e detyron Sh. Demirajn të nxjerrë dy përfundime. Njëri: "... */s/ i. e. në një fazë të hershme të gjuhës 'nënë' të shqipes do të ketë pasur një shqiptim të afërt me atë të fonemës /s/, që dëshmohet ndër të tjera në greqishte, në latinishte, në gjuhët sllave, gjermanike etj." (*Fonologjia* 208). Tjetri: "... */s/ i. e. qysh në periudhën parahistorike të shqipes duhet të ketë pësuar një ndryshim të rëndësishëm në shqiptim ... që anonte më fort me /sh/, apo më saktë, me një /s/ të qiellzorëzuar ..." (*Fonologjia* 208).

Ne vazhdojmë të mbetemi me mendimin e shprehur më parë (Luka *Stud. gjuh.* VIII, f. 126 v e 144) se në shqipe mund të kemi pasur që në lashtësi dy fonema /s/ të dalluara ndërmjet tyre: njëra fërkimore e pazëshme /s/; tjetra, qiellzore /ʃ/. E para, duke dalë në shumicën e rasteve në bashkëvajtje me bashkëtingëllore, veçanërisht në ballë të fjalës, është asimiluar, duke u reduktuar fare (khs. *sm-* > *m-* **sme*Kr- : shq. *mjekër*, *sn-* > *s-* **snōg-* : shq. *thënegël*; *-sl-* > *l* **koslā* : shq. *kollë*; *sr-* > *r-* **sreu-* : shq. *rrjedh* ; **sū-* > *v-* **sūē*Kur : shq. *vjehërr* etj.). Një /s/ e trashëguar ka rënë që së lashti edhe kur ndodhej në vendosje fundore në funksion të mbaresës (khs. **tās* : shq. *ato*; **ūlq^uos* : shq. *ujk* etj.) (K. Topalli *Fërkimoret* 47 v. Sh. Demiraj *Fonologjia* 214).

Megjithëkëtë fërkimorja e pazëshme /s/ indoevropiane nuk është zhdukur fare nga inventari i fonemave bashkëtingëllore të shqipes. Sh. Demiraj, p.sh., shprehet se "Dhe mund të pohohet se shqipja është *ndoshta* e vetmja gjuhë i. e., ku fonema e hershme */s/ nuk është ruajtur në asnjë pozicion fonetik" (*Fonologjia historike* ... 208. Khs. edhe K. Topallin, *Fërkimoret* 59).

Së pari, ajo ngjan të jetë ruajtur te fjalët *nuse*, *pas* e *sy*. Së dyti, do të paraqitej jashtë çdo mundësie që, po në kohë të lashta, të dilte një fërkimore /s/ nga grupe tjera, në qoftë se ajo nuk do të ekzistonte më në gjuhën shqipe në kohën e këtij përftimi (khs. *fī* > *s*, *tt* > *s*, *k^u* / *i*, *e* / - > *s* etj.).

ungj,~i “vëllai i babait ose i nënës (kundrejt nipit a mbesës); xhaxha, dajë” (*Fjalor* 1980, f. 2089).

Fjalë e mbarë shqipes, po e përdorur rrallë, veçanërisht në gegërishte. Del te Bardhi *ungjë-i* lat. *avunculus*. Vëllai i nënës ose i babës, axha, daja “auunculus, zio: *ungjë*” 195; “patruus: *ungjë*” 85 (Ashta Lek. III 281). Te Bogdani *ungj-i* “*Andrea Bogdanit, tim ungji*” (“Të primitë përpara letërarit”) Ashta Lek. IV 370.

Në të folmet popullore del si term etnografik *ungj-i* “vëllai i babës, axha” (Luli *Kanuni* 42). E ka këtë fjalë edhe *Bashkimi* 505. Në Mirditë *ugj-i* “ungj, xhaxha” (DSH IV 125). Në folklor *unkël-i* “ungj; vëllai i babait a i nënës” (*Folklor* I 537). Te arbëreshët e Italisë *ungëlj-i* “ungj”, *unkëlj*, *ungjëll* (Kamsi *Fjalor arb.-shqip* 291). Në letërsinë artistike, te *Lahuta* (f. 572) e Fishtës *ungj-i* “axhë, xhaxhai”.

Në “Fjalorin italisht-kroatisht-greqisht-shqip-turqisht” të Julije Bullatoviqit, viti 1693 (HD nr. 5-6, 1994, f. 98) italishtja “Barba” përkthehet në shqipe “Ungie” (“ungj”); khs edhe Kastrati *Albanologjia* 138.

Te fjalori i Da Lecces 842 krahas *ungj* “zio”, del edhe tjetra *ungull* “zio”.

Dihet që *ungj* e shqipes është huazim nga lat. *avunculus* (shiko E. Çabej SGJ II 247, me gjithë bibliografi). Ndërkaq, zhvillimet fonetike nga *avunculus* : *ungj* paraqesin disa vështirësi.

Që nga G. Meyeri (*Gröb. Gr.* I 816) e këtij dihet që mbylltoret e pazëshme /b/ /d/ /g/, kur kanë qenë në vendosje ndërzanore, në gjuhën shqipe kanë rënë. Me gjithë revizionimet, përjashtimet e përmirësimet e mëvonshme, kjo rregull ende mbetet në fuqi.

K. Topalli (*Sist. bashk.* 119) mendon se rregulla e mësipërme duhet ndrequr në atë mënyrë që ajo ka vlerë për bashkëtingëlloret e zëshme /b/ /d/, por jo për grykoren /g/; ndërkaq në radhën e atyre bashkëtingëlloreve që kanë rënë në këtë vendosje duhet shtuar fërkimorja e zëshme /v/. Për të konkretizuar mendimin e vet, ai rreshton tani si shembull

edhe *ungj* të shqipes nga lat. *avunculus*, duke shtuar se kjo rënie ka ndodhur para se të binte zanorja *a* në ballë të fjalës (po aty, f. 131). Gjithashtu Topalli (po aty, f. 167), për të vërtetuar kalimin e grykores së shurdhët /k/, që kthehet në /g/, sjell si shembull edhe *ungj* të shqipes nga lat. *avunculus*.

Duke u mbështetur sa më sipër mund të paraqesim kështu zhvillimin nga lat. *avuncul* në *ungj* të shqipes: **āvūncūl-* > **aūncul-* > *ēūnkēl-* > **ūnkl-*. Me këtë zhvillim fjala e latinishtes duhet të kishte përfunduar në shqip *ynkj-* > *ynq-* > *yngj-*.

Duke marrë parasysh që *ungj* “Është një fjalë me të cilën shqipja merr pjesë në latinitetin perëndimor dhe në lindorin” (E. Çabej SGJ II 247), në njërën anë dhe se nëpër mbishkrimet latine të provincave romake të ndryshme dalin trajta popullore *aunculo aunculus*, duhet detyrimisht të mendohet për rindërtimin e një baze vetëm për shqipen. Ne mendojmë që një bazë **uncul-* (me rënien e hershme të rrokjes së parë gjithsesi paratheksore), do të përligjte dukuritë përkatëse fonetike në zhvillimin e tyre normal.

Me interes është edhe ndjekja në kohë e zëvendësimit të kësaj fjale nga latinishtja me huazimin turk “xhaxha”, punë që do të ketë ndodhur rreth shek. XVII.

virgjër (*i, e*) “1. Që nuk ka pasur kurrë marrëdhënie seksuale me dikë ...” (*Fjalor* 1980, f. 2168). Aty edhe rrjedhojat *virgjërësh/ë, ~a* “vajzë e virgjër ...”, *virgjëri, ~a* “1. Të qenët e virgjër ...”, *virgjëror, ~e* “1. Që shpreh virgjëri ...”

Fjalë e mbarë gjuhës. Del së pari te Buzuku si emër *virgjën-a* lat. *virgo-ginis* “*Virgjëna e shekruome*”, Meshari X/1, 17; “*je lëm n virgjënet*”, Meshari IX/1, 13. Aty edhe *virgjinitat-i* lat. teksti *virginitas-atis* “*për virgjinitatit të Zonjës shenë Mëri*”, Meshari X/4, 19. Te Matrënga *virgjërë-a* emër, lat. *virgo-virginis*, “*virgjërë*” 5 = “*vergine*” (Ashta Lek. II 88). Te Budi *virgjënë-a* emër, lat. *virgo-virginis*, “*(janë) disa virgjëna, disa të martuome*” S 2 (Ashta Lek. II 304). Aty edhe *virgjinitat-i*, lat. librore *virginitas-atis* “*virgjinitati*” S 284; “*shinifikon virgjinitatnë*” R 177. Te Bardhi *virgjënë-a* emër, lat. *virgo-ginis*, “*virgo: virgjënë*” 184 (Ashta Lek.

III 184). Te Bogdani *virgjinë-a* emër, lat. *virgo-virginis*, “*prej virgjinash*” I I, IV, 21; “*vergine*” (Ashta Lek. IV 377). Aty edhe *virgjini-a* “*ruejti virgjeninë (e) vet*” I III, VII, 3: “*verginita*”; “(ruajti) *virgjininë*” I III, I, 7; *virgjinueshim (i)* “*i virgjinueshim*” I III, VII, 5: “*verginale*”. Te Kuvendi i Arbënit, *virgjinë-a* emër, lat. *virgo-virginis*, “*virgjin prej virgjinet*” 18 (Ashta BSHSH 1, 1982, f. 110). Te Gjon N. Kazazi “*virgjin*” 7 (Ashta BSHSH 1, 1973, f. 97).

Në “Fjalorin italisht-shqip” (“*Dizionario Italiano d’Albanese*”) i vitit 1710, që ruhet në manastirin e Grottaferratës nën shenjën *Zoccolanti* 425, fjala italishte *Vergine* përkthehet në shqipe “*Virghine*” (f. 17 e origjinalit).

Te fjalori i Da Lecces 849 dalin *virgjinë* “*vergine*”, *virgjinëzë* dhe *virgjinë*.

Te fjalori i Bashkimit 494 *virghen*, *virghni*; *virghin-a*, *virghineshë*, *virghinii*, *virghinisht*.

Del si term etnografik, *virgj/in, ~na* “quheshin kështu vajzat që vendosnin të mos martoheshin dhe mbanin veshje burrash”, *Virgjinat (femnat që veshen si burrë) s’veçohen prej grash tjera (E drejta zakonore 543)*. Në Kanunin e Skënderbeut (Luli 44) *virgjinëshë-a* “*vajza që rrin pa u martue, banon te prindt e vet, veshet me pantallona si burrë dhe pret flokët*”, *Virgjinëshat në kuvend të katundit dhe kudo njeti, rrijnë me burra*.

G. Meyeri EW 470 merr në analizë trajtën *vërgjëri* (geg. *virgjinë*), dhe e bie si huazim prej lat. *virginem*.

Ashtu siç kemi thënë edhe për raste të tjera të huazimeve latine, del e nevojshme të saktësohet se nga cila trajtë e latinishtes vulgare është huazuar në shqipe. Përndryshe, duke operuar me trajtën e latinishtes klasike, mund të zbatojmë rregulla që nuk përlijen me fonetikën historike të shqipes.

Së pari, duhet shënuar që *Fjalori* 1980 e ka mënjanuar emrin *virgj/ën, ~na* të gegërishtes, si edhe tjetrën të toskërishtes *virgjer-a*, të cilën e jep *Fjalori* 1954. Këto dy fjalë dalin edhe te autorët e vjetër. Për etimologjinë dalja e këtyre dy trajtave ka rëndësi të madhe për të përcaktuar rrjedhojat e tyre, që

përndryshe, duke u mbështetur te *Fjalori* 1980, do të niseshin në mënyrë të gabuar nga mbiemri (*i, e*) *virgjër*.

Së dyti, dukuria fonetike *i > e* (khs. lat. *viridis*, *viridis*: shq. *i verdhë* etj., por edhe lat. *fides* : shq. *fë*, lat. *vitium* : shq. *ves* etj.), nuk është zbatuar te lat. *virginem*. K. Topalli (*Sist. zanor* 59 v.) mendon se ky shndërrim fonetik nuk i përket shqipes, por është veçori e latinishtes vulgare. Sipas Topallit, shqipja i mori këto fjalë nga një idiomë latine, ku /i/-ja e shkurtër kishte kaluar në zanoren /e/, ose kishte filluar hapjen e saj drejt kësaj zanoreje. Në të mirë të vërtetimit të mendimit të vet, ai sjell faktin që /e/ e dalë nga një /i/ e shkurtër e latinishtes vulgare nuk është diftonguar në shqipe në /je/, ashtu siç ka ndodhur me /e/-në e shkurtër të trashëguar.

Në qoftë se Topalli ka të drejtë, atëherë për fjalën shqipe *virgjën* duhet vendosur një bazë **vérgin-* nga një fjalë e latinishtes mesjetare **verginem*.⁴²

KU SHTRIHEJ KANUNI

Thuhet se Sh. Gjeçovi, normat kanunore që botoi, i pat mbledhur kryesisht në Mirditë dhe diçka në Kurbin. Një pjesë e mirë e këtyre normave janë të Kanunit të Skënderbeut. Kjo afri, sipas Ulqinit, shpjegohet se Kurbinin e pjesërisht Mirdita qenë përfshirë në zotërimet e Kastriotëve.⁴³

Tani, në qoftë se problemi do të vështrohet në pikëpamje gjuhësore, do të vëmë re se të gjithë kanunet e botuara⁴⁴ (së

⁴² Për etimologjitë e mësipërme, shiko hollësitë te D. Luka SGJ X; aty edhe shkurtimet e përdorura për bibliografinë (ndër kllapa), në f. 15 v.

⁴³ K. Ulqini *Terma* 134.

⁴⁴ *Kanuni i Skanderbegut*, Mbledhë e kodifikue nga Dom Frano Illija, Editrice La Rosa, Milot, 1993.

bashku me variantet e tyre),⁴⁵ ngjasojnë në tërë fjalorin që përdorin për të shprehur termat kanunore. Këtë ngjasim e pati vënë re K. Ulqini, kur shkruan se “pjesa esenciale e terminologjisë është e përbashkët, është kombëtare, sikurse vetë Kanuni i Skënderbeut dhe i L. Dukagjinit, janë pjesë nga e drejta e popullit shqiptar e trashëguar nga lashtësia, e zhvilluar dhe e pasuruar gjatë shekujsh”.⁴⁶

Nuk është e rastit, pra, që Gjeçovi e emërtoi veprën e vet “Kanuni i Lekë Dukagjinit”. Ai ngjan ka qenë i ndërgjegjshëm që, megjithëse mbledhjet i ka bërë kryesisht në Mirditë e në Kurbin,⁴⁷ ato përfaqësonin pothuaj krejt krahinat e veriut të vendit: Mirditë, Malësi e Madhe, Dukagjin, Postribë, Malësi e Gjakovës, Kurbin, Benë, Mat, Dibër, Lumë, Kthellë.

Për sa më lart vjen në vështrim një dorëshkrim i Gjeçovit në dy motërzime; njëri i titulluar “*Plangu i Dukagjinëve - vende qi thirren me emen t’Dukagjinëve*” dhe, tjetri, “*Vende që përkujtojnë Dukagjinët*”, që ruhen në arkivin e bibliotekës “Marin Barleti” në Shkodër. Etnologu K. Ulqini, që e botoi këtë dorëshkrim, shprehet: “Shtjefën Gjeçovi i hulumtoi toponimet në djepin e Dukagjinëve, në Pejë, Malësi e Gjakovës, Has dhe Pukë, ku në përgjithësi burimet historike

⁴⁵ Xhemal Meçi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit* (Varianti i Pukës), Tiranë, 1997. Xhemal Meçi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit* (Në Variantin e Mirditës), Tiranë, 2002.

⁴⁶ K. Ulqini *Terma* 134 v.

⁴⁷ Rreth viteve 1900 nis punën e tij patriotike për mbledhjen e visarit popullor (tradita, gojëdhëna, përralla etj.), të cilat do t’i japin lëndën e parë për veprat e mëvonshme e veçanërisht për kryeveprën e vet, Kanunin e Lekë Dukagjinit. Botimi i Kanunit nis në numrin e parë të “Hyllit të dritës” (tetor 1913).

Në shënimet që ka lënë e që ruhen në Arkivin e Shtetit, ai në vitin 1900 shkruan në ballë të njëres prej këtyre fletoreve: “Laç-Sebaste-Kurbin. Fjalë, shprehje popullore, krijime fjalësh të reja”. (Khs. këtu fjalë të rralla si: *kerlesh, bershë, fjoll, gazhel, katralesh, katrosh, laresk, katrasyll, rrmang* etj.). Në këto fletore ai ka lënë edhe një numër të madh shënimesh për emra njerëzish, emra botanikë, emra orësh e zanash (të mbledhura në krahinën e Kurbinut), një pjesë prej të cilave edhe i botoi në revistën “Albania”.

përputhen me gojëdhënat popullore. Përmes bajrakëve të Mirditës (Spaç, Kushnen, Fan, Orosh e Dibër) gjarpërojnë kufijtë e principatave të Kastriotëve e të Dukagjinëve.”⁴⁸

Ngjan që fillimisht të kemi pasur një kanun të përbashkët për të gjithë Shqipërinë e Veriut. Nevoja për një kanun të tillë duhet të ketë nisur në kohën e Skënderbeut, po gjithsesi mbështetur në një strukturë të mëparshme, prej së cilës duhet të jenë trashëguar norma kanunore të asaj kohe. Më pas pushtimi turk vendosi një organizim të ri ushtarako-administrativ. Vendi në atë kohë u nda në vilajete, ku zbatoheshin kanunat e pushtuesit. Prej këtij organizimi u vendos edhe emërtimi *kanun-i*, huazuar nga turqishtja.

Ne, pa u shtyrë aspak në analizën e termave, në thelbin e tyre etj., do të mundohemi të japim ndihmesën tonë vetëm me mjete gjuhësore.

Në Kanunin e Lekës vërehen disa tregues gjuhësorë, që i përkasin të folmes dialektore të Mirditës. Khs. këtu:

mêtuajt (të) 78 “të miturit; të vëgjël; fëmijë me moshë të vogël” (*Shka të bâjn të mêtuajt / mêcat /*). Të *mêtuajt* është trajta mirditore e të *mituajt* me shqiptimin *i : ê*, krakteristikë e të folmes së krahinës.

mêc, -i 78 “djalë i vogël; djalë i ri (fjalë e përdorur zakonisht në të folmen e Mirditës.)” (*Shka të bâjn të mêtuajt / mêcat /*). *Mêc* është trajta mirditore e fjalës *mic* “djalë.”⁴⁹

Për prapashtesën *-aj/ë* te shembujt e mëposhtëm, Xhuvani-Çabej shkruajnë: “Më të shumtat e fjalëve me *-ajë* janë të gegërishtes veriore, dhe ka të ngjarë që përhapja e kësaj prapashtese të ketë filluar nga ato dialekte të Veriut, si

⁴⁸ K. Ulqini, *Toponime*, “Kundrime” 161 v.

⁴⁹ *Mêc* është trajta mirditore e fjalës *mic* “djalë” (E. Çabej SE V 342).

Mirdita, që e diftongojnë *-i-në* në *-aj*; kështu trajtës *lisnajtë* në disa vise të Veriut i përgjigjet trajta *lisnî*.⁵⁰

arnaj/ë, -a 40 “arë-a; toka buke; toka të punueshme” (*ndermjet dy arnajve*).

pëmaj/ë, -a 41 “pemishte; vende me pemë frutore” (*nder veshita e nder pëmajë*).

vijnaj/ë, -a 46 “*shum.* i *vijë-a*; tërësia e vijave të ujit a vijave që përdoren për vaditje” (*Vendet neper të cillat kalojnë vijnajet*).

Këta e të tjera si këta, veçanërisht në mënyrën e të shprehurit të figurshëm, janë të shumta në Kanunin e Lekë Dukagjinit, që tregojnë se Gjeçovi është mbështetur kryesisht në krahinën e Mirditës.

Në një krahasim të bërë ndërmjet fjalorit të nxjerrë të Xh. Meçi (për Mirditën dhe për Pukën) me atë të Kanunit të Skënderbeut (nxjerrë nga F. Luli) vëmë re se në thelbin e tyre fjalët e rreshtuara aty janë pothuaj variante të të njëjtit kanun, atij të Lekë Dukagjinit. Bile në disa raste jo vetëm fjalët tituj janë të njëjta, po edhe shembujt që sillen për t’i konkretizuar, janë të njëjlojtë; khs. *almistrat*: te Gjeçovi *almistra qesh*; te Meçi *Qetë nuk mjellin pa almistrat e vet*. Te Gjeçovi *am / ë* (*po kje e bleme me amë e me plang*); te Meçi (*Vija e bleme me amë e me plang bahet e blesit*).

Poshtë po rreshtojmë një pjesë të fjalëve tituj të variantit të Mirditës (Meçi), të variantit të Pukës (Meçi) dhe të Kanunit të Skënderbeut (F. Lulit), që dalin të përbashkëta me Kanunin e Lekë Dukagjinit:

Mirdita (Meçi): *bajrak, barrë, bashkarî, betâr, brac, dahe, damçor, derk, detyrës, dypërnja, eshkë, famullî, gatojcë, grazhd, grosh, gurapesh, gjâ, gjak, gjakhupës, hu, hutë, ndërmjetës, ndore, okë, opangë, pashtrak, peng,*

⁵⁰ Xhuvani-Çabej *Prap.* 430.

pleq, pleqnár, porotë, pré, pretár, rême, rrjedhë, sanë, sedi, simahor, strafulec, shpez, shpijar, tagër, tërkuzë, tumirë, ujem, um, ungj, valanicë, varrë, virgjin, vurgnue, xanë, zhibël etj.

Puka (Meçi): *apangë, bajrak, barrë, bashkarí, bé, betár, brez, burrim, cará, magjatore, marre, mih, ndore, pashtrak, peng, pjestar, plang, qese, sterplak, shkues, tagër, tym, thekprrem, ujem, um, vegjëllí, (e) vejë, xanë etj.*

Kanuni i Skënderbeut (Luli): *almise, arnajë, bakeq, barrtor, batore, bé, berr, berrejshëm, bëzaj, (e) bujtme, bukëdhanës, cub, derk, desharë-t, deshtas, djerrje, dorzanë, dredh, dhetim, fikë, fisnikí, gand, gergás, grabí, grazhdoj, gjá, gjak, gjakhupës, gjamë, gjamatar, gjini, gjobtar, gjojë, hekurishte, hjekës, hjekësi, hú, jagëz, (i) jetosun, jezulli, kallcikë, kapercell, kaptinë, kapucár, karmoj, kasnec, katundisht, kërcik, kjor, kofën, kori, kryekcyem, kryegjá, kujrí, lagje, lak, lás, leçitë (me), magjetare, mdheckë, mangore, mje, moh, mort, mriz, mrizoj, mtí, muranë, ndërmjetës, ndërmjetësi, ndore, ngarkicë, opangë, papërdhok, paronik, parotë, pashtrak, përtekë, përcjellës, perkae, plang, plirje, pré, pretarë, prije, rême, ride, rob, rrill, simahuer, straplak, shëngjetë, short, (i) shpifun, tagër, tamza-t, telonza, tërkuzë, ujem, ungj, vade, valenicë, vogjlí, xanë, zhibla etj.*

KANUNI I LEKË DUKAGJINIT, PASQYRË E GJUHËS SHQIPE TË KOHËS

Përgjithësisht për Kanunin e Lekë Dukagjinit, burimi më i rëndësishëm mbetet përmbledhja e Shtjefën Gjeçovit.⁵¹ Gjeçovi ka bërë punë pionieri, pa pasur modele ku të mbështetej. Atë e ka shtyrë kryesisht dëshira për të vërtetuar lashtësinë e popullit tonë si edhe mënyrën e vetëqeverisjes së tij gjatë kohëve. Dhe këtë punë ai e ka bërë në mënyrë të

⁵¹ K. Ulqini *Terma* 112.

përkryer, duke na dhënë pasqyrën e saktë të pasurisë gjuhësore të shqipes, me një fjalor të pasur e me një stil e mënyrë të shkruarit për t'u pasur zili. Nuk ka në krejt Kanunin asnjë përkufizim të paqartë apo që nuk kuptohet. Aty, me një gjuhë shpesh figurative, shprehen detaje e norma kanunore, të cilat do t'i kishte për gjedhe çdo kod civil a penal i sotëm. Prandaj shpesh Kanuni emërtohet si "*Kushtetutë*" e këtij vendi. Në këtë drejtim duhet kuptuar edhe kritika, që Gjeçovi "ka bërë zëvendësimin apo përkthimin e disa termave të huaj në shqip."⁵²

Gjeçovi nuk ka bërë as zëvendësime termash e as përkthime të tyre. Përkundrazi, ai ka bërë vetëm sqarime, duke përdorur kllapat. Si shembull mund të përmendet këtu fjala *testamend* (mos me *bâ testamende*). Fjala *testamend* ngjan të jetë përdorur prej Gjeçovit si term juridik, të cilin vendësit nuk ia kanë ditur as emrin dhe as nuk do ta kenë dëgjuar ndonjëherë. Ndërkaq, Gjeçovi, vë pranë fjalës *testamend*, tjetrën, të përdorur po si term Kanuni: *të lanunat*. Kemi, pra, një neologjizëm të përdorur nga Gjeçovi në mënyrë të ndërgjegjshme, për të sqaruar juridikisht termin që ai përdor në Kanun (*të lanunat* = *testamend*).⁵³

Krahas dubletave *bajraktar* (flamurtar); *bajrak* (flamur)⁵⁴ mund të përmendim këtu: *bâna* (qela) e famullitarit (1); *Me qillue se shtyhen me besat* (forcade), *ka ndollë* (16); *Gjeli* (knduesi-kadoci)/ (80); *Knduesi âsht herori* (sahati) *i të vorfnit* (80); *huta* (martina) (54); *këmesa e terkuza* (teja) *i mirret* (75); *qêtha, vjedra* (mjelca), *mtjË*,

⁵² K. Ulqini *Terma* 112. Aty shënohet se "... kritika ka bërë vlerësime dhe ka vënë në dukje disa të meta të asaj vepre. Përsa i përket terminologjisë, mund të themi se mbledhësi i kanunit, në përputhje me konceptet e gjykimet e tija historiko-shoqërore ka bërë zëvendësimin apo përkthimin e disa termave të huaj në shqip etj." Khs. edhe F. Nopça *Shqipëria* 291 v.

⁵³ Shiko për këtë "kapitullin e nandët", KLD 27. Gjithashtu edhe shën. nr 187 te pjesa *Fjalori*.

⁵⁴ KLD 30 (khs. *per nderë të mârrun ká 500 grosh gjobë Flamurit /Bajrakut/*).

vegsha, vorba, kuça (24); të lanunat **me barrë** (*me detyrë*) (28); *Shka të bâjn të mëtujt* (*mêcat*) (78); *Tagri i parbinís* (*djalit të parë*) (23); *me pretue* (*me marrë prë*) (23); *vada* (*rendi i ujit*) (23); *me vjellë flakë grykëholla* (*pushka*) (85) etj. Siç shihet, sqarimi i fjalëve në një dubletë, është në metodën e punës së Gjeçovit.

Gjeçovi nuk punon vetëm si shkencëtar-etnograf. Ai në radhë të parë është atdhetar i flakët. Dhe nuk ishte i vetëm.

Teza për të paraqitur në mënyrë autentike jetën, gjuhën e mendësinë e malësorëve të Veriut ka qenë moto e një katërshe të goditur të klerit katolik të Shkodrës: Gjergj Fishtës, Bernardin Palajt, Donat Kurtit dhe Shtjefën Gjeçovit.

I pari, Fishta do të përpiqej që në veprën e vet “Lahuta e Malcís” të shtjellonte jetën e banorëve të Malësisë së Veriut të vendit, për të vërtetuar se aty gjallonte ende fryma e lashtësisë së këtij kombi. Është pikërisht këtu vendi që të ripërsërisim se Fishta ishte i bindur se duke sjellë në *Lahutë* këngën e malësisë, po i shërbente kombit duke ringjallur frymën, zërin e fjalën e të parëve të vet. Nuk bëhet fjalë pra këtu për “çështje ekzotike”, po për “çështje kombëtare”, sepse për Fishtën “palca etnike ilire” ruhej gjithnjë e pastër dhe e paprekur në malësitë e Veriut. Pra, ai që i ndërgjegjshëm se duke ringjallur këtë frymë kombëtare, po kryente një detyrë të shenjtë.⁵⁵

I dyti, Palaj, folklorist dhe mbledhës i apasionuar i këngëve të kreshnikëve, pati rastin të njihej më së miri me gjuhën e mrekullueshme të këtyre vlerave popullore të papërsëritshme. Prandaj fjalori i veprës poetike të Palajt paraqet interes të veçantë për studiuesin, sepse reflekton gjuhën e pastër të maleve (atë kohë të virgjër) të Veriut të vendit.

I treti, Donat Kurti, doktor shkencash, i dalluar jo vetëm si shkencëtar i mirëfilltë, por edhe si njeri për t’u mbajtur mend jo vetëm si erudit, por edhe si modeli i thjeshtësisë, që karakterizon dijetarët e vërtetë, ka qenë mbledhës i apasionuar

⁵⁵ D. Luka, *Ndihmesa e Fishtës për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe*, në rev. “Studime filologjike”, nr. 1-2, 2001, f. 78 v.

i folklorit e, më pas, studiues i tij. Ka lënë pas një numër veprash. Dallohen këtu dy vëllimet e “Prrallave Kombtare”. Ka lënë në dorëshkrim një arkiv të tërë me lëndë të pasur folklorike si përralla, legjenda, fjalë të urta e gjëgjëza dhe një fjalor frazeologjik, punuar gjatë viteve të burgut, ku qëndroi plot 17 vite, natyrisht pa pasë bërë asnjë faj, por vetëm sepse ishte klerik dhe se kishte punuar me mish e me shpirt për të ngritur sa më lart kulturën e atdheut të vet.

I katërti, Gjeçovi, dallohej në punën e tij të madhe për mbledhjen e “Kanunit”, ku përveç anës juridike, paraqiste interes të veçantë gjuha e kësaj vepre monumentale për kombin tonë.

Kemi këtu katër autorë të mëdhenj, që na lanë si trashëgim të vyer katër kryevepra kryesore,⁵⁶ të cilat do të qëndrojnë gjatë në themelet e kulturës shqiptare, sepse jo vetëm i bënë ballë kohës, por edhe i kanë shërbyer përparimit të vendit e kulturës së tij.

Vepra e Gjeçovit mund dhe duhet të vlerësohet në tri drejtime.

Së pari ajo është vepër me vlerë kombëtare, sepse rreh të paraqesë para botës tiparet morale të një populli të vogël, po me merita të mëdha, duke i dhënë vendin që meriton në historinë e rajonit, e më tej.

Së dyti, është objekt i studimeve juridike, duke i treguar botës se ky popull i vogël, kishte vendosur dhe i mbronte me norma juridike të drejtat e njeriut, të cilat i kishte shpallë para revolucionit frëng. Për shqiptarin të gjithë njerëzit ishin të barabartë, sepse: *“Çdo njeri në kandar të vet peshon 400 derhem; i miri dhe i keqi shkojnë nja për nja”*.

Së treti, është objekt kulture, sepse përfaqëson (ndërmjet tjerash) edhe gjuhën e gjallë popullore që arrinte të shprehte pa asnjë keqkuptim edhe normat më të vështira e më të ndërlikuarat, që përcaktonin të drejtat popullore të kohës.

⁵⁶ “Lahuta e Malcís” e Gj. Fishtës; “Visaret e Kombit” të B. Palajt; “Prralla Kombtare” të D. Kurtit dhe “Kanuni i Lekë Dukagjinit” i Sh. Gjeçovit.

Nuk kam gjetur në krejt Kanunin asnjë nen (a shprehje), që të mos jetë krejtësisht i qartë, dhe jo vetëm kaq, por edhe i shprehur bukur edhe nga ana e formës, duke u përdorur mjete gjuhësore të figurshme, të cilat e saktësojnë më tej thënien. Vetëm ai që ka jetuar për një kohë të gjatë në këto zona, ku është mbledhur Kanuni, mund ta dallojë se gjuha e tij është krejtësisht pronë e popullit,⁵⁷ Gjeçovi vetëm e ka mbledhur atë. Dhe këtë punë e ka bërë në mënyrë të përkryer.

SA I VJETËR ËSHTË KANUNI

Duke u nisur nga emërtimi i kanunit, që i kushtohet një personi historik të kohës së Skënderbeut (Lekë Dukagjinit) e në të njëjtën kohë kanunit tjetër, emërtuar i *“Skanderbeut”*, ngjan që këto kanune kanë qenë në përdorim të plotë veçanërisht gjatë e pas pushtimit turk të vendit. Etnografi K. Ulqini shkruan: “Nga terminologjia që njohim në kanunet, nuk del gjëkund të ketë terma të shoqërisë fisnore. Vetë normat e kanunit nuk janë të asaj shoqërie. Por nëpërmjet të terminologjisë gjegjë gjurmët e disa instituteve të stërlashta

⁵⁷ B. Demiraj (*Fé dhe Të prémt e fés*, HD 1, 2016, f. 121) do të shkruajë: “Parë nga perspektiva e albanologjisë si shkencë gjuhësore-filologjike, në këtë larmi variantesh të Kodit Zakonor Shqiptar - kushtëzuar sigurisht prej kohës së fiksimit të tyre në shkrim, ashtu edhe prej zonës etnografike ku vepronte njëri apo tjetri syresh - gjëllin një thesar i vyer gjuhësor, i mbledhur drejtpërsëdrejti prej traditës gojore, krehja e të cilit lejon, ndër të tjera, shqyrtime dhe përsiatje me karakter të mirëfilltë etnolinguistik, pra mundëson nergut rindërtimin e historisë së mbrendshme që kanë përjetuar e përjetojnë sot njësi të tilla leksikore me përdorim leksikor specifik (vetëm?) në diskursin popullor të jetës zakonore shqiptare.”

që qenë karakteristikë e shoqërisë fisnore patriarkale të një kohë të largët shumëshekullore.”⁵⁸

Në paragrafin (§) 492 të Kanunit të Lekë Dukagjinit shkruhet: “Kanûja e hershme - si edhe e kohve të vona në shum rasë - nuk ká pasë njoftë çmime të hollash e detyrët laheshin me “gjâ çdo gjâ.”⁵⁹

Sa më sipër vërteton se jo vetëm “në kohë të hershme”, por edhe “në kohët e vona” *gjâ*-ja ka qenë etaloni (a njësia) e shkëmbimeve ndërmjet njerëzve. Ngjan që një ndër mbeturinat e kësaj kohe ka qenë pazari që i bëhej *kaut me hû*, i cili jepej hua kundrejt një çmimi një barrë drithë (150) kg.⁶⁰ Këta shembuj janë tregues të një ekonomie natyrale, kur paraja ende nuk përdorej si mjet shkëmbimi.

Ndërkaq, ne do të përpiqemi të bëjmë analizën gjuhësore të leksikut të Kanunit të Lekës, nëpërmjet shtresëzimit të tij, duke ndarë fjalët e vendit nga huazimet. Gjithsesi duhet thënë që në fillim që në këtë fjalor kemi të bëjmë në shumicën e rasteve me terma që kanë përgjegjëset e tyre fillestare në fjalorin e gjuhës shqipe. Nuk mund të flitet, pra, për fjalë me burim indoevropian në Kanun, kur ajo del si njësi leksikore në fjalorin e gjuhës shqipe.

Si shembull po marrim fjalën *barrë-a*, e cila pa asnjë dyshim është me burim të lashtë indoevropian.⁶¹ Ky përfundim ka vlerë përgjithësisht për gjuhën shqipe, për të vërtetuar prejardhjen indoevropiane të saj. Në këtë drejtim *barrë-a* e Kanunit në të gjitha trajtat e kuptimet e përdorimit të saj:

barr/ë, -a 1 “detyrë; detyrim për t’u kryer” (*Kanûni s’mund t’i vëjë kurrnji barrë kishës*).

barr/ë, -a 22 “masë peshe që përdoret kryesisht për drithrat” (*tri barrë drithë*).

⁵⁸ K. Ulqini *Terma* 124 v.

⁵⁹ KLD 54.

⁶⁰ KLD 34.

⁶¹ Khs. E. Çabej SE II 173. Shiko edhe B. Demiraj AE 92.

barr/ë, -a 89 “*barra* e gruas; shtatzânia; (gruaja që është) me barrë” (*i a presin edhe barrës tri qese*).

barrt/uer, -ori 45 “(punëtori) që ban barrë drithi prej një vendi në një tjetër; ai që çon barrë drithi nëulli” (*mos t’u hupë gjâ barrtorve*),

nuk paraqet asnjë shenjë vjetërsie. Në Kanun ka ngjarë një shpërbërje polisemike; fjala e shqipes ka pësuar një specializim kuptimi, duke dhënë fjalë e kuptime të mbartura, që kanë vlerë vetëm për termat e krijuara me këto fjalë. Vetëkuptohet që fjalët e prejardhura, janë formime përbrenda shqipes e, përgjithësisht, me mjetet e vetë gjuhës. Fjala *barrë* në gjuhën shqipe ka një numër të madh kuptimesh e përdorimesh të ndryshme, ndër të cilat veçojmë: ngarkesa e një kafshe a e një punëtori; (grua) shtatzânë (“grua me barrë”); detyrë a detyrim për t’u kryer etj.⁶²

Ndërkaq, fjalët (a termat) që shënojnë thelbin e familjes (*atë, amë - ëmë, bir - bijë, vëlla - motër, djalë - vajzë*) e që janë me burim indoevropian, duhet detyrimisht të vështrohen dhe të analizohen si autoktone, duke treguar se institucioni i familjes jo vetëm ka qenë i formuar mjaft herët, por gjithsesi krahas me popujt e tjerë indoevropianë.⁶³

⁶² Fjalor 1980, f. 108 v.

⁶³ Shiko hollësitë te D. Luka SGJ X, veçanërisht *Hyrjen*. K. Ulqini *Terma* 123 shkruan: “Në kanunet gjejmë të rreshtuara një sasi termash farefisnore e familjare, si: *burrë, grue, vlla, motër, dajë, axhë, ungj, teze, emtë, tatë, babë, nanë, kushri, vllazni* etj., që i përkasin të drejtës familjare. Një pjesë e rëndësishme e kësaj terminologjie është e huajtur sidomos nga latinishtja. Duhet shënuar se mungon një term adekuat me *zadruga*. Termi “shpi e madhe” tregon një familje me shumë meshkuj dhe e fuqishme ekonomikisht e jo një organizim familjar-kushrinor.”

Gjan që autori ka pasur parasysh studimet që kryhen sot në këtë fushë të dijes. Trajtimi gjuhësor i termave të farefisnisë prej disa kohësh bëhet nën udhëheqjen e antropologjisë. Edhe vetë Szemerényi e Benveniste nuk

Në mënyrë të veçantë duhet të analizohen huazimet në Kanunin e Lekë Dukagjinit, sepse nëpërmjet tyre mund të nxirren përfundime të rëndësishme për shumë probleme që deri më sot kanë mbetur pezull.

Së pari me huazimet turke (përkat. orientalizmat). Këto huazime tani mund të diktohen me siguri jo vetëm nga etimologjitë e E. Çabejt, por edhe më saktësisht, nëpërmjet *Fjalorit* të orientalizmave të T. Dizdarit, ku krahas gjuhës parësore, së cilës i përkasin (persisht, arabisht etj.), jepet edhe gjeografia gjuhësore, shpesh edhe me përfshirjen e tyre në Kanunin e Lekës.

Në fjalorin, që pason studimin e K. Ulqinit (prej 500 lemesh), autori dallon gjith. 50 orientalizma (përkat. huazime nga turqishtja), që përbëjnë 10% të krejt fjalorit. Ne, në mbi 960 fjalë lema, të nxjerra nga Kanuni i Lekës, kemi dalluar gjith. 26 huazime të tilla, rreth 3%.

Meqë te Fjalorthi i Ulqinit janë vjelë dy kanune, diferenca prej 24 huazimeve i takon Kanunit të Skënderbeut.

Te mbledhjet tona doemos duhet që paraprakisht të bëhet një ndarje e atyre huazimeve që janë të mbarë shqipes e që nuk kanë lidhje me të drejtën popullore, ndaj atyre që i kanë këto lidhje, sepse vetëm këto të fundit mund të bëhen objekt studimi.

i shpëtojnë kësaj prirjeje, që nuk është tjetër veçse kërkimi ndërmjet popujve më të ndryshëm i modeleve të strukturave familjare, për t'iu afruar kuptimit të strukturës së hamendësuar të familjes indoevropiane e për të shpjeguar lidhjet e brendshme e të jashtme të vetë emërtimeve gjuhësore (shiko Onofrio Carruba, *Il lessico indoeuropeo della famiglia*, në rev. "Ars linguistica", Roma, 1998, f. 129 v. me gjithë bibliografi). B. Delbrück ka shprehur mendimin se *familja indoevropiane* ka pasur një strukturë të njëjtë me "familjen e madhe", që ruhej ende në kohë të tij te sllavët e Ballkanit (shiko B. Delbrück, *Die indogermanischen Verwandtschaftsnamen*, Leipzig, 1889; cituar sipas Campanile *Introduzione* 20).

HUAZIMET TURKE TË KANUNIT TË LEKË DUKAGJINIT

<i>angari</i>	<i>futë</i>	<i>parà</i>
<i>bajrak</i>	<i>gajret</i>	<i>pusí</i>
<i>bajraktar</i>	<i>grosh</i>	<i>qese</i>
<i>çibuk</i>	<i>kandar</i>	<i>reng</i>
<i>çoban</i>	<i>kanun</i>	<i>sahat</i>
<i>derhem</i>	<i>kullë</i>	<i>tepsí</i>
<i>dyqan</i>	<i>maraz</i>	<i>vade</i>
<i>ferishte</i>	<i>okë</i>	<i>zagar</i>
<i>fishek</i>	<i>pajë</i>	

Fjalët: *çibuk, derhem, dyqan, fishek, ferishte, futë, gajret, kandar, maraz, reng, sahat, tepsí* janë huazime të mbarë shqipes. Si të tilla nuk mund të bëhen objekt studimi për etnografinë.

Fjalët: *angari, çoban, grosh, kanun, kullë, okë, pajë, parà, pusí, qese, vade, zagar* janë edhe terma kanuni, a të paktën përdorën në Kanun si emërtime që kanë lidhje me normat e tij.

Ndër këto të dytat paraqet interes të veçantë të diktuarit se nga ka hyrë fjala *kanun* në gjuhën shqipe, e cila është përgjithësuar me kuptimin e “përmbledhje ligjesh të pashkruara”. E. Çabej (SE V 36), duke cituar G. Meyerin (EW 174), e bie prej turq. *kanun*, kjo vetë prej greq. së re κανών κανόνας. T. Dizdari (*Fjalor* 494) e përforcon këtë prejardhje nga turq. < arab. *kanún*. Ky emërtim duhet të ketë zënë fill me vendosjen e sundimit turk (përkant. administratës turke) në Veri të vendit, duke u ndikuar tani edhe nga dy fjalë-terma, huazuar nga turqishtja: *bajrak* e *bajraktar*.

Fjala *bajrak-u* në *Fjalorin* e vitit 2006 përkufizohet kështu: “3. *hist.* njësi ushtarake e më vonë administrative në ndarjen tokësore të disa krahinave të Shqipërisë, në vend të

administrimit fisnor patriarkal.”⁶⁴ Ndërsa *bajraktar-i* “hist. kreu i bajrakut.”⁶⁵

Vetëkuptohet se këto njësi ushtarake e, më vonë, administrative, historikisht kanë pasur dy qëllime kryesore: rekrutimin e ushtarëve, që do të shërbenin në ushtrinë turke dhe, vjeljen e taksave.

Mirdita ka qenë më e mbrojtur ndaj pushtimit turk. Së pari, krejt krahina ka qenë e besimit katolik. Së dyti, ka qenë mjaft e varfër dhe nuk paraqiste ndonjë interes të madh për Perandorinë Turke. Së treti, mirditorët shkonin me kënaqësi ndër ekspeditat e ushtrisë turke, sepse kishin përfitime të ndryshme nga kjo punë. Dhe, së fundi, normat e organizimit shoqëror të atëhershëm kanë qenë aq të forta, sa nuk ishte fort e lehtë të ndërhyhej në to.

Në krejt krahinën e Mirditës normat e sheriatit as nuk njiheshin e as nuk zbatoheshin gjëkund. Nuk ka asnjë shenjë që të vërtetojë qoftë edhe ndërhyrjen më të vogël në këtë drejtim. Këtu lidhjet dokesore ishin kaq të forta, sa edhe vetë kisha shpesh nuk mund të çante dot. Shembull për këtë janë disa prej termave të Kanunit që flasin për *martese jashtë kunore*, kur burri, pasi gruaja e parë nuk lindte fëmijë, merrte të dytën, pa pyetur se një martesë e dytë me gruan e parë gjallë, që e ndaluar nga kisha e asaj kohe. Bile shpeshherë klerikët vendës, që e njihnin mirë psikologjinë e banorëve, mbyllnin njërin sy para rasteve të tilla.

Me këtë ngjan të kenë lidhje edhe fjalët *bajrak* e *bajraktar* që Gjeçovi herë i shkruan në këtë formë e herë i zëvendëson me *flamur* e *flamurtar*. Për Gjeçovin këto dy fjalë ngjan nuk janë terma kanuni, ata nuk regjistrohen gjëkund në Kanun, sepse nuk janë të tilla. Janë dy huazime turke njëlloj si të tjerat. Janë pra emërtime thjesht administrative.

Huazimet sllave kanë një specifike të veçantë, sepse duhet gjurmuar se ku e si kanë hyrë në ato krahina, siç është p. sh.

⁶⁴ *Fjalor* 2006, f. 65.

⁶⁵ Po aty.

Mirdita, me të cilën nuk kanë pasur kurrfarë lidhjeje a takimi as gjeografik e as ekonomik. Në këtë rast që në pamjen e parë, të krijohet bindja se këto huazime të Kanunit janë gjurmë të një administrimi të dikurshëm të shteteve sllave, si ai i Stefan Dushanit etj.

K. Ulqini në mbledhjet e veta regjistron vetëm 3 huazime-terma nga sllavishtja. Në *Fjalorthin* tonë prej 965 fjalësh kemi dalluar 34 njësi të tilla (afër 4%).

HUAZIMET SLLAVE NË KANUNIN E LEKË DUKAGJINIT

<i>beditë (me)</i>	<i>koshiq</i>	<i>rend</i>
<i>bûcë</i>	<i>kotec</i>	<i>rob</i>
<i>carâ</i>	<i>leçitë (me)</i>	<i>sanë</i>
<i>godis</i>	<i>micë</i>	<i>sundim</i>
<i>grabitë (me)</i>	<i>megje</i>	<i>ujem</i>
<i>grazhd</i>	<i>ograjë</i>	<i>vedër</i>
<i>gjobë</i>	<i>opangë</i>	<i>vigâ</i>
<i>kasnec</i>	<i>porotë</i>	<i>vojvodë</i>
<i>kërtollë</i>	<i>porotnik</i>	<i>zabel</i>
<i>konop</i>	<i>prag</i>	<i>zhibël</i>
<i>koritë (me)</i>	<i>prozhëm</i>	
<i>kosh</i>	<i>purtekë</i>	

Duke gjykuar për huazimet e mësipërme diçka mbetet e sigurt, ato janë krejtësisht huazime serbe, të cilat i përkasin kryesisht Veriut të vendit. Shumica prej tyre janë pronë e leksikut të shqipes, pra janë huazime që i kanë kryesisht të folmet veriore të vendit në përdorim të përditshëm të tyre. Disa të tjera kanë hyrë së bashku me objektin që përfaqësonin (khs. *vedër*).

K. Ulqini vë re se në termat e Kanunit “dallojmë një shumicë termash të administratave të ndryshme paraturke, të

cilat... janë gjurmë të gjalla të një pushteti qeveritar të vendosur edhe në zonat e thella malore.”⁶⁶

Shpërbërja e këtyre administratave të hershme, la gjurmë në vazhdimin e përdorimit të disa termave, të cilat me kohë ndërruan edhe kuptimin e përdorimit të tyre, por duke u ruajtur fjala përkatëse në Kanun. Një proces i tillë, siç do ta shohim në vazhdim, ka kapur edhe disa fjalë-terma të kohës bizantine, të mbetura si rudimente të asaj kohe.

Huazimi **porotë** “juri e përbërë prej 24 vetësh” nuk përdoret në leksikun e përditshëm të shqipes. Është fjalë që ndeshet vetëm në Kanun. Pa asnjë dyshim është mbeturinë e organizmit të vjetër serb që duhet të ketë vepruar në zonat e Veriut të vendit. Është huazuar nga serb. *porota* që në shek. XIV-XV njihej si “kuvend i gjykatësve.”⁶⁷

Huazimi **poronik** “ai që shënohej për porotë; anëtar i porotës” është po mbeturinë e organizimit serb të asaj kohe. Në Mirditë përdoret me kuptimin “dëshmitar”. Vjen nga serb. *porotnik* “anëtar i porotës, betar.”⁶⁸

Huazimi **ujem** “mielli ose drithi që i jepet si pagesë mullixhiut për blojën; drithë i përzier.” Fjala përdoret edhe në Jug të vendit, çfarë tregon se kemi një huazim të hyrë në shqipe në Veri nga serb. *ujam* “taksë e mullisit” dhe në Jug nga bullg. *uem*, e të dyja së bashku nga një trajtë më e vjetër *ujьmъ*, e përbashkët për të dyja gjuhët.⁶⁹

Huazimi **zabel** “një vend në pyll a një pjesë pylli, pronë private, që është lënë për të prerë dru për nevoja familjare; pjesë e vogël e një pylli e caktuar për të bërë dru për dimër.”

⁶⁶ K. Uqini *Termat* 117.

⁶⁷ A. Omari *Marrëdhëniet* 237, me gjithë bibliografi.

⁶⁸ Po aty, f. 236.

⁶⁹ A. Omari *Marrëdhëniet* 299, me gjithë bibliografi.

G. Meyeri⁷⁰ e trajton si fjalë sllave dhe (duke cituar Jireçekun “një pyll i rrethuar quhej *zaběl* te sllavët e vjetër të gadishullit”) e krahason me serb. *zabijeliti* “zbardh, shënoj një pemë duke prerë lëkurën.” P. Skok shënon fjalën e vjetër *zabel* “pyll rezervat ku është ndaluar hyrja” në Kodin e Stefan Dushanit (1345), si postverbal i *zaběliti* > *zabijeliti* “shënoj duke prerë lëvoren e drurit për të treguar ndalim”; në serbishten e Kosovës *zabelj*, në shqipe *zabel* “pyll”.⁷¹ Ngjan si fjalë e vjetër e trashëguar nga sllavishtja, që duhet të ketë bërë pjesë në fjalorin e organizimit shoqëror të kodeve të asaj kohe.

Fjala *kasnec* “lajmëtar, tellall”. Huazim nga serb. e vjetër *kaznъcbъ* “camerarius, mbajtës i thesarit”. Është fjalë e administratës mesjetare serbe, që ka hyrë edhe në italishten ballkanike të bregdetit dalmat: në statutet e Budvës “*li casneci; casnezzo dell'imperador*.”⁷² E. Çabej⁷³ *kasnec* “term juridik marrë nga serb. e vjetër *kaznъcbъ*, në mbretërinë serbe mesjetare “camerarius”.

K. Ulqini do të shpjegojë si ka ndryshuar fjala *kasnec* në vazhden e kohëve. Ai shkruan: “Në Shqipëri në administratën e periudhës turke *kasnec* thirrej një njeri i caktuar në shërbim të katundit, bajrakut e të qeverisë (*kasneci i Pashës*), që kishte për detyrë të çonte lajmin apo ndonjë kumtim të Valiut në krerë e në popull.”⁷⁴ Në vazhdim autori i sipërm (duke cituar M. Shuflajn) shprehet se “Emri *kasnec* lidhet me rudimentet e administratës serbe, respektivisht me ato të organizacionit të esnafëve bizantinë.”⁷⁵

Huazimin *vojvodë* “hist. I ngarkuar i qeverisë osmane në një krahinë të caktuar të Shqipërisë së Veriut në shek. XIX për

⁷⁰ G. Meyer EW 479.

⁷¹ Shiko sa më lart te A. Omari *Marrëdhëniet* 320 v.

⁷² A. Omari *Marrëdhëniet* 161, me gjithë bibliografi.

⁷³ E. Çabej SE V 58.

⁷⁴ K. Ulqini *Terma* 117.

⁷⁵ K. Ulqini *Terma* 117.

të ndjekur zbatimin e urdhrave të qeverisë, sidomos pas reformës së Tanzimatit; *etn.* Kryetar i një vëllazërie të madhe brenda fisit në Malësinë e Madhe e në Dukagjin”. Edhe ndër sllavë kjo fjalë ka përhapje e kuptime të ndryshme. Në serbisht *vojvoda* ishte një titull ushtark, shënonte flamurtarin, prandaj në vitin 1333 u përkthye latinisht “vexillifer”, “prijës i luftëtarëve”; te kroatët e te boshnjakët ishte titull që e mbanin princat. Në bullg. *vojvoda*, bullg. e vjetër *vojevoda* “komandant ushtrie”.⁷⁶

Historikun e termit *vojvodë* e ka shpjeguar K. Ulqini, deri në shpërbërjen e tij të plotë. Ulqini përfundon: “Në Malësi të madhe mbeti si titull nderi, të cilin më tepër e mbanin pleqtë e mehallës, kurse në Kosovë ruajtësit e manastireve thirreshin *vojvodë*.”⁷⁷

Deri më sot fjala shqipe *lëçis* “shpall” është trajtuar si huazim nga serb. *ličiti* “publikoj, shpall duke thirrur”. Ne kemi shprehur një mendim tjetër. Pasi kemi bërë ndjekjen e kësaj fjale në tërë historinë e saj, daljen e saj te autorët e vjetër si edhe të gjitha trajtat e kuptimet në të folmet krahinore⁷⁸,

⁷⁶ Shiko sa më sipër A. Omari *Marrëdhëniet* 315 v. me gjithë bibliografi.

⁷⁷ K. Ulqini *Terma* 131 v. me gjithë bibliografi.

⁷⁸ *lëçis* “1. Shpall. 2. E nxjerr fisit. 3. Këndoj, lexoj” (*Fjalor* 1954, f. 262). Fjalë e mbarë shqipes. *Fjalori* 1954 jep trajtën me *e* (*leçis*) me kuptimet e mësipërme. *Fjalori* 1980, f. 974 e jep këtë fjalë në trajtën *lëçit* (*lëçis*) e vetëm me kuptimin “lexoj” (si fjalë e vjetruar; aty edhe rrjedhojat *lëçitës* “lexues” e *lëçitje* “lexim”). Te *Fjalori* 1954, f. 262 edhe *leçi-a* “*vê leçi* = porosis (për një punë); ndaloj të ngrënët e mishit në një ditë të caktuar” dhe *leçitës-i* “1. tellall; 2. lexues”. Në Kanunin e Lekë Dukagjinit (varianti i Pukës) fjala *leçit* ka kuptimin “mos me i hy brenda shtëpisë për asnjë rast dikuj që është sjellë keq, që ka shkelur zakonet, khs. *Asht e randë me u leçitë prej shokësh*” (Meçi Kanuni i Pukës 255). Në Lahutën e Fishtës fjala *leçi-a* përdoret me kuptimin e “një kushti që parandalon”, khs. *edhe sot m’ka vu leçi / mos me folë n’gjuhë t’t’parëve t’mi* (IX/446). Kolgjini (*Shpalime* 117) pranon si kuptim të parë “me premë marrëdhëniet ...”, duke përjashtuar kuptimet e tjera si “porosi”, “shpallje” etj.

Këtë fjalë Buzuku nuk e ka. Del te Pjetër Budi *e leçiti e e kallëzoj këtë kafshë ende coram* (= përballë) *Populli* (Pasqyra 209); *tue e leçitun gjithë kuujnaaj* = duke e shpallur, duke ia treguar gjithkuej (ibid. 274, cituar sipas A. Xhuvanit SF 3, 1972, f. 146). Khs. edhe *leçi-a, (me) leçitunë dhe (të) leçitunë /-itë/* (përk. në RR 184, 70 e 184). Te *Kuvendi i Arbënit /me/ leçitunë* “shpall, lajmëroj publikisht” (leçitunë divanisht, lat. *annuntiare* “të leçitnjë”); po aty edhe *i leçitunë* (mbiemër), por edhe i përdorur si emër *leçitje leçi* “shpallje publike”, lat. *publicatio* (*dy muojë mbas të leçitunit i këti Konçilli*) së bashku me *leçimë-a* (*leçimat; tue kallëzuem ... popullit leçimën e këtyne ligjave të Provinciesë*”; Ashta BISH nr. 2, 1979, f. 69). Edhe te Bogdani *me forcë të leçisë* (Ashta BISH 2, 1985, f. 167).

Te K. Kristoforidhi 180 gjejmë *leçis, leçitem e leçitës*; te *Bashkimi* 227 *lëçis* “pubblicare, separare della compagna”, *lëçii e (i, e, të) lëçitun e po kështu edhe te Buseti 786-787 me leçitë e t’leçitunit*; te arbëreshët e Italisë *leçit-ënj* “pubblicare” e *leçitës-i* “predicatore ...” (Giordano 223). Te *Bashkimi* 227 dalin *leçii-a* “pubblicazione”, *leçis* dhe *(i, e) leçitun*. Nuk e kemi ndeshur kurrkund këtë fjalë ndër të folmet krahinore (në trajtat dhe me kuptimet e mësipërme), as ndër gjashtë vëllimet e “Dialektologjisë shqiptare”, gjë që të lë të dyshosh se mos jemi para një fjale savante. Megjithëkëtë, në Gropën e Shkodrës përdoret rëndom në popull, veçanërisht si folje (khs. shprehjen *janë shitë e janë leçitë*). Ndërkaq, dalja e kësaj fjale në të folmen e Skraparit *lëçis* “shetis, lëviz për t’u shlodhur; p.sh. *lëçi një çikë se duke ndenjur në një vend sëmuresh më keq*” (SF 3, 1972, f. 155); khs. edhe *leçit* “eci me këmbë e me duar, hiqem zvarrë, zvarritem”, me përdorim në rrethin e Korçës (GJJ 4, 1989, f. 70); po kështu te poezia e N. Frashërit “Zogu dhe djali” përdoret folja *lëçij* me kuptimin “loz, bredh, shetis”, khs. vargjet: *Kam edhe unë shpirt dhe dua të rroj / të lëçij ...*, të lë të kuptosh që ose jemi para të njëjtës fjale, që me kohë ka pësuar bigëzime në kuptimet që paraqet, ose mund të kemi një përzierje, në njërën anë një fjalë savante dhe në tjetrën një fjalë të përdorimit popullor, që ndoshta edhe mund të mos ketë lidhje burimore të drejtpërdrejtë me të.

Trajta e parë e fjalës, që duhet bërë objekt studimi, është ajo e përgjithshmja me *e* (*leçis*).

E. Çabej (së bashku me G. Meyerin EW 212) mendon që *leçis* “shpall, i jap tellallit një plaçkë që ta shpallë nëpër pazar për ta shitur” është huazim nga sllavishtja *ličiti* (*Mbi disa izoglosa* SF 2, 1976, f. 66; edhe SE V 207). Mendimi i Çabejt ndërkaq mund t’i nënshtrohet kritikës. Së

kemi arritur në përfundimin se “*leçis* (përkat. *lëçis*) është formim përbrenda shqipes nga një trajtë *leçi* (kjo vetë e formuar me prap. -*i* nga një bazë **leç-* prej lat. *lēge/ml*⁷⁹), me prap. -*s* nën ndikimin e fjalës sllave *ličiti* në njërën anë dhe asaj turke *elçi-a* në anën tjetër (kjo e fundit e kuptuar në analogji

pari, nga doli trajta me *ē* të gjatë, të cilën e dallojmë qartë që te *Kuvendi i Arbënit*, përkundër tjetrës me *ë* (*lëçis*) në të folmen e Skraparit etj.? Së dyti, si duhen trajtuar rrjedhojat *leçi* e *leçis*? A kemi prej saj foljen e pastaj emrin, siç mendon E. Çabej (khs. “nga *leçis leçi* “porosi; ndalim i të ngrënit mish në një ditë të caktuar”, SF 2, 1976, f. 66), apo e kundërta, nga emrat me -*i* të kenë dalë foljet me -*ils* (khs. *arratis* = *arrati* + *s*, *bezdí* + *s*, *lemerí* + *s* etj., shiko për këtë mënyrë formimi te *Gramatika* II 302). Ndërkaq, nuk përjashtohet mundësia që të jenë të drejta të dy formimet e mësipërme e të kemi këtu ndikime reciproke.

Përdorimi i kësaj trajte në të folmen e Skraparit etj. në trajtën *lëçis* për punë të formës mund të lidhet fare mirë me sllavishten (me errësimin e *i*-së paratheksore në *ë*, dukuri e njohur në gjuhën shqipe). Por, evoluimi i kuptimit të fjalës nga “shpall” në “shetis, lëviz për t’u çlodhur”, tregon se kemi të bëjmë me një huazim të vjetër ose me një fjalë mbi të cilën ka ndikuar edhe një trajtë tjetër, e afërt me të për formë e për kuptim.

Ne mendojmë që *leçis* është formuar nga *leçi* me prap. -*ils* nën ndikimin e fjalës sllave *ličiti* (e jo vetëm kësaj; khs. edhe Omarin *Marrëdhëniet* 182 v me gjithë bibliografi). Fillimisht duhet të kemi pasur një **leç-*, nga e cila doli *leçi* (me prap. -*i*). Në këto rrethana duhet gjykuar se ç’përfaqëson kjo **leç-*. Për ne **leç-* është e lidhur me lat. *lēge/ml* “ligj” me kuptimin fillestar “shpallje, lajmërim”; me formën e parë **lēgj* e me rrjedhojën **lēgji* (**lēgj* + *i*). Mbi këtë **lēgj-* duhet të ketë ndikuar trajta sllave *ličiti* e pas saj edhe fjala turke *elçi-a* “lajm” (për *elçi-a* shiko p.sh. *Bashkimin* 102) e “lajmëtar”, e kuptuar kjo e fundit në ndjenjën gjuhësore të popullit si trajtë që ka marrë një *e* nistore në pozicion antekonsonantik (khs. *elngatë* “lëngatë”, *elkurë* “lëkurë”, *elmue* “lëmue” etj., e po kështu edhe *eltí* “lëti, latin” etj., dukuri e studiuar dhe e analizuar në mënyrë shembullore nga E. Çabej SGJ IV 112 v). Pra, të kemi nga *elçi* me mënyrën e sipërtreguar *leçi leçi*. (D. Luka SGJ III 23 v)

⁷⁹ Për origjinën indoevropiane të fjalës latine *lēgis* shiko te Zingarelli *Voc.* I 945.

me fjalë të tjera që marrin një *e* nistore në pozicion antekonsonantik.)⁸⁰

Gjurmë nga administrata bizantine ngjan të jetë edhe fjala *pashtrak* për të cilën E. Çabej do të shkruajë: “*pashtrak-u* “taksë kullote; vendi i kullotës brenda kufijve të një bajraku”. Fjalë e gegërishtes veriore (Mirditës) e e Kanunit të Lekë Dukagjinit, e padalë në dritë në kohë të G. Meyerit. Nga një lat. ballkanike **pastūrāticum*, prej *pastūra* “kullotë”, me sufiks *-aticum*, i shpeshtë sidomos në latinishten ballkanike.”⁸¹

Te fjalori i Bashkimit 324 del fjala *pashtrak-u* “mercede o multa per pascoli”.

Është për t’u vënë re se kjo fjalë del edhe te Këngët e Kreshnikëve, po tani në dy variante e me të njëjtin kuptim “taksë bari” (khs. *travinë*,⁸² *pashtrak*). Përballë tyre, po me të njëjtin kuptim, del fjala shqipe *bar-i*. Khs.

Varianti i parë: kudhot bjeshkën, *barin* s’e paguonë

...

Varianti i dytë: pa *pashtrak* bjeshkët ja u kullot ...

Varianti i tretë: Ani, pa *travni*, po, bjeshkën e po e han!...⁸³

Te Omari⁸⁴ shkruhet: “*travinë* “taksë kullote” *travina* *bjeshkës*. Përdoret sidomos në poezinë popullore të Veriut (Këngët e Kreshnikëve). Sot pothuaj ka dalë jashtë përdorimi, përveç në shprehje si: *s’kullotet bjeshka pa travinë* “pa mund, pa zor” (Shkodër, Malësi e Madhe). Nga serb. *travarina* “taksë

⁸⁰ D. Luka SGJ III 25.

⁸¹ E. Çabej SE VI 154.

⁸² Huazim nga sllav. (serb.) *travarina* (Omari *Marrëdhëniet* 294).

⁸³ Shiko tekstet e plota të këngëve, së bashku me hollësitë e shpjegimet përkatëse te D.Luka SGJ XVIII 50 v.

⁸⁴ A. Omari *Marrëdhëniet* 294.

kullote” (*trava* “bar”). Svane 114 sjell për *travina* “takse kullote” për serbishten e Malit të Zi, që mund të jetë burimi i drejtpërdrejtë i fjalës shqipe.

Ka të ngjarë që të kemi këtu një dubletë *barishte* dhe *travinë*. Shembuj të kësaj natyre i kemi ndeshur edhe ndër regjistrat e kadastrës osmane të shek. XV. Mbase edhe fjala e Kanunit *bar-i* “tokë e papunuar, e lënë livadh për të kullotur bagëtia”, mund të ketë lidhje gjenetike a mbase të krahasohet me “barishten” e Këngëve të Kreshnikëve. Është për t’u shënuar këtu se në Malësi të Shkodrës përdoret fjala *barishtje* “taksa e barit apo e kullotës.”⁸⁵

Për fjalën *simahor*, *-i* “ai që i lehtëson punën a i sheshon rrugën një vrasjeje a një vjedhjeje; ndërmjetës në këto veprime”, është dhënë ky shpjegim: Sipas N. Joklit është një zgjerim me *-uer -ori*, e semantikisht me një specializim (keqësim) të kuptimit, i greq. σίμμακχος “bashkëlufëtari, shok armësh”. Fjalë e administratës bizantine, po, si shënon ky dijetar, për punë të ruajtjes së *-s-së* si e tillë e të reflektimit të *u-së* greke si *i*, huazim i marrë jo para shek XI, afërsisht ashtu si *fis*.⁸⁶ Gjithsesi huazim që flet për gjurmë të vjetra në Kanunin e Lekë Dukagjinit.

Duhet shënuar këtu edhe dyshimet që janë shprehur nga gjuhëtarë të ndryshëm për origjinën sllave të disa fjalëve të shqipes. Diku-diku mohimi është i prerë, ndërkaq në shumicën tjetër shprehet dyshimi nëse ato kanë ose jo prejardhje sllave.

Fjalën *babûne* G. Meyeri nuk e jep si sllavizëm, vetëm e krahason me greq. e re μπαμπούνα “enjtje, gjë e fryrë.” Selishçevi e jep si huazim sllav nga sllav. *baba* “gjyshe” me kuptim figurativ “gjë e rëndë, e plogët, e trashë”. N. Jokli e barazon me fjalën greke dhe i nxjerr të dyja nga sllavishtja e vjetër **bob-*, **bobun-* “gjë e fryrë”. Janë dhënë edhe mendime

⁸⁵ K. Ulqini *Terma* 137.

⁸⁶ Shiko E. Çabej SE VII 14.

të tjera për një burim onomatopeik të fjalëve shqipe e greke etj. E. Çabej⁸⁷ vetëm parashtron mendimet e ndryshme pa miratuar ndonjërin prej tyre. Sipas Omarit⁸⁸ “Gjithsesi nuk kemi një paraformë sllave të një substantivi konkret me kuptimin e fjalës shqipe, siç është e zakonshme për huazimet sllave të shqipes, prandaj nuk është i sigurt si huazim sllav.” Ngjan që Omari ka të drejtë. Fjala mund të jetë shqipe e vjetër me burim indoevropian ku përfshihen një numër i madh trajtash që nisin me *bob-* (khs. *bobe* “kalibobë”, *bobë-a* “enë prej teneqeje ose prej llamarine, që shërben për të mbajtur vaj ose vajguri, bidon”; *bobël* “lloj kërmilli”, *bobëz* “rriqër”; *bobol* “kokrra e misrit”; të gjitha me rrjedhë të hershme nga një rrënjë indoevrop. **bheul-* **bul-* “ënjtem”, ku përfshihen një rreth i gjerë fjalësh.”⁸⁹

Folja *grabis* “i marr një tjetri një gjë me pahir; rrëmbej; plaçkit”, deri më tani është çmuar si huazim nga serb. *grabiti*, bullg. (maq.) *grabi*.⁹⁰ Duke gjykuar nga rrjedhojat e shumta, të krijuara brenda shqipes (*grabitje*, *grabitqar*, *grabitës*, *i grabitur*, *grabí* etj.), mund të mendohet se fjala duhet të ketë hyrë herët në gjuhën shqipe; pra të jetë një ndër huazimet e para nga sllavishtja; ose të mos jetë huazim sllav. E. Çabej⁹¹ miraton mendimin e një huazimi nga sllav. *grabiti*, por duke shprehur rezervën se “Këtu duhet të jetë përzier fjala sllave me një analoge të vendit, “krijim elementar” në kuptimin e W. Oehlit.⁹² Aty gjan të hyjë *graps* “vjedharak”, *grapcoj* “kafshoj pak nga pak”, fjalë që kanë dalë nga (e hangri) *grap* e *grap*.

⁸⁷ E. Çabej SE II 121.

⁸⁸ A. Omari *Marrëdhëniet* 83.

⁸⁹ Shiko hollësitë te D. Luka SGJ I 162 v.

⁹⁰ Shiko hollësitë te A. Omari *Marrëdhëniet* 146.

⁹¹ E. Çabej SE IV 279.

⁹² Këto fjalë, që paraqesin leksikalizimin e disa grupeve konsonantike shprehëse, E. Çabej, së bashku me W. Oehlin, i kanë pagëzuar “fjalë figurative” ose “lentime (krijime) elementare”. (“Elementare Wortschöpfung”, *Miscellanea linguistica dedicata a Hugo*

Për fjalën *ograje-t* “zabel me kullotë”, është shprehur mendimi se vjen prej sllavishtes, por me diskutimin: “Trajta *ograjë* ose me Joklin nga dialekti čakavik i bregdetit dalmat, ose me gjasë prej një forme dialektore malazeze *ograđa*, me ndërrim dialektor *gj > j* brenda shqipes, ashtu si edhe *megje > meje* e shqipes verilindore.”⁹³ Ndërrimi *gj > j* është krejtësisht dialektor, ndërkohë që fjala *ograje* është së paku e mbarë dialektit të Veriut të vendit (khs. Fishtën le *Lahuta* 251 *Ky zënë priten nalt n’nji ograје* 251. Te fjalori i Bashkimit 310 del *ograie* “campo da pascolo.”)

Fjala *pertek-u* “tra i hollë; gërshërëz; mertik” mendohet (me dyshim) huazim nga sllavishtja (serb. *prut*, bullg. *прѣт* “ë”. Khs. edhe serb. *prutak*, përmes malazishtes lindore *прѣтѣк* etj.)⁹⁴

Duke analizuar prejardhjen e fjalës *mërtek-u* “tra i hollë, gërshërëz” ne kemi shprehur mendimin se lidhja kuptimore ndërmjet *mërtek* (e mbase edhe *mërtik*) me *purtekë* (*përtekë*) e *përtik* del krejt e qartë. Me gjasë kemi të bëjmë fillimisht me një fjalë të vetme me kuptimin e parë “dru i gjatë ...” Duke u përdorur objekti në punë të ndryshme si “mbështetëse hardhish”, “qepra për ndërtim shtëpish” etj.; fjala fitoi fillimisht kuptime të reja, të cilat, në vazhden e kohëve, formuan njësi leksikore më vete, duke dhënë fjalë të reja, të cilat u shoqëruan edhe me ndryshime fonetike sipas të të folmeve ku u përdorën së pari.

Sipas gjithë gjasave *mërtek-u* është formim përbrenda shqipes me parashtesën *m-* dhe *përtik*, kjo e fundit huazim nga

Schuchardt (1922), f. 75-115; *Anthropos* 18-19 (1923-1924), f. 858-879 edhe “Bildworte”)

⁹³ Shiko hollësitë, së bashku me literaturën përkatëse, te Omari *Marrëdhëniet* 209.

⁹⁴ Shiko hollësitë e mëtejme te A. Omari *Marrëdhëniet* 245.

lat. *pertica* “shtangë, shkop i gjatë, purtekë (për me shkundë ullinj etj.)”⁹⁵

Për *prozh/ëm, -mi* “pyll i vogël, që përdoret për të prerë dru; zabel; *korije*” E. Çabej,⁹⁶ duke u nisur nga trajta që gjenden te Bogdani (*ishin do prozhma*), e përjas këtë fjalë me toponimin që del në Kadastrën e Shkodrës të vitit 1416-1417: *posto in luogo dicto Brostema* dhe mbi këtë lidhje të dy formave të fjalëve e bie të ardhur *prozhmë*-n nga sllavishtja: skr. *berst* “syth, bulë” *brstina* “gjethe”, bullg. *br̃s(t)* “gjethe për bagëti”, sllov. *brst* “bulë, sythë, karthja” etj. Selishçevi nuk e llogarit ndër sllavizmat e shqipes. A. Omari ka shprehur mendimin: “Nuk duket fort i sigurt si huazim nga sllavishtja.”⁹⁷

K. Topalli e lidh këtë *prozhëm* me një rrënjë **proç-* me prap. *-(ë)m* dhe ka kthyer afrikatën *-ç-* në *-sh-*, duke u zëshmuar kjo e fundit nga sonantja *-m*. Me këtë rrugë duhet të jetë formuar së pari emri *prozhëm*, që rron edhe sot në të folmet verior, dhe prej tij folja *prozhmoj*.⁹⁸

Për *sanë* “bar i thatë” është shprehur mendimi se vjen nga serb./bullg. *seno* “sanë”. Mbahet si një ndër sllavizmat e vjetra të shqipes, për shkak të zanores së rrënjës *a* që reflekton shqiptimin e sllavishtes juglindore (eā), që në kohë më të vjetra dallonte edhe të folmet më perëndimore të bullgarishtes, por më anë tjetër nuk ka pësuar ndërrimin *s > sh* dhe është e kufizuar gjeografikisht në Veri. A. Omari ka shprehur mendimin se “Gjithsesi refleksi sllav. *ě > shq. a* është problematik.”⁹⁹

⁹⁵ Shiko hollësitë së bashku me literaturën përkatëse te D. Luka SGJ III 146 v.

⁹⁶ E. Çabej SE VI 240.

⁹⁷ Shiko hollësitë te *Marrëdhëniet* 244.

⁹⁸ K. Topalli SF 3-4, 2013, f. 109.

⁹⁹ A. Omari *Marrëdhëniet* 262.

Fjalën *tû*, *-ni* “ana e sprasme e sopatës, me të cilën godasim.” Desnickaja e bie si sllave: *bullg. tune* “më kot, huq.” Me këtë shpjegim emri duhet të shënonte pjesën e mbrapme apo të papërdorshme të veglës. G. Svane shpreh dyshimet e tij për etimologjinë e kësaj fjale edhe për faktin se rrënja **tun* nuk gjendet në serbishte dhe ndërtimi substantiv nuk del në asnjë nga gjuhët sllave.¹⁰⁰ Ndërkaq edhe kuptimet e të dy fjalëve nuk përputhen gjëkund.

vigâ, *-ni* “figurë mitologjike me trup jashtëzakonisht të madh dhe me fuqi të jashtëzakonshme; njeri i fuqishëm e me shtat shumë të madh.” G. Meyeri e bie nga serb. *viganj* “kudhër, farkë”, duke vënë në dukje perceptimin popullor të farkëtarit si qenie e mbinatyrshme, ka shprehur mendimin : “lidhja semantike mes fjalës sllave dhe huazimit në shqip nuk është krejt e qartë.”¹⁰¹ Ngjan që Meyeri ka të drejtë.

Për *bûc/ë*, *-a* “copat e dheut që nxjerr umi (‘thika e parmendës’), *plis-i*”. E. Çabej¹⁰² ka shprehur mendimin: “Si fjalë e geg. veriore, huazim krahinor prej skr. *bûs* “plis dheu me bar, një copë vend me bar.”¹⁰³ Ne kemi shprehur mendimin: “*bûcë* gjithsesi mbetet fjalë me burim të diskutueshëm. Veçse mundësia që të jetë huazim krahinor prej serbokroatishtes në mos duhet përjashtuar fare, duhet vështruar si tepër e pasigurt.”¹⁰⁴

¹⁰⁰ Shiko hollësitë te A. Omari *Marrëdhëniet* 86 v.

¹⁰¹ Shiko hollësitë te A. Omari *Marrëdhëniet* 310.

¹⁰² E. Çabej SE II 344.

¹⁰³ Shiko edhe A. Omari *Marrëdhëniet* 112.

¹⁰⁴ D. Luka SGJ I 208. Po japim të plotë etimologjinë e kësaj fjale e shprehur në SGJ I 208.

bucë-a “1. Plis që ngre parmenda a plugu gjatë lërimin të tokës ... 2. Top bore” (*Fjalor* 1980, f. 187). E. Çabej sjell një numër variantesh fonetike të fjalës *bûcë*: *busë* (Shestan), *bâs* (Has), *bâz* (Çerem, Tropojë), *bâos* (Tropojë), *bâsa* e *bosë* (Kosovë), *bazë* (Gjakovë), *bons* (te Arbanasi), *bazë* e *bazinë* (Krasniqe). Ai mendon (SE II 344) se kemi këtu një huazim

krahinor prej serbokr. *bûs* "plis dheu me barë, një copë vend me bar." (Khs. edhe Omarin *Marrëdhëniet* 112, me gjithë bibliografi).

Së pari duhet diskutuar a është fjala *bucë* vetëm e gegërishtes veriore, siç mendon E. Çabej? A. Xhuvani (SF 1, 1986, f. 165 v) ka regjistruar krahas *bâs* "top dheu" (Has); "top bore" edhe *bac-i*, *basë-a*, *bacë-a*; *bazë-a* "plis dheu" dhe *bâs-i*, *basë-a*, *bâçë* edhe *bucë*"; *bâzinë-a* "tokë që del me plisa kur punohet", nga *bazë-a* "plis dheu, plis arash"; *bancë-a* e *boncë-a* "plis dheu" (Kosovë, f. 161). Në Çamëri kemi dëgjuar *bazinë* "tokë e kuqe" e "plis me dhe të kuqe", aty edhe mbiemrin (llagap familjeje) *Bazina*. Një *bazinë* me kuptimin "kaçamak, mëmëligë" e jep edhe Xhuvani (SF 1, 1986, f. 166) po për Çamëri. Në Mat edhe *buse-u* "plis dheu ..." (GJJ 1, 1988, f. 79). Në Kurvelesh (Totoni DSH I 90) *bes-i* "plis". Te *Lahuta* e Fishtës *bucë* (*E si s'epri m'arë nper bûca XXIII/579*, por edhe *m'gur a m'bûsë qëjtë t'i ketë gjue XVIII/804*; botimi VIII, 1997 e ka *bûcë*).

Në këto larmi trajtash e kuptimesh duhet mbajtur parasysh fakti i njohur që kur një fjalë del në dy cepat më veriorë të territorit ku flitet një gjuhë, ajo zakonisht është e vjetër. Në këtë rast diçka saktësohet me siguri, ajo nuk mund të konsiderohet kurrsesi si huazim krahinor. Në të mirë të këtij mendimi flet edhe rrethana tjetër që në shqipe *bucë* paraqitet në disa trajta, nganjëherë mjaft larg njëra-tjetrës, të cilat nuk mund të shpjegohen kurrsesi nëpërmjet serbokroatishtes. Zakonisht huazimet sllave të shqipes, duke qenë të reja a relativisht të reja, nuk pësojnë ndërrime të thella, ato në shumicën e rasteve ruajnë formën e fjalës nga kanë zanafillën.

Për *bûcë* të shqipes mund të rindërtohet pa dyshim një paraardhëse *bun/s/* (për punë të û-së hundore; khs. *bancë* e *boncë*) e më tej një **bunfi-* a **bonfi-*. Në qoftë se rindërtimet e sipërme janë të drejta, atëherë *bancë* e *boncë* mund të paraqesin trajtat që janë më afër primitivit të fjalës. Vetë rrënja *bun-* mund të lidhet përbrenda shqipes me fjalën *bun-i*, kuptimi i së cilës paraqitet ende i pasaktësuar mirë. *Fjalori* i vitit 1980, f. 197 jep "1. Kasolle e vogël ... që ngrejnë barinj të në stanet ku bjeshkojnë ... 2. Folë kandrash". Gazulli 75 jep për kuptim të parë "vend banimi, *ban-i*". Tani ka të ngjarë që në ndjenjën gjuhësore të popullit të jenë përzier për punë asociacioni (a tejbajtje kuptimi) *bun-i* (përkat. *ban-i*) me *buncë* (përkat. *bun-së*), duke menduar që plisat "bucat" të jenë përdorur për ndërtimin e *bunit*. Ose zanafilla mund të paraqitet edhe më e vjetër, dhe atëherë duhet të mbështetemi te

Ka edhe një numër jo të vogël huazimesh nga gjuhë të ndryshme, që dalin në Kanun, po që nuk paraqesin shumë rëndësi për terminologjinë e vërtetë, sepse zakonisht kanë hyrë në gjuhën shqipe së bashku me objektet që përfaqësojnë. Për përcaktimin e termave të Kanunit, gjuhësisht mund të japim këtë ndarje:

Së pari kemi huazime, të cilat janë në përdorim të përditshëm të popullit, pra i përkasin fondit aktiv të gjuhës. Është krejt e natyrshme që disa prej tyre të kenë kaluar edhe

kuptimi “diçka që del mbi tokë, e ngritur e vogël” në vështrimin e parë “vend banimi”. Për këtë rast mund të afrohet këtu për krahasim edhe greq. *βουνός* “breg, kodër” e mbase edhe të gjithë ato emra ilirë që H. Krahe (*Die Spr.* I 101) i krahason me këtë fjalë. Khs. tani këtu edhe shpjegimin “Buse quhen edhe pjesët e mëdha të tokave që dalin nga shkarja e dheut” që e jep B. Dollma (GJJ 1, 1988, 79) me përdorim në Bushkash të Matit.

Në të mirë të mendimit tonë të shprehur më sipër, që te *bucë* kemi një trajtë vendëse, flet edhe trajta *bancë*, e cila mund të jetë formuar paralelisht me *buncë*, por tani jo nga *bun-i*, por nga sinonimi i tij, *ban-i*. Me këtë rrugë përbrenda shqipes mund të shpjegohen tani të gjitha variantet dialektore të gjuhës, pa pasë nevojë aspak t’i referohemi serbokr. *bûs*. Trajta fillestare e fjalës, pra, mund të mendohet **bun/fi-* ku *-fi* paraqet prapashtesën e vjetër vendëse të ndërruar në *-s* përbrenda gjuhës. Nga **bunfi-* doli *buns-*. Me rënien e *n-së*, siç ngjet shpesh në gegërishte (khs. *lsho qëtë* për “lësho qentë”), doli trajta *bûsë* (me *û* hundore, khs. trajtën *bûsë*, e përdorur në Shestan) dhe në vazhdim, me ndërrimin e *-s-* në *-c*, *bucë*. Dihet që prap. *-c* është karakteristikë e gegërishtes veriperëndimore. Veçse kjo *-c* (përk. *-cë*) u përgjigjet për nga funksioni prap. *-ë/s*, *-cë* e *-zë* qoftë të gegërishtes verilindore e jugore, por edhe vetë toskërishtes (Xhuvani-Çabej *Prapashtesat* 456). Me këtë mënyrë shpjegohen trajtat e toskërishtes (përk. çamërishtes) *bazinë* (*baz + inë*), e po kështu *boncë* e Kosovës, me ndërrimin e *u-së* në *o* në gegërishten verilindore që, sipas Çabejt (*Karakteristikat* SGJ IV 258) është zhvillim i brendshëm i shqipes; shiko edhe kundërshtimin e mendimit të Çabejt te I. Ajeti SGJ I, f. XXI (*Parathënia*).

në shpjegimet e normave të Kanunit. Si të tilla ato nuk duhen vlerësuar si terma të mirëfillta.

Së dyti, përdorime kanunore elementesh të leksikut të shqipes. Kemi pra këtu apelativa që kanë kaluar në norma kanuni, tani me shpërbërje polisemike, duke dalë atje me kuptime e përdorime të reja. Kompozita *kryeplak* gjen përdorim në Kanun duke përfaqësuar “personin e zgjedhur a të emëruar, që drejtonte punët e fshatit e të lagjes, transmetonte aty urdhrat e qeverisë dhe i shërbente kësaj”. E ky njeri, mund të ishte edhe djalë i ri a burrë në moshë.

Së treti, fjala që shënon termin, nuk del në leksik të shqipes (khs. *porotë, porotnik, pashtak* etj.) Në këtë rast ajo duhet bërë objekt studimi për të përcaktuar prejardhjen e saj etj.

Ne po rreshtojmë këtu edhe ato huazime të Kanunit të Lekë Dukagjinit, të cilat nuk paraqesin ndonjë vëmendje të madhe, sepse nuk çojnë asnjë peshë në normat kanunore të tij.

Përsa i përket kriterit gjeografik a përcaktimit të gjeografisë gjuhësore të fjalëve, a priori do të parapëlqehet puna p. sh. që huazimet italiane, që paraqesin trajta veneciane, kanë hyrë nga Venediku, me të cilin veriakët kanë pasë lidhje të vazhdueshme tregtare e të natyrave të tjera, sesa të kenë hyrë p. sh. prej greqishtes së re, takimet me të cilën qofshin gjuhësore, qofshin jashtëgjuhësore kanë qenë më të largëta.

Nga venecianishtja kemi *almise, kofën, kusí*. Të tri fjalët kanë hyrë në shqipe së bashku me objektet që emërtojnë. Po kështu edhe këto huazime turke: *çubuk, derhem, fishek, futë, kandar, okë, qese tepsí, sahat zagar* e ndonjë tjetër. Nga sllavishtja (kryesisht serbishtja): *gjobë, kërtollë, konop, kosh, koshiq, kotec, opangë, valanicë, vedër* etj. Nga ital. *kapar, pistole*. Nga greq. e re *kariq*.

Me rëndësi është dalja e emrave të disa parave të vjetra si *asper, grosh* etj. që tregojnë se krahina e Mirditës nuk ka qenë e izoluar; ajo ka jetuar e ka punuar me tempin e kohës, ka dhënë

e ka marrë. Fjala *qese* p. sh. nga “strajcë e vogël” është kthyer në njësi monetare në përdorim të përditshëm në marrëdhëniet ndërmjet njerëzve.

FJALORI I KANUNIT

Nga teksti i Kanunit (përkat. rreth 100 faqe të plota), ne kemi dalluar rreth 960 fjalë tituj (përkat. njësi leksikore), të shpjeguara jo vetëm për kuptimet e tyre, por duke dalluar (kryesisht në shënimet nën vijë) edhe të dhëna gramatikore me interes për gjuhën shqipe.¹⁰⁵ Është për t’u vënë re këtu se fjalët

¹⁰⁵ Në fund të Kanunit të Lekë Dukagjinit, nën titullin “Fjalori i fjalvet e i frazevet të rralla”, janë rreshtuar rreth 270 të tilla. Sipas një shënimi të faqes 139 (“Kjo veper postume e P. Shtjefen Gjeçov - ndjesë pastë! - kje rreshtue e plotësue me diftojsë analitik-alfabetik e fjaluer relativ neper kujdes t’ A. Benedikt Dema O. F. M.”), merret vesh se autori i këtij fjalorthi është patër Benedikti. Qëllimi i tij kryesor ka qenë të japë kuptimin e fjalëve të rralla të përdorura në Kanun. Fjalët këtu shpjegohen sipas njohjes së autorit, pra janë krejt vetjake, personale e jo sipas rregullave a kriterëve shkencore leksikore që ndiqen në të tilla raste, duke mos u shënuar as numri i faqes ku ajo del në tekstin përkatës. Ashtu si te fjalori i *Lahutës*, patër Benedikti shton edhe fjalë që nuk ndeshen në Kanun. Khs. këtu: *anë* “odë”, *ashklatisun* (*i*), *bludë*, *cing e ping*, *bashtinë*, *binak*, *breshtëni*, *calinë*, *cemtë* (*i*), *çetinë*, *çurlikue* (*me*), *çuterr*, *dermuer*, *dituer*, *ftim*, *galdim*, *gallushter* “shpellë e vogël”, *gjarpnushë* “lloj arme”, *ilik* “stejë kandili”, *karmatisun* (*i*), *koçanë*, *ledinë*, *lukur* “dele”, *merqer*, *nagaçe*, *pansirë*, *pojatë*, *qasë*, *qasë* (*me*), *qokë* (*me*), *senjuer* “qifllek”, *stenë* “krep”, *sund*, *tekë*, *ulkojë* etj., që me gjithë përpjekjet tona, nuk i kemi ndeshur në Kanunin që kemi përdorur. Në ndonjë rast Dema ka lexuar keq një gabim shtypi: khs. *per tekë* (*thuper*), duhej *pertekë* (*thuper*) KLD 35 dhe e ka interpretuar gabim *tekë* “thuper”. Është për t’u shënuar që, pothuaj të gjitha fjalët e shënuara më lart (e që nuk dalin në Kanun), janë të regjistruara te *Lahuta* e Fishtës, khs. D. Luka SGJ XIV.

e rreshtuara te *Glosari*, të mbledhura në Mirditë nga B. Beci,¹⁰⁶ në shumicën e tyre nuk takojnë me këto të Kanunit.

K. Ulqini shënon se “Kritika ka bërë vlerësime dhe ka vënë në dukje disa të meta të kësaj veprë. Përsa i përket terminologjisë, mund të themi se mbledhësi i Kanunit, në përputhje me konceptet e gjykimet e tija historiko-shoqërore, ka bërë zëvendësimin apo përkthimin e disa termave të huaj në shqip si *bajrak*, *bajraktar* në *flamur* e *flamurtar*, dhe disa të tjerë nuk i ka regjistruar, ose i ka mënjeluar si: *selem*, *nusja me kollçikë të zez*, *grua sadike* etj.”¹⁰⁷

Për fjalësin e fjalorit ne do të gjykojmë për atë që ka mbledhë dhe ashtu si e ka mbledhë vetë Gjeçovi (dhe jo për atë që nuk ka mbledhë, apo nuk pasqyrohet në të),¹⁰⁸ duke analizuar kryesisht anën gjuhësore të tij.

Së pari me neologjizmat, të cilat pa asnjë dyshim janë përdorur prej Gjeçovit në mënyrë të ndërgjegjshme për të dhënë saktësimin e kuptimit të normave të Kanunit: *pandehun* (*i*), *parbini*, *sodumë* (*me*) janë pa asnjë dyshim neologjizma të kallura në Kanun prej vetë Gjeçovit.

Termi juridik (*i*) *pandehun* as nuk njihet e as nuk përdoret gjëkund në Mirditë e gjetkë. Ngjan që është futur aty prej vetë

¹⁰⁶ B. Beci, *E folmja e Mirditës*, “Dialektologjia shqiptare” IV, 1982. Në një shënim të vënë aty thuhet: “Ky punim është hartuar në vitin 1965 dhe është diskutuar në sektorin e gramatikës e të dialektologjisë po në atë vit.”

¹⁰⁷ K. Ulqini *Terma* 112.

¹⁰⁸ Ne nuk e shtrojmë problemin nëse Kanuni i mbledhur dhe i kodifikuar nga Gjeçovi pasqyron në mënyrë shteruese terminologjinë e plotë, që në atë kohë përdorej në Mirditë. Duke gjurmuar në dokumente arkivore të vjetra, si edhe në letërkëmbimet e krerëve të Mirditës, dalin edhe shumë terma (kryesisht huazime nga turqishtja), të cilat nuk pasqyrohen në Kanunin e Gjeçovit. Ne kemi analizuar vetëm ato fjalë-terma, që dokumentohen me shkrim te Kanuni i sipërpërmendur.

Gjeçovit, i cili mund ta ketë parapëlqyer para tjetrës “i paditun”. Kjo për ta bërë më të qartë kuptimin e fjalës.

Fjala *parbini-ja* pa asnjë dyshim është kallur aty nga vetë Gjeçovi, i cili e ka përdorur në vend të “(tagrit të) djalit të parë”. Në Mirditë e as ndër rrethe kjo fjalë nuk njihet.

Folja *me sodomë* është deverbativ, formuar sipas Biblës, ku flitet për shkatërrimin e qytetit që mban emrin *Sodomë-a*. Kjo fjalë del edhe te *Lahuta* e *Fishtës* me kuptimin: “me shkatërrue kulm e themel; me rrafshue për tokë gjithçka; me qitë faret; me zhbî; me asgjesue” (*Tue e sodomë si kokrra e rrës*) 252; (*Po sodomë e dermohet*) 425.

Mospelqim ngjan si savante, fjalë e krijuar vonë,¹⁰⁹ sepse nuk është formim në natyrën e gjuhës shqipe.

Edhe për termat: *lisi (i gjakut)*, *lisi (i tamlit)* është thënë se janë krijime¹¹⁰ të Gjeçovit. Nuk besoj të jetë krejtësisht kështu, sepse edhe një studiues kosovar, Sh. Sejdiu, vë re se “Sistemi i farefnisës te shqiptarët ... mbështetet fort në relacione gjenetike. Sipas traditës zakonore ky sistem ndahet në dy vija apo në dy trugje: në atë të gjakut apo patrilinear dhe në atë të tamblit apo matrilinear.”¹¹¹ Tani *lis-i* me *trung-u* ngjajnë pothuaj njëlloj.

Në Kanun dalin një numër fjalësh, të cilat kërkojnë analizë të veçantë, sepse shumica prej tyre nuk regjistrohen në fjalorët e gjuhës shqipe e as ndër të folmet e tjera krahinore: *dukshme*

¹⁰⁹ Te Xhuvani-Çabej (*Parashtesat* 386 v) thuhet: “Në gjuhën e shkrimit kjo parashtesë është shumë produktive, duke u modifikuar disi funksioni i saj në krahasim me atë të gjuhës popullore”. Dhe më tej: “... të gjitha këto fjalë janë neologjizma të sajuara në këta brezat e fundit.”

¹¹⁰ K. Ulqini *Terma* 115.

¹¹¹ *Probleme ...*, po aty, f. 54.

(e), *gygjue (me), jashtue (me), jashtuem (i), jetòs, jezullí, kadoc, ligjue (me), mëdheskë, mirvet, njimend, pagjak (i), paligjë (i), përbashkënisht, përbishtnim, perkasi, permbsi, perpjesënohen, përvan, praptue (me), pritëtar, sedije, shëngjetë, sheste, shestoj, trajtue (me), trupue (me), varzë.*

Disa prej fjalëve të sipërme shprehin trajta e kuptime të vjetra. Si shembull marrim foljen *me trajtue*, që në Kanun del me kuptimin: “me ndreqë një shtëpi të re; me ndërtue një shtëpi” (e të mbushet mëndja **me trajtue** shpín nder shêje të vís).

Trajtë e trajtoj janë dy fjalë që në vazhden e kohëve e kanë ndërruar kuptimin e kryehershëm të tyre. *Trajtonj* te Buzuku përdoret për “ndërtoj” *me trajtuom udhëtë e tî* (Meshari IX/1, 13); *porsi üshtëria qi anshhtë trajtuom për luftë* (Meshari X/1, 17); *Zot, ti qi trajtove farësë ümane* (Meshari X/4, 19). Këtë dukuri E. Çabej e quan me rëndësi për etimologjinë. Ai vë re se “disa fjalë në tekstet e vjetra e nëpër dialekte na shfaqen ndryshe nga forma e përgjithshme, gjë që përbën shpeshherë një pikënisje të sigurt për studimin e tyre.”¹¹²

Fillimisht *trajtoj* (përkata. *trajto/n/j*) e përdorur me kuptimin e parë primitiv *ndërtoj* (e dëshmuar kjo, siç thamë, që te Buzuku), ka qenë me gjasë fjalë e mbarë shqipes. Me kohë nisi bigëzimi në kuptimin e saj. Në të folme të veçanta krahinore ajo ruajti përgjithësisht kuptimin e kryehershëm “ndërtoj, ngre ...”, ndërsa ndër shtresat e shkolluara u shfaqen edhe ndikime savante, të marra nga gjuhë të tjera, veçanërisht nga frëngjishtja, me të cilat fjala e shqipes takon në formë e për kuptim si edhe në zanafillën e vet (khs. fr. *trait* e *traïter*).¹¹³

Varzë është primitivi i tjetrës *vajzë*.¹¹⁴ Në Kanun, pra, ruhet trajta e vjetër (**varzat** e *plangut të shuem*).

¹¹² E. Çabej SE I 37.

¹¹³ Shiko hollësitë te D. Luka SGJ IV 286 v.

¹¹⁴ E. Çabej SE VII 219 v.

Sheste e *shestoj* janë dy fjalë të vjetra, që paraqesin interes për etimologjinë e tyre. Veçanërisht për të diktuar rrugën që kanë bërë këto dy fjalë deri në Mirditë e, më tej, edhe në Kanun.

Për *shestë* ne jemi shprehur: “Si përfundim na duket më i drejtë mendimi që *shestë-a* është huazim nga ital. e vjetër (ose edhe drejtpërdrejt nga venecianishtja), një fjalë savante e kallur në shqipe fillimisht ose së bashku me mjetin që përfaqësonte, ose vetëm për të emërtuar atë gjatë përkthimit nga italishtja.”¹¹⁵

¹¹⁵ D. Luka SGJ IV 161 v. Khs. edhe shpjegimet e dhëna aty: *shestë-a* “1. Kompas, pergjel. 2. Qëllim, plan, shestim. 3. Rregull, rend” (*Fjalor* 1980, f. 1829). Fjalë vetëm e gegërishtes. *Fjalori* 1954, f. 519 jep vetëm kuptimin “kompas, pergjel”. Edhe Kristoforidhi 323 përmend një *shestë* “διαβήτης” me shënimin “Bgd.” (= Bogdani).

E gjejmë këtë fjalë te Fr. Bardhi 12 me kuptimin “kompas” (*circinus* : *shestë*). K. Ashta lexon te Buzuku *atoh sheste qi en klishet ordhënuom s janëh* (BISH 1, 1966, f. 36; khs. edhe leximin te *Leksiku* I 448). E. Çabej e lexon ndryshe *e ato festë qi N Klishet ordhënuom s janë* (61 XXI/2). Kemi pra *festë*, e lexuar te K. Ashta *shestë*, për punë të ngjashmërisë grafike të *f-së* me *s* te *Meshari* i Buzukut. Leximi i Çabejt duket i drejtë, sepse në vazhdim kemi *e gjithë festë qi ty ordhënuom të jetë N Klishet shenjte* (61 XXI/2).

A. Xhuvani (SF 2, 1979, f. 92), te fjala *shestë-a* shpjegon që ajo del te *Bleta* e Th. Mitkos e te *Bashkimi*, por me kuptimin “plan, tërtip”. Veçse shembulli që jep Xhuvani për *Bashkimi* (këtu me gjasë kemi një ngatërresë a gabim, sepse *Bashkimi* 118, ka *shestë-a* “kompas” e *shestoj* “me matë me kompas”, *li/ shestuem* “i matun me kompas”) *vuni shestën me e përngjitë bregun e Shqipnisë më tepër se “planin” ka kuptimin e “veglës” (më saktë “majën” e veglës), sepse nuk thuhet vuni planin, por bân planin, sajoi planin, sendërgjoi planin.*

Kuptimi primitiv i fjalës, duke u mbështetur te Bardhi e te Bogdani, ka qenë “kompas” (khs. edhe *shest-a* “kompas, i sho funen me shest” me përdorim në Mirditë, Beci DSH IV 123). Kuptimet e tjera me gjasë kanë rrjedhë nga folja *shestoj* “bëj planin për të kryer një punë”. Në ndjenjën gjuhësore të popullit ka të ngjarë që *shestë* të jetë kuptuar si deverbativ, si emër që doli nga folja *shestoj*.

Fjala shqipe *shestë-a* i ka të gjitha shenjat e një huazimi nga ital. *sésta*, që zakonisht përdoret me kuptimin “kompas” (edhe te G. Meyer,

Folja *shestoj* në shqipe del me disa kuptime.¹¹⁶ Në Kanun “me hartue planin e një veprimi; me bâ projektin e një pune; ravizoj në vija të përgjithshme; me sendërgjue; me sajue” (*Si të shestohet të kaluemt e vís*). Khs. edhe Fishtën te *Lahuta ... na këtu s’bashkut me vendue / këtë Shqipni si m’e shestue / që n’dorë Turku na ka lshue / me e vu n’shete sido kjoftë* (XXX/88).

EW 402). Por, duhet shënuar se kjo fjalë në italishte ka edhe kuptime të tjera si “ora sesto del giorno”, “Intervallo che abbraccia 6 gradi” e “Gamba lunge” (Zingarelli *Voc.* II 675), që të shtynjë të mendosh edhe për prejardhje të tjera të saj.

Ndërkaq krahasimi formal ital. *sesta* : shq. *shestë* është i shpjegueshëm nëpërmjet fonetikës historike të shqipes. Ndërrimi *s* : *sh*, dihet, ka si kufi shek. X. Në këtë ndërrim nga huazimet mesjetare marrin pjesë vetëm shtresat më të vjetra të huazimeve sllave dhe italiane (E. Çabej SGJ III 138). Pra, *shestë* mund të radhitet me huazimet e vjetra italiane. Por, ajo mund të jetë marrë mbase edhe si fjalë savante drejtpërdrejt nga venecianishtja, që e shqipton këtë *s* “disi të palatalizuar”.

Mundësia e dytë është më afërmendsh po të mbajmë parasysh se grupi *st* në këtë fjalë nuk është kthyer në *sht*. Ky ndërrim (*st* : *sht*) është tipar vetëm i elementit autokton dhe i huazimeve të vjetra të gjuhës shqipe (shiko për këtë ndërrim te Çabej, SGJ II 176).

Mundësia për një rrjedhë nga lat. *sexta* (khs. *sexta hora*, *sextans* “instrument astronomik, që mat gjashtë pjesët e rrethit”, *sextarius* “lloj mase”, *sextilis* “term astrologjik”), mbase e drejtë për italishten (khs. përkat. *sesta*, *sestante*, *sestiere*, *sestile*) e frëngj. *sextant* (nga lat. *sextans*, Robert 1646), për shqipen është kuptimisht më e largët dhe pothuaj e pamundur në punë të ndërrimeve fonetike.

Kundër prejardhjes latine dhe në të mirë të prejardhjes italiane të fjalës flet jo vetëm përhapja e saj me kufij dialektorë të kufizuar, por edhe ndërrimet formale relativisht të pakta të fjalës (në krahasim me elementin latin).

Për rrjedhën italiane të fjalës *sceste* (= *sheste*) të Bardhit, është shprehur edhe K. Ashta (BISH 1, 1975, f. 67). Më parë, po ky autor (*Shkodra* 2, 1962, f. 52) e ka renditur këtë fjalë në “huazimet e latinishtes së mesme e të re”. *Shestë-n* (siç!) të Buzukut, K. Ashta e bie nga lat. *sesta* “kompas” (BISH 1, 1966, f. 36).

¹¹⁶ D. Luka SGJ IV 162.

Në këtë situatë ne e përjashtojmë mundësinë e formimit të fjalës përbrenda shqipes nga *shest/ë/ + o/j/*.

Pas gjithë gjasësh *shestoj* është huazim nga ital. *asestare* (*sestare*) “aggiustare per l’apunto ...”¹¹⁷ Në punë të kuptimit të dy fjalët përqasen përbukuri.

Fjala *jetos* del me kuptimin “i jetun; i mbetur; plak që e ka lënë këmba e dora” (*edhe pse â’ plakë jetòs*). Del kjo fjalë edhe në *Fjalorin* 2006 me të njëtin kuptim.¹¹⁸ Në *Fjalorin* e Bashkimit 169 dalin: *jetos, jetosem* dhe mb. (*i, e*) *jetosun*.

Ngjan të jetë formuar nga *jet/ë/* me prap. -os-, me të cilën dalin pak mbiemra prej emrash e foljesh, me kuptim pejorativ.¹¹⁹

Fjala *mirvet*, që del në Kanun me kuptimin: “me vullnet të plotë; pa e detyruar njeri” (*Dorzâni hin me mirvet*), ka në përbërjen e saj mbiemrin (*i, e*) *mirë*; ndërkohë pjesa tjetër -vet mbetet e paqartë. Mbase mund të mendohet për një kompozitë “(e) *mira e vet*” (përk. “me të mirën e vet”).

Fjala *jezulli* “prush; shpuzë zjarri; hija që shtëpia ose pema e një banori bën në dëm të kopshtit të mbjellë me perime (ose diçka tjetër që kërkon diell) të një prone, duke i zënë diellin a duke e dëmtuar” (*Jezullin e huej*), e formuar nga *jezull* me prap. --i *jezull-i*, gjendet te Gazulli me kuptimin “zjarmi e përmbrendshëm”.¹²⁰ Ngjan që etimologjia e dhënë nga Çabej: “Prandaj *ezull* (e andej *jezull*) pas gjithë gjasësh ka dalë nga një zbërthim (shpërbërje, dekompozim) i fjalës *ndezulli* “zjarmi; zell, ndezë”¹²¹ është e qëlluar. Te Gazulli gjejmë *ndezulli-ja* “zjarmi”, me përdorim në Malësi të Madhe.¹²² Te

¹¹⁷ Zingarelli Voc. II 54.

¹¹⁸ *Fjalor* 2006, f. 420.

¹¹⁹ Xhuvani-Çabej *Prapashtesat* 531.

¹²⁰ Gazulli *Fjalorth* 183.

¹²¹ E. Çabej SE IV 112.

¹²² Gazulli *Fjalorth* 285.

fjalori i Bashkimit 169 regjistrohët fjala *iexull-i* “cenere e fumo che s’innalza dal fuoco”.

Fjala *shengjet/ë, -a* “pjesa që i përket atij që ka vrarë i pari gjënë në gjojë; pjesa e caktuar paraprakisht për të; çmimi për pagesën e një gjaku me para” (*Shengjeta perbâhet prej mushknish, e kaptinet ...*), ngjan të jetë formuar me tejbajtje kuptimi, me shpërbërjen polisemike të primitivit *shëngjetë* “shigjetë”, e lidhur me atë gjuetar që qëllon i pari gjahun. Duhet të jetë kjo fjalë e trashëguar së lashti, sepse tani gjahu vritet me armë zjarri.

Për fjalën *kadoc, -i* “gjel-i” (*Gjeli /knduesi-kadoci/*), Xhuvani-Çabej kanë shkruar se nuk i dihet burimi.¹²³

Ngjan të kemi këtu një formim me prap. -oc (shumë e rrallë, e përdorur kryesisht në gegërishten veriore) dhe rrënjën *kad-* si ngushtim i *kë/n/d-* (*kënd/oj*), që me asimilimin -nd : d (si dukuri krahinore) dhe me kalimin e theksit te prap. është hapur në *ka/n/d-*, duke përfunduar në trajtën e sotme *kadoc*. Khs. tani fjalën *kodec* “gjel”, që e jep Beci po për Mirditë.¹²⁴

Folja *pervarë (me u)* “me u shmangë; u bën bisht vendimeve që janë marrë kundër tij; duke u përligjur e duke gjetur kleçka për t’i ikur vendimeve përkatëse kundër tij; anoj nga një krah padrejtësisht; përvirem” (*kur t’i pervaret kush*), e formuar nga *per* + *var*, ka marrë tani kuptim të ri “mënjanohem”, që nuk regjistrohët në fjalorët e shqipes. Një fjalë me kuptim të afërm me të sipërmen e gjejmë te Bashkimi 343 *pervar/i* “prevaricare” dhe mb. (*i*) *pervarun*.

Fjala *perkasí, -ja* “trashëgimia” (*s’ka tager trashigimi as perkasiqe*) është e formuar nga emri *perkaes* “përkasës; trashëgues i një pasurie” (*s’mund të bâhen kurr perkaes /trashigues/*), shpjeguar nga vetë Gjeçovi “trashigues”. *Perkasi*

¹²³ Xhuvani-Çabej *Prapashtesat* 521.

¹²⁴ Beci *E folmja e Mirditës*, po aty, f. 108.

është formuar nga folja *(me) perká* “(me) përkitë”; së pari *perká* + -s “ai që i përket (një diçka)” dhe, më pastaj me prap. tjetër -i (*perkás* + -i) me kuptimin e “(pronës) që i përket dikujt; trashëgimia”.

perpjesnue (me) “ndaj një gjë pjesë-pjesë” (“Fitimi e rreziku i të bijve i *perpjesnohet t’et e vllazenve*”) ngjan të jetë neologjizëm në ngjasim me tjetrën *përpjesëtohen*.

Folja *jashtoj* dhe mbiemri *(i) jashtuem* nuk dalin as në fjalorin e vitit 1954 e as në tjetrin e vitit 1980, por regjistrohen në fjalorin e vitit 2006. Në Kanun dalin *jashtue (me)* “me përjashtue; me nxjerrë jashtë” (*a në jashtoftë kend*). *Jashtuem (të)* “të përjashtuar; të nxjerrur jashtë” (*graníja e fníja janë të jashtuem prej kanúnit*).

Folja *me gjygjue* “me bâ gjyq; me gjykue” (*do të gjygiohen ... me pëgje*), ngjan të jetë futur vonë si term kanuni; në vend të saj atje është përdorur tjetra *pleqnoj*. Po edhe neologjizëm e krijuar nga Gjeçovi nuk mund të jetë, sepse ai do të kishte përdorur në këtë rast të përgjithshmën *gjykoj*. Mbase në Kanun kjo *gjygjoj (gjygj “gjyq” + -o/j)* mund të kenë patur edhe ndonjë nuancë tjetër kuptimore krahas “pleqnoj”.

Është për të vënë re se folja *(me) gjygjue* regjistrohet te fjalori i Bashkimit 144, së bashku me *gjygj, (i) gjygjuem, gjygjtar* etj.

Folja *me ligjue* “me i dhënë arsye atij që të ka nën urdhër; me i dhënë shkoqitje për gjithçka pronarit kur ai e kërkon këtë” (*bulku do t’i ligjohet të zot’t me bé*; (*e per të shame do t’i ligjohet*), del tani me kuptime të reja nga zanafilla “përligjet, justifikohet”. Në tekstet e nxjerra nga Kanuni *ligjohet (ligj + o/j)* tani ka edhe kuptimin “(i) përgjigjem, (i) nënshtrohem”.

Folja *(me u) ligjue* “giustificarsi, domandare giustizia” del në Fjalorin e Bashkimit 232; aty edhe mbiemri *(i, e) ligjuem*.

Emri *m/ë/dheskë* zërthehet nga kuptimi i saj “shtëpi përdhese; që nuk është e ngritur nga toka” (*mdheskë a kullë*).¹²⁵ Kemi pra një formim nga parafjala *më*, e cila i paraprin pjesës tjetër që vjen pas: /*më/ -dheskë*, kjo e fundit nga *dhë* me prap. e aglutinuar *-skë* (-s + -k/ë/), ndërtime që nuk gjejnë shoqe në gjuhën e sotme shqipe, veçanërisht prap. -k, origjina e së cilës është e diskutueshme.¹²⁶ Fjala *mdheskë* del në *Fjalorin* e vitit 1954 me kuptimin “shtëpi e vogël përdhese, si kasolle.”¹²⁷ *Fjalori* 2006 këtë fjalë nuk e regjistron fare, me gjasë si krahinore. Kuptimi i mirëfilltë i saj është “shtëpi e ndërtuar pa u ngritur nga toka; pra rrafsh me tokën”. Këto tipe ndërtimesh takohen shpesh në zonën e Mirditës e gjetkë, veçanërisht në zona fushore, ku mungon guri. Raste të ngjashme të ndërtimit me parafjalën *më* (përkat. *në*), janë të vjetra në gjuhën shqipe; ato i gjejmë edhe në defterët kadastralë osmanë të shek. XV.

128

Folja *me praptue* “me prapësue; me kthye mbrapsht; me prishë një punë të nisur që më parë; me prapë” (*të mos*

¹²⁵ KLD 43.

¹²⁶ Xhuvani-Çabej *Prapashtesat* 508 v.

¹²⁷ *Fjalori gjuhës shqipe* 1954, f. 302.

¹²⁸ Po kështu, në defterin e vitit 1467 dalin emrat e fshatrave *Mshgret* (sot *Shkreta* në krahinën e Krujës), *Mdosh* (sot *Dusha*, lagje e fshatit *Bruz* të Krujës) dhe *Nebaz* (sot *Bazi*, fshat në Mat). Të tre emrat e sipërm paraqesin një formim me parafjalën *më* (përkat. *në*) të rasës vendore, që i është parangjitur emrave përkatës, duke formuar bindjen se kemi të bëjmë me një *m-* protetike. Ne, pas një studimi të plotë të këtij defteri, së bashku me identifikimin dhe lokalizimin e emrave të tij, patëm arritur në përfundimin se kemi këtu thjesht një formim me parafjalë, që i përgjigjet pyetjes që ka bërë regjistruesi i defterit. Ai ka pyetur: “Ku banon?”, dhe ka marrë përgjigjen: “Më Shkretë” etj. Duke qenë qatipi i huaj, e ka regjistruar emrin ashtu si e ka dëgjuar, pra *Mshgret*. Kuptohet se tipet e emrave të sipërpërmendur përbëjnë vetëm një bazë të shëndoshë për të nisur studimin e mëtejshëm për të shtuar fjalët paraletrare të gjuhës shqipe.

praptohet e mara e saj),¹²⁹ sot përdoret rrallë në gjuhën shqipe. Vendin e saj e ka zënë tjetra *prapësoj*. E regjistron këtë *praptoj Fjalori 1954*.¹³⁰ Ai i vitit 1980 e ka hequr, me gjasë si krahinore. E ka këtë fjalë fjalori i Bashkimit 361 *(me) praptue* e *(me u) praptue*, së bashku me mbiemrin *(i, e) praptuem*. Ndërkaq duhet vënë re se *prapësoj* me *praptoj* nuk janë e njëjta fjalë, sepse nuk e mbulojnë plotësisht njëra-tjetrën. *Praptoj* është e ndërtuar nga ndajf. *prapa* me prap. *-toj* (*prap/a/ + tój > prapëtój > praptój*).

Emri *sedij/e, -a* është leksikalizim i fjalisë *s'e di*, që përdoret prej atyre dëshmitarëve që deklarohen se nuk e dinë çështjen për të cilën pyetën a japin shpjegime (*Maja e bës asht "sedija"*).¹³¹ Kjo fjalë del e regjistruar në Fjalorin e vitit 1954 si edhe atij të vitit 2006 (këtu me shën. *bisedore*).

Interes të veçantë paraqet analiza e fjalës *doke-t* "ligje të pashkruara që janë transmetuar brez pas brezi e që janë ligjëruar në kanû", mbi bazën e të cilave janë ndërtuar "normat kanunore". E. Çabej (SE III 277), duke ndjekur hullinë e hapur nga Jokli, shkruan: "... është një emër foljor nga *doket*, trajtë e geg. verilindore për *duket*, që i përgjigjet fjalës *dukë* f. të gegërishtes veriperëndimore. Kështu *doke* del po një fjalë me *dokë doke* "pamje e jashtme e një njeriu, të pamit, të parët". Në vazhdim, Çabej, do të vërë re se "Kuptimi që mori kjo fjalë për "zakon" është një zhvillim i rëndësishëm për drejtësinë popullore shqiptare. Këtu kemi një fjalë vendi me këtë përdorim, pranë sllav. *zakon* e turq. *kanun* e *adet*. Kalimi semantik që përshkoi fjala u krye nëpërmes të një përdorimi "ajo që pëlqehet, që duket e mirë".

Pikërisht mbi bazën e këtij konceptimi, sa interesant, po edhe tërësisht progresiv, u ndërtuan edhe nenet e kanunit.

¹²⁹ KLD 8.

¹³⁰ *Fjalor 1954*, f. 426.

¹³¹ KLD 62.

Është për t'u shënuar se në Kanun mungon fjala *zakon*. Kjo sepse *zakon* nuk është term juridik.¹³²

Siç shihet deri më tani, mund të pohohet pa frikë se gjuha e Kanunit është jo vetëm e pasur, por edhe bazë materiale e burim i pashtershëm për të gjitha degët e gjuhësisë shqiptare.

TAKIMI I FJALORIT TË KANUNIT¹³³ ME FJALORIN E KËNGËVE TË KRESHNIKËVE¹³⁴

KANUNI	KRESHNIKËT
armatisun (i) 101*	<i>armatisë (me u) 10/2</i>

¹³² Në Kanun nuk del gjekundi fjala *zakon-i*, e cila dihet se është huazuar në shqipe nga serb. *zakon* "ligj". Me këtë kuptim kjo fjalë del që te autorët e vjetër; khs. Buzukun: "1. Mënyrë jetese e sjelljeje e lënë nga të parët *porsi ish zakoni me votë ditënë e festësë* (Meshari XXXVII/3 99); 2. Ligj *porsi ish zakoni i Moiseut* (Meshari LIV/1 165); 3. Urdhënim *një në kësish zakona* (Meshari LXXXVII/2 373); khs. K. Ashta Lek. I 488. Te Budi del me kuptimin "rregull" *bahen të tjera ceremonie e zakone të rea* R 8 (K. Ashta Lek. II 308). Te Bardhi *zakon* del me pesë kuptime a përdorime të ndryshme (K. Ashta Lek. III 292). Po kështu te Bogdani (K. Ashta Lek. IV 385). Ngjan që huazimi *zakon* të ketë qenë në fillimet e veta fjalë savante, me përdorim libror e në rrethe urbane. Në zonat fshatare kjo fjalë nuk përdoret (khs. p.sh. Gazullin). Mospërputhjen e plotë në kuptimin e fjalës *zakon* "ligj" të serbishtes me *zakon* të shqipes e ka dhënë edhe G. Meyer (EW 548) kur shënon kuptimet (për fjalën e shqipes) "doke, shprehí, përdorim". K. Ulqini (*Kundrim* 111) shprehet se "është gabim të thuhet norma dokësore ose norma zakonore për norma kanunore".

¹³³ Fjalori i Kanunit është në këtë libër (pjesa e dytë).

¹³⁴ Fjalori i Kreshnikëve është te D. Luka SGJ XVIII 125, *Fjalor i përzgjedhur i fjalëve të rralla të këngëve të kreshnikëve*, nxjerrë nga *Kangë kreshnikësh dhe legjenda* (Botimi II), mbledhë e redaktue nga At Bernardin Palaj dhe At Donat Kurti, Botime Françeskane, Shkodër, 2005.

bajrak, -u 2	<i>bajrak, -u 18/2</i>
bajraktar, -i 5	<i>bajraktar, -i 95</i>
barr/ë, -a 1	<i>barr/ë, -a 26</i>
batar/e, -ja 5	<i>batare 13/2</i>
behë (me) 49	<i>beh 110</i>
bûjtë (me) 74; bujtme (e) 17	<i>bûjtë (me) 224</i>
burg, -u 75	<i>burg, -u 9, 60</i>
burrní, -ja 58; burrnim, -i 78	<i>burrneshë 177; burrnisht 40</i>
carâ, -ni 17	<i>carâ, -ni 255</i>
cofë (me) 32; cofët 34	<i>coftë 22/2</i>
cub, -i 3; cubní, ja 20	<i>cub, -i 26</i>
cûgj 75	<i>cung, -u 10, 60; cung/ë, -a 162</i>
çartë (me) 2	<i>çartë (me) 41</i>
çerranik, -u 30	<i>çerranik, -u 160</i>
darsmorë-t 18	<i>dazmorisht 16/2</i>
dashamirsí, -ja 44	<i>dashamir, -i 18/2</i>
derk, -u 33	<i>derk, -u 259</i>
djerrun (i) 60	<i>djerrë (me u) 226</i>
dorëzan/ë, -i 70	<i>dorëzanë 266</i>
dredhue (me) 84; dredhim, -i 47	<i>dredhë (me) 18; dredh/ë, -a 158</i>
drom, -i 6	<i>drom, -i 15; drum, -i 20</i>
duk/ë, -a 16	<i>dok/ë, -a 33/2</i>
dugaj/ë, -a 46	<i>dugaj/ë, -a 85, 275</i>
dyndë (me u) 35	<i>dyndë (me u) 30, 53</i>
dhân/ës, -si 52	<i>dhanshin 6/2</i>
dhantí, -ja 24	<i>dhantí, -ja 8</i>
edh, -i 54	<i>edh, -i 204</i>
falë (me u) 66	<i>falë (me u) 51</i>
famull, -i 73; famullesh/ë, -a 73	<i>famull, -i 74</i>
fikë (me u) 68	<i>fikë (me u) 178</i>
fis, -i 2; fisnikí, -ja 85	<i>fis, -i 26</i>
forcad/e, -ja 16	<i>forcë, -ja 7</i>
gac/ë, -a 68	<i>gac/ë, -a 138</i>
goditë (me u) 73	<i>goditë (me) 22</i>
grazhd, -i 25	<i>grazhd, -i 280</i>

grazhdue (me) 34	<i>grazhdue (me) 21/2</i>
grosh, -i 5	<i>grosh, -i 151</i>
gjâja 32	<i>gjâ, -ja 9</i>
gjak, -u 12; gjak, -u 22	<i>gjak, -u 151</i>
gjak/ës, -i 4	<i>gjaks, -i 185</i>
gjâm/ë, -a 83	<i>gjam/ë, -a 9; gjamue (me) 9, 132</i>
gjegjë (me) 17	<i>gjegjë (me) 40</i>
hjekësi, -ja 65	<i>hjeksi, -ja 28, 37</i>
hullë (me) 51	<i>hudhë (me u) 213</i>
hupë (me) 1	<i>hupë (me) 52</i>
hupës 33; hupsë 76	<i>hupsh 2/2</i>
kallamoq, -i 15	<i>kollomboq, -i 260</i>
kambë (berri) 31	<i>kâmba-doras 32; kamcë 22</i>
kandár, -i 65	<i>kandar, -i 203</i>
kanun, -i 1; kanunár 94	<i>kanû, -ja 46, 185</i>
kobshem (i) 80	<i>kob, -i 137; kobitë (me) 238</i>
konop, -i 2	<i>konop, -i 65, 68, 171</i>
koritë (me) 2; korituni (i) 65	<i>koritë (me) 21; kori, -ja 77</i>
kortár, -i 102	<i>kortarë 10/2</i>
koshar, -i 30	<i>kozhar, -i 56</i>
krení, ja 84	<i>krení, -ja 17/2</i>
krushk, -u 14	<i>krushk, -u 2</i>
kryqzue 93	<i>kryqalisht 172</i>
kulár-krrabza 76	<i>kular, -i 22/2</i>
kull/ë, -a 30	<i>kull/ë, -a 21</i>
kumbar, -a 72	<i>kum/b/ar, -a 73</i>
kunat, -i 19	<i>kunat, -i 106</i>
kunat/ë, -a 19	<i>kunat/ë, -a 279;</i>
kunetí, -ja 22	<i>kunetí, -ja 245</i>
kuvend, -i 9	<i>kuvend, -i 53</i>
lak, -u 76	<i>lak, -u 155</i>
lang/ue, -oni 48	<i>langue-langoni 8</i>
latush/ë, -a 35	<i>lat/ë, -a 24/2; latue (me) 96</i>
lig (i) 59; ligë (e) 19	<i>ligë (e) 6; ligt (t') 126</i>
lypë (me) 82	<i>lypë (me /i/) 8</i>

magjar, -i 78	<i>magár, -i 158</i>
marr/e, -ja 4	<i>marr/e, -ja 26, 171</i>
mê (me) 47	<i>mê (me) 18</i>
megje-t 40	<i>megj/e, -ja 29</i>
mik 90	<i>mik, -u 39</i>
miqasore 91	<i>miqasisht 6/2; miqasue (me u) 209</i>
mner/ë, -a 70	<i>mner/ë, -a 11</i>
mort, -i 74	<i>mord/e, -ja 44</i>
motmot, -i 110	<i>motmot, -i 38/2</i>
motnuem (i) 37	<i>motnueme (e) 29</i>
mriz, -i 35; mrizue (me) 35	<i>mriz, -i 2</i>
mundshtue (me) 9	<i>mundshim 178</i>
muran/ë, -a 38	<i>muran/ë, -a 44</i>
nadj/e, -a 15	<i>nadj/e, -a 162</i>
ndêjë (me) 94	<i>ndêjshëm 30</i>
ndor/e, -ja 2	<i>ndor/e, -ja 9</i>
ndreqë (me u) 47	<i>ndrejt 27</i>
ngucatë (me) 17	<i>ngucë (me) 64</i>
ngulë (me) 26	<i>ngulë (me) 31</i>
ngurrue (me) 47	<i>ngurue (me u) 245</i>
ngushtue (me) 70	<i>ngushtue (me u) 3, 128</i>
nip (trungu) 71	<i>nip, -i 176</i>
ok/ë, -a 15	<i>ok/ë, -a 200</i>
paj/ë, -a 14	<i>paj/ë, -a I 33</i>
pám (të) 27	<i>pám (t') 253</i>
par/e, -ja 83	<i>par/e, -ja 27</i>
pend/ë, -a 44	<i>pend/ë, -a 41/2</i>
perbé (me u) 37	<i>perbé (me) 48</i>
petk, -u 13	<i>petka-t 110</i>
pistol/e, -ja 54	<i>pishtole-t 158</i>
pleqni 96	<i>pleqni. -ja 144</i>
praptue (me) 8	<i>prapue (me u) 27</i>
prit/ë, -a 81; pritëtar, -i 82	<i>prit/ë, -a 32</i>
qes/e, -ja 7	<i>qes/e, -ja 266</i>
qitë (me) 87	<i>qitë (me) 28</i>

rême-t 8; remët (e) 13	<i>rême-t 161</i>
rend, -i 43	<i>rend,-i 44</i>
rmue (me) 64	<i>rmue (me) 224</i>
rob, -i 10; robí, -ja 5	<i>robin/ë,-a 6, 137, 30/2</i>
rrêjtë (me) 37	<i>rrêjtë (me) 271</i>
rrekë (me u) 22	<i>rrekë (me u) 46</i>
rreng, -u 62	<i>rreng,-u 44</i>
rrnes/ë, -a 20	<i>rrnue (me) 137</i>
rrogtar, -i 29	<i>rrogtar/e,-ja 272</i>
rrokë (me) 39	<i>rrokë (me) 94</i>
rrokull 44	<i>rrokull 167</i>
rrshânas 14	<i>rrshanas 17</i>
rrûm, -i 44	<i>rrum 216</i>
sahat, -i 80	<i>sahat,-i 199, 266</i>
strajc/ë, -a 48	<i>strajc/ë,-a 93</i>
sumbull, -a 69	<i>sumbull,-a 212</i>
shkepë (me) 104	<i>shkepë (me u)</i>
shnjerzim, -i 110	<i>shnjerzue (me) 37, 83</i>
shmangë (me) 94	<i>shmangë (me u) 15</i>
shpêz, -i 48	<i>shpêz,-i 246</i>
tatgjysh, -i 37	<i>tat/ë,-a 33</i>
tbân/ë, -a 33	<i>tban,-i 29</i>
termal 46	<i>termale 93, 184</i>
tinëz 30	<i>tinzisht 177</i>
trevez/ë, -a 66	<i>trevez/ë,-a 4, 172</i>
trokllue (me) 4	<i>trokllue (me) 110, 176</i>
trupue (me) 39	<i>trupue (me) 99</i>
turr/ë, -a 88	<i>turr 171</i>
tutun (i) 27	<i>tut/ë,-a 22; tutësh 62</i>
urtë (i) 100; urtí, -ja 67	<i>urtisht 32</i>
vad/ë, -a 23	<i>vad/ë,-a 171</i>
vad/e, -ja 12	<i>vad/e,-ja 119</i>
varr/ë, -a 22	<i>varr/ë,-a 43</i>
vath/ë, -a 9	<i>vath,-i 46</i>
vllá (me bâ) 36	<i>vllath,-i 29</i>

vrugnue (me) 94	vrugue (me) 255
zatetë (me) 3	zatetë (me) 86

* Fjalori do të ndiqet kështu: te radha e majtë (Kanuni) rreshtohen fjalët dhe ngjitur me to jepet numri i faqes ku del ajo te Át Shtjefën Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, botimi III, Shkodër, 2010. Djathtas (Kreshnikët) rreshtohen fjalët e nxjerra nga *Kangët e Kreshnikëve* dhe pas tyre numri i faqes në librin përkatës.

Me interes paraqitet krahasimi i fjalorit të Kanunit të Lekë Dukagjinit me atë të Këngëve të Kreshnikëve. Nga një mijë fjalë të përzgjedhura për krahasim në veprat e mësipërme, rreth 143 (15%) prej tyre janë të njëjta. Megjithëse tematika e zhvillimit të ngjarjeve te *Kanuni* e te *Kreshnikët*, nuk është e njëjtë, prapëseprapë takimet përligjen po të marrim parasysh se jemi gjithsesi në një rrafsh (përk. mjedis) shqiptar, ku jo vetëm mënyra e jetesës është pothuaj e njëjtë, po edhe botëkuptimi, marrëdhëniet shoqërore me njëri-tjetrin e, mbi të gjitha, një pjesë e riteve, të shprehura tani në fjalorët përkatës. K. Ulqini vë re se “Në këngët e epikës heroike legjendare besa, ndorja etj., nuk janë cilësi të veçanta apo vetjake të një heroi, po ligje të një shoqërie, institucione karakteristike të njohura gjatë shekujve.”¹³⁵

Në të dy arealet, te Kreshnikët e te Kanuni, dalin fjalë (përk. huazime latine) që kanë lidhje me familjen e farefisit si *famull*, *famulleshë*, *fis*, *kumbarë*, *krushk*, *kunat*, *kunatë*, *nip* etj., që tregojnë zanafillën e vjetër të këtij populli të vogël ndër shekuj dhe takimet e bashkëjetesa me latinë në trojet autoktone. Tanimë dihet që këto huazime jo vetëm janë të vjetra në gjuhën shqipe, po ato kthehen edhe në institucione të familjes shqiptare.

Gjenden të përbashkëta te Kreshnikët e te Kanuni fjalë që kanë lidhje drejtpërdrejt me institucionet e të së drejtës popullore si: *dorëzanë*, *kanun*, *bajrak*, *bajraktar*, *gjak*, *gjakës*, *kuvend*, *ndore*, *pleqëri*, *qese* etj.

¹³⁵ K. Ulqini, *Elemente*, “Kundrime” 63.

Huazimet nga turqishtja, të shumta te Këngët e Kreshnikëve (275 fjalë, 26%), në Kanun janë krejt të pakta (26 fjalë, 3%). Kjo është e shpjegueshme për dy arsye. E para, Këngët e Kreshnikëve vazhdojnë të këndohen edhe në një mjedis mysliman (Rugova), ku shumica e huazimeve nga turqishtja kanë hyrë atje së voni. Ndryshe ndodh me Mirditën, ku mendohet të jetë mbledhur Kanuni. Këtu vendi është krejtësisht i besimit të krishterë (përkrah. katolik) dhe ndikimet nga turqishtja edhe në kohën e sundimit turk kanë qenë krejt të parëndësishme. Dihet që Mirdita nuk u pushtua asnjëherë nga turku (si krahinat e tjera të vendit), përkundrazi, ajo edhe në kohën e këtij pushtimi ruajti njëfarë pavarësie.

Te Këngët e Kreshnikëve dalin gjith. 52 huazime sllave (rreth 4.6%); ndërkah te Kanuni rreshtohen 34 huazime (rreth 4%). Qoftë për huazimet nga turqishtja, qoftë për huazimet nga sllavishtja duhet dalluar edhe cilësia e tyre. Ndërsa te Kreshnikët këto huazime zakonisht janë të mbarë gjuhës (pra nuk kanë ndonjë specifikë të caktuar), te Kanuni shprehin lidhje historike e shoqërore të kohës (khs. *kanun*, *bajrak*, *bajraktar*, *qese* etj.). Po kështu huazimet sllave te Kreshnikët janë kryesisht krahinore, të marra nga serbishtja, me të cilën qenë në kontakt të vazhdueshëm banorët shqiptarë. Te Kanuni këta huazime sllave shprehin tani marrëdhënie më të vjetra me strukturat organizative të kodeve sllave të kohës së Dushanëve (khs. *porotë*, *porotnik*, *ujem*, *vojvodë* etj.)

Krahas fjalëve që tregojnë armatime si (*i armatisun*, *batare*, *pistoletë* etj.), dalin një numër i madh fjalësh të përbashkëta, që flasin për mënyrën e jetesës së atyre që i përdorin: khs. *burg*, *cub*, *darsmorë*, *grosh*, *kollomoq*, *langue*, *latushë*, *magjar*, *muranë*, *okë*, *tbanë*, *vath* etj. Në këtë mes do të veçoja dy prej tyre. Njëra *trevezë-a* “tryeza karakteristike, ku hanë bukë shqiptarët e asaj kohe” dhe tjetra *tatë-a* “baba-i”, e cila ende nuk është zëvendësuar me huazimin nga turqishtja *babà*. E para *trevezë*

mbase lidhet me *tryezë*,¹³⁶ dhe e dyta, *tatë*, është fjalë vendi e vjetër.¹³⁷

¹³⁶ Me sa dimë ne, fjalës *trevezë* nuk i dihet prejardhja. Ne mendojmë se ajo mund të jetë zhvillim përbrenda shqipes i *tryezë* me ndërrimet e mundshme *tryezë* > *tryvezë* > *trevezë* me shtesën e një -v- për të zhdukur hiatin.

¹³⁷ **tatë,~a** “baba, atë” (*Fjalor* 1980, f. 1970). Aty edhe rrjedhojat *tatëlosh,~i* “1. Gjysh, babagjysh ...”, *tatëmadh,~i* “gjysh, babagjysh”, *tatëzot,~i* “1. Gjysh ...”

Fjalë e mbarë shqipes, por e përdorur më tepër në Veri të vendit. Del që të Buzuku *tatë-a* “atë, babë” n shpirtit të *tatësë tim e të mamësë sime e atyne* ü ndije *katetë e tyne*, *Meshari* XIX/4, 55; foli *Izaku përrindit tî e tha: Tatë!*, *Meshari* LXI/2, 233; “dixit Isaac patri suo: Pater mi” *Genesis* XXII, 7. Budi nuk e ka. Bardhi *tatë-a* “atë, babë”, “incanescit pater: u thinj tata” 35; “pater, padre: baba, tatë” 194 (*Ashta Lek.* III 272). Aty edhe *tatgjysh-i* “gjysh”, “euus, auo, atta: *tatagjysh*” 194. Bogdani nuk e ka.

Kristoforidhi 351 *tatë-a* “ὁ πατήρ” (lat. *tata*).

Ndër të folmet krahinore, në Dukagjin *tatëgjysh,~i* “gjysh, babagjysh, tatëzot” (GJJ 4, 1988, f. 82). Në të folmen shqipe të fshatit Mandricë (Bullgari) *tate-ja* “babai” (SF 2, 1965, f. 168).

Te arbëreshët e Italisë *tat/ë-a* “baba”, *tatëz*, *tatëljash-i* “tatë i shkuar nga mosha”, *tatëlosh*, *tatëmadh-i* “gjysh” (*Kamsi Fjalor arb.-shqip* 272). Te fjalori i Da Lecces 830 *tat* “padre”.

Në letërsinë artistike të Fishta (“Anzat”) *tat/ë,~a* “babà” (*Luka Stud. gjuh.* IX 71), khs. vargjet *Se tata plak i diq ktij djali t’ri* (f. 75).

Si term etnografik *tatë,-a* “babë, emër me të cilin thërrasin e nderojnë te rinjtë më të vjetrit” (*Luli Kanuni* 40). E ka këtë fjalë edhe *Bashkimi* 449.

G. Meyeri EW 424 e vendos *tatë* të shqipes në një grup të madh fjalësh të gjuhëve të ndryshme indoevropiane duke nisur nga indishtja e vjetër *tāta* etj. dhe duke e çmuar si fjalë vendi e shqipes. Të tjerë e vendosin në grupin e gjuhës së fëmijëve, që ndeshen në një numër gjuhësh të ndryshme të botës, të cilat disa herë nuk janë të një familjeje.

Ne mbetemi me mendimin e E. Çabejt (SGJ II 167), që e sheh këtë *tatë* përfitim përbrenda shqipes “një nominativ i dalë nga akuzativi i *at-it*: i *ati*: *t’atnë*: *tatnë*: *tata*”, por me një ndryshim të vogël. Ashtu siç jemi shprehur te emrat *mamë* (përk. *mëmë*), të cilët ngajnë të formuar nga togfjalëshi *em amë* (përk. *im ëmë*) e që në rrjedhën e kohës u përngjitën

Me interes paraqitet analiza historike e fjalës *nadje* “mëngjes”, trajtë e mirëfilltë dialektore e gegërishtes. Te Kreshnikët: **nadj/e, -a** 162 “mëngjes-i” (në përshëndetje *Mirëmëngjes!*) (*N’nadjet Muja kênka çue*). Te Kanuni: **nadj/e, -a** 15 “mëngjes-i” (*Të shtunden nadje shkojnë krushqit*). Sipas E. Çabejt *nadje* lidhet me *natë* duke marrë tani kuptimin e “mëngjesit të parë”.¹³⁸ Kjo tejbjatje kuptimi ndeshet te Budi: *natje* “mëngjes” (“*mbë atë ditë të bekuome ndë natjet* R 222).¹³⁹ Te Frang Bardhi *ndënatë-ja* (“*aurora : akshani i dritësë o ndënatëja*”).¹⁴⁰ Te Bogdani *ndënatje* “mëngjes; lat. matutinum” (*tue u çuem ndënatijet*).¹⁴¹

Te fjalori i Da Lecces 414 ital. *mattina* përkthehet në shqipe “natë; ndë mingjes.” Te *Gramatika ndënatë* “mëngjes”.¹⁴²

Me interes është të ndiqet fjala (*me bâ*) *vlla* me tjetrën *vllath*. Të dy fjalët emërtojnë veprimin e lashtë të të pirit të një pike gjaku të njëri-tjetrit, akt që i vëllazëron ato për jetë.

Në këngën “Martesa e Halilit” gjejmë këtë varg: “*Për një punë, ti vlláth, sot me m’ndihmue.*”¹⁴³ Ne kemi dhënë për këtë rast shpjegimin: “zakonisht me këtë emër thirret probatini, i cili çmohet si vëlla”; kemi këtu një formim me prap. *-th* dhe emrit *vlla*. Vlen të diskutohet nëse kemi këtu dy fjalë, që emërtojnë të njëjtin objekt: njëra fjalë thjesht shqipe *vllath* dhe tjetra *probatin*, e huazuar nga sllavishtja.¹⁴⁴ Vlen të përmendet këtu edhe një varg i këngës “Omeri i ri”, që thotë:

në një fjalë të vetme, ashtu mendojmë edhe për *tatë*, formuar tani nga *yt atë* > *y tatë* > *tatë*, me rënien e *y*-së nistore për shkak të sandhit, duke qenë ajo e patheksuar.

¹³⁸ E. Çabej SE VI 9.

¹³⁹ K. Ashta Lek. II 245.

¹⁴⁰ K. Ashta Lek. III 208.

¹⁴¹ K. Ashta Lek. IV 266.

¹⁴² K. Ashta Lek. V 271.

¹⁴³ *Visaret* II, 126.

¹⁴⁴ Khs. Omari *Marrëdhëniet* 242 v.

- Ku po don, Omer, me shkue,
Probatina na sot pa u vllaznue?¹⁴⁵

Siç shihet brenda një vargu është përdorur dubleta bilingue sllavisht e shqip, për të shprehur të njëjtin emërtim. Rast të ngjashëm me të sipërmin kemi edhe te kënga “Arnaut Osmani e Hyso Radoica”, kur Arnaut Osmani pyet Hyson:

A ké lânë rob në shpí?
A ké lânë ndo’i shoq në vllazní?¹⁴⁶

Raste të kësaj natyre nuk janë të pakta në tekstet e Këngëve të Kreshnikëve e të Kanunit të Lekë Dukagjinit.

Fjalët *bajrak* e *bajraktar* (të dyja huazime nga turqishtja) nuk dalin me të njëjtin kuptim në të dy ndarjet e sipërme. Te Kreshnikët ka kuptimin “flamur” (*U del para me një bajrak të zí*). Te Kanuni: “njësi administrative në viset e malësisë së Veriut të vendit, e themeluar nga turqit me drejtim të caktuar për çështje gjyqësore e fiskale” (*djelmve të Bajrakut*).

Diktohen fjalë të përbashkëta që tregojnë për të njëjtën mënyrë jetese e veprimtari shoqërore: *kanuni* “ligj popullor i pashkruar, që zbatohet në mënyrë të ndërgjegjshme e pa detyrim; tërësia e këtyre ligjeve, që rregullonin jetën dhe veprimtarinë e asaj kohe”, si te Kreshnikët (*Se né të parët një kanû na kan lânë*), si te vetë Kanuni, ka të njëjtën peshë. Bile te Kreshnikët tani vërehet jo vetëm lashtësia e tij, po edhe vazhdimësia gjatë kohëve. Po kështu: *ndore, gjakës, gjâmë, muranë* etj.

Fjalë të përbashkëta vërehen edhe në emërtimin e mjeteve të jetesës: *carâ, okë, qese, tbanë, vath* etj.

Me interes paraqitet edhe evoluimi në kuptimin e foljes *me trupue*. Te Kreshnikët: “i kaloj me trup; i përshkoj (me trup)” (*Trupon bjeshkët e mbrapa po i lën*). Në këngët e Rugovës: *Ani,*

¹⁴⁵ Visaret 87.

¹⁴⁶ Visaret 105.

*qat-her' burrat lloçin p'e trupojnë.*¹⁴⁷ Te Kanuni “i pres një druri degët e rrënjët dhe e bëj trup; e cungoj; e bëj cung” (*më gjejnë tuj trupue arrnej të perhjedhun*).

¹⁴⁷ D. Luka SGJ XVIII 194.

FJALËFORMIMI

I. Formime me parashtesa

m- : *mkamë (me), mprojtar.*

mos- : *mospelqim.*

nder- : *ndermjetës.*

n/ë/- : *ndore, nëgojsh.*

nën- : *nëndorësh.*

nji- : *njimend..*

para- : *paravû (me).*

pa- : *pabesí, pabesní, paburní, padetyrë (i), pagjak (i), pakunorë (i), paligjë (i), pamarrveshtje (i), panjefun, (i), papasmi (i), paperlimsí, pasosme (e), pathyeme (e).*

per- : *perbashkënisht, perbé (me u), perbishtnim, perbûjs, perbûjtore, perdhuni, pergiakë (me), pergjegjme, pergjymsash, perhjellun, perkujdesë, perligj, perlim, permbasi, permendunt (të), pertejme (të), pervar.*

pici- : *picigjatë.*

sh- : *shkapercye (me), shkepë (me), shkmye (me), shnjërzim, shthurun (i).*

ster- : *sterdá (me u), sterkqí, stermarrë (me), sternip, sterplak.*

t/ë/- : *tbânë, tëhjek.*

zh- : zhdrivillim, zhgarkim, zhgulë,

II. Formime me prapashtesa

-aj/ë : arnajë, pemajë, vijnajë.

-ak/e/ : shpijak, zemrak, veshtak.

-an/ë/ : muranë.

-ar : deshar/ë/, grabitçar, kanunar, kufijar, shpijar.

-ar/í/ : bashkarí.

-as : ballas, deshtas, letas, ngiatas, rrethas, rrshanas.

-ash : dyzash.

-at/ë/ : forcade (forcát), ngucatë (me).

-ç : plumç.

-e : dahe, droje, shorte, shtoje.

-es/ë/ : blés, ndigiesë, presë, rresë, urdhnesë.

-esh/ë/ : famulleshë.

-/ë/ni : burrní, cubní, djelmní, nipní, pabesni, vajzëni, vjedhni.

-ë : bânë, fikë, krijë, kunatë, pri/j/ë, xanë.

-í : bashkarí, bulkí, cilltí, dashamirsí, dorzani, dredhí, dhantí, famullí, fisnikí, grabí, graní, hjeksí, hulli, jezullí, kasnecí, krení, krezhmí, krushqí, kumbarí, kunetí, kushriní, mbrapshtí, ndermjetësi, ndrikullí, nusí, pasí, puntorí, pusi, robí, shkuesí, urtí, vllazní, vogilí.

-ic/ë/ : ngarkicë.

-ij/e/ : kopshtije, zjarmije.

-im : blim, burrnim, dhetim, farkim, ferkim, gjallnim, lavrim, mashkullim, ndeshkim, ngatrrim, pelqim, peshim, pretim, qortim, randim, rrenim, sundim, shentim, shenjim, shnjërzim, trazim, urdhnim, veçim, vllaznim, zhdrivillim.

-in/ë/ : rrethinë.

-isht : fisnikisht, katundisht, kuvendisht, pjesnisht, uhazisht, vajzënisht.

-me : bujtme (e), dokshme (e), folme (e), hikme (e), kapme (e), keqsueme (e), kerkueme (e), lujtme (e), marrme (e), mshehme (e), përtëjme (e), shkrepme (e), shtime (e), thurme (e).

-or/e/ : gjaksor, magjatore, mangore, miqasore, tregtore.

-s/ë/ : blesë, gatojc/s/ë, gergas/ë/, mnisë, ngasë, prisë, urdhnesë, vrasë.

-s : báj's, detyr/ë/s, dhânës, frý's, gjakës, hjekës, hupës, lás, lanës, marr/ë/s, ngas/e/, prís, rojs, sjellës, shkues, thirc/s/.

-shëm : dokshme (e), duhshme (e), dyshueshëm (i), dhunshëm (i), kobshëm (i), kohshme (e), ngatrrueshme (e).

-t/as/ : çiltas.

-tar : bajraktar, besimtar, bestar, betar, dishmitar, famullitar, flamurtar, gjamatar, gjobtar, kcimtar/e/, lajmtar, mbrojtat, meshtar, ngatrrëstar, pretar, pritëtar, rendtar, rrogtar, shtektar, udhtar.

-tor/e/ : barrtuer (barrtore), faltore, magjatore, tregtore, ujtatore.

-tyr/ë/ : amtyrë.

-uer : dâmçuer, darsmuer, gjaksuer, plangçuer, tagruer.

-ull : rrumbull, shakull.

-ush/ë/ : latushë.

-zë : dhizë, kallzë, kupzë.

III. Kompozitat

1. **emër + folje** : bukëdhânë/s/, dorëdhânë/s/, dorëra/s/, dorëzânë, gjakhupë/s/, kryekcyem, mikpremë, shtaxânë, vetvrasë.

2. **emër + emër** : gurapeshë, krahamajtje, kryegjâ, kryeplak, kryeneç/i/, mjesditë, tatgjysh.

3. **emër + mbiemër** : berrëjshëm, faqezí, fjalëmirë, grykhollë.

4. **folje + emër** : bëzâj, hamendje.

5. **folje + ndajfolje** : bâkeq, bâmir.

6. **emër + ndajfolje** : kryeshëndosh.

7. **përemër + emër** : at/ë/botë.

8. **emër + numëror** : krushkaparë.

IV. Përngjitjet

Dypërnjahe (dy për një); tumirë (/kë/tu /âsht/ mirë); motmot (mot e mot).



FJALORI I “KANUNIT TË LEKË DUKAGJINIT”

A

almistra-t¹⁴⁸ 23 “vegla e mjete të ndryshme që përdoren prej bujkut; që përdoren në bujqësi” (*almistra*¹⁴⁹ *qësh*; 35 /*landë e almiste*/).

¹⁴⁸ Rreshtimi i fjalëve është bërë sipas alfabetit, duke ruajtur të paprekur formën e tyre në tekstin origjinal. Gjithsesi, u zbatuan ato kritere që përdoren edhe në fjalorët normativë; pra emrat u dhanë në njëjtsin e shquar, foljet kryesisht në trajtë të paskajores e kështu me radhë. Pas fjalës lemë shënohet numri i faqes ku ndodhet kjo në tekstin përkatës. Ndonjëherë shënohet më shumë se një numër; kjo ose për të dhënë intensitetin e përdorimit të fjalës, ose ndonjë kuptim a përdorim të ri të saj. Në vazhdim, ndër thonjëza, jepet shpjegimi i saj e, më pas, ndër kllapa, jepet fraza ku del fjala në veprën e cituar, duke u dalluar ajo që merret në shqyrtim.

Shpjegimi i fjalëve të rreshtuara në *Fjalor* në vendin përkatës, përbënte një çështje më vete, veçanërisht për foljet, që detyrimisht jo vetëm do të viheshin në trajtën e paskajores, por edhe duhet të shpjegoheshin po me të njëjtën trajtë. Përndryshe kuptimi i tyre nuk dilte i saktë dhe i plotë. Po kështu edhe nevoja e përdorimit të disa shprehjeve dialektore të gegërishtes, të cilat e jipnin më të plotë kuptimin e fjalëve. Kemi, pra, në tekstin e përdorur prej meje në shpjegimin e fjalëve disa herë një përzjerje të standardit me trajtat dialektore të gegërishtes. Ngjan që nuk kemi këtu një *thyerje* të *standardit*, por mbase një mënyrë për ta pasuruar atë.

¹⁴⁹ G. Meyeri (EW 9) jep vetëm formën *alëmistra* në shumës dhe mendon, me rezervë, si burim greq. e re. Fjala del së pari te Bogdani (*shumë duer alëmisash*). Sipas E. Çabejt fjalë e burimit venecian (SE III 34).

âm/ë, -a 45 “zanafillë; burim; aty ku ka zënë fill së pari” (*po kje e bleme me âmë e me plang*); 46 (*âma e bân vendin plang*); 46 (*Vija kâ rrjedhë, edhe e kâ bâ vendin âmë*).

amtyr/ë, -a 5 “burimi /i ndeshkimeve/; zanafilla e tyre; aty ku zënë fill, ama” (*Amtyra*¹⁵⁰ e ndeshkimeve).

and/e, -a 29 “andje e madhe; dëshirë tërheqëse; ëndje” (*Po s’heci pas andes së zotnis*).

angarí, -ja 2 “punë e papaguar; detyrim ndaj shtetit të asaj kohe për të kryer një punë pa pagesë; puna e papaguar që bujku duhet t’i bënte pronarit të tokës për disa ditë të caktuara” (*as shkon angarí*¹⁵¹ nder pûnë të famullís).

argat, -i 59 “punëtor krahu që kryen punë të ndryshme dhe paguhet me mëditje” (*Argat*¹⁵² i keq).

argjanët (e) 13 “që është prej argjendi” (*prej një unaze të rêmet a të argjanët*).

armatisun (i) 101 “(i) armatosur” (*në kuvend rrîjn t’armatisun*).

arnaj/ë, -a 40 “arë-a; toka buke; toka të punueshme” (*ndermjet dy arnaje*).

arnê, -ni 39 “*shum.* i arnyell-i ‘lloj pishë’ (Pinus excelsa); molikë” (*më gjejnë tuj trupue arne*¹⁵³ të perhjedhun).

¹⁵⁰ Fjala *amtyrë* ngjan si neologjizëm e përdorur nga Gjeçovi nën ndikimin e atyre fjalëve me origjinë latine që mbarojnë me *-yr/ë* (përkat. *-ûr*).

¹⁵¹ Kjo fjalë vjen prej turq. *angarya, angarye* (kjo vetë prej greqishtes), e cila ka shtegtuar edhe ndër gjuhë të tjera ballkanike (E. Çabej SE II 49). Khs. edhe T. Dizdarin *Fjalor* 30.

¹⁵² E. Çabej (SE II 74) ka shprehur mendimin se mund të kemi të bëjmë me një huazim të dyfishtë, pjesërisht drejtpërdrejt prej greqishtes (së re ose të mesme), pjesërisht prej turqishtes. Khs. edhe T. Dizdarin *Fjalor* 34.

¹⁵³ E. Çabej ngjan nuk e ka njohur trajtën e njëjësit *arnyell*, dhe të gjithë analizën etimologjike e vendos mbi trajtën e shumësit, duke nxjerrë përfundimin se “*arne* është një nga ato fjalët e shqipes që janë të shumëkuptimshme në punë të etimologjisë” (SE II 82)

asp/er, -ra 73 “para argjendi, e përdorur në atë kohë” (*nji asper*¹⁵⁴ të rrgjanët).

atbotë 7 “atëherë; në atë kohë” (*atbotë* zgjidhet).

atm/e, -ja 7 “atdhe-u”; neologjizëm e përdorur për herë të parë te *Fjalori i Bashkimit*¹⁵⁵ (*kan nji atme*).

¹⁵⁴ *Asper* “monedhë e vjetër e argjendë; të holla; përgjith. pare” është huazuar nga greq. bizantine ἄσπερα shm. “të bardha”, kjo prej lat. *asper*. Del që heret te autorët e vjetër (Budi e Bardhi), E. Çabej SE II 97.

¹⁵⁵ *Bashkimi*, f. 28.

B

bâ (me) /váj/ 1 “me u ankue; me kërkue një të drejtë” (*veç do të bâjë vâj te i Pari i Fës*).

babûn/e, -ja 15 “enë e drunjtë në formë cilindri që përdoret si masë drithi nga 10 deri në 25 okë” (4 *babûne*¹⁵⁶ *grunë*).

bajrak, -u 2 “njësi administrative në viset e malësisë së Veriut të vendit, e themeluar nga turqit me drejtim të caktuar për çështje gjyqësore e fiskale” (*djelmve të Bajrakut*).¹⁵⁷

bajraktar, -i 5 “i pari i bajrakut; ai që kryeson bajrakun” (*Vetem Bajraktari*¹⁵⁸ *me krenë*).

bajs, -i 106 “(njeriu) që bân fjalët; që është i porositur për ta kryer këtë detyrë; mbartës-i” (*âsht bajs*¹⁵⁹ *i fjalvet të porosituna*).

bâkeq, -i 5 “një njeri që bën të këqia” (*fisi mâ i afermi i bâkeqit*).¹⁶⁰

ballas 78 “ballë për ballë” (*ballas e me perdhûni*).

bâmir, -i 1 “njeriu që bën të mira” (*prej bujaris së bâmirve*¹⁶¹).

¹⁵⁶ G. Meyeri nuk e jep si sllavizëm, vetëm e krahason me greq. e re *μπαμπούνα* “enjtje, gjë e fryrë”. Selishçevi e jep si huazim sllav nga sllav. *baba* “gjyshe” me kuptim figurativ “gjë ë rëndë, e plogët, e trashë”. N. Jokli e barazon me fjalën greke dhe i nxjerr të dyja nga sllavishtja e vjetër **bob-*, **bobun-* “gjë e fryrë”. Janë dhënë edhe mendime të tjera për një burim onomatopeik të fjalëve shqipe e greke etj. E. Çabej (SE II 121) vetëm parashtron mendimet e ndryshme pa miratuar ndonjërin prej tyre. Sipas A. Omarit *Marrëdhëniet* 83 “Gjithsesi nuk kemi një paraformë sllave të një substantivi konkret me kuptimin e fjalës shqipe, siç është e zakonshme për huazimet sllave të shqipes, prandaj nuk është i sigurt si huazim sllav”.

¹⁵⁷ Huazim prej turq. *bayrak* “flamur” (E. Çabej SE II 134). Khs. edhe T. Dizdarin *Fjalor* 58.

¹⁵⁸ Huazim prej turq. *bayraktar* “flamurtar” (E. Çabej SE II 134). Khs. edhe T. Dizdarin *Fjalor* 58.

¹⁵⁹ *Bâjs* është prejfoljor, formuar nga folja *bâj* “mbart” me prap. -s.

¹⁶⁰ *Bâkeq* është kompozitë e formuar nga folja /me/ *bâ* dhe ndajfolja *keq*, me kuptimin “(ai) që bën keq”.

¹⁶¹ *Bâmir* është kompozitë e formuar nga folja /me/ *bâ* dhe ndajfolja *mir/ël*, me kuptimin “(ai) që bën mirë”.

bân/ë, -a 1 “ndërtesë banimi” (*bâna /qela/ e famullitarit*).

bár (djerr) 6 “arë që lihet disa vjet djerr; që lihet qëllimisht papunuar; që lihet për të kullotur bagëtia” (*tuj i a lânë token bár /djerr/ per disa vjetë*).

bár, -i 51 “bima”; fjala merr dy kuptime: “bima e barit”, si edhe “arë e lënë djerr për të kullotur bagëtia” (*Si të jetë lshue bár*).¹⁶²

¹⁶² Te kënga e dytë me titull “*Martesa e Halilit të ri me Ruzhën e Kalan Kapetanit*”, e botuar te gazeta “Shpnesa e Shqypnis” kemi fjalën *barishte* (në vargun “*du’ me e kudhot bjeshkën pa barishtjen.*”; *Mbledhës* III 529). Në vendin përkatës, botuesi i kësaj rapsodie (*Mbledhës* III, 529, shën. 223) jep këtë shpjegim: “Në variantet e njohura *travinë, traminë* (nga sl. *travarina* - taks bari). Mund të jetë shqipërim i kësaj fjale.”, pa treguar se kush e ka bërë këtë ndërhyrje dhe, gjithashtu, përse e ka bërë.

Tani dihet se çdo fjalë e kësaj natyre lind në kushte të caktuara; ajo gjithsesi ka historinë e vet. Po kështu edhe huazimi *travinë* “taksë bari”. Në të gjithë këngët e kreshnikëve askund nuk thuhet që shqiptarët e asaj kohe kanë zënë kullotat e sllavëve (sllavët nuk ishin vendës, por të ardhur në ato zona). Kjo sepse shqiptarëve nuk u ka lindur nevoja për një gjë të tillë. Bjeshkët e tyre kanë pasur hapësira të pamasa, të cilat ua kanë plotësuar të gjitha nevojat për kullotjen e bagëtive etj. E kundërta ndodh me sllavët e asaj kohe. Janë pikërisht ata që zënë kullotat e shqiptarëve në bjeshkë.

Në këngën e titulluar “*Basho Jona*” thuhet:

Ishte kânë Plaku Basho Jona,
Gjâ e máll Zoti i kish’ dhânë,
Gjân e mallin Radi i a kish pa’ xânë,
Nândë copë bjeshkë shkjaui i a kish’ marrë.
Nuk m’a lânë me gjâ me kullotë,
As nuk gjegjet **travinën** me i a lá ... (*Visaret* II 146.)

A. Omari *Marrëdhëniet* 294. Aty shkruhet: “*travinë* “taksë kullote” *travina bjeshkës*. Përdoret sidomos në poezinë popullore të Veriut (këngët e kreshnikëve). Sot pothuaj ka dalë jashtë përdorimi, përveç në shprehje si: *s’kullotet bjeshka pa travinë* “pa mund, pa zor” (Shkodër, Malësi e Madhe). Nga serb. *travarina* “taksë kullote” (*trava* “bar”).

- barí, -u** 31 “*Barí* thirret ai, qi i prîn tufës-gjâs në kullosë.”¹⁶³
- bariu-rrogtar** 31 “bariu që e kryen këtë detyrë i pajtuar me rrogë te zotnia” (*Bariu-rrogtar* është me detyrë me i a vû menden tufës).
- barr/ë, -a** (I) 1 “detyrë; detyrim për t’u kryer” (*Kanuni s’mund t’i vëjë kurrnji barrë*¹⁶⁴ kishës).
- barr/ë, -a** (II) 22 “masë peshe që përdoret kryesisht për drithrat” (*tri barrë drithë*).
- barr/ë, -a** (III) 89 “barra e gruas; shtatzânia; (gruaja që është) me barrë” (*i a presin edhe barrës tri qese*).
- barrt/uer, -ori** 45 “(punëtori) që bân barrë drithi prej një vendi në një tjetër; ai që çon barrë drithi në mulli” (*mos t’u hupë gjâ barrtorve*).
- bashkarí, -ja** 47 “bujq që punojnë bashkë; bujq që bashkojnë kafshët a edhe veglat e punës; ortakí-ja” (*e mira e bashkarís*).¹⁶⁵

Svane 114 sjell për *travina* “taksë kullote” për serbishten e Malit të Zi, që mund të jetë burimi i drejtpërdrejtë i fjalës shqipe.

Ka të ngjarë që të kemi këtu një dubletë *barishte* dhe *travinë*. Shembuj të kësaj natyre i kemi ndeshur edhe ndër regjistrat e kadastrës osmane të shek. XV. Mbase edhe fjala e kanunit *bar-i* “tokë e papunuar, e lënë livadh për të kullotur bagëti”, mund të ketë lidhje gjenetike a mbase të krahasohet me “barishten” e këngëve të kreshnikëve. Është për t’u shënuar këtu se në M. Shkodër përdoret fjala *barishtje* “taksa e barit apo e kullotës” (K. Ulqini *Terma* 137).

¹⁶³ KLD 31.

¹⁶⁴ Fjala *barrë* në gjuhën shqipe ka një numër të madh kuptimesh e përdorimesh të ndryshme, ndër të cilat veçojmë: ngarkesa e një kafshe a e një punëtori; (grua) shtatzânë (“grua me *barrë*); detyrë a detyrim për t’u kryer etj. Per sa më lart shiko *Fjalorin* 1980, f. 108 v.

¹⁶⁵ *bashkarí* është neologjizëm me kuptimin “së bashku; kolektivitet”; te *Bashkimi* “tutto insieme società”. Del në trajtën *bashkëri* që te Bogdani *tue mos përziem as ndonji bashkëri* (sa më lart, shiko E. Çabej SE II 180).

batar/e, -ja 5 “të shtëna armësh me breshëri” (*bâhet **batare**¹⁶⁶ prej Bajrakut*).

bé, -ja 3 “pranoj ose nuk pranoj një fjalë të folme a një punë të bërë; por gjithsesi para një njeriu a një grupi njerëzisht, duke pasur përpara një gjë të shenjtë, apo duke i u drejtuar asaj” (*Prihti s’çohet në **bé***); 60 (***Béja** lán gjaqe*).

beditë (me) 63 “trazon; mërzit (me fjalë e me vepra)” (*s’ka tager kush **me** i u **beditë***).¹⁶⁷

behë (me) 49 “me ardhë papritmas; me ardhë menjëherë” (*e mbas do kohe **behem** un*).

béja (mbë gur) 60 “*beja* që kryhet duke mbajtur në sup një gur të rëndë” (***Béja** mbë “gur” kah kanûja âsht nder mâ të rândat*).

béja (mbë Kryq a mb’Ungjill) 60 “*beja* që kryhet duke vënë dorën mbi kryq a mbi ungjill” (*mohuesi do të bâjë **bé** ... mbë Kryq e Ungjill*).

béja (me sedije) 63 “të bërit bé për një problem që nuk e di” (***Sedija** âsht një mjet qi Kanûja e ka vû per parim, per me i a rrudhë pëjt katundit, qi të mos bâhet kush hjekësi gjâs së shoqnís e kuejtdo*).

beja (në krye të djelmvet) 62 “të betuarit mbi kryet e djemve” (*Beja qi bâhet në krye të **djelmvet**, njehet nder bé të rânda*).

béja (per derë) 62 “të betuarit e të zot të shtëpisë në emër të të gjithë pjesëtarëve të familjes” (*Në **bé** per derë do të betohet i zoti i shpís n’êmen të vet e n’ êmen të gjindes së shpís*).

bekue (me) 3 “riti që kryhet nga prifti i famullisë kur bekon shtëpiat që përfshin juridiksioni i tij” (*me **bekue** shpíjat*).

¹⁶⁶ Si për greqishten e re (e arumanishten), edhe për shqipen të kjo fjalë vjen në vështrim ose ven. *bataria* “quantità di cannoni posti in luogo determinato per battere il nemico e una piazza”, ose turq. *batarya*, më pak drejtpërdrejt it. *batteria*” (E. Çabej SE II 183). Puna që kjo fjalë është përfshirë në sistemin e theksimit të huazimeve turke të shqipes, e afron atë me bashkësinë e këtyre huazimeve.

¹⁶⁷ Huazim prej serbokr. *bediti* “me shtërngue” (G. Meyer EW 30; E. Çabej SE II 188). Shiko edhe A. Omari *Marrëdhëniet* 99.

berr, -i 31 “bagëti të imta, kryesisht dele e desh” (*Me i tretë ndo’i kâmbë berri bariut*); 9 (*se çë farë berri a lope âsht per t’u hjekë*).

bërrëjsh/ëm, -mi 63 “(njeriu) që bën bé duke gënjyer” (*Mos të ndeshët Zoti në bërrëjshmin*¹⁶⁸).

bertitë (me) 109 “me lëshue zë të lartë; me folë me zë të lartë” (*Burrnimi nuk bertasin*).

bes/ë, -a 83 “*Besa* âsht një vade lirie e sigurimi, qi shpija e të vramit i jep dorërasit e shpijarëvet të tij, tuj mos i ndjekë per gjak perkohësisht e mje në vade të caktueme.”¹⁶⁹

besa (e gjâs e e çobanit) 84 “*Besa e gjâs* e e çobanit âsht ajo, qi dý a mâ flamure vëjn nder vedi me pelqim të njani tjetrit.”¹⁷⁰

besat 16 “përdorimi i forcës” (*Me qillue se shtýhen me besat /forcade/, ka ndollë*).

besimtar~e 60 “që beson” (*sjellje besimtare*).

bestár, -i 83 “Bestarë janë ata, qi hijnë te prindja a kushrinija e të vramit, për me xjerrë besë për dorërasin e per shpí të tij; janë mprojtaret e dorërasit e të shpísë së tij, qi të mos t’i gjêjë gjâ në vade të besës.”¹⁷¹ (*Bestarë*¹⁷² janë ata).

betar, -i 60 “Betarë a Poronikë njehen disá ‘dorë bejet’, qi do të perkasin Ungjillin, e disá tjerë lëhen per me ndigiuë bën në Kishë.”¹⁷³ (*Betarë*¹⁷⁴ a Poronikë njehen).

bijtë (me) 1 “me dalë bima prej toke”; këtu e përdorur me kuptim të figurshëm: “me dalë ndonjë kundërshtim” (*Me bijtë ndonji kundërshtim*).

¹⁶⁸ *Bërrëjsh/ëm, -mi* është emërzim i mbiemrit (njeri) *bërrëjshëm* (që bën bé në rrënë); kompozitë e formuar nga emri *bé* dhe mbiemri (*e*) *rrëjshme*.

¹⁶⁹ KLD 83.

¹⁷⁰ KLD 84.

¹⁷¹ Shpjeguar sipas KLD 83.

¹⁷² *bestar* formim nga emri *bes/ë* me prap. -tar.

¹⁷³ Shpjeguar sipas KLD 60.

¹⁷⁴ *betar* formim nga emri *bé* me prap. -tar.

- bind-i** 39 “diçka e madhe; përbindësh; një gjë që të çudit” (*nji rrasë a gur sa bindi*).
- biramel, -i** 78 “që do të dijë gjithçka; që fut hundët në punët e të tjerëve; që zhbiron gjithçka në punët e të tjerëve” (*brraca e biramela*).¹⁷⁵
- bish/ë, -a** 34 “kafshë e egër; zakonisht përdoret si eufemizëm për ‘ujkun’, për të mos ia përmendur emrin” (*Po e kaptoi kán bisha*).
- bjerrë (me)** 88 “humbet (fuqinë); nuk është më i aftë për të kryer një punë, të cilën më përpara e ka kryer lehtësisht” (*e bjerrë fuqin e vet*).
- blés, -i** 51 “ai që blen; blerësi” (*njiqind blesë*).
- bleta** (e gjetun) 34 “bleta e ikur që vjen e ngulet në pronat e një tjetrit” (*Bleta e gjetun ndër kopshtë*).
- bleta** (e hikun) 34 “tërësia e bletëve, që ka lëshuar, që ka roitur e gjitha prej banimit të parë për të kërkuar një vend tjetër” (*Bleta e hikun prej vathit të vet*).
- blim, -i** 45 “përfundimi i veprimt të foljes *bluaj*; të *bluarit*” (*blimi shkon si të vijn barrtorët*).
- brrac, i** 78 “njeri që vjedh gjëra të vogla; hajdut xhepush, hajdut pulash etj.” (*brraca e biramela*).
- bracnue (me)** 8 “me vjedhë kryesisht gjëra të vogla; vjedh xhepat e njerëzve; vjedh pula etj.” (*per n’u raftë per sÿsh se bracson*).
- bré (me u)** 90 “grimcoj dalëngadalë një objekt; e bëj grimca të vogla; e bëj pluhur” (*mos t’i lête t’u brejshin prej krÿjet*).
- brêz, -i** 26 “vëllezër të një gjaku; brezní” (*edhe me njiqind brêza në kjoshin*).
- brêz, -i (i gjakut)** 71 “njerëzit e një familjeje që mbajnë mbiemrin e babës; që kanë lindur në vijë mashkullore” (*Brêzat e gjakut rrjedhin prej ânet të babës*).

¹⁷⁵ *biramel* “që brimon për të marrë vesh çdo gjë”, fjalë e dialektit të Shkodrës, që shënohet së pari te Junku. Përmban fjalën *bir/ë* dhe një element *-mel*; *-a-* është zanore lidhëse (shiko te E. Çabej SE II 240).

brêz, -i (i gjinisë) 71 “njerëzit që kanë lindur në vijë femërore (nga ana e nënës)” (*Brëzat e gjinis rrjedhin prej ânet të nanës*).

brim/ë, -a 29 “të bërtiturit; të qortuarit më zë të lartë për një faj të bërë” (*Brimen e qortimin e zotnís do t’i kaperdijë rrogtari*).

brumbullaksue (me u) 104 “me u mbledhë me hov; me u lëshue më ta” (*i brumbullaksohen*¹⁷⁶ në derë).

brumbullakzue (me) 64 “shiko brumbullaksue” (*gjaksit i brumbullakzohen në derë pleqt*).

bûc/ë, -a 37 “copat e dheut që nxjerr umi (‘thika e parmendës’), *plis-i*” (*nji bûcë*¹⁷⁷ dheu).

bûjtë (me) 74 “me fjetë diku; kaloj natën a disa net diku” (*Kumbara bûn at natë në shpí të famullit*).

bujtme (e) 17 “e fjetmja” (*paret e së bujtmes*).

bukdhân/ës, -si 78 “(ai) që është mikpritës; që është bujar” (*Cubi e bukdhânsi*¹⁷⁸ janë nji).

bukë (e dhunueme) 29 “kur dikush vret a rreh dikë (këtu rrogtarin), që ha bukën e dikujt (këtu të zotnisë)” (*Me rrahë rrogtarn dora e huej, ky lypë gjygj e zotnija bukën e dhunueme*).

¹⁷⁶ *brumbullaksoj* është formuar nga *brumbullak* (kjo vetë nga kryqëzimi i *brumbull* me *rrumbullak*) me prap. -/ë/solj (shiko te E. Çabej SE II 333).

¹⁷⁷ E. Çabej (SE II 344) ka shprehur mendimin: “Si fjalë e geg. veriore, huazim krahinor prej skr. *bûs* “plis dheu me bar, një copë vend me bar”. Shiko edhe A. Omari *Marrëdhëniet* 112. Ne kemi shprehur mendimin: “*bûcë* gjithsesi mbetet fjalë me burim të diskutueshëm. Veçse mundësia që të jetë huazim krahinor prej serbokroatishtes në mos duhet përjashtuar fare, duhet vështruar si tepër e pasigurt” (SGJ I 208).

¹⁷⁸ *Bukdhân/ës, -si* kompozitë e formuar nga dy tema emërore: *buk/ël* dhe *dhânës* me kuptimin fillestar “ai që jep bukë”.

- bulg, -u** 43 “Bulg thirret njaj, i cilli hînë me punue token e njaj zotnije.”¹⁷⁹ (*Bulg*¹⁸⁰ *thirret njaj*).
- bulgë** 22 “shiko *bulg, -u*; këtu fjala është përdorur me kuptim të figurshëm ‘i nështruar’; khs. “Sá të jët i ati gjáll, i biri njehet si bulgë” (*i biri njehet si bulgë*).¹⁸¹
- bulkí, -ja** 45 “bujqësi, -ja” (*nuk hijnë në bulkí*).¹⁸²
- burg, -u** 75 “vendi ku mbahet bagëtia; hauri i bagëtime; stalla e bagëtime” (*edhe e ndrÿn në burg*).
- burrë** (per shpí) 9 “*term. kanuni*; në rast alarmi çdo shtëpi ishte e detyruar të jipte një burrë që mbante armë dhe që paraqitej i gatshëm për këtë punë” (*kur të thirren “Burrë per shpí”*).
- burní, -ja** 58 “të qenunit burrë zakoni, me cilësi morale në lartësinë e kohës” (*me mbajtë burnín tande*).
- burnim, -i** 78 “tërësia e burrave” (*Burnimi i shpís do t’a*).
- bylmet, -i** 24 “qumështi e gjithçka që bëhet me qumësht si djathi, gjiza, gjalpi e kosi; bulmet” (*Bylmeti e çdo melmesë do të ndahen*).
- bzâ (me)** 109 “me bâ zâ; bëj zë; flas më zë të ulët” (*nuk mund t’i bzâj*¹⁸³ *kush*).

¹⁷⁹ Shpjeguar sipas KLD 43.

¹⁸⁰ *bulg* paraqet trajtë e lashtë të fjalës, që ndeshet që te autorë e vjetër të shqipes. Te Buzuku *të afëronetë bulku me korësit* Meshari LXXXVIII/3, 299.

¹⁸¹ Ngjan që trajta *bulgë* (me -ë fundore) duhet të jetë gabim shtypi. Në vazhdim kemi të tjerat *bulg* e *bulkí*.

¹⁸² *Bulk* është trajta e lashtë e fjalës, që del si e tillë edhe te autorë e vjetër të shqipes; khs. Buzukun *të afëronetë bulku me korësit* Meshari LXXXVIII/3, 299 (shiko për këtë te E. Çabej SE II 356).

¹⁸³ *Bzâj* është kompozitë e ndërtuar nga folja *bâj* “bëj” dhe emri *zâ* “zë” me kuptimin “bëj zë”. Fillimisht ngjan të kemi pasur një juxtapozicion (pranëvënie), që me kalimin e kohës është kthyer në kompozitë.

C

calik, -u 19 “lëkurë bagëtie, e tharë dhe e regjur, që përdorej si thes për të mbajtur groshë, raki etj.” (*Grueja njëfjet si një calik për me bajtë*).

camerdhok, -u 37 “fëmijë i vogël dhe i shëndetshëm” (*kur isha camerdhok*).

carâ, -ni 17 “gurë që vihen në të dy anët e vatrës e që shërbejnë për të ndihmuar djegien e druve” (*carânin*¹⁸⁴ e votres).

cilltí, -ja 5 “cilësi, -ja” (*Cilltija*¹⁸⁵ e ndeshkimeve).

cofë (me) 32 “me ngordhë (bagëtia)” (*me cofë ndo'i kambë*).

cofët 34 “që është i ngordhur; që është i dobët tej mase; ngordhalaq” (*E gjet cofët*).

cub 73 “ndajf. tek (khs. tek a çift)” (*Ditët e ndëjes së ndrikulles të kumbara do të jenë gjithmonë cub e jo kurr parë*).

cub, -i 3 “ai që grabitë me armë e në mënyrë të organizuar; kusar” (*Kur cubi e njëf gabimin e vet*); 31 (*Po duel cub bariu*).

cubní, -ja 20 “zanati (profesioni) i cubit” (*Per bracní a cubní burri e lshon gruen*); 29 (*Po ndolli cubnija a vrasa në katund*); 77 (*per cubní e per çdo send*).

cuc/ë, -a 85 “vajzë e vogël; grua e pamartuar” (*djalë a cucë*).

cûgj 75 “shum. i fjalës cung ‘rrënjë hardhije’ (sa cûgj hardhije).

cup, -i 37 “sup-i (i krahit)” (*do të ngarkojë në cup të krahit një gur*).

¹⁸⁴ Huazim prej sllavishtes, sll. *čerěnb* “vatër” (Jokl). Për punë të vokalizmit të rrokjes së dytë (sll. *e* : shq. *a*), po sipas Joklit, prej bullgarishtes perëndimore (shiko te E. Çabej SE III 11). Shiko edhe A. Omari Marrëdhëniet 114.

¹⁸⁵ Kjo fjalë (*cilltija*) ngjan të jetë neologizëm e krijuar nga vetë Gjeçovi (përemri *cilli* me prap. -tí).

Ç

çak/ël, -la 28 “sende shtëpie, zakonisht të vogla e pa vlerë” (*rraqe, çakla*).

çartë (me) 2 “me prishë, me shkatërrue; me dërmue” (*e me pasë me e çartë kush ndoren*).

çashtj/e, -a 94 “çështje” (*Pleqt e çashtjeve*¹⁸⁶ të veçanta).

çerranik, -u 30 “një lloj rafti, në të tri anët me rrjetë teli, që vendoset në pjesën më të freskët të shtëpisë e që shërben për të mbajtur sendet e ushqimit; çarranik” (*çerraniku*¹⁸⁷ i tamblit).

çibuk, -u 68 “një lloj pipe me bisht të gjatë, që përdoret për të pirë duhan të grirë; llullë” (*me kallë çibukun*).¹⁸⁸

çiltas 99 “haptas” (*del edhe çiltas*).

çoban, -i 84 “bari” (*Besa e gjâs e e çobanit*).¹⁸⁹

çub/ë, -a 73 “tufë flokësh; balluke” (*nji çubë*¹⁹⁰ në báll).

¹⁸⁶ Fjalë e re e shqipes letrare, formuar aty nga fillimi i shek. XX. Të dy fjalët: geg. *çashtje* tosk. *çështje*, N. Jokli (*Studien* 90) i bie të formuara nga *ç’âsht*, *ç’është*, duke u bashkangjitur në një fjalë të vetme.

¹⁸⁷ Huazim nga sllav. (serb.) *čeren čerjen* (A. Omari *Marrëdhëniet* 118).

¹⁸⁸ Huazim nga turq. *çubuk* (E. Çabej SE III 114). Khs. edhe T. Dizdarin *Fjalor* 168.

¹⁸⁹ Fjala *çoban* “bari” është huazuar prej turq. *çoban* (e kjo vetë prej persishtes), e përhapur në shumë gjuhë të Evropës Juglindore e Lindore, deri në rusishte. Buzuku e Budi kanë vetëm *bari* e *bëruo*. Mungon kjo fjalë te arbëreshët e Italisë, por del te ata të Greqisë. Nga shkrimtarët e vjetër e jep i pari Fr. Bardhi, që përdor të dy fjalët *bari-u* e *çoban-i* (E. Çabej SE III 128). Khs. edhe T. Dizdarin *Fjalor* 177.

¹⁹⁰ E. Çabej (SE III 135) mendon: “Një krahasim i fjalës shqipe *çubë* me ato të gjuhëve sllave rus. *čub*, skr. *čub* ‘xhufkë e zogjve’, *čupa* ‘tufë flokësh, flokë, xhufkë’, paraqitet mjaft bindës, po më fort si një afri ‘elementare’ ose ‘etimologjike’ se gjenetike zhvilluar në rrugë paralele e të pavarur.”

D

- dah/e, -ja** 7 “ndarje; mjete që nuk përfshihen në ndarjen e pjesëtarëve të shtëpisë sipas Kanunit” (*Kanûja e dahes s’i pershîn*).
- dalt/ë, -a** 24 “vegël hekuri, me majë të mprehtë, që përdoret për të hapur vrima” (*thadra, dalta etj.*).
- dalun (i)** 94 “i çmendur; i luajtur mendsh” (*të dalunin mendsh*).
- dalun (i) fare** 28 “shtëpi a fis që nuk vazhdon më në vijë mashkullore; që shuhet, sepse nuk ka më trashëgimtarë” (*Kushrinija e të dalunit fare*).
- dâmç/uer, -ori** 3 “(ai) që bën dëm” (*do t’ a lajë dâmçori*); 39 (*po u shterngue ... dâmçori*).
- dark/ë, -a** 8 “buka që hahet në mbrëmje, kur zakonisht janë të pranishëm të gjithë njerëzit e shtëpisë, që gjatë ditës mund të kenë qenë në punë të ndryshme” (*Me bâ gati mjesditën a darken*).
- darsmorë-t** 18 “ata që marrin pjesë në dasëm” (*do të lshojn darsmorët dhantît*).
- das/ë, -a** 43 “përcaktimi i saktë i kufijve të pronave të njerëzve; ndarja e tyre; ndarjet përgjithësisht e të ndamet e ujit të vadës” (*me jau vû menden dasave*);¹⁹¹ 47 (*Vija e katundit ka dasat e veta*).
- dashamirsí, -ja** 44 “miqësi; të shkuarit mirë me njërin ose tjetrin” (*Farketari nuk do të shikojnë dashamirsín*).
- dashi** (i kumbonës) 31 “dashi që i prin tufës me kumbonë në qafë; oqiçi” (*skjapi a dashi i kumbonës*).
- dedej/e, -a** 63 “në mbarim e sipër; duke menduar fundin (e asaj pune); duke bëlbëzitur; duke iu marrë goja; me folë me dyshime, pa i saktësuar e provuar fjalë e veta” (*dedejen me bé s’e bân kanûja*).
- dell, -i** 41 “drejtim-i” (*Udha ndjek dellin, e s’ndalet as mund pritët*).
- derdhë (me u)** 98 “përdorim i figurshëm i fjalës: shpërndahen njerëzit e mbledhur në një vend në drejtime të ndryshme,

¹⁹¹ *das/ë, -a* prejfoljor i formuar nga (*me*) /n/dá me prap. -s/ë.

- ashtu siç derdhet uji nga një enë” (e *derdhet* në punë të vet seicilli).
- derdhë (me)** 102 “me caktue lajmëtarë, të cilët do të shpërndahen në të gjitha anët për të kryer detyrat e ngarkuara” (*me derdhë kasneca*).
- derhëm, -i** 65 “njësi peshe sa 1/400 e okës, baras me 21/2 gram” (Në kandár të vet se i cilli peshon katerqind *derhëm*).¹⁹²
- derk, -u** 33 “zog thiue; derr i vogël; derrkuc; dirk” (Po u muer *derku* fëmen).
- desharë-t** 15 “ai që shkon në dasëm me dash.”
- deshtas** 47 “me dëshirë të vet; pa kundërshtuar; me dashje” (Po e prishi kush vîn e kuej *deshtas*).
- detyr/ë, -a** 62 “veprim për t’u kryer; shërbim për t’u kryer” (*uhân a detyren*).
- detyrs, -i** 50 “njeriu që është ngarkuar për bërjen e një pune e që duhet ta kryejë atë me përgjegjësi” (*detyrsi* do t’i a çojë të zot’t); 70 (me i shkue në derë *detyrsit*).
- diftes/ë, -a** 100 “dëshmi; kallëzim” (Si të tumiren *diftesat* e kapucarit).
- dirq-t** 33 “shum. i derk” (e *dirqt* dahren).
- dishmitar, -i** 15 “ai që dëshmon në gjyq; ai që është ndodhur në ndonjë punë a në një ngjarje dhe prandaj mund të thotë diçka për të; dëshmues.”
- dishmitarë-t** 37 “gurë të vegjël, të ngulur në tokë, që shërbejnë për të përcaktuar kufirin e një are” (Guri i kufinit ká per rreth *dishmitarë*).
- Djelmni, -ja** 100 “institucion që përfaqësonte të rinjtë (*djelmninë*) në kuvend të burrave” (Vogjlí a *Djelmni*).
- djelmt (e bajrakut)** 2 “forca e armatosur brenda bajrakut” (*djelmve* të Bajrakut).
- djerrun (i)** 60 “(i) humbur; që nuk gjendet” (Gjân e *djerrun*).
- dlirë (me)** 4 “me pastrue”; këtu e përdorur në mënyrë figurative “spastroj veten nga gabimet e mundshme të

¹⁹² Huazim prej turq. *dirhem* (kjo vetë prej arabishtes), E. Çabej SE III 226.

- bëra gjatë jetës, punës etj.” (per me **dlirë** vedin); 60 (si per të **dlirun** prej zhgarkimesh).
- dnue (me)** 32 “me pakësue; me dënue; me dinue” (as nuk shtohet, as nuk **dnohet** kurr).
- doke, -ja** 7 “zakone-t; ligje të pashkruara që janë transmetuar brez pas brezi e që janë ligjëruar në kanû” (nji **gjûhë**, e **doke**).
- dokshme (e)** 70 “sipas dokeve; ashtu siç i përcakton Kanuni e rregullat e shoqërisë” (Fjalët e **dokshme** të ndermjetsit janë).
- dor/ë, -a** 95 “këtu fjala është përdorur me kuptim të figurshëm: ‘që nuk mund të kontrollohet më; që nuk u nënshtrohet rregullave të Kanunit’ (katundi i dalun **dore**).
- dordhân/ës, -si** 70 “ai që ka hyrë dorëzanë për një punë a një veprim e që detyrohet të përgjigjet për detyrimet e pakryera të personit për të cilin ka hyrë dorëzanë” (ky bahet **dordhânës**).¹⁹³
- dorë (me vû)** 29 “me rrahë dikë” (e me vû **dorë** nuk mundet).
- dorëras, -i** 4 “ai që vret dikë me dorë të vet; personi që kryen vrasjen” (Me u vrá **dorëras**¹⁹⁴ prej Famullije).
- dorëzan/ë, -i** 70 “**Dorzânë** thirret aj, i cilli i lidhet kuej per të pergjegjun të një detyre, të cillen, po s’e lau në vade të caktueme detyrsi, ky bâhet dordhânës.”¹⁹⁵
- dorëzanët (e gjakut)** 91 “**Dorzânët e gjakut** janë ata, qi hijjnë per me mbajtë larg çdo të persritun mnijet e zjarmit, qi kishte me mujtë me u ndezë ndermjjet shpís së të vramit e dorërasit.”¹⁹⁶
- dorëzanët (e të hollave të gjakut)** 92 “ata që hyjnë dorëzanë për të dërguar në vendin e duhur të hollat që do t’i paguhen per gjakun e marrun shtëpisë së të vramit” (**Dorëzanët e të hollave të gjakut** i zgjedhë shpija e të vramit).

¹⁹³ *dorëdhânës* kompozitë e formuar nga dy tema emërore *dorë* + *dhânës* me kuptimin e parë “ai që jep me dorë”.

¹⁹⁴ “Dorëras thirret aj, i cilli vret kend me dorë të vet” KLD 82.

¹⁹⁵ KLD 70.

¹⁹⁶ KLD 91.

- dorëzani, -ja** 8 “detyrimi që merr përsipër dorëzani” (*e as dorëzanin këso dore*).
- dorzanitë (me u)** 20 “me u marrë vesh njëri me tjetrin; kryesisht ata që kanë hyrë dorëzanë” (*do të dorzanitet me dy lagje dorzânë*); 65 (*të keqsuemt dorzaniten*).
- dos/ë, -a** 33 “femra e derrit” (*porsa ta dajë dosa*).
- dredhi, -ja** 96 “sendërgjim fjalësh e veprash për të shtënë në grackë një njeri për dobi vetjake, dinakëri; djallëzi” (*gjygin nuk do t’a bâj me dredhi*).
- dredhim, -i** 47 “përfundim i veprimit të foljes *me dredhue*, të dredhurit; degëzim” (*a mos të shkojë vonë e ardhmja e ujit prej dredhimesh*).
- dredhue (me)** 84 “kjo folje merr kuptime të ndryshme, por gjithsesi në bazën e saj mbetet “lëvizje e shpejtë e me rrotullim a kthim prapa” (*si tuj dredhue udhtari*).
- drekë-t** 27 “sofra që shtrohet me rastin e një vdekjeje; vercall” (*Me u bâ drekët bijave po diqne në shpi të vet*).
- droj/e, -a** 66 “frikë-a; formim nga folja *me drashtë*” (*ai do të rrîjë pa droje*).
- drom, -i** 6 “rrugë kalimi; rrugë këmbësore” (*pronet e dromet*).
- dugâj/ë, -a** 46 “dyqan” (*Per dugâjë*¹⁹⁷ *e per mullî nuk gjobiten shokët*).
- duhshem (e)** 91 “të duhur; ata që duhet të jenë aty” (*dorzânë e duhshem*).
- duk/ë, -a** 16 “pamja e jashtme e një njeriu; portreti” (*s’e shikjon per dukë*); 31 (*pa shej e pa dukë*).
- dyndë (me u)** 35 “me u shpërngulë; me lëvizë prej një vendi në një tjetër” (*Me u dyndë një shpi*).
- dypernjâh/e, ja** 64 “gjoba që i vihet vjedhësit kur zihet me dorë në të ose kur i provohet vjedhja” (*Per gjak s’ka dypernjâhe*);¹⁹⁸ 79 (*nuk ka dy-per-njahren*).

¹⁹⁷ Huazim nga turq. *dükkan* (T. Dizdari *Fjalor* 239).

¹⁹⁸ Fjala *dypernjaje* paraqet një pranëvënie (juxtapozicion) (*dy per një*) të emëruar, të kthyer tani në kompozitë me kuptimin “gjobë” që i vihej dikujt që kryente një vjedhje.

dyshueshem (i) 100 “me dyshim; që nuk i zihet më besë; i dyshuar” (*Po duel kapucari i dyshueshëm*).

dyzash 18 “me dyshim; që është i pavendosur për të kryer një punë” (*me i da dyzash*).

DH

dhân/ës, -si 52 “ai që jep; ai që shet diçka” (e *dhânsi nuk ka dishmitár*).

dhantí, -ja 24 “dhuratat që i dërgohen nuses për martesë” (*Dhantít, qi i mbliidhen nuses*).

dhetat (të) 3 “taksë në natyrë, që i dërgohen kishës si detyrim i përvitshëm” (*të dhetat e kishës*); 103 (*të dheta e telozen*).

dhetim, -i 108 “taksa që u vihej tokave si edhe gjësë së gjallë” (*prej dhetimit të tokave*).

dhiz/ë, -a 37 “i vogli i dhisë; edh; kec” (*barí dhizësh*).¹⁹⁹

dhûn/ë, -a 88 “përdorimi i forcës ndaj një tjetri” (*Ata qi kan shtat e dhûnë bashkë*).

dhunshem (i) 60 “që përdor dhunën; cilësi e atij që përdor dhunën” (*prej një zhgarkimi të dhunshem*).

dhunshme (e) 105 “veprim që shoqërohet me dhunë” (*Po kje mbrapshtí teper e dhunshme e e shemtueshme*).

dhunueme (e) 88 “(grua) mbi të cilën është ushtruar a përdorur dhuna” (*gruen e dhunueme*).

¹⁹⁹ *dhizë* formim nga *dhí* me prap. zvogëluese -z/ë.

E

edh, -i 54 “kec-i” (*kingji e edhi*).

eltër, -i 64 “altar” (*do t’i lajë mbi eltër per kishë*).

epër (të) 92 “të sipërm” (*të praktikut t’eper të derës së shpís*).

eshk/ë, -a 44 “një lëndë në formë sfungjeri, që përftohet zakonisht në lëkurën e disa bimëve dhe që ndizet shumë ngadalë. Është përdorur dikur në vend të shkrepeve. Eshka (*kaf-i*) merr zjarr prej shkëndijave që dalin nga goditjet e urorit mbi strall” (*Eshkën do t’i a bijnë të zotët e hekurave*).

F

fajd/e, -ja 56 “kamatë; interes” (*Kanûja e maleve nuk njef uhá me shtojca fitimesh /Fajde/*).²⁰⁰

faji (i kobshëm) 80 “vjedhja e shtëpisë etj. së mikut” (*Kush vjedhë shpín e strajcën e mikut, kanûja i ka caktue per gjobë “faqen e zezë” e âsht i hjedhun prej kuvendit e gjygjit*).

falë (me u) 66 “me u përshëndetë (në mënyrën e vjetër tradicionale)” (*Falet me mik*).

falmet (të) 27 “të holla a dhurata të ndryshme që i falen dikujt; me lânë gjâsend për shpirt; me lânë gjâ për kishë etj.” (*Per të lânunat a të falmet*); 94 (*të falmet e të premet e kanûs*).

faltor/e, -ja 101 “vendi ku falen njerëzit; tempull; kishë” (*nder rrenime të vjetra faltroresh*).

falunat (të) 1 “shiko (të) falmet” (*e me mbajtë të falunat*).

familj/e, -a 7 “grup njerëzish: prindër, fëmijë, nipër dhe të afërm, që rrojnë bashkë; fis” (*në një Familje*²⁰¹ *mâ të hapët*).

famull, -i 73 “quhet kështu fëmija që mbahet në pagëzim nga nuni ose nuna; kur i kanë prerë flokët a edhe kur e kanë mbajtur në ritin e krezmimit” (*Famull ... thirret djali*).

famullesh/ë, -a 73 “femërorja e famull-i” (*Famulleshë ... thirret vajza*).

famullí, -ja 1 “krahina, vendi a treva, banorët e të cilëve janë nën kujdesin shpirtëror të një meshtari, që quhet famullitar” (*mbrendë e jashta famullijet*).

famullitar, -i 1 “prifti i një famullie” (*bâna /qela/ e famullitarit*).

fagezí, -u 105 “që nuk ka turp; që nuk ka nderë; i pacipë” (*të fageziut*).

²⁰⁰ Në Kanun fjala *fajde* nuk njihet as nuk përdoret gjëkund. Është vënë aty prej Gjeçovit si dubletë për të sqaruar termin vendës “shtojca fitimesh”. *Fajde* është huazim prej turq. (Dizdari *Fjalor* 263).

²⁰¹ “Familje âsht një të mbledhun gjymtyrësh, të cillët gjallisnin nen një kulm, qellimi i të cillve âsht të shtuemit e gjindes nper mjet të martesës, të mkambunt e tyne kah zhdrivillimi i shtatit e kah zhvillimi i mendes e i shises” KLD 7.

farkim, -i 44 “përfundimi i veprimit të foljes *me farkue*” (e në *ket rend të farkimit*).

farkue (me) 44 “me punue në farkë; ushtrimi i profesionit të farkëtarit” (*Farketari do të farkojë*).

fat, -i 11 “këtu e përdorur në mënyrë të figurshme per burrin e ardhshëm” (*Vajza s’ka tager me zgjedhë fatin e vet*).

fë-ja (e preme) 14 “fejesa”; “Me prë *fën*²⁰² don me thanë me da ditën e vaden e kputme se kur me nisë krushqt me marrë nusen.”²⁰³

fej/e, -a 11 “fejesë-a” (e as në të *prém fejet*).

²⁰² E. Çabej (SE IV 154) mendon se *fë* ka edhe kuptimin “fejesë; gostë e fejesës; nishan i fejesës”; duke përmendur këtu edhe shembujt e shumtë që dalin te Kanuni i Lekës, por pa dhënë shpjegime të mëtejme për lidhjen etimologjike të këtyre dy fjalëve. Një shkrim të tërë do t’i kushtojë kësaj fjale B. Demiraj, botuar në rev. “Hylli i dritës” (nr. 1, 2016). Pas një analize gjuhësore historike të imtësuar deri në shterim, Demiraj do të shkruajë në fundin e këtij shkrimi **Dy fjalë përmbyllëse**: “Do të ishim sigurisht të paplotë, nëse do t’u anashkalonim në interpretimin tonë gjuhësor diakronik realies kulturore-historike në motin e huazimit, përkatësisht shndërrimeve që përjetoi në gjuhën shqipe edhe paleta kuptimore e fjalës për gjatë mesjetës, kur lat. mesj. *fides* (= lat. vulg./rom. */fē.de-/), përpos konsolidimit në përdorimin e saj të specializuar në terminologjinë kishtare si “besimi i krishterë, besimi i fjalës së Zotit”, vazhdon të gjëllijë edhe me kuptime (më) të përgjithshme në diskursin (juridik-) zakonor, si p. sh. “(mirë)besim” e sidomos “dorëzani me fjalëdhënie, premtim i mirëqenë”, që vjen me thashun shqip: *fjalë e ndarë/prerë/këputur* ~ geg. *fjalë e dame/preme/kputme* (me dikë për diçka). Është pikërisht ky kuptim leksikor që e ndeshim qysh në gurrën latine mesjetare të vetë fjalës, i cili mundi të përballojë motet në Kanunin e Lekës e që i dha formë e kuptim edhe këtij studimi modest, një studim ky që rreket të dëshmojë vetiu e natyrshëm atë vlerë të pallogaritshme që bartin fshehur në vetvete shumë e shumë njësi të atij fondi leksikor që sendërton në gjuhë matriksin e kulturës etnike të popullit shqiptar. Parë nga kjo perspektivë, vepra fammirë e Át Shtjefën Gjeçovit ruan dhe fiton në kohën tonë gjithnjë e më shumë kuptim.”

²⁰³ KLD 14.

ferflue (me) 39 “me përplasë krahët një shpend që sapo ka nisë fluturimin; me flakrue; *vërtis; përplas*” (po e *ferllova* *gurin*).

ferisht/e, -ja 26 “foshnje; kërthi; çilimi” (*Ferishte*²⁰⁴ *djepi*).

ferkem, -i 78 “gjurmë; fërkim”; “Gjurma është ferkemi, qi bân gjâja, permbas së cillës udhton i zoti i gjâs së vjedhun, tuj e çue gjurmën: a mbrenda kufinit të një katundi a të një lagje, a mbrenda rrethit të një shpije, t’njij oborri a të një vathi”²⁰⁵ (*Gjurma është ferkem*²⁰⁶).

fik/ë, -a 8 “shkaku që çoi në prishjen a rrenimin e shtëpisë” (*mos ta çojë kah ... fika shpín*).

fikë (me u) 68 “këtu është përdorur me tejbajtje kuptimi: “me qitë fare; me shkatërrue e zhdukë” (a të *fiket*, a të *koritet*).

fir, -i 66 “një lloj bime me fletë me dhëmbëza (*Filices*); *fier-i*; përdorej si shtroje për të fjetur” (*zjarmi e trangu e do firi*).

firuk, -u 85 “lapanjor; halabak; njeri i papunë, që sillet gjithë ditën rrugash e veç i shihet sherri; sallahan” (*firukun kishin me e vrá*).

fis, -i 2 “organizimi kryesor i shoqërisë primitive, lidhje familjesh të mëdha nga numri që janë të një gjaku dhe kanë pjesërisht ekonomi të përbashkët (kullota, burime për ujitje etj.); një radhë breznish që rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët; tërësia e familjeve që janë të një barku; gjak e gjëri” (*Në vorre të njëj vllaznije a të njëj fisi*); 7 (*gjinija në fise*).

fisnikí, -ja 85 “fisnikëri; cilësia e atij që është i pajisur me veti morale të larta; sjellje fisnike” (*per dukë e per fisniki*).

fisnikisht 65 “në mënyrë fisnike; fisnikërisht” (*me të falun fisnikisht*).

²⁰⁴ *ferishte* huazim nga turq. *feriştah* “i dërguar; ëngjëll” (E. Çabej SE IV 161), fjalë e gurrës perse. Shiko edhe T. Dizdari *Fjalor* 269.

²⁰⁵ KLD 78.

²⁰⁶ KLD 78. Ka të ngjarë që *ferkem-i* është shqiptimi vendës i fjalës *fërkim-i*, me ndërrimin e njohur *i : e*, tipar karakteristik i të folmes së Mirditës.

fishëk (më sh/p/inë²⁰⁷) 14 “fishëku që prindja e nuses i japin anës së dhëndrit, për ta përdorur në qoftë se ajo zihet duke ikur për t’i shpëtuar martesës me përdhunin, pra jashtë dëshirës së saj” (*qi e ká xânë me fishëk²⁰⁸ më sh/p/inë*).

fjala (peng) 96 “fjala, që jepet si peng në vend të objektit” (*“Fjala peng” jet vetëm atbotë kur t’i flasë kush kuej kaq e kaq per n’ i a ndreqët një punë*).

fjalëmirë 12 “që flet fjalë të mira” (*rreket m’u bâ fjalë-mirë*).

fjalisë (me u) 2 “me folë pa baza duke marrë nëpër gojë dikë; me u marrë me fjalë e me thashetheme” (*Dhunon kishen njaj qi fjaliset*); 86 (*që u fjalisen*).

fjalisun (i) 96 “i marrë nëpër gojë pa ndonjë fakt a vërtetim fakti” (*nuk mund t’u randohen të fjalisunvet*).

flamur, -i 7 “bajrak; këtu i përdorur në vend të fjalës *bajrak* si term kanuni” (*fiset në flamur*); 23 (*vllaut të parë i perket Flamuri*).

Flamurtar, -i 23 “bajraktar; këtu i përdorur në vend të fjalës *bajraktar* si term kanuni” (*Me kenë derë Flamurtari*); 95 (*ndonji prej Flamurtarësh*).

folm/e, -ja (e) 57 “*E folmja* është prëmtimi i njëj sendi, qi i bân kush kuej per një mûnd qi do të hjekë.”²⁰⁹

forcad/e, -ja 16 “forcë; përdorim i forcës” (*Me qillue se shtyhen me besat /forcade/, ka ndollë*).

frÿs, -i 44 “rëshiqi që përdor farkëtari për t’i fryrë eshkës, në vatrën ku do të skuqë hekurin” (*Rrshiqi, frÿsi, kullma e të tjera vegla janë të farkëtarit*).

fut/ë, -a 16 “shami e zezë që vënë gratë me raste vdekjeje ase për të mbajtur zi” (*e nuses i a vu futa²¹⁰ më krye*).

²⁰⁷ Ngjan të jetë gabim shtypi për “fishëk më shpinë”.

²⁰⁸ Huazim nga turq. *fisenk* (T. Dizdari *Fjalor* 278).

²⁰⁹ KLD 57.

²¹⁰ *futë* huazim nga turq. *futa* (kjo vetë prej arabishtes), që ka hyrë edhe ndër të tjera gjuhë ballkanike (shiko E. Çabej SE IV 230). Shiko edhe T. Dizdarin *Fjalor* 285.

G

gac/ë, -a 68 “qymyr i ndezur tërësisht e që shndrit; copë druri e ndezur tërësisht” (*Veç një gacë me ta lypë kush*).

gajret, -i 109 “qëndresë ndaj një fatkeqësie; forcë për të kaluar një të keqe a një punë të vështirë; të dhanunit zemër për qëndresë, për të mos u mërzitë etj.” (*Zoti i u dhashtë gajret*).²¹¹

gand, -i 53 “gandim që shkaktohet nga një sëmundje a nga një plagë e rëndë, e cila lë shenjat e veta të dallueshme për tërë jetën” (*n’ia gjetsh ndo’i gand mbrapa*).

gatojc/ë, -a 15 “gruaja e caktuar me detyrën e të gatuarit (në familje).”

gergas, -i 5 “ai që shtie ngatërresa; ngacmues (me qëllim të caktuar); ai që nis sherrin i pari” (*gergasi*²¹² *lân vetem një gjobë*).

²¹¹ Huazim nga turq. *gayrét* (T. Dizdari *Fjalor* 288).

²¹² **gërgas** “1. Trazoj, prek dikë a diçka me dorë ...” (*Fjalor* 1980, f. 546). Fjalë e gegërishtes veriore. Te *Lahuta* e Fishtës *Me pak pare e tuj gergá* (IV/39). E përdor kryesisht Gropa e Shkodrës, por e ndeshim edhe ndër rrethe të saj, *gërgas* “nxit, ngacmoj” (Rranxat e Mbishkodrës, Shkurtaj DSH IV 240). Shkojnë me *gërgas* edhe *gërgamë-a* “grindje midis dy a më shumë vetave, që shkaktohet e nxitet nga një i tretë”; *gërgasë-a* “gërgamë”; *gërgasës* “ai që shqetëson e mërzit dikë me dorë a me fjalë” (*Fjalor* 1980, f. 546). Te *Fjalori* i Da Lecces 680 folja *me u gërgām* “stizzare”.

K. Kristoforidhi 114 jep krahas *gërgas* (Shkodra) edhe *gërgitem* (Shkodra) pësore e *gërgas*. Edhe te *Bashkimi* 124 krahas *gërgas* dalin edhe (i) *gërgām*, *gërgame-ja*, *gërgās-a* dhe *gërgim* “gërgame”.

Për *gërgas* është dhënë mendimi se është formim përbrenda shqipes nga parashtesa *gër-* (variacion i parasht. *g/ë/-* me epentezë të një *r-je*) dhe foljes *ngas* (Xhuvani-Çabej *Parashtesat* 371; për formimin e kësaj fjale me parashtesë, shiko edhe E. Çabejn SE I 92 e SE IV 256). Ky shpjegim, i drejtë në formë e për kuptim (këtu me gjasë parashtesa ka karakter intensiv), do shpjegim për punë të asimilimit *ng > g*, që nuk është tipar i të folmes së Shkodrës, ku kjo fjalë përdoret rëndom. Ndërkaq, vetë folja *ngas* paravendon një formim *n + kas* me sonorizimin e *k-së* pas *n-së*, dukuri e njohur në gjuhën shqipe. Këndeje shtrohet

gergás~e 22 “mbiem. që gërget; që ngacmon; që fut sherrin ndërmjet njerëzve” (*Me kenë nâna gergáse*).

germushë (me u) 3 “me kërcnue dikë; me iu kanosë dikujt” (*e shân e i germushet*).

germushunat (të) 59 “kanosjet” (*Te germushunat e kercnimet*).

goditë (me u) 73 “me u rregullue vendi ku do të priten të ftuarit” (*goditet²¹³ vendi*).

gojë (me vû) 29 “me lëshue akuza kundër një njeriu; me folë pa doganë kundër njërit apo tjetrit; me marrë kënd nëpër gojë” (*me vû gojë keqas mbë të*).

govixh, -i 24 “enë e madhe prej druri, ku shtypim rrush; gaviç” (*vozga, govixha, fuçija, sheka*).

grabí, -ja 78 “grabitje; të grabiturit; të rrëmbyerit.”

grabitë (me) 78 “i marr një tjetri një gjë me pahir; rrëmbej; plaçkit” (*edhe i grabiti²¹⁴ kuej a kál, a mushkë*).

pyetja: mos kemi një formim fillestar *gër + kas*, që në vazhden e kohëve dha *gërgas*? Për të folmen e Shkodrës, pra, një *gër + ngas > gërgas* është pak i mundshëm. Por edhe një *gër + kas > gërgas* do të kërkonte shpjegim për prejardhjen e *gas*, e cila paravendon këtu një *ngas* me asimilimin *ng > g*. Mirëpo, edhe ky asimilim nuk është tipar i të folmes së Shkodrës, por i Malësisë së Mbishkodrës. (Një *gas* “ngacmoj, shqetësoj: *mos e ga djalin*” p.sh. e ndeshim në të folmen e fshatit Postrripë, Luli SF 1, 1975, f. 86).

G. Meyer (EW 123) e bie *gërgas* nga sllav. *glagoliti* (**golgoliti*), khs. aty edhe greq. *γεργίνος* e te Heziku *γαργαρής*. Ne mendojmë se *gërgas* është fjalë vendi, relativisht e vjetër, e formuar përbrenda shqipes nga parashtesa *gër-* (variant i *gë-* me një shtesë *r* epentike homorganike) me funksion intensiv dhe foljes *gas* (përkat. **kas*), që paraqet primitivin e *ngas* (*n + gas* përkat. *n + kas*) kur ajo nuk e kish marrë ende parashtesën *n-*.

²¹³ Huazim prej sllav. *goditi* (E. Çabej SE IV 270). Khs. edhe A. Omari *Marrëdhënie* 142 *godis godit* “1. qëlluj, i bie, ndodh, rastis; 2. ndërtoj, ndreq, rregulloj”. Fjalë e mbarë gjuhës, por me kuptime të ndryshme në të dy kryedialektet. Huazim nga sllav. Khs. serb. *goditi* “pëlqej, përshtatem, merrem vesh, qëlluj në shenj; ndodh” etj.

²¹⁴ Huazim nga serb. *grabiti*, bullg. (maq.) *grabi* (shiko hollësitë te A. Omari *Marrëdhëniet* 146). Duke gjykuar nga rrjedhojat e shumta, të

grabitçarë 17 “që grabisin; që plaçkisnin ditën për diell”
(*Krushqit vijn si grabitçarë*).

grabitç/uer, -ori 78 “Grabitçori është ai, i cilli ballas e me
perdhûni i a merr kuej një gjâ per ndo’i detyrë.”²¹⁵
(*Grabitçori është ai*).

grabituni (i) 79 “i grabituri; ai që është grabitur” (*del i padetyrë
i grabituni*).

graní, -ja 9 “të gjitha gratë së bashku; tërësia e grave të
familjes” (*Granija janë në detyrë me punue per shpi*).

grazhd, -i 25 “vend i ndarë në stallën e bagëtive ku u shtien
kashtën bagëtive të trasha; *përgjith. stallë*” (*Grazhdi*²¹⁶ -
sâna e kashta).

grazhdue (me) 34 “i vë në grazhd bar a kashtë kalit, gomarit,
lopës a kaut” (*aj pasët e grazhdofët*).

grî (me) 23 “e bëj copa-copa; e thërmoj”; këtu e përdorur me
specializim kuptimi: “me ekzekutue dikë me pushkatim”
(*fisi e grîn dorasin*).

grishë (me) 60 “me ftue dikë në një gëzim, në një dasëm a në
një punë tjetër çfarëdo” (*tuj e grishë*).

grosh, -i 5 “monedhë e vjetër, e përdorur në atë kohë” (*e kân
e hullís 400 grosh*),²¹⁷ 51 (*Kapari është njaj grosh qi epet para*).

krijuara brenda shqipes (*grabitje, grabitqar, grabitës, i grabitur, grabí* etj.),
mund të mendohet se fjala duhet të ketë hyrë herët në gjuhën shqipe;
pra të jetë një ndër huazimet e para nga sllavishtja. E. Çabej (SE IV 279)
miraton mundësinë e një huazimi nga sllav. *grabiti*, por duke shprehur
mendimin se “Këtu duhet të jetë përzier fjala sllave me një analoge të
vendit, “krijim elementar” në kuptimin e W. Oehlitz. Aty gjan të hyjë
graps “vjedharak”, *grapcoj* “kafshoj pak nga pak”, fjalë që kanë dalë nga
(e hangri) *grap* e *grap*.

²¹⁵ KLD 78.

²¹⁶ Huazim nga sllavishtja e vj. kishtare *grazdъ*, bullg. *grazd* “stallë”
(shiko hollësitë te A. Omari *Marrëdhëniet* 148).

²¹⁷ Huazim nga turq. *grosh* (T. Dizdari *Fjalor* 297). E. Çabej (SE IV
293), duke shkruar pas hullisë së Meyerit, e bie me burim prej bullg.
groš, skr. *grōš* për burimin e të cilave në analizë të fundit nga lat.
denarius grosus. Selišcevi nuk e numëron *grosh*-in ndër huazimet sllave
të shqipes.

grue (e grabitme) 10 “grua që e kanë grabitur; që e kanë marrë kundër vullnetit të saj; grua e martuar pa shkues” (*Grueja e vajza e grabitme, e jashtë-zakonshme kah feja e kanuja*).

grue (e lshueme) 12 “grua që është ndarë nga burri; grua e divorcuar” (*Të mos të jetë grueja e lshueme*).

grue (e mbajtme mbi kunorë) 10 “Grua që nuk është kurorëzuar në kishë; gruaja e dytë” (*Grue e mbajtne mbi kunorë, kundra fejet e kanuje të Lekës*).

grue (e pakunorë) 21 “grua e marrë pa vënë kurorë në kishë; pa u martuar sipas zakonit e Kanunit” (*Ai, qi të mârre gruen pa kunorë, jet i lidhun kah Feja e kah kanûja*).

grykëholl/ë, -a 85 “pushka”; këtu e përdorur si eufemizëm për të mos ia përmendur emrin e vërtetë” (*me vjellë flakë grykëholla*).

grremç, -i 63 “copë e vogël druri a hekuri me majë të kthyer si të kërrabës, që shërben për të varur plaçka; çengel”; këtu e përdorur në mënyrë të figurshme për “të kapur pisk” (*s’ka si me i a njitë grremçin*).

grrishtë (me u) 109 “me gërrisë fytyrën me thonj kur burrat vajtojnë një njeri të vdekur” (*grrishten edhe tundin krahnorin*).

gurapesh, -i 39 “guri me të cilin bëhet beja” (*me gurapesh*).²¹⁸

guri (i kufinit) 38 “guri që merr në krah ai që do të bëjë bé për vendosjen a caktimin e kufijve” (*si t’a mârresh gurin e kufinit në krah*).

²¹⁸ *gurapesh* kompozitë e formuar nga emri *gur* dhe ndajfolja *pesh/ë* “lart; hava”, me kuptimin “gur që çohet peshë”.

GJ

gjâja (per gymës) 32 “të caktuarit me saktësi i detyrimeve të gjësë së dhënë pëgjysmë me një tjetër” (*Po u dhanë përgjymës dhí a dele, pjella, këmenda e leshti dahan per gjymës ndermjet zotnís e bariut*).

gjâja (me përgjegje) 32 “të përgjegjës për çdo dëmtim që mund t’i ndodhë gjësë (së gjallë) të marrë në dorëzim” (*Gjâja me përgjegje nuk mirret*).

gjak, -u (I) 12 “fis-i” (të mos të jetë **gjak** e gjini); 71 (*Gjaku e gjinia, vllaznimi e kumbaria në Kanû të Malevet*).

gjak, -u (II) 22 “term kanuni, armiqësi që rrjedh nga një vrasje dhe që duhet paguar po me një vrasje në fisin e atij që ka kryer vrasjen e parë” (nderen i a kerkon burri, varren e **gjakun** prindja).

gjak/ës, -i 4 “*gjakësuer*; ai që vret dikë për gjak” (*prej shpís së gjaksit*).

gjakhupës, -i 5 “njeri i nxjerrun jashtë Kanuni²¹⁹ e që vritet katundisht” (*shkon gjakhupës*);²²⁰ 22 (“Kush vret vedin shkon **gjak-hupës**”).

gjaks/uer, -ori 81 “gjakës-i; ai që vret dikë për gjak” (*u vëjn pusí gjaksorvet*).

gjallitë (me) 7 “me gjallue; me kenë gjallë; me jetue nën një kulm” (*gjallisín nën një kulm*).

gjallnim, -i 22 “jet/ë, -a; të gjallnuarit” (*e mbi gjallnim të të bijve*).

gjâm/ë, -a 83 “vaji që bëhet në malësitë tona të Veriut kur vdes një njeri” (*do të shkojë në mort e në gjâmë*).

gjâmatar, -i 109 “persona të caktuar që bëjnë gjâmën e një të vdekurit” (*Gjâmatarët rreshtohen*).

gjedh, -i 15 “bagëti e trashë” (*gjedhi i darsmes*).

²¹⁹ Në kanun përcaktohen rastet kur një njeri nxirret jashtë tij, si edhe kur grihet “pushkatohet katundisht e, si i tillë, shkon *gjakhupës*”.

²²⁰ *gjakhupës* kompozitë e formuar nga dy tema emërore: *gjak* dhe *hupës*.

gjegjë (me) 17 “me i kthye përgjigje; me iu përgjegjë dikush thirrme s të lëshuar nga një njeri” (*se kanuja s’jau gjegjë vajin*); 57 (*kanûja s’i a gjegjë vajin per pûnë të pakryeme*).

gjel, -i 80 “shpend shtëpiak; mashkulli i pulës” (*Gjeli /knduesi-kadoci/*).

gjind/e, -ja 7 “njerëzit e fisit; njerëzit e shtëpisë” (*të shtuemt e gjindes*); 8 (*gjinden e shpís*).

gjini, -ja 7 “njerëz të afërt nga gjaku; gjiri-a” (*vllaznija në gjini*); 12 (*të mos të jetë gjak e gjini*); 71 (*Gjaku e gjinia, vllaznimi e kumbaria në Kanû të Malevet*).

gjithnduer 48 “gjithfarë; cilido” (*msÿn gjithnduer njeri*).

gjob/ë, -a 1 “taksë e përcaktuar qartë në Kanun për veprime të kundërligjshme” (*Kishës i duhet bâ pjesë në gjobë*).²²¹

²²¹ **gjobë-a** “detyrim ... si dënim ...” (*Fjalor* 1980, f. 623). Aty edhe rrjedhojat *gjobar-i*, *gjobëtar*, *gjobim*, *gjobit*, *gjobitem*, *gjobitje*, *gjobohem*, *gjoboj*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del te Bogdani në trajtën *gjobë* (... të shkruhej në *gjobë o haraç*) II I, IV,3; K. Ashta Lek. IV 183). Te Kristoforidhi 129 vetëm *gjobë-a* e *gjobar*, kjo e fundit me përdorim në Shkodër. Në krahinën e Matit edhe *gjobtoj* “gjobis” (Ulqini BUSHT SSHSH 3, 1961, f. 211). Te *Fjalori* i Th. Hondros edhe *gjobësi-a* “çdo pagesë prej gjobe” (Lloshi, SF 1, 1982, f. 186). Te *Bashkimi* 126 trajtat *gjobë*, *gjobis*, (*i*) *gjobitun*, *gjobtaar*. Te arbëreshët e Italisë *gjobë* e *xhobë* edhe me kuptimin “pasje, shpërbllim” (Giordano, përkat. 147 e 558). Te *Fjalori* i Da Lecces 687 del emri *gjobë*, por edhe folja *me gjobitunë*.

Në qoftë se kuptimi i kësaj fjale te arbëreshët e Italisë është marrë nga atdheu mëmë (pra nuk është ndikim i mëvonshëm i italishtes; khs. edhe refleksin *xh-* për *gj-*), krahas mendimit të G. Meyerit (EW 141) e E. Çabejt (SE IV 335), që shqipen *gjobë* e bie prej serb. (sllav. e vjetër), khs. bullg. *globa*, ruman. *gloabă*, mund të afrohet këtu edhe një lat. *juvāre* “me vjeftë” (khs. edhe ital. *giovare* me të njëjtin kuptim); më saktë një **juv-* a **jov-* me ndërrime fonetike të përligjura (*j = gj*, *v = b*). Në të mirë të këtij mendimi flasin trajtat *gjoboj* e *gjobëtoj* përballë *gjobis* e *gjobit*.

A. Omari (*Marrëdhëniet* 153) e bie këtë fjalë nga sll.; serb. bullg. *globa* “ndeshkim në të holla, gjobë” me shënimin: “Në shqipe gl-

gjobtár, -i 100 “personat e caktuar për të mbledhur gjobat; gjobar;²²² term kanuni që emërton personat që kryejnë vjeljen e gjobave të vëna për shkelje Kanuni etj.”²²³

gjoj/ë, -a 48 “gjah-u” (*Percaktimi i gjojës*).

Gjomarkut (Dera e) 64 “Dera e Gjomarkajve: Derë princore Dukagjinësh (Kapitana), qi sundon mbarë Mirditën; emni i kësaj Dere rrjedhë prej Gjon Markut (rreth 1700). Simbas Athur Moor qyshë në shek. XVII ka kenë e njohtun Dera e Gjomarkajve si sunduese në Mirditë. Sulltanat i a njohten gjithmonë Mirditës njifarë lirije, neper taktikë e veprim të kësaj Dere; i vetmi kusht i asaj autonomie ishte siguri i një kontingjenti të caktuem ushtarësh në kohë lufte.”²²⁴ (*e 500 grosh Ders s Gjomarkut*); 95 (*do të bâhet me dije Dera e Gjomarkut*).

gjurdí, -ja 73 “rrobe e zezë e leshtë me gjysmë mëngë me jakë e me thekë nga pas e me xhufka, që e mbajnë kryesisht shqiptarët e Veriut të vendit; *xhurdi*” (*Ndrikulla do t'i apë kumbarës gjurdí ... e mangore*); 109 (*jakzat e gjurdijavet*).

gjurm/ë, -a 78 “ferkemë (fërkimë), shenja që lë ai që ka kryer një aksion, mbi të cilin bazohen pleqtë për ta ndjekur dhe fajësuar” (*Gjurma e vûme*).

gjurma (e prûme) 78 “ferkemi që është ndjekur dhe sjellë deri në një katund të caktuar” (*Gjurma e prûme mbrenda katundit*).

burimore sllave ka kaluar në të gjitha fazat e zhvillimit të zakonshëm *gl, gi, gj.*”

²²² *gjobtar* është formim nga emri *gjob/ë* me prap. -tar.

²²³ “Gjobtarë thirren ata, të cillt n’ëmen të kuvendit mbarë reshten në vath të gjas së të gjobitunit, për të marrë aq krenë desh a që si mbas së premes së gjyqit të krenvet, të Pleqve, e të Vogjlís.” KLD 104.

²²⁴ Át Benedikt Dema, OFM, *Fjalori historik - gjeografik - mytologjik i “Lahutës së Malcís”*, HD, nr. 1, 2016, f. 188.

gjugjue (me) 87 “me bâ gjuq; me gjukue” (*do të gjugjohen*²²⁵ ...
me pëgje).

gjylpan/ë, -a 93 “gjylpërë” (*i shpojnë me gjylpanë*).

²²⁵ *gjugjoj* neologjizëm, fjalë që nuk dëgjohet gjëkund dhe që regjistrohët rrallë ndër fjalorët e vjetër të shqipes (Bashkimi). Ngjan formim nga emri *gjugj* me prap. -o/j/.

H

hamend/e, -ja 97 “të marrët me mend të një pune; të gjykuarit sipas gjase” (me *hamende*).²²⁶

hamendj/e, -a 78 ‘shiko te *hamende*’ (e vetem prej *hamendjet*).

han/uer, -ori 79 “cjav i patredhur” (*Ogiçi, hanori*²²⁷ e *vergâni*).

hangermja (e) 110 “e ngrëna; të ngrënit” (*Pa krye së hangermi*).

hjeksi, -ja 95 “puna që ban hjekësi (informatori)” (per *hjeksi, pabesni*).

hekurishta-t 43 “veglat e hekurit që zakonisht përdoren në një shtëpi të madhe fshatare” (*hekurishtat e të prefunt e tyne*); 24 (*do të dahan ... si edhe hekurishtat*).

heror, -i 80 “orar-i” (*Knduesi është herori*²²⁸ /*sahati*/ i të vorfnit).

hij/e, -a (e kishës) 1 “Për hije kishet xëhet rrethi mje kû mrrîn kufini i tokës, me të cillen është ndertue.”²²⁹ (*Kisha nuk gjobitet*).

hikm/e, -ja (e) 84 “të ikurit”; “Si të bien në gjak nieri, të ikmen e të mshefmen i ka per detyrë.”²³⁰ (*të hikmen e të mshehmen i ka per detyrë*).

hiri (pa) 88 “pa dashje; rastësisht” (*vrasa pa hiri*).

hjek/ës, -si 77 “Hjekës thirret ai, i cilli me ndermjetsi të mbrapshtë e per nen dhë i jep ndimë tjetrit per me bâ ndo’i rrenim a ndo’i faqe të zezë tjetër në katund të vet.”²³¹ (*Hjekës thirret ai*).

²²⁶ *hamende* më tepër se kompozitë e mirëfilltë, ngjan si pranëvënie (juxtapozicion) *ha me mende* “përpiqem të gjej diçka me mend”, me rënien e njërës *me* si efekt i haplologjisë, pra *hamemende* > *hamende*.

²²⁷ Për etimologjinë e kësaj fjale E. Çabej (SE IV 352) miraton mendimin e N. Joklit që rrjedh prej *hanë* e ka lidhje me besimet popullore rreth fuqisë së çuditshme që i vishet hënës.

²²⁸ Ngjan të kemi këtu një ndërhyrje të Gjeçovit, sepse fshatarët e asaj kohe nuk e njihnin këtë fjalë të huaj (latinisht).

²²⁹ KLD 1.

²³⁰ KLD 83.

²³¹ KLD 77.

hjekësi, -ja 77 “veprimi a puna që kryen hjekësi”.

hjeksi, -ja 60 “*shiko te hjekësi-ja*” (per me u lidhë me besë kundra *hjekëve*).

hollat (të) 92 “paratë e caktuara që paguhën për të larë një gjak” (*të hollat e gjakut*).

hollí, -ja 17 “hullí-ja” (*Nji hollí kaut larg shpís*).

hov, -i 26 “lëvizje e shpejtë; menjëherë”; këtu e përdorur me kuptim të figurshëm “në valë të punës, të veprimit a të muhabetit” (*e aty m’at hov merr sundimin mbi gjâ, pasuní e prone*).

hú 34 “masë sasië, një deri në dy barrë; shpërblimi vjetor që i jep bujku të zotit të kaut” (*Kau me hú²³² po e dimnoi bulku, ka nji barrë drithë*).

²³² K. Ulqini *Terma* 145 jep këtë shpjegim: **hu**: 1.masë drithi prej një barre (100 okë); 2. sasi drithi që mirrte pronari i kaut prej atij që ia kishte “dhënë me hu” (Mat e Mirditë).

Gazulli 178 regjistron “**hú-ni, hú-t**, s.m. as. shms. *hú-të, nji hú drithë, nji govixh me tre húsh*, masë”. Trajta e parë (**hú-ni**) duhet të jetë gabim shtypi, përndryshe ai detyrimisht (për punë të -n fundore), duhet të dilte në trajtën *hú-ni*.

Te Bashkimi 164 shkruhet: **huu, huni**, vm. shum. *huu-t*. Moggio, staio (*misura di biade*).

Te Busetti 617 ital. **moggio** (*misura di granaglie*) përkthehet në shqipe *huu-ni*, pl. *huu-t*, m.

Del kjo fjalë edhe te fjalori i Kristoforidhit 138 **hun-i** “masë për grunë, misër etj.” me përdorim në Shkodër, duke u bërë edhe krahasimet me *koshiq-i, karroqe-ja, babune-ja*.

E merr në analizë këtë fjalë E. Çabej SE IV 378 duke dhënë dy trajta të saj “**hú** m., geg. *hû* edhe “masë drithi 100 okësh (një barrë)”. Ngjan që Çabej *hûni hu-ri* me tjetrën *hu-t* i merr si variante të së njëjtës fjalë. Çabej vetë parashtrohet analizat e bëra nga Meyeri, Bariçi, Pedersen, Tagliavini etj., por pa dhënë mendim për to. Vetë Çabej përfundon: “Fjalë e mbarë gjuhës. Del që te Bardhi: *hu* “palus”. Kuptimi “masë drithi 100 okësh” (një barrë mbetet i paqartë.)”

Duhet saktësuar këtu se e mbarë gjuhës është fjala *hû-ni hu-ri*; tjetra *huu-t (hû-t)* “masë drithi” është vetëm e gegërishtes dhe nuk takon me të parën as në formë e as në kuptim. Pa asnjë dyshim kemi të bëjmë me

- hullë (me)** 51 “me u afrue; me ardhë aty afër” (*nuk mund të hullet kush me gjuejtë*).
- hullí, -ja** 5 “vija që bën plori në arë” (*e kán e hullís 400 grosh*).
- hupë (me)** 1 “humb, humbas” (*kur kjo hupë ndimen e tij*).
- hupës** 33 “i humbur; që nuk e kërkon më kush për asgjë” (*qëni shkon hupës*); 90 (*gjaku i shkon hupës*).
- hupsë** 76 “shiko te hupës” (*shkojnë hupsë*).
- hurdh/ë, -a** 51 “pellg me ujë të ndenjuri; gropë e vogël me ujë” (*i zoti i hurdhës*).
- hut/ë, -a** 54 “lloj pushke krahu e vjetër, e gjatë dhe që mbushej nga përmbropa; martinë” (*huta /martina/*).
- hutue (me u)** 82 “me u habitë e kështu mos me veprue në kohë” (*e mos të hutojn mendsh*).

dy fjalë më vete, me dy njësi leksikore krejtësisht të pavarura nga njëra-tjetra, të cilat duhen analizuar veç e veç.

I

imtue (me) 39 “me analizue; me shkoqitë deri në imtësi; me nda në pjesë të imta” (me *imtue* doket e maleve tona).

Ipeshkëv, -i 1 “kryetari kishtar i një dioqeze; peshkop katolik” (te i *Pari i Fës* - te *Ipeshkvi* -).

J

jakz/ë, -a 109 “jaka e xhurdisë” (*jakzat e gjurdijavet*).

jashtue (me) 98 “me përjashtue; me nxjerrë jashtë” (*a në jashtoftë²³³ kend*).

jashtuem (të) 62 “të përjashtuar; të nxjerrur jashtë” (*granija e fmija janë të jashtuem prej kanûnit*).

jetòs 23 “i jetun; i mbetur; plak që e ka lënë këmba e dora” (*edhe pse â’ plakë jetòs*).

jetuemt (të) 19 “jeta; të gjallët” (*Burri e blen mundin e të jetuemt e grues*).

jezullí, -ja 40 “prush; shpuzë zjarri; hija që shtëpia ose pema e një banori bën në dëm të kopshtit të mbjellë me perime (ose diçka tjetër që kërkon diell) të një prone, duke i zënë diellin a duke e dëmtuar” (*Jezullín²³⁴ e huej*).

²³³ *jashtoj* është formim nga ndajfolja *jasht/ël* me prap. -ol/j/. Në këtë trajtë del rrallë në të folmet krahinore e në fjalorët e gjuhës shqipe.

²³⁴ E. Çabej (SE IV 111) vë re tri fjalë me të njëjtin kuptim: *ezull*, *jezull*, *jezullí* duke i quajtur “fjalë me përhapje ndërdialektore, kryesisht ndër dy trajtat e para nëpër dialekte, dhe me kuptime që sillen rreth atij të një të nxehtit të madh”. Duke i kundruar këto përdorime së bashku, ato mund të përmbliidhen te kuptimi i të nxehtit. Prandaj *ezull* (e andej *jezull*) pas gjithë gjasësh ka dalë nga një zberthim (shpërbërje, dekompozim) i fjalës *ndezullí* “zjarmi; zell, ndezë” (po aty 112).

K

- kadoc, -i** 80 “gjel-i” (*Gjeli /knduesi-kadoci/*).
- kallamoq, -i** 15 “misër” (*miell kallamoqit*).
- kallë (me)** 68 “me dhanë zjarr; me ndezë zjarr; me nisë zjarrin” (*me kallë çibukun*).
- kallxue (me)** 37 “me tregue” (*më ká pasë kallxue tatgjyshi*).
- kallz/ë, -a** 44 “kallinjtë e drithit; kallinjtë që mbeten në arë mbasi të jetë korrur gruri” (*nder koteca rrûm a kallzë*).
- kambë (berri)** 31 “(vetëm) një berr; përdorim i figurshëm i fjalës për të emërtuar një berr të vetëm” (*Me i tretë ndo'i kambë berri bariut*).
- kandár, -i** 65 “mjet që përdoret për të peshuar; *peshore*” (“*Në kandár*²³⁵ të vet se i cilli peshon katerqind derhëm”).
- kanûn, -i** 1 “ligj popullor i pashkruar, që zbatohet në mënyrë të ndërgjegjshme e pa detyrim; tërësia e këtyre ligjeve, që rregullonin jetën dhe veprimtarinë e asaj kohe” (*e jo nen ligjë të Kanûnit*).²³⁶
- kanunár** 94 “(e drejta) kanunore; që është e konsakruar në Kanun” (*të tagrit kanunár*).
- kapar, -i** 51 “Kapari është njaj grosh (të hollash), qi epet para se të mirret në dorë gjâja, që blehet.”²³⁷ (*Kapari*²³⁸ është njaj grosh qi epet para).
- kaparueme (e)** 51 “e kaparosur; që i është dhënë kapari” (*i zoti i gjâs së kaparueme*).
- kapercyell, -i** 41 “një dru bigë, i ngulur mbi një gardh, me anën e së cilës hidhemi e dalin matanë gardhit; kufiri i udhës së verbër; asnjani” (*Shtegu e kapercyelli*).
- kaperdî (me)** 29 “gëlltit; përcjell poshtë” (këtu e përdorur në mënyrë të figurshme tani për durimin ndaj fjalëve të pronarit) (*Brimen e qortimin e zotnis do t'i kaperdijë rrogtari*).

²³⁵ Huazim nga turq. *kandar-i* (T. Dizdari *Fjalor* 492).

²³⁶ Huazim nga turq. *kanun-i*, kjo vetë prej greq. së re κανών κανόνας (khs. edhe T. Dizdari *Fjalor* 493).

²³⁷ KLD 51.

²³⁸ Huazim prej ital. *caparra* (E. Çabej SE V 38).

- kapist/er, -ra** 53 “litari që u shkojmë kafshëve në qafë për t’i tërhequr; kapistall” (*Kali blehet gjithherë me kapister*).
- kapmet (të)** 101 “të ngatërruarit e dy vetëve për gjëra të vogla e krejt të parëndësishme” (*Çashtjet e vogla e të kapmet*).
- kaptin/ë, -a** 104 “koka e njeriut”; “kamba e huej, kaptinat t’ona”²³⁹ (*kaptinat t’ona*).
- kaptin/ë, -a** 48 “kokë (njeriu ose bagëtie), krye, rradake” (*Shengjeta perbâhet prej mushknish, e kaptinet ...*).
- kaptue (me)** 34 “e kapërcej; ia kaloj atij tjetrit”, këtu e përdorur me kuptimin: “e vë nën vete; dëmtoj a e ha (ujku)” (*Po e kaptoi kân bisha*).
- kapucár, -i** 98 “Kapucar thirret aj, i cilli difton fajin e ndokuj, si bj. fj. ndo’i vjedhjení të mshefme, a ndo’i vrasë të hupne përmbas hetimeve, qi bân.”²⁴⁰ (*Kapucár*²⁴¹ thirret ai).
- kapucarí, -ja** 34 “të ushtruarit e profesionit të kapucarit; ai që bën punën e kapucarit” (*Kapucarín do t’a lajnë zbashkut*).
- kapunt (të)** 96 “të kapurit; ata që gjykojnë jo me drejtësi, po sipas interesit të atyre që i kanë kapur” (*e të kapunt në padí*).
- kariq, -i** 50 “rrjetë katrore, të katër qoshet e së cilës u ngjiten majave të dy purtekave të vëna kryq, përdoret për të zënë peshq” (*Peshku qi xêhet me rret, plumç, me perzivoj e kariqe*).²⁴²

²³⁹ KLD 104.

²⁴⁰ KLD 98. K. Ulqini (*Termat* 146) jep këtë shpjegim: “**kapucar**: denoncues i një fajtori dhe dëshmitar i fshehtë e ndonjëherë i hapët. Zakonisht emri i tij nuk çpallet dhe merr shpërblim sipas rëndësisë që ka objekti i procesit. Në qoftë se ai e thotë publikisht dëshminë paguhet 500 grosh.”

²⁴¹ E. Çabej (SE V 44) miraton mendimin e Kristoforidhit që e shpjegon *kapucar*-in si “ai e ajo që merr këpucë për të mbaruar ndonjë punë të mirë”. Sipas Çabejt “Ky kuptim i figurshëm i *këpuc*-ës duhet të ketë dalë nga një përdorim i mirëfilltë e konkret i fjalës. Ai i ka pasur rrënjët te një zakon i moçëm që jepeshin një palë këpucë si shpërblim për një shërbim të kryer.”

²⁴² Sipas E. Çabejt (SE IV 51) fjala *kariq* vjen nga greq. e re καρίκι “purtekë e gjatë, ku kapim rrjetën e peshkimit”.

- karmue (me)** 22 “me e nxjerrë jashtë; me e dëbue; i jap dërmen; e shkatërroj” (*me karmue të birin shpijet*); 68 (*Me kanû të hershme gjygji e karmote me hû të pabesin*).
- kasnec, -i** 107 “Kasnec a i lajm thirret ai, i cilli hapë e lajmon urdhnat e kreut të fisit a per derë, a prej një patalokut, të caktuem prej kreut, prej Pleqsís e prej Voglijet.”²⁴³ (*kasnec²⁴⁴ i fisit*)
- kasneci, -ja** 70 “të ushtruarit e profesionit të kasnecit” (*vetëm prej dhûnet e kasnecijet*).
- kashat/ë, -a** 66 “kafshatë; copë buke sa nxë goja” (*Me njeje kashaten*).
- kasht/ë, -a** 25 “tërësia e kërcejve të bimëve të arës (grurit, misrit etj.), pasi i janë vjelur kallinjte” (*Grazhdi - sâna e kashta - dâhen mbas gjâjet*).
- katund, -i** 29 “fshat” (*a në katund të zotnís*).
- katundisht** 38 “tërë së bashku; fshatçe” (*e grihet katundisht*).
- kathed/er, -ra** 21 “karrike” (*edhe pse e dán kathedret*).
- kau (me hû)** 34 “ká i dhënë me shkëmbim të një mase të caktuar drithi” (*Kau me hû po e dimnoi bulku, ka një barrë drithë*).
- kcimatar/e, -ja** 15 “kërcimëtare; vajzat që do të kërcejnë në dasëm” (*Kcimatare*).
- kelbazët (e)** 53 “me sëmundjen e këlbazës” (*e duel e kelbazët*).
- keqsuemt (të)** 65 “të keqësuarit; ata që janë prekur a cënuar prej dikujt” (*të keqsuemt dorzaniten*).
- kerçik, -u** 24 “pjesa e këmbës prej gjurit e deri te neni” (*Rendi i ujit do të dahet me kerçik*).

²⁴³ KLD 107. K. Ulqini (*Termat* 146) jep këtë shpjegim: “**kasnec**: në administratën e periudhës së sundimit turk, një njeri i caktuar në shërbim të katundit, bajrakut apo të Valiut, që kishte për detyrë të çonte lajmin apo ndonjë kumtim të qeverisë në krerë e në popull”.

²⁴⁴ Fjalë e administratës mesjetare serbe, që ka hyrë edhe në italishten ballkanike të bregdetit dalmat etj. Nga serb. e vjetër *kaznъcb* (shiko hollësit te A. Omari *Marrëdhëniet* 161). Khs. më parë E. Çabejn SE V 58 “term juridik marrë nga serb. e vjetër”.

kerkuem/e, -ja (e) 106 “të kërkuarit e një gjaku; adresimi i këtij gjaku në një drejtim të caktuar” (*E kerkuemja e gjakut*).

kertoll/ë, -a 44 “patate” (*a kertolla*²⁴⁵ *jashta kopshtit*).

kervisë (me u) 33 “me u mbarsë” (*Po u kervis dosa e puell*).

këmend/ë, -a 32 “i gjithë leshti i dhisë që del kur e qethin” (*këmenda e leshti dahan per gjymse*).

kingj, -i 54 “qëngj-i; i vogli i deles” (*kingji e edhi*).

kish/ë, -a 1 “faltarja e të krishterëve; këtu me fjalën *kishë* kuptohet krejtësisht hapësira që zë kisha me të gjitha anekset përkatëse” (*Kisha gjindet e vendosun nen sundim ...*).

kiz/ë, -a 24 “kadhë; kmesë e vogël që përdoret për të prerë ferra, degë të holla etj.” (*kiza, sharra, thadra ...*).

kj/uer, -ori 78 “vendi i ndarë në një shtëpi banimi ku ruhen ushqimet; *qilar*” (*Kjori; e është ai që e strofullon*).

kmes/ë, -a 75 “një lloj vegle pak më e madhe se kadha (*kiza*), me dorezë druri e me pjesën e metalit gjysmë të përkulur, që përdoret për të prerë ferra, për të korrur grurë etj.” (*kmesa e terkuza /teja/ i mirret*).

kndues, -i 80 “gjel” (*Gjeli /knduesi-kadoci/*).

kobshem (i) 80 “që është i mbrujtur me fatkeqësi e mashtrim; që është i mbrujtur me një të keqe të madhe” (*Faji i kobshëm*).

kof/ën, -na 50 “një lloj trine a thurime në trajtë kupe, që përdoret për të zënë peshq” (*Gjoja e peshkut me kosh e me kofen*).²⁴⁶

kohshme (e) 60 “që është e kohës; ashtu siç e kërkon koha” (*e gjobës së kohshme kah kanëja*).

²⁴⁵ Huazim nga serb. *krtola* me të njëjtin kuptim (shiko hollësitë te A. Omari *Marrëdhëniet* 163). Nuk përjashtohet që fjala të ketë hyrë edhe drejtpërdrejt prej gjerm. *kartoffel*, e cila ka kaluar edhe në vetë serb.

²⁴⁶ E. Çabej (SE V 107) miraton mendimin e Tagliavinit që e bie këtë fjalë të shqipes (*kofën*) nga venec. *cofa*. Vetë E. Çabej shprehet se “Forma *kofën* është përfundimi i singularizimit të shumësit *kofën*”.

kollçikë-t 73 “rrypa stofe me të cilat mbështillet këmba nga neni e deri afër gjurit; kalca, tozllukë” (*ride e kollçikë*).

kóm, -i 7 “komb-i” (*e cilla quhet Kóm*).

konop, -i 2 “litar”; këtu e përdorur në mënyrë të figurshme për “forcë fizike” (*Kisha shpatë e konop²⁴⁷ s’ká*).

kopshtije-t 24 “tërsia e kopshteve” (*e arve a e kopshtijeve*).

korí, -ja 39 “turp; marre e faqe e zezë” (*per te shporrë marren e korín*).

koritë (me) 2 “me i marrë nderin dikujt; me e turpnue” (*në çë farë-do mndyre koritet²⁴⁸ prej kuej*).

korituni (i) 65 “(ai) që është i koritur” (*I korituni ka deren çilë*).

kortár, -i 102 “pjesë-pjesë; copa-copa; përdoret kryesisht për njerëzit (gjithsesi në mënyrë të figurshme)”; këtu me kuptim “trup-i (i njeriut), për ta dalluar nga koka” (*Kortarë janë të fiseve, kryet është të Gjemarkut*).

kosh, -i 50 “një objekt në formë shpatuke, thurur me degë të vogla, që shërben për të mbartur rrush, fiq etj., por nganjëherë i përgatitur edhe për të zënë peshq” (*Gjoja e peshkut me kosh²⁴⁹ e me kofen*).

koshar, -i 30 “vendi ku mbahet drithi” (*koshari i drithit*).

koshiq, -i 44 “masë drithi prej 25 okësh; koshi që përdoret për këtë punë” (*Mundi i farkëtarit lahet koshiq²⁵⁰ per pendë të dheut*).

kotec, -i 44 “vend i thurur ku mbahet misri për t’u ruajtur; koshare misri” (*nder koteca²⁵¹ rrûm a kallzë*).

²⁴⁷ Huazim nga serb. *konop* me të njëjtin kuptim si në shqipe; bullg. (maq.) *konop* “kërp, cannabis sativa” (shiko hollësitë te A. Omari *Marrëdhëniet* 169).

²⁴⁸ Huazim nga sllav. (serb.) *koriti* (A. Omari *Marrëdhëniet* 170).

²⁴⁹ Huazim nga serb./bullg. (maq.) *koš* me të njëjtin kuptim si në shqipen.

²⁵⁰ Huazim nga serb. *košić* “kosh i vogël” (shiko hollësitë te A. Omari *Marrëdhëniet* 174).

²⁵¹ Huazim nga bullg. (maq.) *kotec* “qymez pulash”; serb. *kotac* “stallë e vogël për qingja, derra etj.”

kpuc/ë, -a 12 “Shpërblim i shkuesit apo plakut për pleqëri, opingë. Shpërblimi që i jepet atij që kryen detyrat e kapucarit Shej konvencional që fsheh mbas vetes shumëmonetare.”²⁵² (*Kpucët e shkuesit e kanë vaden në ditë që të mirret nusja*); 64 (do të lajë **kpucët** e kapucarit); 99 (*Kpucët e kapucarit janë me dorë në bërë*).

kpucët (e pleqve) 25 “shpërblimi që i jepet plakut (a pleqve) që kanë bërë ndarjen e pasurisë etj.” (*Kpucët e pleqve të të damit do t’i apin*).

kputë (me) 94 “me përfundue një gjyq; me dhanë vendimin e prerë pas gjykimit të një çështjeje” (*nuk mund të kpusin kurrnji gjyqi*).

kputë (me u) 38 “ndërpritet” (*atbotë kputet çdo pleqni*).

krahamajtj/e, -a 94 “me mbajtë krahin; me mbajtë anën e njëres palë në gjykimin e një çështjeje” (*e pa krahamajtje*).

kremte (e) 74 “ditë feste (zakonisht fetare)” (*as të kremtet*).

krenë-t 5 “të parët e vendit, zyrtarët më të lartë të fshatit, bajrakut apo krahinës.”²⁵³ (*Vetem Bajraktari me krenë*),

krení, -ja 84 “kryelartësia; krenaria” (*mos të shesin krení*).

krepatue (me u) 31 “me i dalë zot asaj që i ka ndodhur, duke lëshuar kushtrimin” (*i zoti do të krepatohet*).

krezhmí, -ja 17 “të mbajturit e kreshmës”; *kreshmë* “koha në të cilën feja i ndalon besimtarët e krishterë që të hanë bulmet e mish, sidomos të shtatë javët para Pashkëve” (*Në ditë krezhmijet*).

krîj/ë, -a 90 “lloj krimbi që bren dërrasat e mobiljeve, të dyerve etj.” (*mos t’i lête t’u brejshin prej krîjet*).

krushk, -u 14 “ai që shkon me marrë nusen (së bashku me një grup njerëzish, të caktuar më përpara për këtë detyrë)” (*Krushqt do të shkojnë me marrë nusen*).

krushkapar, -i 16 “krushku i parë; ai që u prin krushqve; krushku i madh” (*Krushkapari s’mundet me kenë*).

²⁵² Sipas K. Ulqinit *Termt* 147.

²⁵³ “Krenët janë të parët e fiseve” KLD 102. Sipas K. Ulqinit *Termt* 147.

- krushqí, -ja** 72 “lidhje me anë martese; lajmësia, shkuesia; të gjithë krushqit së bashku, tërësia e krushqve” (*e ndalon krushqín*).
- kryegjâ, -ja** 32 “kapitali; krerët; kryet e gjâsë” (*Kryegjâja âsht e të zot’t*).
- kryekcyem, -i** 8 “që është kokëfortë; që punon në kokë të vet e pa pyetur njeri” (*Kryekcyemin me e dá shpijet*).
- kryeneçi, -ja** 47 “të qenët i pabindur; që është kokëfortë; që është kryeneç” (*Po të ngurroi mëndja në kryeneçi*).
- kryeplak, -u** 85 “personi i zgjedhur a i emëruar, që drejtonte punët e fshatit e të lagjes, transmetonte aty urdhërat e qeverisë dhe i shërbente kësaj” (*kryeplak a sterplak*).
- kryeshndosh** 109 “(shkoj) për të ngushulluar (kryesisht për raste vdekjesh)” (*me pritë per kryeshndosh*).
- kryqzue** 93 “që i ka duart e vendosura njëra mbi tjetrën në formën e kryqit” (*me duer kryqzue*).
- krrab/ë, -a** 53 “çengel që përdoret për të varur një objekt (armën etj.)” (*e vore në krrabë*).
- kthellët** 39 “*ndajf.* nga thellësia e shpirtit; përgj. *thellë*” (*sado kthellë me hî*).
- kuç, -i** 24 “një lloj kudhi a vorbe; enë për përdorim shtëpiak” (*qëtha, vjedra / mjelca /, mtîj, vegsha, vorba, kuça*).
- kue (me)** 93 “kuaj; mëkoj; i jap fëmijës së vogël për të pirë gji” (*i a kojne shoqi-shoqit*).
- kufijár, -i** 40 “pronarë a persona çfarëdo që janë kufitarë njëri me tjetrin; që i kanë pronat a shtëpiat pranë njëri-tjetrit” (*udha e dy kufijarve*).
- kufini** (i fituem me gjak) 38 “vendi ku janë vlarë për caktim kufijsh” (*Aty ku t’u ngulen muranat, jet vendi i kufinit*).
- kufini** (i fituem me gurapesh) 39 “kufiri që vendosej duke mbartur një gurë në shpinë” (*Me rrasë a gurë të madh në shpinë: tuj ngarkue rrasën a gurin, shtëheshin mje që jitshin nen të*).
- kufini** (i ngulun me spatë) 39 “kufiri që fitohej me të ngulur të sopatës sa më thellë në trup të drurit, në mënyrë që rojet e pyllit nuk mund ta nxirnin dot” (*Po u shterngue me të*).

shpejtë damçori, e i punovi fuqia e krahve, edhe i dha spatës tuj e ngulun mje në tû në trup t'arrmënit, e po s'mund e xueren rojtarët e bjeshkës, kufini i flamurit të këtij qi e nguli spaten, jitte aty).

kûj, -i 90 “një copë dru i vogël a mjet tjetër metalik, që vihej nën sergji për të varur diçka” (*Kûji e krraba janë vû*).

kûj mbë kûj 53 “shprehje e figurshme, kalimi i pronës nga njëri kunj te tjetri, pra nga një pronar te tjetri; pas këtij veprimi nuk ka më pazar tjetër, pushka a kali kalon në kunjin e të zotët” (*“Pushka e kali e kan kûj mbë kûj”*).

kujní, -ja 24 “shiko te kujri-a” (*Kujnija, mali e bjeshka s'dahen*).

kujrí, -ja 1 “vendi i përbashkët i një katundi a i një bajraku i caktuar për të kryer një punë (për kullotë, për dru, për gëlqere etj.)” (*e në mullî të kujrís*).

kulár-krrabza 76 “një trekëndësh druri që i vihet derrit në qafë për ta penguar që të bëjë dëme, të thyej gardhe etj.” (*Po u gjet thi u në dam pa verza (kulár-krrabza)*).

kulet/ë, -a 57 “qese prej pëlhere a lëkure që përdoret për të mbajtur paratë” (*E folmja ásht në fund të kuletës*).

kulm, -i 7 “këtu fjala është përdorur në mënyrë të figurshme për “të gjithë anëtarët e familjes që do të përgjigjen për detyrimet e tyre sipas Kanunit” (*nen kulm të shpís*).

kull/ë, -a 30 “ndërtesë karakteristike e shqiptarëve të Veriut të vendit, zakonisht dy ose trikatëshe, kati i parë i së cilës shërbente si haur për të mbajtur bagëtinë, rrethuar me frëngjia, që përdoreshin qoftë për të kontrolluar të gjitha anët e saj, por edhe për t'u mbrojtur nga ndonjë sulm a rrethim i armikut” (*po kje kullë*).²⁵⁴

kullm/ë, -a 44 “mbështetësja prej metali ku farkëtari rreh hekurin e skuqur për t'i dhënë formën e dëshiruar” (*Rrshiqi, frýsi, kullma e të tjera vegla janë të farkëtarit*).

kullos/ë, -a 44 “vend i hapët me bår ku fusim bagëtinë për të ngrënë” (*Kullosen e livadheve*).

²⁵⁴ Huazim nga turq. *kullë-a* (T. Dizdari *Fjalor* 562).

- kumarë-t** 15 “personat që marrin pjesë si dëshmitarë në ceremoninë e martesës së një çifti” (*Kumarët e Kunorës*).
- kumari, -ja** 12 “të qenët kumbarë; ata që kryejnë ritin e kumbarës” (*Të mos të ketë kumari*).
- kumbar, -a** 72 “personi që është dëshmitar në martesën e një çifti a në pagëzim të një fëmije; ai që i pret flokët për herë të parë një djali të vogël të një familjeje; quhen me këtë emër edhe të gjithë pjesëtarët e familjes së kumbarës” (*të kumbarës e të ndrikulls*).
- kumbari, -ja** 71 *shiko te kumari-ja*” (*Gjaku e gjinia, vllaznimi e kumbaria në Kanû të Malevet*).
- kumbari, -ja** (e Flokvet) 72 “personat që marrin flokët e fëmijës së vogël” (*Kumbarija qi bâhet në të rruem e në të marrun të flokvet*).
- kumbari, -ja** (e Kunorës) 72 “personat që dëshmojnë martesën e një çifti” (*Kumbaria e Kunorës e ndalon krushqin nder robët e shpís së kumbarve e të shpís së dhandrrit*).
- kumbari, -ja** (e Pagzimit) 72 “personat që marrin pjesë në pagëzimin e fëmijës.”
- kunat, -i** 19 “vëllai i gruas (për burrin); vëllai i burrit (për gruan)” (*i kunati me vrá kunaten*).
- kunat/ë, -a** 19 “motra e burrit (për gruan); motra e gruas (për burrin); grua e vëllait” (*i kunati me vrá kunaten*).
- kunetí, -ja** 22 “të gjithë kunetrit bashkë; tërësia e kunetërve” (*Me rrahë kunetija gruen*).
- kunor/ë, -a** 11 “celebroj martesën; vë kurorë; simboli i martesës së burrit me gruan” (*m’u pergjegjë detyrve të kunorës*).
- kupz/ë, -a** 109 “enë e drunjtë që përdoret për të pirë diçka” (*kupzen e pshtesin në tokë*).
- kurth/ë, -a** 76 “vegël që përdoret për të kapur a për të zënë kafshë të egra etj”; *dhokan, çark*” (*Në kopshtë tem e ngrefa kurthen a lakun*).

kusî-, ja 53 “enë zakonisht prej bakri, që përdoret për të zier gjellë; për të ngrohur ujë etj.) (*Kusija*²⁵⁵ 15 okshe).

kushriní, -ja 26 “të gjithë kushërinjtë së bashku; tërësia e kushërinjve; vllaznija; fisi”²⁵⁶ (*kushrinija ... janë me detyrë me e rritë*).

kuvend, -i 9 “1. Marrëveshje (*kanë kuvend me shoshojnë*); 2. Mbledhje e burrave të lagjes, fshatit, mbledhja e parisë apo një forumi më të lartë; 3. Vendi ku bëhet mbledhja.”²⁵⁷ (*Ka tager ... në kuvend*²⁵⁸ të katundit).

kuvende (të pjesshme) 100 “Kuvende të pjesshme janë ato të katundeve, në të cillat marrin pjesë Pleq, Sterpleq e Voglija e një katundi.”²⁵⁹

kuvende (të përgjithshme) 100 “Kuvende të përgjithshme janë ato, në të cillat bashkohen Pleq, Sterpleq, Vogli me Krenë e me Derë të Gjemarkut.”²⁶⁰

kuvendisht 7 “*ndajf.* që është marrë me miratimin e të gjithë kuvendit; që është vendosur (një çështje etj.) nga i gjithë kuvendi i burrave, ky i fundit si institucion që e ka në juridiksionin e vet (sipas Kanunit)” (*zgjidhet kuvendisht*).

²⁵⁵ Fjala *kusî* vjen nga venecianishtja *cusina* (për it. *cucina*) “kuzinë” (E. Çabej SE V 182).

²⁵⁶ Në malësi *kushrí* u thonë meshkujve që lidhen nga ana e babës (K. Ulqini *Terma* 148).

²⁵⁷ K. Ulqini *Terma* 148.

²⁵⁸ “Kuvendi është një bashkim fisit a fisesh me Krenë, Pleq, Sterpleq e Vogli a Djelmni të dheut, qi kan qellim me rrahë ndonji çështje a me lidhë ndonji besë” KLD 100.

²⁵⁹ KLD 100.

²⁶⁰ KLD 100.

L

- lá (me)** 75 “me shlye një detyrim; me pague dëmin e bërë” (*Po vrau kush në dâm ... lán gjân*).
- lagj/e, -ja** 17 “grupe njerëzish”; këtu “dy palë krushq, që lëvizin në drejtime të kundërta” (*M’u ndeshë dy lagje krushq*).
- lajm (i)** 107 “Kasnec a i lajm thirret ai, i cilli hapë e lajmon urdhnat e kreut të fisit a per derë, a prej një patalokut, të caktuem prej kreut, prej Pleqsís e prej Voglijet”; shiko te *kasnec-i* (*Kasnec a i lajm*²⁶¹ thirret ai).
- lajmtar, -i** 106 “Lajmtár thirret aj, që çon në vend porosín e derguesit.”²⁶² (*Lajmtár thirret aj*).
- lak, -u** 76 “litar, konop”; këtu e përdorur për një lloj kurthe a çarku që shërben për të zënë zogj a kafshë të egra (*Në kopshtë tem e ngrefa kurthen a lakun*).
- lakue (me)** 38 “me bâ lak; me prishë drejtimin” (kufini s’do të *lakojë*).
- lân/ës, -si** 28 “personi (njeriu) që në prag të vdekjes i lë dikujt tjetër si trashëgim sasi parash, pasuri të patundshmne, apo ndonjë objekt tjetër” (*si lanësi si këta*).
- land/ë, -a** 39 “dru që nxirret në pyll dhe përdoret kryesisht për ndërtim” (*nuk mund të gjejë aso lande*).
- lang e plang** 27 “e gjithë pasuria (që zotëron), e tundshmja dhe e patundshmja”. Këtu, thjesht për punë stili, janë përdorur dy fjalë që bëjnë rrimë, po gjithsesi, e para, *lang-u*, me kuptimin e pasurisë së luajtshme dhe, tjetra, *plang-u*: “trungu i familjes, shtëpia e të parëve me tokat që zotëron rretheqark saj” (*a edhe lang e plang me t’eger e të butë*).

²⁶¹ Në qoftë se nuk është gabim shtypi a lajthitje e vetë Gjeçovit, përdorimi i dubletës *kasnec* me *i lajm*, ku fjala e dytë jepet me një të përparme (*i*), do të paraqiste interes të veçantë për gramatikën e gjuhës shqipe, si rast i rrallë i saj.

²⁶² KLD 101.

- lang/ue, -oni** 48 “qen gjahu, i shpejtë, i thatë, me këmbë të holla e të larta e me turi të mprehtë; zakonisht shërben për të gjuajtur lepuj, dhelpra etj.” (*me langoj e me zagarë*).
- lanun (e)** 88 “e braktisur për shkaqe të ndryshme; e pabanueshme; e lëshuar” (*shpí e ligë edhe e lanun*).
- lânunat (të)** /me barrë/ 28 “testament; pasuri që lihet pas vdekjes”, por në këtë rast me detyrime (*barrë*), të cilat duhet t’i kryejë një më një ai që e trashëgon pasurinë përkatëse. Në të kundërtën, testamenti prishet, nuk ka më fuqi zbatuese. Në këtë rast pasuria kthehet në origjinë” (*të lanunat me barrë /me detyrë/*).
- lânunat (të)** /pa barrë/ 28 “Testament pa detyrime për t’u zbatuar nga përfituesi i pasurisë së lënë etj.” (*të lânunat pa barrë ... pa kurrfarë detyre*).
- lânunat (të)** 27 “(objekte a para) që i lihen a i falen dikujt” (*Per të lânunat a të falmet*).
- las-i** 92 “ai që lán; ai që do të paguajë të hollat (e gjakut etj.) (*do t’a ngushtojë lasin e keq*).
- latush/ë, -a** 35 “vegël e vogël hekuri që përdoret kryesisht për të krasitë një pemë; sakicë, latë” (*me hjedhë latushen*).
- lavrim, -i** 44 “lëvrimi i tokave; punimi i tokave” (*Lavrimin e tokvet*).
- leçi, -ja** 104 “të leçiturit”.
- leçitë (me)** 3 “Me leçitë, me gojë të Kanunit, don me thënë me dá, me lënë mbas dore e me shkepë një shpí, tuj i a hjekun çdo tager, hír e ndër, si kah katundi, si kah Flamuri.”²⁶³ (*mbasi ky ta ketë leçitë vjedhjen në famulli*); 104 (*Me leçitë,*²⁶⁴ *në gojë të kanûnit, don me thënë*).
- ledh, -i** 40 “kufi (i ndërtuar zakonisht me gurë të thatë ose me të ngritur të dheut), që ndan një arë nga një tjetër” (*Po u rrethue vendi me ledh*).

²⁶³ KLD 104.

²⁶⁴ Mendohet (Miklošić, Meyer etj.) se vjen nga serb. *ličiti* “publikoj, shpall duke thirrur”. Për hollësi të mëtejme shiko te A. Omari *Marrëdhëniet* 142.

letas 97 “lehtas; lehtësisht” (*e mund t’a hetojnë mâ letas*).

lëshue (me) /vajzën/ 13 “me prishë fejesën e bërë sipas rregullave të Kanunit” (*Tagri i djalit per me lshue vajzën e xânun*).

Lidhunat (të) 73 “(rit fetar) nata në të cilën besimtarët e fesë së krishterë lidhen që të mos hanë mish e bulmet” (*nji muej para të Lidhunash*).

lig (i) 59 “që është i keq, që bën punë të këqia; që bën punë të mbrapshta” (*punë të liga*).

ligë (e) 19 “fem. e (i) lig” (*per çdo punë të ligë*).

ligj/ë –a 1 “rregullat e vendosura nga Kanuni; detyrimet që duhen zbatuar pa fjalë” (*e jo nen ligjë të Kanunit*).

ligjue (me u) 34 “me i dhënë arsye atij që të ka nën urdhër; më i dhënë shkoqitje për gjithçka pronarit kur ai e kërkon këtë” (*bulku do t’i ligjohet*²⁶⁵ *të zot’t me bë*); 29 (*e per të shame do t’i ligjohet*).

lim/ë, -a 102 “vegël hekuri që përdoret për të limuar një trup tjetër; këtu e përdorur në mënyrë figurative për të treguar se nga gërdhishtja nuk shpëton askush (sipas Kanunit), as Dera e Gjomarkajve” (*edhe ket Derë e perket lima*).

lis, -i (i gjakut) 71 “Rrjedhja e brêzave prej ânet të babës thirren “Lisi i gjakut”²⁶⁶ (*prej ânet të babës thirret Lisi i gjakut*).

lis, -i (i tamblit) 71 “Rrjedhja e brêzave prej ânet të nânës thirren “Lisi i tamblit”²⁶⁷ (*prej ânet të nânës thirret Lisi i tamblit*).

lodhë (me iu) mendja 87 “shpr. e fig. “me iu ndërrue mendja; me ndërrue mendim” (*e atij s’i lodhet mendja me t’a lshue*).

lshue (me) 34 “roit; largohet luzma e bletëve prej një vendi për të zënë një vend tjetër; braktis zgjonin (bleta)” (*Bleta, qi lshon, do të mirret mbrapa*); (*po lshoi bleta*).

²⁶⁵ Folja *me ligjue* është prejmemëror e formuar nga *ligj* me prap. --o/j/. Ngjan si neologjizëm. Këtë folje nuk e kemi ndeshur as në të folmet krahinore e as ndër fjalorë të gjuhës shqipe.

²⁶⁶ KLD 71.

²⁶⁷ KLD 71.

luejtme (e) 82 “lëvizje” (*Dorëras* e ka **të luejtmen** naten).

lypë (me) 82 “me kërkue (besë)” (*me lypë* besë).

KEN'S

LL

lloftar, -i 97 “i pangopur; gopç; që ha tej mase” (*mos të jenë gjind lloftarë*).

KEN'S

M

- magjar, -i** 78 “kafshë pune; gomar” (*tuj i ndalë ... magjarin*).
- magjator/e, -ja** 15 “gruaja që punon në magje; gruaja që gatuan bukën.”
- mangor/e, -ja** 73 “lloj xhamadani me mëngë të gjata, zakonisht prej shajaku, nganjëherë prej cohe; stolisur me gajtanë e me fije ari; mëngët shpeshherë shërbejnë vetëm për zbukurim dhe nuk vishen po lëshohen nga pas; mëngore” (*Ndrikulla do t’i apë kumbarës gjurdi ... e mangore*).
- maraz, -i** 31 “ndjenja që përftohet kur nxehet njeriu nga një shkak çfarëdo; inat” (*per dhûnë a prej ndo’i marazit*).²⁶⁸
- martesa** (me kunorë) 10 “martesa që vihej në kishë; martesa me kurorë kishe” (*Martesa me kunorë e pelqyeme kah feja e kanûja e Lekës*).
- martesa** (me provë) 10 “martesa me provë bëhej në qoftë se gruaja e parë lindi fëmijë, burri vinte kurorë në kishë; nëse jo, vinte kurorë me gruan e dytë” (*Martesa me provë kundër fejet e kanûjet*).²⁶⁹
- martue (me u)** 10 “M’u martue me kanûn, do’ me thënë m’u bâ shpí, me i a shtue shpís një rob mâ teper, sá per krah të punve, sá per të shtuem të fmive.”²⁷⁰
- marr/e, -ja** 4 “turp-i; punë e keqe” (*s’i lshon marre*); 17 (*s’i quhet kuej per marre*); 39 (*per te shporrë marren e korín*).
- marrme (e)** 6 “e marrun; që është marrë” (*per nderë të marrme*).
- mârrs, -i** 61 “(njeriu) që merr” (*mârrsit s’i bjen béja*).
- marrue (me)** 66 “turpëroj” (*Me i a marrue armët e krahit a të brezit*).
- marruem (i)** 68 “i turpëruar; i koritun; pa kurrfarë dinjiteti” (*jet i koritun e i marruem pergjithmonë e jetës*).
- marruemi (i)** 88 “(personi) që del i marruem” (*I marruemi e e marruemja ... shkojn gjak-hupës*).
- marruemja (e)** 88 “fem. e (i) marruemi” (*I marruemi e e marruemja ... shkojn gjak-hupës*).

²⁶⁸ Huazim prej turq. (T. Dizdari *Fjalor* 617).

²⁶⁹ Shiko hollësitë te K. Ulqini *Terma* 148.

²⁷⁰ KLD 10.

- martin/ë, -a** 54 “një lloj arme krahu, e gjatë, e përdorimit të asaj kohe, që e ka marrë emrin nga firma “Martini”, ku prodhohej” (*huta /martina/*).
- mashkullim, -i** 86 “të gjithë meshkujt e shtëpisë; tërësia e meshkujve të një shtëpie” (*me mashkullim të shpís*).
- mbaj/ë, -a** 80 “të mbajturit; që shërben si ushqim për të mbajtë njerëzit e shtëpisë” (*Thiu i ushqyem është mbaja e një shpije*).
- mbath/ë -a** 8 “Të mbathurat; këpucët, opingat etj. që përdoren për t’u veshur ‘mbathur’ ndër këmbë” (*M’u perkujdesë për veshë e mbathë*).
- mbrapshti, -ja** 29 “punë e keqe, moskryerja për së mbari e punëve të ngarkuara; punë të liga, jashtë normave morale të kohës” (*Po bânî ndo’i mbrapshti rrogtari*); 105 (*Po kje mbrapshti teper e dhûnshme e e shemtueshme*).
- mdhesk/ë, -a** 43 “shtëpi përdhese; që nuk është e ngritur nga toka” (*mdheskë a kullë*).
- mê (me)** 47 “me prâ; me pushue; mos me u dëgjue mâ zhurma që vazhdonte deri më atë kohë” (*mos të mêjë ujët*).
- mêc, -i** 78 “djalë i vogël; djalë i ri (fjalë e përdorur zakonisht në të folmen e Mirditës)” (*Shka të bâjn të mêtujt /mêcat/*).²⁷¹
- megje-t** 40 “kufi-ri; sinor-i; pronë; bashtinë; megjë-a” (*Udha e shtegu ndermjet dy megjeve*²⁷² *lypë pashin e vet*).
- melmes/ë, -a** 24 “yndyra që i shtihet gjellës” (*Bylmeti e çdo melmesë do të ndahen*).
- mend/e, -ja** 95 “mendje-a, aftësia për të gjykuar drejt mbi thelbin e gjërave dhe dukurive që na rrethojnë” (*e bien në mend me ndeshkime*).
- mengut** 17 “mangut; mbetur pa u plotësuar tamam sa duhet” (*po erdh mengut, i ati i nuses ka tager me e ngushtue*).

²⁷¹ Mêc është trajta mirditore e fjalës *mic* “djalë” (E. Çabej SE V 342).

²⁷² Huazim nga sllav. e vj. kishtarë *mezda* (A. Omari Marrëdhëniet 193).

- mesë (bijash)** 71 “*Mesë bijash thirret ai varg fëmnash, qi rrjedhin prej bijave të martueme.*”²⁷³
- mesë (trungu)** 71 “*Mesë trungu thirret ai varg fëmnash ... që rrjedhin prej plangut të babës.*”²⁷⁴
- meshtar, -i** 3 “prifti që thotë meshën; që çon meshë” (*janë nën rojë të Meshtarit të kishës*).
- metë (e)** 52 “që nuk është e saktë; që del mangut; që nuk punon si duhet; që nuk i plotëson kushtet që ka kërkuar ai që e ka blerë” (*po duel e metë*).
- mëtujt (të)** 78 “të miturit; të vëgjëlit; fëmijë me moshë të vogël” (*Shka të bâjn të mëtujt*²⁷⁵ / *mêcat* /).
- mëdhesk/ë, -a** 30 “shiko te *mdheskë*” (*mëdheskë a ksollë*).
- mic/ë, -a** 76 “mace” (*qêni e mica*).²⁷⁶
- mifë (me)** 35 “punoj tokën me shat a me bel (me vangë)” (*Aty ku të fillojë me mifë, do t’ulet kâmbëkryq*).
- mihë (me)** 8 “më punue tokën me një vegël dore, që përdoret për këtë punë” (*me korre a me mihë*).
- mik (i prém)** 90 “miku që i është vrarë në besë një personi të caktuar” (*Pushka e shtime per mik të prém*).
- mikprém** 68 “ai që i është vrarë miku në besë a në mbrojtje” (*me të vramin mikprém*).
- miqasore** 91 “miqësore” (*qortimet miqasore*).
- mirvet** 70 “me vullnet të plotë; pa i detyruar njeri” (*Dorzâni hîn me mirvet*).
- miz/ë, -a** 34 “blet/ë, -a; (mizë) mjalti” (*Zgjoni i bletës me miza mbrendë*).
- mje** 21 “deri” (*s’mund t’a shklasë token e vet mje qi t’a largojë gruen*).
- mjesdit/ë, -a** 8 “mesi i ditës” (*Me bâ gati mjesditën a darken*).

²⁷³ KLD 71.

²⁷⁴ KLD 71.

²⁷⁵ Të mëtujt është trajta mirditore e të mitujt me shqiptimin i : ê, krakteristikë e të folmes së krahinës.

²⁷⁶ Huazim nga serb. *mica* “kotele, mace e vogël” (shiko te A. Omari Marrëdhëniet 189).

- mkambë (me)** 26 “me ngritë në kambë”; këtu e përdorur në mënyrë të figurshme “me rritë djalin për së mbari, sipas normave të Kanunit” (*me rritë e me mkambë djalin*); 68 (*ti do t’a mkâmish nderen e mikut me rrezik të jetës s’ate*).
- mkambunt (të)** 7 “të ngriturit më këmbë”, këtu me kuptimin “të pasuruarit e të sjellurit mbarë të familjes” (*të mkambunt e tyne*).
- mllef, -i** 51 “zëmërim; inat i madh; mëri; maraz” (*vetem prej mllefi*).
- mner/ë, -a** 70 “frikë e madhe; tmer” (*perzihet lamshi per mnerë*).
- mnî, -ja** 40 “inat e zemërim që kemi me njëri-tjetrin; armiqësi”; *mëri-a*” (*veç prej mnîjet*).
- mnis/ë, -a** 97 “*shiko te mnî-ja*” (*të mos të jenë ... mnisa*).
- moh, -i** 34 “të mohuarit, të rënit hasha; të deklaruarit kundër një problemi a një çështjeje, për të cilën je shprehur pozitivisht më përpara (zakonisht për përfitime personale)”, përdoret përgjithësisht në shprehjen *I ra mohit*. (*Po i rá mohit*).
- mohues, -i** 59 “*Mohues* thirret ai, i cilli nuk i vëhet zhkarkimit as shpifjes, kje per ndo’i dâm, per vjedhni a per ndo’i vrasë etj.”²⁷⁷
- mort, -i** 74 “vdekje” (*As mort, as darsen*).
- mospelqim, -i** 108 “papëlqim-i; që nuk pëlqehet; që nuk përputhet saktësisht me normat kanunore” (*mospelqimi i saj kah kanûja*).
- motmot, -i** 110 “një vit plot” (*per ndo’i ditë të motmotit*).
- motnuem (i)** 37 “e vjetër; e vjetëruar; e kaluar motesh” (*edhe ndo’i landë e motnueme*).
- mprojtár, -i** 83 “ai që mbron; ai që vihet në mbrojtje të dikujt” (*janë mbrojtaret e dorërasit*).
- mriz, -i** 35 “vend me hije ku pushojnë bagëtia në zheg të ditës (në valën e të nxehtit)” (*Mrizat a lisat, qi lën kush*).

²⁷⁷ KLD 59.

- mrizue (me)** 35 “me ndejë nën hije për t’iu larguar vapës së madhe” (*per me mrizue gjân*).
- msall/ë, -a** 73 “pëlhura e tryezës së bukës” (*msalla, qi do të shtrohet*).
- mshehme (e)** 84 “e fshehura; të fshehurit” (*të hikmen e të mshehmen i ká per detyrë*).
- mshilë (me)** 49 “me e mbyllë”, përdoret edhe me kuptimin “me e burgosë a me e mbyllë (në haur)” (*edhe e mshilë në shpellë*).
- mti, -ni** 24 “dybek; tundës ku rrahim qumështin; *pti*” (*qêtha, vjedra /mjelca/, mtij, vegsha, vorba, kuça*).
- mull/ë, -a** 97 “bark; stomak; *përgj.* të përbrendshmet e njeriut” (*per nji mullë bukë*).
- mullar, -i** 44 “grumbull i madh bari, i thatë, i mbledhur dhe i rrasur në trajtë koni rreth një strumbullari; ruhet për dimër” (*Sânen e livadheve bulgu e vên mullár*).
- mundshtue (me)** 9 “me i vû kushte; me e qortue; me e kritikue (për atë që bën)” (*nuk munden me mundshtue*).
- muran/ë, -a** 38 “grumbull gurësh që vihen në vendin ku është vrarë një njeri” (*gurët e muranave*).
- mzat, -i** 99 “dem i ri; ká i patredhur; *mëzat.*”

N

- nadj/e, -a** 15 “mëngjes-i” (*Të shtunden **nadje** shkojnë krushqit*).
- ndêjë (me)** /pa fjalë/ 1 “nuk do të flasë asnjë fjalë, pra do të pranojë gjithçka që do të vendoset” (*famullija, do t’i rrîjn pá fjalë*).
- ndêjë (me)** 94 “me pranue vendimin e gjyqit e me e zbatue atë një më një” (*me i ndêjë gjygit*).
- nder/ë, -a** 22 “emri i mirë; integriteti; nderimi që gëzon një njeri në shoqëri për cilësitë e tij morale e mendore, për trimëri, bujari etj.” (*nderen i a kerkon burri, varren e gjakun prindja*); 65 (*Nderen seicilli e ka per vedi*).
- ndera (e kishës)** 2 “Kisha është institucion që mbrohet nga famullia; pra është pikërisht famullia ajo që do të përgjigjet kur ndokush përpiqet të cënojë (përkata. të marrë a të godasë) nderen e saj” (*Nderen e kishës e lypë Famullija*).
- ndermjet/ës, -si** I 69 “*Ndermjetës* thirret ai, i cili hîn për me dá fjalët e kqija, me shmangë rragen, prej të cillave mund të shkaktohet vrasa a ndo’i rrënim tjetër.”²⁷⁸
- ndermjet/ës, -si** II 12 “personi që ndermjetëson për të zgjidhur një problem; ai që kryen detyrën e shkuesit” (*Shkuesi është ndermjetsi te dhandrri e te nusja*).
- ndermjetsí, -ja** 108 “të kallurit (të futurit) e një njeriu si ndermjetës në mes dy vetëve, që zakonisht zihen a kanë për të zgjidhur një problem të caktuar” (*ndoren e ndermjetsín i a ruen*).
- ndesh (me u rá)** 23 “me kundërshtue; mos me ia zbatue fjalën” (*as me u rá ndesh fjalës*).
- ndeshkim, -i** 5 “Per **ndeshkim** kuptohet një e keqe, qi prej pushtedit të ligjshëm i pertrîhet kuej për faj të bâm.”²⁷⁹
- ndigies/ë, -a** 22 “të dëgjuarit dhe të zbatuarit të fjalës së më të madhit; ndëgjesë” (*nen sundim e ndigiesë*).
- ndigjes/ë, -a** 29 “bindjen e plotë ndaj të zotit” (*Zotnija ka urdhnesen, rrogtari ndigjesen*).

²⁷⁸ KLD 69.

²⁷⁹ KLD 5.

- ndor/e, -ja** 2 “*institucion i së drejtës popullore (term kanuni)*; kur një njeri i kërkon mbrojtje një njeriu tjetër, për të përballuar rrezikun që e kanos”, i kërkon, pra, që ta marrë ai *ndore*, kjo e fundit e ndërtuar nga përngjitja (juxtapozicioni) e togut *në dorë (tënde)*. Në këtë rast personi i marrë *ndore* fitonte imunitet të plotë” (*me i rá kush ndore kishës*).
- ndreqë (me u)** 47 “me drejtue, me rregullue diçka” (*po s’u ndreqe me shokë*); 91 (*Pa u ndreqë puna e gjakut*).
- ndrikull, -a** 72 “gruaja që ndodhet si dëshmitare në kurorëzimin e nuses e të dhëndrit; gruaja që mban foshnjën në pagëzim; *nunë-a*” (*të kumbarës e të ndrikulls*).
- ndrikullí, -ja** 72 “të gjithë ndrikullat së bashku; tërësia e ndrikullave” (*Kumbarija e ndrikullija*).
- nendores** 95 “korrupsion-i; të hollat që jepen nën dorë për me fitue një të drejtë që nuk të takon; mitmarrje” (*e pa u thye prej nendores*).
- nëgojësh** 60 “vetëm me gojë; vetëm me fjalë, pa u shoqëruar me fakte a me objekte e veprime që e përforcojnë benë e bërë” (*Bén nëgojësh kanûja as s’e pelqen*).
- ngá (me)** 6 “me ngacmue; me gërgá (me fjalë ose me vepra)” (*me ngá rrogтарin*).
- ngae (me)** 17 “me ngacmue; me ngucatë; me futë fitme me qëllim” (*mos me i ngae kush*).
- ngarkic/ë, -a** 51 “ngarkesë” (*qi bjen ngarkicen e rrjellit*).
- ngas/e, -ja** 5 “ngacmim” (*per ngase të puntoris së kishës*).
- ngatrrim, -i** 38 “të ngatërruarit e njerëzve për shkak të besë në rrenë që bën ai që betohet në përcaktimin e kufijve; përfundimi i veprimit të foljes *me ngatrrue*” (*Po u bâ ndo’i vrasë mbas ngatrrimit të kufinit të luejtun*).
- ngatrristar, -i** 38 “ai që sjell ngatërresa në caktimin e kufijve të tokave” (*ngatrristari do të lajë për gjobë 100 desh*).
- ngatrrue (me)** 38 “ngatërrimi me qëllim i kufijve të tokave” (*Kush t’a luej kufinin me qëllim qi me ngatrrue*).
- ngatrrueshme (e)** 98 “e ngatërruar; e ndërlikuar; e vështirë për t’u zgjidhur” (*teper e ngatrrueshme*).

- ngiatas** 84 “ngjat; pranë njëri-tjetrit; afas e afas” (*per në kjo shin ngiatas me shpi të vramit*).
- ngiati (i)** 44 “që e ke afër; që e ke pranë” (*të largtin prej të ngiatit*).
- ngrefë (me)** 95 “me nisë (luftën); me shpallë luftë” (*per me u ngrefë luftë*).
- ngrefitë (të)** 90 “(pushka) që është lënë me plumb në fole dhe pa siguresë; pra pa u siguruar që të mos shprazet për ndonjë arsye boshe a pa hiri” (*Po e la miku pushken të ngrefitë*).
- ngucatë (me)** 17 “me ngacmue; cys, nxis; me ngucë” (*e ka shtekun çilë me i ngucatë*).
- ngulë (me)** 26 “me zanë vend; me ngulë me banim; me ngrehë ngulime të reja; me ngulue” (*të mos dyndet nipnija me ngulë*); 96 (*po ngulen pleqt*).
- ngurrue (me)** 47 “me mbetë në një vend; mos me pranue një mendim a një vendim të marrë, vetëm për kryneçësi” (*Po të ngurroi mëndja në kryneçësi*).
- ngushtue (me)** 70 “me e detyrue me të keq; me e vënë para përgjegjësisë” (*katundi do t’a ngushtojë detyrsin*).
- nip (bijash)** 71 “*Nip bijash* thirret ai varg mashkujsh, qi rrjedhin prej bijave të martueme.”²⁸⁰
- nip (trungu)** 71 “*Nip trungu* thirret ai varg mashkujsh ... që rrjedhin prej plangut të babës.”²⁸¹
- nipi (i tamblit a bijash)** 26 “shiko te nip bijash” (*e jo nipit të tamblit a nipit bijash*).
- nipi (i trungu a gjakut)** 26 “shiko te nip (trungu)” (*Nipit të trungut a të gjakut i perket trashigimi*).
- nipni, -ja** 26 “tërësia e nipave; të gjithë nipat së bashku” (*të mos dyndet nipnija me ngulë*).
- nisun (e)** 89 “të qëlluarit me armë jashtë rregullave të caktuara, veçanërisht kur je në grup pushkatarësh” (*Pushka e nisun ka gjobë*).

²⁸⁰ KLD 71.

²⁸¹ KLD 71.

nun, -i 73 “***Nun** a kumbar thirret ai që merr flokët.*”²⁸²

nusí, -ja 72 “të nusëruarit e nuses” (Ndrikullija është si ***nusija***).

²⁸² KLD 73.

NJ

njefun (të) 97 “të caktuar që më parë; të shënuar (o prej gjyqtarëve, o prej atij që bën gjyqin) (*Poronikvet të njefun per derë*).

njefë (me) 97 “me caktue njerëzit, që do të dëshmojnë në gjyq” (*Gjyqi do të njefin per poronikë gjind prej vllazniet*).

njes/ë, -a 22 “/pa/ ndjesë; pa i kërkuar ndjesë për veprimin që po kryen” (*i biri e qet t’âmen prej shpijet pa njesë*).

njeti 13 “gjetiu; në një vend tjetër” (*jânë të lirë me e martue njeti*).

njimend 68 “me të vërtetë; me gjithë mend; seriozisht” (*Njimend, se s’i pritet mik, porse jet i koritun*).

ogiç, -i 42 “dash i madh me këmborë në qafë që i prin kopësë; përçor” (*Kumbona e oğiçit*).²⁸³

ograje-t 8 “zabel me kullotë” (*xâna /ograje/*).²⁸⁴

ok/ë, -a 15 “masë peshe e barabartë me një kilogram e katërqind derhem (një kilogram e 408 gram)” (4 *okë*²⁸⁵ kafe).

opang/ë, -a 49 “një copë lëkurë e regjur (kryesisht nga dhia ose nga bualli), e prerë sipas këmbës (mbi të si shtresë vihet një copë shajak i hollë), që përdorej nga malësorët tanë të Veriut si këpucë”. Kjo lloj *mbathjeje* ngjeshej për këmbë me lidhëza (toje) leshi (*aq parë opanga*); 57 (*Opangat e holla*); (*Opangat e trasha*); 83 (*kanûja nuk don qi të marrin opanga*).²⁸⁶

ortar, -i 96 “ngjan të jetë ora e xhepit me gjithë qostek” (*per peng xêhet arma fisheku, ortari*²⁸⁷ a edhe kutija e duhanit).

²⁸³ Mendohet se është huazuar nga sllav. *jaǵnъcb* “qingj i vogël”. E. Çabej (SE VI 104) miraton burimin sllav me rezervën e pikave të diskutueshme lidhur me zanoren nistore (shiko hollësitë te A. Omari *Marrëdhëniet* 208).

²⁸⁴ Huazim prej sllavishtes, por me diskutimin: “Trajta *ograjë* ose me Joklin nga dialekti čakavik i bregdetit dalmat, ose me gjasë prej një forme dialektore malazeze *ograda*, me ndërrim dialektor *gj > j* brenda shqipes, ashtu si edhe *megje > meje* e shqipes verilindore” (shiko hollësitë, së bashku me literaturën përkatëse, te A. Omari *Marrëdhëniet* 209).

²⁸⁵ Huazim prej turq. *okká* (T. Dizdari *Fjalor* 728).

²⁸⁶ Huazim nga serb. *opanak opanka* (A. Omari *Marrëdhëniet* 212). Kemi të bëjmë me një prej huazimeve sllave në gjuhën shqipe para shek. XIV, kur ka ndodhë kalimi i jereve sllave (ѣ, ѓ) në *a* në serbishten.

²⁸⁷ Ngjan të jetë neologjizëm e krijuar ng vetë Gjeçovi për të emërtuar sahatin e modës së vjetër me gjithë qostek.

P

- pabesi (i)** 68 “ai që të pret në besë; ai që nuk mba besën e dhënë” (*Veç i pabesi me të pabesin falen me te*).
- pabesní, -ja** 95 “mosmbajtja e besës”; “shkelja a thyerja e besës së dhënë” (*per hjeksi, pabesní*).
- padetyrë (i)** 78 “që nuk i detyrohet kujt; i padetyruar ndaj dikujt” (*e së mbrami del i padetyrë i grabituni*).
- pagjak (i)** 81 “që nuk është në gjak me njeri” (*Simahori i pagjak*).
- pagzim, -i** 72 (*rit. fet.*) “veprimi simbolik i kishës me të cilin një foshnje pranohet në bashkësinë e fesë kristiane.”
- pagzuem (i)** 72 “i pagëzuar; që ka marrë ritin e pagëzimit.”
- paj/ë, -a** 14 “gjërat që merr vajza me vete kur martohet (irroba, etj.)” (*Prindja s’mendon per pajë*);²⁸⁸ 24 (*Paja e grues*).
- pajtimi (i gjakut)** 91 “marrëveshja e kryer për të pajtuarit e një gjaku” (*Pajtimi i gjakut bâhet dy mndyrësh*).
- pakunorë (i)** 26 “(fëmijë) i lindur jashtë martese (kur prindërit nuk kanë vënë kunorë në kishë)” (*Djalín të pakunorë kanûja s’e njef per trashigues*).
- paligjë (të)** 21 “të paligjshëm a të paligjëruar (fëmijë të lindur me një grua me të cilën nuk ke vënë kunorë kishë)” (*njehen të pa-ligjë*).
- pám (të)** 27 “të parë” (kur nusja vjen për të parën herë mbas martese te prindërit e vet) (*Me i pritë në të pá*).
- pamarrveshtj/e, -a** 38 “mosmarrëveshje” (*per me shporrë çdo pamarrveshtje*).
- pandehun (i)** 61 “i pandehur; i paditur në gjyq për një faj” (*me i a mbledhë pëjt të pandehunit*).²⁸⁹

²⁸⁸ Nga dy etimologjitë që diskutohen për këtë fjalë (lat. *pallia* dhe it. *palio*), E.Çabej (SE VI 124), mendon se ajo e burimit latin mbetet më e besueshmja. T. Dizdari *Fjalor* 741, e bie këtë fjalë huazim nga turq. *pajë*.

²⁸⁹ Ky term juridik (*i*) *pandehun* as nuk njihet e as nuk përdoret gjëkund në Mirditë e gjetkë. Ngjan që është futur aty prej vetë Gjeçovit, i cili ngjan ta ketë parapëlqyer para tjetrës “i paditur”. Për etimologjinë e kësaj fjale është shprehur E. Çabej (SE VI 137), kur

panjefun (të) 97 “dëshmitarë (që thirren në gjyq), por pa u paracaktuar, pra pa u caktuar më përpara për të dhënë dëshminë e tyre” (*Edhe Poronikvet të panjefun do t’u shkojë për derë i zoti i bës*).

papasm (i) 44 “i papasuri; i varfri; ai që nuk ka” (*nuk do të veçojë të pasmin prej të papasmit*).

paperdhok, -u 35 “gur i vogël i rrumbullakët; guralec” (*do të marrë një paperdhok në dorë*).

paperlims, -ja 1 “privilegj; përjashtimi nga një detyrim i përgjithshëm” (*Paperlimsija e kishës*); 22 (*Paperlimsija e grues*).

paravû (me) 41 “me paravënë; me dalë para” (*E mira e perbashkët i paravêhet damit të veçantë*).

paraz 22 “baras; njëlloj; barabar” (*trashigimin paraz m’u lânë djelmve*).

parazue (me u) 34 “me u barazue; me u bâ baras; me u bâ njëlloj” (*i parazohet shpís së thyeme*).

parbiní, -ja 23 “e drejta (tagri) i djalit të parë; tagri i mashkullit që ka lindur i pari, (i) parilemë” (*Tagri i parbinís²⁹⁰ /djalit të parë/*).

shkruan: Në gjuhën e përgjithshme fjala përdoret më fort si term juridik i *pandehur* “i paditur në gjyq për një faj, i akuzuar”.

²⁹⁰ Fjala *parbini*-ja pa asnjë dyshim është kallur aty nga vetë Gjeçovi, i cili e ka përdorur në vend të “(tagrit të) djalit të parë”. Në Mirditë e as ndër rrethe kjo fjalë nuk njihet. Te M. Camaj kemi fjalën **parilemë (i)** “djali që ka lindur i pari në një shtëpi”. Kjo fjalë, e përdorur te Buzuku (*i parilenë*, lat. *primogenitus*), është ripërdorur (përk. ringjallur) te tregimi “Pishtarët e natës” të Camajt. në përmbledhjen “Shkundullima” (Proza), Romë, 1981, f. 7, 35.

Edhe në ungjillin e sotëm lat. *primogenitus* është përkthyer “i Njëlinduri”, një neologjizëm jashtë natyrës së gjuhës shqipe, ku nuk kemi asnjë kompozitë të këtij lloji. Ngjan të kemi këtu një kalk gjuhësor nën ndikimin e tekstit origjinal, që është përdorur si bazë për përkthimin në shqipe (khs. ... /lucis/ *Unigéniti*; *MISSALE ROMANUM*, Libreria editrice Vaticana, MCMLXXV, f. 140). Mbase, më i saktë (në këtë rast) do të paraqitej emërtimi (*i*) *Vetmlemë*, që do të ishte më pranë semantikës së objektit që përfaqëson.

- par/e, -ja** 83 “para-ja; të holla” (*nuk hîn kush me **pare***²⁹¹).
- parë** 73 “*ndajf. çift*” (*Ditët e ndêjes së ndrikulles te kumbara do të jenë gjithmonë cub e jo kurr **parë***).
- pari (i)** /i fesë/ 1 “ai që drejton organizimin kishtar” (*nen sundim të të **Parit** të Fës*).
- pasí, -ja** 110 “vizita e parë e nuses në shtëpinë e babait; përgjithësisht vizita e nuses në shtëpinë e babait” (*Me ardhë në shpí të prindes në **pasí***²⁹² *bija e martueme e me dekë aty*).
- pasosme (e)** 4 “(e) pasosur; që nuk sos asnjëherë; që nuk përfundon kurr; që është e përjetshme” (*së Drejtës së **pasosme***).
- pash, -i** 40 “masë gjatësie, që bëhet duke hapur plotësisht krahët në të dyja anët e krahërorit” (*Udha e shtegu ndermjet dy megjeve lypë **pashin** e vet*).
- pashtrak, -u** 38 “taksë për kullosë” (*ai më lypi **pashtrakun***);²⁹³ 41 (***Pashtrakun** epe vetë*). “Pashtrak thirret vendi i kullotës mbrenda kufinit të një flamuri, në të cilin nuk mund të hije me kullotë tufa e një flamurit tjetër.”²⁹⁴
- patalok, -u** 107 “shesh i madh; shesh për dyluftim” (*prej një **patalokut***).
- pathyeme të** (bukë) 18 “buka në malësi shtrohet në tryezë pa u prerë, po e tërë dhe thyhet me duar në copa për t’u

²⁹¹ Huazim prej turq. *pará* (T. Dizdari *Fjalor* 748).

²⁹² Sipas Meyerit, e gjithashtu edhe N. Joklit, *pasí* shpjegohet nga *pa(r)tsí*, me rënien e *r*-së para spirantit. Ne mendojmë se *pasí* është formuar përbrenda shqipes e me mjetet e saj. Kemi së pari *pás* me prap. -i. Kjo *pás* me kuptimin “ai që shikon” është formim nga folja (*me*) *pá* me prap. -s. Përfundimisht *pasí* analizohet *pá/s/* + -i.

²⁹³ Paraqet interes të veçantë prejardhja e fjalës *pashtrak*. E. Çabej shprehet se *pashtrak-u* “taksë kullote; vendi i kullotës brenda kufijve të një bajraku”. Fjalë e gegërishtes veriore (Mirditës) dhe e Kanunit të Lekë Dukagjinit, e padalë në dritë në kohë të G. Meyerit. Nga një lat. ballkanike **pastūrāticum*, prej *pastūra* “kullotë”, me sufiks -aticum, i shpeshtë sidomos në latinishten ballkanike” (SE VI 154).

²⁹⁴ KLD 41.

ndarë ndër pjesëtarë e sofrës” (*dhantít per nusen mbi bukë të pathyeme më tryezë*).

pelqim, -i 94 “pranimi i pengut nga gjyqtarët popullorë që do të bëjnë gjyqin për të cilin jepet pengu; pranimi i padisë që ka për shenj pëlqimin e pengut. Me këtë rast pleqtë janë të detyruar të hapin gjyqin për të cilin u lëshua pengu” (*pengu i pelqimit*).

pëmaj/ë, -a 41 “pemishte; vende me pemë frutore” (*nder veshta e nder pëmajë*).²⁹⁵

pend/ë, -a 44 “një çift që (a buaj) që mbrihen në parmendë a në qerre” (*Mundi i farkëtarit lahet koshiq per pendë të dheut*).

peng, -u 56 “term kanuni,²⁹⁶ një diçka që hidhet në formën e dorezës së duelit, e cila shërben si sfidë për të ngritur një çështje në gjyqin e fshatit a të krahinës (zakonisht për këtë përdoret kutia e duhanit, çibuku a ndonjë send tjetër personal). Objekti i kthehet të zot pasi të jetë ndarë çështja në gjyq. Në vargun e poshtëshënuar për objekt të lënë, shërben vetëm *ffala* e atij që flet. Kuptimi këtu është: “(Ai) nuk ka lënë kurr *ffalë* peng, sepse i ka zgjidhur vetë punët pa patur nevojë për ndihmën a ndërmjetësimin e tjetërkujt” (*Pengu, qi mirret per uhá të dhanun, mund të xêhet si “Peng hupës”*); (*famullija s’mund t’i lypë peng kishës*).

pengu (i pelqimit) 94 “pengu që u jepet në dorë pleqvet, që vërteton se ato që do të gjykohen e miratojnë gjykimin e tyre” (*Si t’u epet pleqvet në dorë pengu i pelqimit*).²⁹⁷

²⁹⁵ *pemajë* formim nga *pem/ë/* me prap. *-aj/ë* (khs. *bungajë, dushkajë, lisnajë* etj.) Vlen të silltet këtu shënimi i Xhuvani-Çabejt (*Prap.* 430): “Më të shumtat e fjalëve me *-ajë* janë të gegërishtes veriore, dhe ka të ngjarë që përhapja e kësaj prapashtese të ketë filluar nga ato dialekte të Veriut, si Mirdita, që e diftongojnë *-i-në* në *-aj*; kështu trajtës *lisnajë* në disa vise të Veriut i përgjigjet trajta *lisní*.

²⁹⁶ “Pengu është një shëj i landët, qi epet në dorë të Pleqve gjygtarë me tager qi të bâjn gjýgj mbi ankimet e dy kundershhtarve.” KLD 95.

²⁹⁷ “Pengu thirret ‘Pengu i pelqimit a i zâbukës’, qi don me thânë se, tuj e dhânë pengun në dorë të Pleqvet gjygtarë, këta gjinden gati me i ndêjë gjýgjit e pleqnís.” KLD 95.

- pengueme (e)** 13 “e penguar; që ndodhet nën peng, dhe si e tillë nuk mund të fillojë bisedime të tjera për një shkuesi të re” (*se gjindet e pengueme*).
- perbashknisht** 36 “të përbashkët; të gjithë së bashku” (*e ka perbashknisht një katund*).
- perbé (me u)** 37 “me u vënë në bé; me u përbetuar” (*do të perbehet para se të niset*).
- perbishtnim, -i** 63 “me i bâ bisht; me i ikë besës; mos me i ndejë besës së bërë” (*Bëja s’ka skâj, por s’bân perbishtnime*).
- perbûjs, -i** 45 “i huaji që flen në një shtëpi si mik i saj; ai që ruan të vdekurin” (*Mullisi e perbûjsi do të flëjn në njënin brryl*).
- perbujtor/e, -ja** 44 “vendi ku përbujnë udhëtarët; hotel; han” (*mullinit e perbujtores*).
- percjell/ës, -sa** 16 “ai që shoqëronte njeriun deri në një shenj vendi e që e kishte në besë të vet; në rastin tonë mund të jenë edhe percjellës të zakonshëm, pra ‘ata që shoqërojnë të vdekurin’” (*musja me krushq, e percjellsa me të deknin*).
- percllue (me u)** 74 “me u përzhitë; më digjen lehtë vetullat nga flakët; djegie e lehtë pasi kalon një flakadâ” (*i percllohet me flakët*).
- perdorue (me u)** 13 “zihet për fejesë; fejesa quhet e kryer” (*Me shêj perdorohet vajza*).
- perdhuni** 41 “me dhunë, me detyrim, pa të pyetur fare” (*per ndryshe t’a marrin edhe me perdhuni*).
- pergjakë (me)** 48 “e bëj me gjak” (*Ai, qi t’a pergjakë*).
- pergjegjme (të)** 69 “që janë bërë si përgjigje ndaj një ngacmimi a fyerjeje” (*kan shkaktue vrasë të pergjegjme shi në trevezë*).
- pergjymsash** 93 “përgjysmë” (*mbushin pergjymsash*).
- perhjedhun (i)** 39 “të shpërndarë pa rregull; të përhapur andej e këtej” (*më gjejnë tuj trupue arnej të perhjedhun*).
- perkaes** 21 “përkasës; trashëgues të një pasurie” (*s’mund të bâhen kurr perkaes / trashigues /*).

perkasí, -ja 27 “trashëgimia” (*s’ka tager trashigimi as perkasje*).²⁹⁸

perkujdesë (me u) 8 “me u kujdesë në mënyrë të veçantë e me përgjegjësi” (*M’u perkujdesë per të marët e gjindes e të shpís*).

perligjë (me) 3 “shpërblen; justifikon; e vë në ligj” (*ai do t’i perligjet Famullís*); 19 (*do ta perligjin prindja e grues*); 43 (*porse udha e shtegu do të perligjen me një vend tjetër*).

perligjme (e) 19 “e shpërblyer; e justifikuar” (*kjo s’është e perligjme*).

perlim, -i 8 “detyrë” (*Perlimi e detyra e të zot’ t të shpís*).

permbasi 25 “pasi; mbasi” (*permbasi u perzien*).

permendunt (të) 52 “të përmendurit; ata që u përmenden më lart” (*Të permendunt kan tager*).

perpjesnue (me) 23 “ndaj një gjë pjesë-pjesë” (*Fitimi e rreziku i të bijve i perpjesnohet*²⁹⁹ *t’et e vllazenve*).

perpushë (me) 66 “me u zhgërrye për tokë; me u shkarravitë; me u shkalafendë; shpupurishet zjarri (me mashë) etj.” (*Perpushet zjarmi*); 89 (*Po u perpush dorëras*).

pershitë (me u) 52 “me u shitë disa herë” (*do të shitet e pershitet*).

pertejme (të) 63 “të mëtejme” (*permbas hetimeve të pertejme*).

pertek, -u 35 “tra i hollë; gërshërëz; mertik” (*Shpijat plangçore munden me pasë mâ se një pertek*³⁰⁰ */thuper/, qi u kanë mbetë trashigim*).

pertrí (me) 25 “me shtue pasurinë (bagëtinë etj.) në vijimësi” (*e pertrí gjâ të gjalla*).

pertríme (të) 25 “(pasuri) e shtuar në vijimësi” (*e posë gjâsë së gjallë të pertríme mbasi janë dá*).

²⁹⁸ *perkasí* është formuar nga folja (*me*) *perká* “(me) përkitë”; së pari *perká* + -s “ai që i përket (një diçka) dhe, më pastaj me prap. tjetër -i (*perkás* + -i) me kuptimin e “(pronës) që i përket dikujt; trashëgimia”.

²⁹⁹ *perpjesnohen* ngjan të jetë neologjizëm në ngjasim me tjetrën *përpjesëtohen*.

³⁰⁰ Me dyshim huazim nga sllavishtja (serb. *prut*, bullg. *prot* “purtekë”). Khs. edhe serb. *prutak*, përmes malazishtes lindore *prütúrk* etj. Shiko hollësitë e mëtejme te A. Omari *Marrëdhëniet* 245.

- pervarë (me u)** 104 “me u shmangë; u bën bisht vendimeve që janë marrë kundër tij, duke u përligjur e duke nxjerrë kleçka për t’i ikur vendimeve përkatëse kundër tij; anoj nga një krah padrejtësisht; *përvirem*” (kur t’i **pervaret** kush).
- perzivoj** 50 “lloj rrjeti për të zënë peshq” (*Peshku qi xêhet me rret, plumç, me perzivoj*³⁰¹ e kariqe).
- peshim, -i** 63 “”të peshuarit”; këtu e përdorur në mënyrë të figurshme për analizën që duhet t’i bëhet një personi kur ai kalon në sitën e gjykimit; pra do të peshohet (përkat. matet në kandar) në të gjitha anët e tij në mënyrë të drejtë” (gjindet në **peshim** para Perendís); 101 (*Nder gjyge e peshime*).
- peshue (me u)** 103 “këtu e përdorur në mënyrë figurative me tejbajtje kuptimi për veprimin që kryhet kur analizohet një faj i kryer” (*këta do të peshohen prej Pleqvet*).
- peshuem (të)** 12 “të mbajturit e fëmijës në pagëzim” (*në të peshuem në derë të kishës*).
- petk, -u** 13 “veshje” (*me petka vajzënjët*).
- picigiatë** 37 “*ndajf*. si të stërgjatur; i hollë e i gjatë e me majë në fund” (*prej gurësh të mdhaj picigiatë*).
- pistol/e, -ja** 54 “pistoletë, revolver; armë brezi” (*pistole*³⁰² të bardha).
- pjesnisht** 100 “pjesërisht; me pjesëmarrje jo të plotë” (*Kuvendet bâhen pjesnisht a edhe pergjithsisht*).

³⁰¹ Fjalë kryesisht e gegërishtes, por e dhënë ndër studiuesit e saj në trajta të ndryshme nga njëra-tjetra. E. Çabej (SE VI 181) nuk e regjistron si fjalë më vete, po e ndërkall te *pezaul* “rjetë peshkimi” dhe miraton prejardhjen që jep G. Meyeri (duke u mbështetur te trajtat *prezevoje prezivoje prezovoli*, që i gjen te Rossi e te Dozoni), dhe e shpjegon fjalën me të drejtë nga greqishtja e re *πεζόβολος*, po me një ndikim nga ana e serbokr. *preda* “pe, fije (leshi), rjetë”.

³⁰² G. Meyeri (EW 339) anon për një burim nga greq e re *πιστόλι* (kjo vetë nga italishtja *pistola*). E. Çabej (SE VI 234) është shprehur: “Burimi i kësaj fjale të përhapur kudo nuk dihet mirë: ose nga emri *Pistoia* të Italisë (khs. *breshanë*) ose nga çekishtja *pist’al* “llullë, gyp, pipëz”.

- plak** (katundi) 23 “kryeplak; koçobash” (*Me kenë plak katundit*).
- plaku (i pengut)** 94 “plaku që ka pranue pengun nga një njeri që kërkon zgjidhjen e një problemi; plaku që do të ndajë gjyqin për pengun e marrë” (*Plaku i pengut nuk mund t'i lypë të falmet e të premet e kanë, pa e ndreqë pûnen*).
- plang, -u** 14 “shtëpi banimi me gjithë truallin përkatës; vendbanim; *përgjith.* pasuri e paluajtshme” (*as më plâng, as më shpî*); 45 (*po kje e bleme me âme e me plang, thirret plangcore*).
- plangç/uer, -ori** 102 “ai që zotëron një plang” (*Plangçuer - tagruer*).
- plangçor/e, -ja** 45 “ajo që zotëron një plang” (*po kje e bleme me âme e me plang, thirret plangcore*).
- plangçore** 35 “ato (shtëpia) që përfaqësojnë plangun; që janë vetë plangu” (*Shpijat plangçore*).
- plangsue (me u)** 72 “me u bâ me plang; me fitue tagrin e plangut” (*qi të plangsohet kumbarija*).
- plangu (i shuem)** 26 “plang që nuk ka trashëgimtarë, sepse njerëzit e tij janë shuar” (*plangun e shuem do t'a dajn zbashkut*).
- pleqní** (e preme) 96 “vendim i formës së prerë” (*Pleqní e preme prej kanëit*).
- pleqt** (e të damit) 24 “pleqtë e caktuar për të bërë ndarjet e njerëzve në familjet e mëdha” (*Pleqt e të damit*).
- pleqt** (e flamurit) 37 “pleqtë e bajrakut” (*edhe pleqt e katundit, pleqt e flamurit*).
- plis, -i** 38 “copë dheu që ngre parmenda; copë dheu me bar; bucë” (*guri e plisi*).
- plumç, -i** 50 “një lloj mjeti artizanal, që përdoret për të zënë peshq” (*Peshku qi xêhet me rret, plumç, me perzivoj e kariqe*).
- plyrë (me)** 19 “me u lá në gjak; me u përlye me gjak; me u plirë” (*Me plyrë burri gruen*).
- poronik, -u** 34 “Betarë a poronikë njehen disa ‘dorë beje’, që do të përkasin Ungjillin, e disa tjerë lëhen për me ndigjue

- benë në kishë.”³⁰³ (*bén e ká me 12 poronikë*); 97 (*Porotë a poronikë*).³⁰⁴
- porot/ë, -a** 62 “Porotë a poronikë me gojë të Kanunit thirren ata njerz të cillt shênjohen me gisht prej gjygjit, per me bâ bé e me xjerrë së keq ndokend.”³⁰⁵ (*me i dhânë bé me porotë*).³⁰⁶
- posaçta (të)** 94 “të posaçme; të veçanta” (*per të kapme të posaçta*).
- prâ (me)** 70 “me pushue (gjithçka); me ra në heshtje (pas një lufte etj.)” (*pushka do të prâjë*).
- prak, -u** 92 “gur i gjatë a dru që vihet për së gjeri në fund të derës” (*të prakut*³⁰⁷ *t’eper të derës së shpís*).
- praptue (me)** 8 “me prapësue; me kthye mbrapsht; me prishë një punë të nisur që më parë; me prapë” (*të mos praptohet e mara e saj*).
- pré (me u)** 68 “me iu tradhtue miku kur ai ndodhet në besë të dikujt; me u vra ose me u plagosë pabesisht; duke mos respektuar besën e dhënë” (*Atij, qi i u pré miku*).
- pré, -ja** 17 “gjë e gjallë e grabitur me armë” (*m’u ra pré*).
- pregje-t** 92 “shum. i fjalës prag-u” (*e nder pregjet e krahvet të derës*).
- prém (të) fejet** 11 “të vendosë për fejesë (të vet)” (*e as në të prém fejet*).
- premet (të)** 94 “ata objekte a diçka tjetër që i janë dhuruar një personi sipas ligjeve të Kanunit” (*të falmet e të premet e kanûs*).

³⁰³ KLD 60.

³⁰⁴ *Poronik-u* “ai që shënohej për porotë”. Nga serb. *porotnik* “anëtar i porotës, betar”. Në shqipe ka ndodhur reduktimi (përkat. asimilimi) i grupit *tn* në *n* (A. Omari *Marrëdhëniet* 236).

³⁰⁵ KLD 97.

³⁰⁶ *Porotë-a* “juri e përbërë prej 24 vetësh”. Këtë fjalë e ka shpjeguar së pari N. Jokli. Nga serb. *porota* që në shek. XIV-XV njihej si “kuvend i gjykatësve” (A. Omari *Marrëdhëniet* 237).

³⁰⁷ Mendohet se është huazim nga serb. bullg. *prag* = sllav. e vjetër kishtarë *pragъ* (shiko hollësitë te A. Omari *Marrëdhëniet* 241).

premja (e) 48 “ashtu si e ka vendosë Kanuni” (*mbas së premes së kanunit*); 105 (**E premja** e shpís áisht kur t’i zhgulin gurët).

prémt (të) 68 “shiko te (e) premja” (*të prémt e mikut*).

pres/ë, -a 82 “shiko te (e) premja” (*i digjet shpija per presë*); 84 (*Presa në besë të gjås*).

pretar, -i 31 “njeriu që kryen prenë; ai që zihet duke rënë pré” (*500 grosh gjobë i mirren pretarit*); 79 (*flamuri i perkrahen pretárit*).

pretim, -i 67 “perfundimi i veprimit të foljes “me pretue” (*e pretime tjera*).

pretue (me) 23 “me ra pré; me marrë pré” (*me pretue / me marrë pré/*).

pretuem (i) 31 “që është dhunuar nga pretari; që është i pretuar; që i kanë rënë pré” (*berr a tufë të pretueme*).

pretuemi (i) 79 “ai që është grabitur nga pretarët; nga ata që i kanë rënë pré” (*I pretuemi nuk mund t’a pretojë*).

prîj/ë, -a 16 “drejtimi, udhëheqja; ftesa për të drejtuar diçka; kryet e vendit; të prirët” (*Prija*³⁰⁸ e krushqve s’luhet as ndrrohet); 95 (*e nen prîje të ksaj Dere*).

prîs, -i 81 “ai që prin; ai që udhëheq; ai që ka marrë përsipër drejtimin” (*gjakun e merr mbi vedi prîsi*).

prishunat (të) 110 “i gjithë malli etj. që shpenzohen me rastin e drekëve që bëhen për një vdekje; shpenzimet e varrimit” (*Të prishunat e drekvet*).

prit/ë, -a 81 “të ndenjurit fshehur në një vend për t’i rënë befaz armikut që vjen drejt teje ose për të plaçkitur dikë që do të kalojë në atë drejtim; vendi ku zihet prita; pusí-a” (*Prita*³⁰⁹ áisht një sjellje).

pritëtar, -i 82 “Pritëtarë janë ata, zyra e të cillve áisht me bâ hetimet e duhshme, tuj e rrethue kapucarin me të pvetuna të shpeshta, tuj i a vû menden, mos po bân lak nder

³⁰⁸ “Prîjen e krushqve lype e pvette e veç atij qi i perket, se s’ká burrë, qi mund të prîjë.” KLD 16.

³⁰⁹ “Prita áisht një sjellje, me të cillen malet e fushat e Shqypnís u vëjn pusijt gjaksorvet a kuejdo, qi të két menden me vrá.” KLD 81.

diftime e mos t'i zhgarkohet kuej.”³¹⁰ (*krisi pushka prej ânet të prîtëtarvet*).

prone-t 2 “pronë; pasuri” (*Pronet e pasunija e kishës*).

prozh/ëm, -mi 23 “pyll i vogël, që përdoret për të prerë dru; zabel; *korije*” (*prozhme*,³¹¹ *zabele*).

prû (me u) 20 “me u sjellë (mirë, keq etj.)” (*Po s'u prû grueja si duhet*).

pruejtun (i) 30 “i dhunuar” (*xêhet e thyeme edhe e pruejtun*).

prûm (me) 94 “me sjellë”; këtu e përdorur në mënyrë të figurshme “me e sjellë ndërmend; me e detyrue të mendojë ashtu si duhet e brenda normave morale të shoqërisë” (*per të prûm në mend*).

pullaz, -i 92 “pjesa e sipërme e shtëpisë që është e mbuluar me tjegulla; *çati-a*” (*sqeparin ... me e hjedhë mbi pullaz*³¹²).

punt/uer, -ori 8 “1. Falanik, që i shkon në ndihmë tjetrit pa shpërblim; 2. uhanik, punëtor të cilit puna do t'i shpërblehet me punë; 3. me pagesë, mëditës, argat; 4. njeri i rekrutuar kundrejt një shpërblimi në të holla për vrasjen e një tjetri. Sips Kanunit gjaku s'i mbetet ‘punëtorit’, por shtytësit.”³¹³ (*me çue gjinden e shpís per puntorë uhá*).

puntorët (e kishës) 4 “njerëzit që punojnë për llogari të kishës dhe që kanë status të veçantë” (*Me ngá kush puntorët e kishës, bjen në gjobë të famullisë*).

³¹⁰ KLD 99.

³¹¹ E. Çabej (SE VI 240), duke u nisur nga trajta që gjen te Bogdani (*ishin do prozhma*), e përqsas këtë fjalë me toponimin që del në Kadastrën e Shkodrës të vitit 1416-1417: *posto in luogo dicto Brostema* dhe mbi këtë lidhje të dy formave të fjalëve e bie të ardhur *prozhmë*-n nga sllavishtja: skr. *berst* “syth, bulë” *brstina* “gjethe”, bullg. *br̃vs(t)* “gjethe për bagëti”, sllov. *brst* “bulë, sythë, karthja” etj. Selishçevi nuk e llogarit ndër sllavizmat e shqipes. A. Omari (*Marrëdhëniet* 244), ka shprehur mendimin: “Nuk duket fort i sigurt si huazim nga sllavishtja”.

³¹² Fjala *pullaz* është identike me *pëllas* “pallat”, kjo nga lat. *palatium* (E. Çabej SE VI 250; aty edhe shpjegimet për ndryshimet fonetike përkatëse).

³¹³ K. Ulqini *Terma* 154.

puntorí, -ja 5 “të gjithë punëtorët së bashku; tërësia e punëtorëve” (*puntorís së kishës*).

pusí, -ja 81 “pritë” (*u vëjn **pusi**³¹⁴ gjaksorvet*).

³¹⁴ Huazim nga turq. *pusú* (nga *pusmak*) T. Dizdari *Fjalor* 780.

Q

- qel/ë, -a** 1 “bâna e priftit; banesa ku jeton prifti i famullisë” (*bâna /qela/ e famullitarit*).
- qeni** (i hekurave) 33 “Qëni i hekurave lshohet mbas darkësh, e rrîn zgjidhë mje që të dalë drita.”³¹⁵
- qerm, -i** 44 “ana pak e ngritur e një are, që e ndanë nga një arë tjetër; hendek” (*Me i çilë qerme tokës*).
- qes/e, -ja** 7 “trastë e vogël prej pëlhere a prej lëkure ku mbaheshin të hollat”, këtu është përdorur për njësi të hollash, pra për një sasi të caktuar parash, me të cilat kryhej një shkëmbim a blihej diçka (*njiqind qese*);³¹⁶ 85 (*do t’i lajë ... 22 qese per gjak*).
- qêth, -i** 13 “një dërrasë e rrumbullakët me bisht të gjatë ku vihet buka për ta futur në furrë; qehën” (*Shkuesi si të njëhë paret më qêthit*); 24 (*qêtha, vjedra /mjelca/, mtîj, vegsha, vorba, kuça*).
- qirue (me)** 8 “me zhveshë kallamoq; heq kokrrat e barërat e këqia grurit etj.” (*me mihë a me qirue*).
- qitë (me)** 87 “me qitë (pushkë); me shti me armë; qëlloj” (*Po qita mbë kend*).
- qortim, -i** 29 “ndreqja e gabimeve dhe e të metave; *korregjim*” (*Brimen e qortimin e zotnis do t’i kaperdijë rrogatari*).
- qúll, -i** 82 “miell i zier, i cili, si të trashet pak, përvëlohet me gjalpë a me vaj”; këtu është përdorur në mënyrë të figurshme “i la pa asnjë mbrojtje; e la vetëm” (*e lën në qúll*).
- qyshk, -u** 51 “kusht; konditë” (*Kanuni i tregtis a blen a shet pa qyshke*).

³¹⁵ KLD 33.

³¹⁶ Huazim nga turq. *qesé-ja* (T. Dizdari *Fjalor* 803).

R

randim, -i 60 “peshë”; përfundimi i veprimit i foljes “me rânduë” (*i nenshtrohet rëndimit të ndeshkimeve*).

razogj 102 “dy hae bukë”³¹⁷

regjë (me u) 94 “punoj lëkurët e kafshëve me shqeme e me mjete të tjera që të bëhen të përdorshme për këpucë e për punë të tjera; bëj turshi specia, kastraveca, domate etj.”, këtu e përdorur në mënyrë të figurshme me kuptimin: “stërvitem, fitoj përvojë për të kryer një punë të vështirë e të mërzitshme; mësohem për të bërë një punë jo të zakonshme” (*qi janë regjë ndër gjygje*).

rême-t 8 “enë bakri”; këtu e përdorur me zgjerim kuptimi: “me gjithë çka të kenë; me laçkë e me plaçkë” (*me ndrue ... rëmet*).

remët (e) 13 “që është prej remi (bakri)” (*prej një unaze të rêmët a të argjanët*).

rend, -i 43 “njëri pas tjetrit; sipas radhës” (*Po theu ujët e vís në rend*³¹⁸ *të huej*).

rendi (i vadës) 8 “radha e përdorimit të vadës së ujit” (*me ndrue ... rendin e vadës*).

rendtar, -i 47 “personi a personat që janë të shënuar të mbajnë radhën a rendin e vadës së ujit në kohën e vaditjes; ai që ka radhën e mullinit, të farkës apo të shërbimit në katund” (*do t’u lajë edhe dâmin rendtarvet*).

³¹⁷ KLD 72. Gazulli 344 jep këtë shpjegim: **razog-u** në Kanunin e Lekës: 1. Dukagjinasit kur pajtohen prej zotnie për punë, i thonë: të due kulaçin e xët me djáth, në nade tri rrojët e ditës, as zogun nuk t’a fal; as nuk t’a shes! Hakun t’a due grumbull! Zogu ishte pushimi me dy orë ditë, prandej kúr zotnia e harronte, thirrshin: *rá zogu, flutëroi zogu!* 2. Razogu = zâmër-a. 3. Razogjt ishin koniqet që i kishte detyrë i Mirditësi Derës Gjomarkajve, kur ndonjë kësi princash dilte me këqyrë gjendjen e popullit.”

³¹⁸ Huazim nga serb. *red* “rend, radhë, rregull” (A. Omari *Marrëdhëniet* 250).

res/ë, -a 97 “hidhërimi që ndjejmë për një të keqe që ka një dashamir yni e që do të kishim dëshirë ta ndanim me të, duke ia pakësuar dhimbjen; zili; smirë” (*prej ndo’i reset*).

reshë (me) 16 “drejton; mbarështron; kollonisë; e vë në hulli; administron” (*Krushka tue e reshë dashin*).

reshtë (me) 43 “me reshë” (*Me da e me reshtë ujët e vís*); 46 (*e per me reshtun ujët*).

reshunt (të) 108 “të mbarështruarit; të administruarit (e një pune)” (*të reshunt e ujit të mullíjvet*).

rid/e, -ja 73 “rizë e bardhë që vënë gratë në kokë; shami e bardhë” (*ride e kollçikë*).

rmore-t 43 “vend thik; shpat thik; tokë që ka rrëshqitur (tokë e rrëzuar); greminë me gurë që rrëzohen tatëpjetë; vend i mprehtë e me gurë që bien për tokë nga lartësia; rrëmore” (*neper prroje e rmore*).

rmue (me) 64 “me gërmue (tokën etj.)”; këtu e përdorur me kuptim të figurshëm: “do ta studiojnë e analizojnë problemin deri në imtësi, për të dalë në një përfundim të drejtë” (*do t’a rmojnë pa të ngutun*).

rob, -i 10 “pjesëtar i një familjeje; njeriu i shtëpisë” (*me i a shtue shpís një rob mâ teper*); 67 (*robët*³¹⁹ e *shpís*).

robí, -ja 5 “të gjithë robët së bashku; tërë njerëzit e shtëpisë” (*i djegun e i pjekun e i qitun me rob e robí*).

rojs, -i 33 “(qeni) që ruan shtëpinë” (*Steli ásht thâna e rojsit të shpís*).

³¹⁹ Huazim nga serb. bullg. (maq.) *rob, robinja* (A. Omari *Marrëdhëniet* 254).

RR

- rrâ (me)** 87 “me u sulë të gjithë së bashku; me ngá në grup; me vrapue në mënyrë të çorganizuar i madh e i vogël” (*rrâne me xjerrë gjân t’ande*).
- rradak/e, -ja** 39 “përgjith. kokë-a; rrashtë-a e kresë; kafka e kokës” (e me *rradake* të lamun).
- rrafgue (me u)** 80 “me kërkue andej e këndej për me zgjidhë një problem; me i dhënë zor vetes; m’u trazue; me u mundue” (*nuk âsht në detyrë të rrafgohet*).
- rrag/ë, -a** 69 “rrahje; me u hangër me fjalë; grindje; shamatë” (me shmangë *rragen*); 94 (*kan tager me shmangë çdo rragë*).
- rraqe-t** 28 “teshat e shtëpisë (gjithsesi pa ndonjë vlerë të madhe); rrangullat (e shtëpisë)” (*rraqe, çakla*).
- rrasë** (e ngarkueme) 39 “rrasa e gurit që vihej mbi shpatulla për caktimin e kufijve të largët” (e për të lar/g/tat bâhej gati *nji rrasë*).
- rrâz/ë, -a** 46 “rrëzë” (edhe votra me të rá aty; *rrâzë* kësaj do të kalojë vija).
- rrëjshme (e)** 63 “e rreme; e gënjeshtër; që bëhet në rrenë” (*tuj e lá me bé të rrëjshme nji nieri*).
- rrëjtë (me)** 37 “me mashtrue, gënjej” (*I bajsha n’at jetë, në kjosha tuj ju rrëjtë*).
- rrekë (me u)** 22 “lodh; mendoj; mërzit; sjell rrotull dikë dhe nuk i mbaroj punë; sillem kot; përpiqem për të zgjidhur një punë” (*Baba âsht në detyrë m’u rrekë*); 34 (*do të rreken në hetim*); 62 (*nuk ka tager me rrekë të pandehunin me bé të tjera*).
- rreng, -u** 62 “dëm a e keqe që i bëhet tjetrit tinëz, për inat a me djallëzi në kurriz të tjetrit” (*nuk t’a kam bâ at rreng*).³²⁰
- rrënim, -i** 16 “shkatërrim; prishje; përfundimi i veprimit të foljes ‘me rrenue’” (*M’u bâ rrënim m’udhë të madhe*).
- rret, -i** 50 “rrjet-i; thurimë zakonisht me spango, që përdoret për të zënë peshk”, këtu e përdorur në mënyrë figurative me zgjerim kuptimi; “të futurit në rreth; rrethim” (*Peshku qi xêhet me rret, plumç, me perzivoj e kariqe*).

³²⁰ Huazim nga turq. renk (T. Dizdari Fjalor 849).

- rreth, -i** 88 “fjala *rreth* këtu është përdorur në shprehjen (përkant. togun e fjalëvë) *i vun rrethin* me kuptimin e drejtpërdrejtë “e rrethuan” (*i vûn rrethin*).
- rrethas** 48 “rreth e rreth; njëri pas tjetrit në formë rrethi” (*do t’a dâjn rrethas*).
- rrethin/ë, -a** 34 “kufiri i pronës së një tjetrit” (*a në rrethinë të shpîs së huej*).
- rrgjanët (i)** 73 “i argjendë; që është ndërtuar prej argjendit” (*nji asper të rrgjanët*).
- rrgjane-t** 19 “zbukurimet prej argjendi që vinin gratë në parzëm a në qafë” (*rrgjanet e fytit*).
- rrjell, -i** 51 “rrill-i, lloj bime me gjethe të imta e lule të verdha, që lëshon një lëng helmues me të cilin helmohet peshku; me këtë mënyrë zihet më lehtë” (*Gjoja e peshkut me rrjell*).³²¹
- rrnes/ë, -a** 20 “rrojte; jetesë” (*atbotë rrnesen e vet*).
- rrogat, -i** 29 “personi që është pajtuar diku në punë me rrogë” (*Zotnija ka urdhnesen, rrogatari ndigiesen*).
- rrogue (me)** 11 “me marrë rrogë; me punue me rrogë; me derdhë mund e djersë; punoj papushim” (*me i rrogue pa zhibla*).
- rrokë (me)** 39 “kap me dorë dhe e shtrëngoq fort” (*rroki latushën /spaten/ e hijnë bjeshkë të huej*).
- rrokull** 44 “rrotull” (*Rrokull vjetit*).
- rrshânas** 14 “ndajf. duke e tërhequr zharg; duke e tërhequr zvarrë” (*nusen ... zhargas e rrshânas do t’a çojnë në shpî të dhandrit*).
- rrshanaz** 39 “rrshanas” (*tuj u rrxue rrshanaz*).

³²¹ Te Gazulli 357 del folja (*me*) *rrilue* me kuptimin “me helmue peshqit me rrill”. Po aty jepet: *rrill-i* “emën që përfshin farën e *Euphorbiaceae* (me përdorim në Shkodër e në Sapë), e gjithashtu “2. *rrill* peshk” (e përdorur po në Sapë). Trajta e parë a primare e kësaj fjale jepet te Çabej: *rryell-i* “*Euphorbia*, qumështore”. Çabej shënon se *rryell* e *rrill*, së bashku me trajtat e tjera dialektore, është fjalë e mbarë gjuhës, duke e lënë varë etimologjinë e saj (SE VI 337).

rrshiq, -i 44 “rrësheku i kovaçit; gjyryku; mjeti që përdoret nga kovaçi për t’i fryrë eshkës kur skuq hekurin” (*Rrshiqi*,³²² *frysi, kullma e të tjera vegla janë të farkëtarit*).

rrudhë (me) 91 “mbledh dhe e bëj me rrudha”; këtu e përdorur në mënyra të figurshme: “me kufizue e me pakësue veprimet e kundërshtarit; me i zvogëlue mundësitë për veprim” (*me u a rrudhun pëjt*).

rrûm, -i 44 “kalliri i kallamoqit, zakonisht i zhveshur” (*nder koteca rrûm a kallzë*).

rrûmbull 17 “tërësisht; rrumbullak; lëmsh; shuk” (*Dashin 12 okësh rrûmbull*).

³²² *rrshiq* është shumësi i singularizuar i *rr/ë/shek-u* “lëkurë dhie për të mbajtur vaj, verë e bulmet; gjyryku i kovaçit”.

S

sahat, -i 80 “orë” (*Knduesi është herori /sahati*³²³ i të vorfnit).

sân/ë, -a 25 “bár i thatë” (*Grazhdi - sâna*³²⁴ e kashta).

sedij/e, -a 62 “leksikalizim i fjalisë *s’e di*, që përdoret prej atyre dëshmitarëve që deklarohen se nuk e dinë çështjen për të cilën pyetën a japin shpjegime” (*Maja e bës është “sedija”*).

simahor, -i 77 “ai që i lehtëson punën a i sheshon rrugën një vrasjeje a një vjedhjeje; ndërmjetës në këto veprime”³²⁵ (*Simahorët*³²⁶ janë ata).

sjell/ës, -si 101 “ai që ka sjellë armën në kuvendin e burrave në mënyrë të fshehtë; pra jashtë rregullave të vendosura” (*sjellsi i armës*).

skam, -i 71 “varfëri e madhe; varfëri e tejskajshme” (*vetem prej skamit*).

skep, -i 105 “cak; qoshe; anë” (*t’i zhgulin gurët e kater skepeve*).

sod, -i 109 “sot; në këtë ditë që jemi” (*Per të mirë mbas sodit*).

³²³ Huazim nga turq. (arab) *sa’át* (T. Dizdari *Fjalor* 858).

³²⁴ Huazim nga serb. /bullg. *seno* “sanë”. Mbahet si një ndër sllavizmat e vjetra të shqipes, për shkak të zanores së rrënjës /a/ që reflekton shqiptimin e sllavishtes juglindore (eä), që në kohë më të vjetra dallonte edhe të folmet më perëndimore të bullgarishtes, por më anë tjetër nuk ka pësuar ndërrimin *s > sh* dhe është e kufizuar gjeografikisht në Veri. A. Omari ka shprehur mendimin se “Gjithsesi refleksi sllav. *ě > shq. a* është problematik (A. Omari *Marrëdhëniet* 262).

³²⁵ “Simahuer është aj, i cili i ep dorë dorërasit, tuj i ndimue a në vrasë a në vjedhni a në të kryem të çdo mbrapshtije tjetër.” KLD 83.

³²⁶ Sipas N. Joklit është një zgjerim me *-uer -ori*, e semantikisht me një specializim (keqësim) të kuptimit, i greq. σίμμαχος “bashkëluftëtar, shok armësh”. Fjalë e administratës bizantine, po, si shënon ky dijetar, për punë të ruajtjes së *-s-së* si e tillë e të reflektimit të *u-së* greke si *i*, huazim i marrë jo para shek XI, afërsisht ashtu si *fis* (shiko E. Çabej SE VII 14).

sodumë (me) 85 “me shkatërrue kulm e themel; me rrafshue për tokë gjithçka; me qitë fare; me zhbî; me asguesue” (*e sodumë*³²⁷ *pasunin e dorërasit*).

sqepar, -i 92 “vegël dore që përdoret prej mjeshtrave (kryesisht marangozë e karpentierë) për të gdhendur drurin dhe për të ngulur e hequr gozhdë” (*sqeparin ... me e hjedhë mbi pullaz*).

stel, -i 33 “kasollja e qenit” (*Steli është thâna e rojsit të shpís*).

sterdá (me u) 25 “me u ndá per së dyti; pasi të jenë ndarë njëherë; me u rindarë pasuria” (*u mbushte mendja me u sterdá*).

sterkqí-të 59 “që janë më përtej se të këqijtë e zakonshëm, pra përtej tyre a dy herë më shumë” (*Fjalët e sterkgíve kanëjua s'i merr para sýsh*).

stermarrë (me) 52 “me marrë mbrapsht një objekt a send që është shitur njëherë” (*e bân shitsin qi t'a stermarrë*); 94 (*nuk mund t' u a stermarrin*).

sternip, -i 15 “djali i nipit; pasardhësit” (*Nipa e sternipa*).

³²⁷ Folja *me sodomë* është deverbativ, formuar sipas Biblës, ku flitet për shkatërrimin e qytetit që mban emrin *Sodomë-a*. Në Bibël shkruhet: “... atëherë Zoti lëshoi mbi Sodomën e Gomorrën, në formë të shiut, sulfur e zjarr. Ata binin prej Zotit, prej qiellit. I zhbui ato qytete dhe krejt krahinën përreth, të gjithë banorët e qyteteve dhe krejt bimësinë mbi tokë”, *Zanafilla* 19 (24, 25, 26). BIBLA (*Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re*), Ferizaj 1994, f. 39. Folja *me sodomë* (përkat. edhe *me sodumë*), emri *sodom-i* (*sodum-i*) dhe mbiem. (*i, e*) *sodomun* (*sodumun*) dalin të *Fjalori i Bashkimit*, f. 402. Ngjan që këto fjalë të jenë përdorur për herë të parë nga klerikë, që e njihnin mirë Biblen, sepse te *Bashkimi* nuk u jepet shpjegimi në shqipe, po vetëm në italishte. Këto fjalë nuk dalin as në *Fjalorin etimologjik* të G. Meyerit (1891) dhe as në *Fjalorin* e Kristoforidhit (1904). Në *Fjalorin* e Busettit këto fjalë do të dalin më të qarta në përkthimin e ital. *annichilare* “me farue, me sosë, me qitë fare, me shqýmë, *me sodumë*, me fikë, me qilisë” (*Vocabolario italiano-albanese*, compilato dal P. Antonio Busetti SJ, Scutari d’Albania 1911, f. 67).

sterplak, -u 85 “plaku i lagjes; plaku i dytë në një pleqni”³²⁸
(*kryeplak a sterplak*).

stershitë (me) 52 “me e shitë për së dyti; pra, mbasi ta kesh shitur një herë” (*t’u mbush mendja ty me e stershitun*).

stolisë (me u) 13 “me u zbukurue kur bëhet nuse” (*nuk mund të stoliset si nuse*).

strafulec, -i 15 “ai që shërben në dasëm; shërbëtor dasme.”

strajc/ë, -a 48 “një qese e madhe me një gjalmë sipër për t’i mbyllur grykën dhe për ta varur në sup a diku tjetër, ku futen gjëra të ndryshme, buka etj.; *torbë; trastë*” (*strajcën e bukës*).

strapleqni, -ja 23 “të qenët *stërplak*; të ushtruarit e kësaj detyre” (*djalit të vllaut të parë i perket strapleqnija*).

strapleqt 95 “*shum. i sterplak-u*; pleqtë e dytë në një gjykim” (*strapleqt e katundit*).

strofull, -a 78 “vendi ku rrijnë e flejnë kafshët e egra” (*bâhet strofull cubash*).

strofullue (me) 78 “me strehues gjân e vjedhun; me e fshehur atë” (*Kjori; e është ai që e strofullon*).

strukë (me u) 84 “fshihem në një vend për t’u mbrojtur” (*e aty, ku t’a çelë drita, të struket*).

sumbull, -a 69 “pjesë e shpatullës së mishit të pjekur” (*do t’i a thejë sumbullen*).

sundim, -i 7 “të sunduarit; zotërimi; drejtimi në mënyrë absolute e pa pyetur njeri; drejtimi i familjes patriarkale sipas rregullave të Kanunit” (*sundimi i shpís*); 11 (*Gruaja a në detyrë: me i ndëjë nen sundim*³²⁹).

³²⁸ Sipas K. Ulqinit (*Termat* 156) “**Stërplak**: në Kurbi e në Mirditë thirreshin kështu pleqtë e lagjeve. Këta edhe luanin rolin e jobarëve. Në Mat qe plaku i dytë në pleqni.”

³²⁹ Tema fjalëformuese e foljes *sundoj* është huazimi sllav *sund*. **Sundi, -ja** “zot, sundimtar” si titull jobizantin vjen nga sllav. *sodija* “gjykatës” (shiko hollësitë te A. Omari *Marrëdhëniet* 280).

SH

shakull, -i 19 “lëkurë bagëtie, e tharë dhe e regjur, që përdorej si thes për të mbajtur groshë, raki etj.; calik”; këtu e përdorur në mënyrë të figurshme (metaforë “si shakull”). (*Gruaja është shakull për me bajtë*).

shat, -i 24 “vegël (dore) që përdoret për punë të ndryshme bujqësore; shum. sheten” (*sheten, kosa, kmesa*).

shaterkaz, -i 43 “një lloj capi i madh me bisht të gjatë, në njërën anë është si shat, në tjetrën me dy cepa” (*Shaterkazi e luen udhen*).

shburrnue (me u) 58 “me ngelë pa burrní; pa dinjitet; pa personalitet e pa integritet. Me humbë të gjitha tiparet e cilësitë e të qenurit burrë” (*jë i lirë me u zhburrnue*).

shêj, -i 13 “objekti që i dërgohet vajzës prej anës së burrit kur bëhet fejesa; merqer” (*per me çue shêjin në natë të dame*).

shêj (i hupun) 14 “shenji i fejesës, kur vdes dhëndri, quhet i hupun. Në këtë rast Kanuni e liron vajzën nga çdo pengim i mundshëm për të kryer një martesë të re” (*me dekë dhandri, shêji xêhet i hupun*).

shek/ë, -a 24 “enë e drunjtë që përdoret për të mbajtur kryesisht djathin; enë e drunjtë ku hanë bukë barinjtë në stan; masë drithi (shinik); shekë-a” (*vozga, govixha, fuçija, sheka*).

shemtim, -i 85 “shkatërrim; shpërfytyrim i pamjes së një sendi duke e ndërruar atë për të keq; që nuk shihet me sy” (*i mirë a shemtim*); 16 “që nuk shihet me sy, sepse është i frikshëm e i çoroditur për të parë; i keq e i mbrapshtë nga duka” (*e edhe fmî e shêmtim për sý me kênë*).

shemtueshme (e) 105 “që është i shkatërruar keq; që ka një pamje krejtësisht të padëshirueshme e të vrazhdë për syrin” (*Po kje mbrapshtí teper e dhunshme e e shemtueshme*).

shengjet/ë, -a 48 “pjesa që i përket atij që ka vrarë (i pari) gjënë në gjojë; pjesa e caktuar paraprakisht për të; çmimi për pagesën e një gjaku me para” (*Shengjeta perbâhet prej mushknîsh, e kaptinet...*).

- shênjim, -i** 59 “përfundimi i veprimit të foljes ‘me shenjue’” (*Shênjimin e fuqin e fjalës*).
- shest/ë, -a** 46 “kompas; përgjel”, këtu e përdorur me zgjerim kuptimi: “me e vû në një vegël për të përcaktuar masën e asaj (pune a çështjeje), që shtrohet për diskutim” (*Ku t’i bie shesta*).
- shetue (me)** 46 “me hartue planin e një veprimi; me bâ projektin e një pune; ravizoj në vija të përgjithshme; me sendërgjue; me sajue” (*Si të shetohet të kaluemt e vís*).
- shi** 69 “tamam; bash aty ku duhet; në mjedis të ...” (*shi në trevezë*).
- shis/e, -ja** 7 “shqise” (*zhvillimi i mendes e i shisesh*).
- shitue (me)** 49 “me plagosë me armë” (*qi e shiton shpëzin*); 86 (*kush të shitojë nieren*).
- shituem (i)** 49 “i plagosur” (*shpezi i shituem*).
- shituemja (e)** 86 “plagosja (kryesisht me armë zjarri)” (*E shituemja shkon mbas kerçikut*).
- shkall/ë, -a** 41 “shkëmb (zakonisht në trajtën e shkallës); shkëmb i thepisur” (*as në shkallë*).
- shkapercye (me)** 84 “me kalue nga një anë në një tjetër; kapërcej; kaloj” (*e pa shkapercye caqet e dame*).
- shkepë (me)** 104 “shqep; shkëput; këpus një copë nga një trup; ndaj nga një e tërë (kryesisht për objektet); *shkap*”; këtu është përdorur me kuptim të figurshëm edhe për një njeri që ndahet nga turma (*Me shkepë një shpi*).
- shkmesë (me)** 40 “këmbej; ndërroj; i jap dikujt një gjë dhe i marr një tjetër; *shkëmbej*” (*ka tager me e shkmesë*).
- shkmye (me)** 8 “shiko te (me) shkmesë” (*çdo send a gjâ qi do të shkmehet*).
- shkrepë (me)** 90 “mos me i marrë zjarm arma e vjetër me gur; mos me iu ndezë baruti i armës; me i bâ çep pushka” (*shkrepë pushka*).
- shkrepmja (e)** 89 “kur arma e drejtuar ndaj dikujt, nuk ndizet, megjithëse i zoti i saj ka shtënë” (*E shkrepnja ka gjobë*).

shkreput (të) 33 “përplasja e dy trupave, prej së cilës dalin shkëndija”; këtu e përdorur në mënyrë të figurshme për daljen e diellit” (*Të shkreput dielli*).

shkues, -i 10 “ai që ndërmjetëson, që lidhë me fejesë dy vetë; *shkesi*”³³⁰ (*me shenjue shkuesin*); 12 “Shkues thirret njaj, i cilli rreket m’u bâ fjalë-mirë a te prindja e djalit a te prindja e vajzës, qi të marrin a të napin vajzën per at djalë.”³³¹

shkuesi (i gjakut) 91 “Shkues i gjakut thirret aj, i cilli perpiqet te shpija e të vramit, per me e pajtue dorërasin.”³³²

shkuesi, -ja 12 “veprimi që kryen shkuesi” (*Shkuesi ka tager mbi 50 grosh të shkuesis*).

shkuesija (e gjakut) 91 “veprimi që kryen shkuesi per pajtimin e gjakut.”

shmangë (me) 94 “me u tërheqë; me u largue prej një vendi pa u vënë re mirë; me u largue me kujdes” (*kan tager me shmangë çdo rragë*).

shnjerzim, -i 110 “përfundimi i veprimit të foljes *shnjerëzoj*: me krye veprime që ishin jashtë moralit të asaj kohe; me krye veprime që kishin lidhje me nderin e malësorëve; me thye a me nëpërkëmbë normat morale e kanunore të asaj kohe siç është fyerja ndaj tjetrit, rreptësisht e ndaluar e që lahej vetëm me gjak” (*sjellje shnjerzimi*).

short, -i 49 “rënia e një gjëje kur ndajmë diçka; rënia në pjesë” (*e qesin short*).

short/e, -ja 53 “*shiko* te short-i” (*shortja e zabelit*).

shpatull, -a 69 “secila nga të dy eshtrat e gjera në formë të një lopate trekëndëshe, që formojnë djathtas e majtas pjesën e sipërme të shpinës; vendi i trupit rreth shpatullës”, këtu bëhet fjalë për shpatullën e bagëtisë së pjekur në hell, e cila sipas mendësisë së asaj kohe, tregonte fatin a të ardhmen e njerëzve” (*e mikut shpatulla*).

³³⁰ K. Ulqini *Terma* 156.

³³¹ KLD 12.

³³² KLD 95.

- shpêz, -i** 48 “*shumësi i singularizuar i em. shpend-i*” (*Shpêzi i vramë*).
- shpifë (me)** 105 “trilloj e përhap fjalë të paqena me qëllim për të dëmtuar tjetrin e për të cënuar nderin e tij” (*i shpifet në pûnë të randë*).
- shpifuni (i)** 98 “personi i paditur në gjyq; i akuzuari; i pandehuri, që nuk i është provuar ende fajësia” (*i shpifuni mundet me fjetë në qetësi*).
- shpija** (e thyeme) 30 “shtëpia që dhunohet; shtëpia që vidhet a që cënohet sadopak prej dikujt tjetër” (*Po u shtyne e çile deren, shpija xêhet e thyeme dhe e prûjtun*).
- shpijak, -u** 7 “ai që rri më tepër në shtëpi; ai që merret me punët e shtëpisë; shpijar” (*zgjidhet kuvendisht prej shpijakve*).
- shpijâr, -i** 83 “shiko te shpijak” (*i ep dorërasit e shpijarvet të tij*).
- shporrë (me)** 8 “heq qafe; largoj; dëboj; përzë” (*per me shporrë shnjerzimin*).
- shprazë (me)** 81 “derdh një enë a diçka tjetër që është e mbushur; largoj njerëzit nga një shesh i mbushur; shkrep pushkën etj.; zbraz”, *anton. i mbraz* “mbush” (*sa pushkë qi të shprazen*).
- shqarth, -i** 49 “kafshë e vogël grabitqare që ha pulat, është e murrme, grykën dhe gjoksin e ka të verdhë dhe ka vetinë të hidhet me lehtësi nepër degët e pemëve (*Mustela martes*)” (*shqerth a vjetulla të ndjekuna*).
- shtat, -i** 88 “këtu me kuptimin e figurshëm, ‘flagrancë’ në punë të këqija” (*Ata qi kan shtat e dhûnë bashkë*).
- shtatxânë** 89 “shtatzënë; (grua) me barrë” (*gruen me shtat xânë*).
- shtâz/ë, -a** 31 “kafshë” (*Po u vodh shtâza*).
- shtektar, -i** 16 “ai që shtekton; ai që bën rrugë” (*aty do të kalojë shtektari*).
- shtëme (e)** 69 “e shtënë; që është shtënë (me armë); të qëlluarit (me armë)” (*Pushka e shtëme per mik të prêm nuk ká gjobë*).
- shtoj/e, -a** 26 “të shtuarat; (ato që) shtohen” (*e shtojet e gjâs do t’i dajë*).

shtrue (me u) 76 “vihen në gatishmëri për të zënë kafshët e egra; ngrifen dhe bëhen gati për punën që do të kryejnë” (*Kurtha **shtrohet** me të mârrme të diellit*).

shtÿ (me u) 86 “me kalue masën e lejuar në përdorimin e fjalëve të rënda a që çënojnë nderin e integritetin e bashkëfolësit” (*nuk mund të **shtÿhen** në fjalë*).

shthurun (i) 76 “që nuk është i thurur; që i është prishur e thurmja” (*në kopshtë të **shthurun***).

T

tag/ër, -ri 7 “një e drejtë e ligjshme; një e drejtë e vendosur me ligj; një e drejtë që i takon sipas normave morale të kohës” (*I zoti i shpís ká tager*).

tagr/uer, -ori 102 “që është me tagër; që i takon e drejta e ligjshme; që është plangçuer; që është vendës i vjetër; autokton” (*Plangçuer - tagruer*).

tamz, -i 73 “tamth-i” (në *tamza* ka një çubë).

tatgjysh, -i 37 “babagjysh” (si më ka pas kallxue *tatgjyshti*).

tbân/ë, -a 33 “kasolle barinjsh në bjeshkë; vendbanim; shtëpi banimi e vogël e njëkatëshe; *tëbanë-a*; këtu me kuptimin ‘shtëpia e qenit’” (*Steli është tbâna e rojsit të shpís*).

tej/ë, -a 75 “tojë; tërkuzë që e përdornin gratë për të ngarkuar diçka në shpinë” (*këmesa e terkuza /teja/ i mirret*).

teloz/en, -na 103 “taksë që merrej kryesisht për tokën” (*të dheta e telozen*).³³³

tepsî, -ja 53 “enë zakonisht prej bakri, e rumbullakët dhe e përfushtë, me buzë pak të ngritura, që shërben për të pjekur bukë etj. në furrë” (*Tepsîja*³³⁴ e mirë).

terkuz/ë, -a 24 “litar që e përdornin gratë për ngarkesë; shpesh tërkuzë, me që kishte përgjithësisht të njëjtën gjatësi, përdorej edhe si njësi matjeje, veçanërisht në

³³³ E. Çabej (SE VII 103) miraton mendimin e G. Meyerit (EW 426) për prejardhjen e kësaj fjale nga greq. e re τέλος “fund, mbarim, vendim; tatim, haraç; mbase nëpërmjet të turqishtes”. Fjala përdoret zakonisht në shumës. Njëjësi *telozën* është shumës i singularizuar. Del kjo fjalë që të autorët e vjetër të shqipes. Më e sakta fonetikisht është ajo që përdoret te Bogdani *me paguem tellosnë Cesarit* “pagare il tributo a Cesare” (K. Ashta Lek. IV 360).

³³⁴ Huazim prej turq. *tepsi* (E. Çabej SE VII 104). Khs.edhe T. Dizdarin *Fjalor* 1021. Është ndër më të parat e më të vjetrat e huazimeve turke në gjuhën shqipe. Dokumentohet që te autorët e vjetër të shqipes. Te Buzuku *ish prûm kryet e Gjonit Batistë ndë tepsit* (*Meshari* LXXIX/1 341). Del kjo fjalë edhe në fjalorin e Da Lecces 831 *tepsî* “tegghia; tiella di rame”.

ndamjen e tokave etj.”³³⁵ (*ograja, prozhme e zabele do të dahen me tërkuzë*); 75 (*këmesa e terkuza /teja/ i mirret*).

termal 46 “*ndajf*. “nga poshtë lart; përpjetë” (*termal e teposhtë*).

terthorzue (me) 41 “i bie tërthori; e përshkoj rrugën jo drejtpërdrejt” (*nuk do ta terthorzojsh*).

testamend, -i 22 “testament; dokument zyrtar, me të cilin dikush përcakton se kujt ia lë pasurinë pas vdekjes; këtu kjo fjalë është përdorur me kuptim të figurshëm: amaneti që lë dikush para vdekjes; *të lanunat*” (*mos me bâ testamende*).³³⁶

³³⁵ Në fshatin Curraj-Eper, Malësi e Madhe “pesë konopë” thuhej për të treguar masën e largësisë a të lartësisë, krahasuar me gjatësinë e (tërkuzës) a konopit që përdorej për ngarkicë.

³³⁶ Fjala *testament* ngjan të jetë përdorur prej Gjeçovit si term juridik, të cilin vendësit nuk ia kanë ditur as emrin dhe as nuk do ta kenë dëgjuar ndonjëherë. Ndërkaq, Gjeçovi, vë pranë fjalës *testamend*, tjetrën të përdorur po si term kanuni: *të lanunat*. Kemi, pra, një neologjizëm të përdorur nga Gjeçovi në mënyrë të ndërgjegjshme, për të sqaruar juridikisht termin që përdor kanuni (*të lanunat* = *testamend*). Shiko për këtë “Kapitullin e nandët”, f. 27.

Në trajtën *testament* (me grupin -st- të pakthyer në -sh/t/- dhe me fundoren -nt të ruajtur) ngjan si fjalë librash, e huazuar nga ital. *testamento* me të njëjtin kuptim. Ndërkaq trajta e kanunit (si edhe sot e kësaj dite edhe e Gropës së Shkodrës) *testamênd* me zhvillimin e fundores -nt në -nd; ngjan të jetë huazuar nga lat. e vonë a italishtja e vjetër (khs. -st > -st e jo -sht). Khs. këtu lat. *conventus* : shq. *kuvend* ; lat. *contentus* : shq. *kondend* etj.

Fjala *testament* del që te autorët e vjetër të shqipes. Te Buzuku e me ùa rekorduom n *testamentit shenjtë së tî* (Meshari II, IX/1, f. 13). Te Budi *testament* “a mos kishnje shtrembuom a rrenë kund ndonjë *testament*” S 143 (K. Ashta Lek. II 295). Te Fr. Bardhi 179 “lat. *testamentum* : *testament të lanë*” (K. Ashta Lek. III 273). Te Bogdani *testament* (K. Ashta Lek. IV 361). Po kështu edhe te fjalori i Fr. Maria da Lecces 832 *testament* për ital. *testamento*. Ndërkaq te fjalori i Bashkimit 455 del trajta me -nd fundore *testamenn*, ku nn përfaqëson nd. Me këtë trajtë do ta gjejmë ital. *testamento* të përkthyer *testamênd-i* edhe te fjalori italisht-shqip i Busetit 1058.

- tëhjek/ës, -si** 81 “ai që tëhjek; personi që shtie me armë; që tëhjek kambëzën” (*tëhjeksi bien në gjak*).
- tëhjekë (me)** 86 “me tërhjekë; me ngrehë” (*i cilli tëhjiqte*).
- tinëz** 30 “fshehtas” (*kur çohet një njeri bâkeq tinëz*).
- tlyen, -i** 8 “lënda (yndyra) që nxirret nga qumështi i rrahur; gjalpë-i” (*Me dhânë ... tlyen*).
- tok** 6 “së bashku; të gjithë bashkë e të pandarë, grupbashkuar” (*do të mblidhet tok*).
- trajtue (me)** 46 “me ndreqë një shtëpi të re; me ndërtue një shtëpi” (*e të mbushet mëndja me trajtue shpín nder shêje të vís*).
- trap, -i** 45 “mjet primitiv për të kaluar një lumë, ndërtohet zakonisht me trarë të lidhur ndërmjet tyre, ose të mbështetur në dy barka (sule)” (*te kroni e te trapi*).
- trazim, -i** 84 “përfundimi i foljes *me trazue* ‘mos me e lanë tjetrin në punë të vet, por me i ndërhy do e kurdo; e ngacmoj duke i prishur rehatin e vet; i prish terezinë’” (*mos t’i shkaktojnë dâme as trazime*).
- tregtor/e, -ja** 2 “dyqan ku shiten mallra të ndryshme” (*farkës e tregtores nuk i pritet kush mik*).
- trevez/ë, -a** 66 “sofër e asaj kohe ku shtrohej buka; një dërrasë e sheshtë rumbullake me dy mbajtëse, rreth së cilës uleshin këmbëkryq njerëzit për të ngrënë” (*Me koritë trevezen*).
- trillue (me)** 95 “me sajue diçka prej vetes; sëndërgjoj a shestoj gjëra që nuk janë” (*qi të mos trillohen pûnë të reja*).
- trimnue (me u)** 16 “trimërohem; bëhem trim” (*Me bâ me u trimnue kush*).
- trokllue (me)** 4 “trokas (në derë); trokëllij” (*do t’i trokillojë kuej te dera*).
- trung, -u** 66 “një copë dru (trung) zakonisht i latuar, që përdorej si jastëk” (*zjarmi e trungu e do firi*).
- trupue (me)** 39 “i pres një druri degët e rrënjët dhe e bëj trup; e cungoj; e bëj cung” (*më gjejnë tuj trupue arrnej të perhjedhun*).

tû, -ni 39 “ana e sprasme e sopatës, me të cilën godasim” (*edhe i dha spatës tuj e ngulun mje më tû³³⁷ në trup të armënët*).

tub/ë, -a 62 “shumicë; grumbull; tërë së bashku; tufë” (*i mbledhë tubë*); 82 (*nji tubë burrash*); 17 (*tubë cubash*).

tuf/ë, -a 31 “bashkësia e deleve që dalin në kullotë të prira nga oghiçi dhe të ruajtura prej bariut” (*a tuj pretue tufen*).

tumirë (me) 60 “jap pëlqimin për kryerjen e një pune; pranoj” (*as s’e tumirë*); 99 (*Si të tumiret kapucari*).

tundue (me) 4 “trazoj; mërzit; e shtyj me qëllim në rrugë të gabuar; ia vë në dyshim mendimet” (*zëhet se tundon Famullitarin*).

turr/ë, -a 88 “grumbull; stivë (drush)” (*turra drush*).

turrë (me u) 33 “me u vërsulë; me iu hjedhë sypri; i derdhem; sulmoj” (*Po t’u turr qeni*).

tutun (i) 27 “i frikësuar” (*mos të jet i tutun prej kercnimit*).

tym, -i 2 “shtëpi; familje; votër” (*t’i a u ketë dá të gjithve per tym*).

³³⁷ Fjalën *tû-ni* Desnickaja e bie si sllave: bullg. *tune* “më kot, huq”. Me këtë shpjegim emri duhet të shënonte pjesën e mbrapme apo të papërdorshme të veglës. G. Svane shpreh dyshimet e tij për etimologjinë e kësaj fjale edhe për faktin se rrënja **tun* nuk gjendet në serbishte dhe ndërtimi substantiv nuk del në asnjë nga gjuhët sllave (shiko hollësitë te A. Omari *Marrëdhëniet* 86 v).

TH

thad/ër, -ra 24 “njëfarë teske e ngushtë e me dy presa, nga të cilat njëra është si çdo teskë e tjetra si daltë, përdoret për të shpuar vrima në vegla druri” (*kiza, sharra, thadra ...*).

thek, -u 20 “xhufkat e holla që varen varg në fund të një petku etj.”; këtu e përdorur me tejbajtje kuptimi: “divorc, ndarja e gruas” (*i pritët theku*).

theku (i prém) 20 “prerja e thekut është veprimi që tregon se burri e ka lëshuar (përk. ndarë) gruan e vet” (*Po s’u prû grueja si duhet te burri, kanëûja i nep lêje me i pré thekun a flokun e me e lshue*).

themelta (të) 97 “që janë me baza të forta ashtu si themeli; që janë të arsyetuara deri në një” (*arsye të themelta*).

thí, -u 49 “derr-i” (*thiut t’eger*).

thirc, -i 15 “personi që në emër të dikujt shkon e thërret njerëzit në dasëm.”

thurmja (e) 44 “të thururit” (*Të thurmën e tokve e ká bulgu*).

U

- udha** (e verbët) 41 “rruga (udha) që nuk të qet askund; rruga që nuk ka fund; që nuk mund të kalohet tërësisht, sepse është e mbyllur në fundin e saj, prandaj është e pakalueshme” (*mbas kanûnit, udha e verbët, po kje në kater kufijt t’ue, ndryje e tokën punoje*).
- udhtar, -i** 54 “ai që udhëton; ai që bën rrugë; rrugëtar” (*Udhtari*³³⁸ i paguem).
- uhá, -ja** 8 “hua-ja; borxh-i; një diçka që është marrë borxh e që duhet kthyer në afatin e caktuar në marrëveshjen e bërë ndërmjet dy vetëve” (*me çue gjinden e shpís per puntorë uhá*); 28 (*Me pasë lanë uhá*).
- uhajtë (me)** 81 “me marrë borxh; me marrë uhá; me huajtë” (*Po e uhajti kush pushken*).
- uhás, -i** 70 “ai që merr borxh te një tjetër” (*uhásit s’i prishet gjá*).
- uhazisht** 36 “të huazuar” (*uhán e miellit e ka uhazisht me katund*).
- uhazishte** 83 “uhazisht” (*Tuj kenë një nevojë uhazishte*).
- ujatore-t** 15 “gra të caktuara për të mbushur ujë; gra që mbushin ujë për t’ua dhënë punëtorëve.”
- ujem, -i** 47 “haku që i paguhet mullisit për bluarjen e bereqetit”; kjo pagë zakonisht paguhet nga bereqeti i bluar (*Ujemi*³³⁹ i blimit).
- um, -i** 80 “thika e parmendës që then tokën; *pluer; umb-i*” (*per um të vjedhun*).
- un/ë, -a** 9 “një copë dru që është pjesërisht i ndezur, *urë*” (*Ka tager me prî me unë zjarmi*); 74 (*me flakë t’únës së pishës*).
- ungj, -i** 15 “xhaxhai; axha; i vëllai i babait”; 17 (*10 grosh ungjit të vajzës*).

³³⁸ “Udhtar thirret aj, i cilli bân rrugë per rrogë per një punë të huejen.” (KLD 54).

³³⁹ Sipas G. Meyerit huazim nga serb. *ujam* “taksë e mullisit”. Sipas Svanes nga një formë më e vjetër *ujbm̃v*, që është e përbashkët edhe bullg. *uem* (shiko te A. Omari *Marrëdhëniet* 300).

urdhnes/ë, -a 29 “të urdhëruarit; dhënia e urdhrit; urdhri vetë” (*Zotnija ka urdhnesen, rrogatari ndigjesen*).

urdhnim, -i 102 “përfundimi i veprimit të foljes *urdhëroj*”; këtu me kuptimin e “dhënies së urdhërit në ushtri” (*Kur të dalë n’ushtri, ká tager prËje e urdhnimi*).

urtë (i) 100 “të bindur; të dëgjueshëm dhe pa fjalë; që sillen mirë e mbrenda normave të caktuara” (*t’urtë e veshtakë*).

urtí, -ja 67 “sjellje krejtësisht sipas normave morale; mendim i drejtë dhe i pjekur; cilësia e të urtit për të dhënë pleqësi të drejtë” (*âsht shêj urtije*).

V

- vad/ë, -a** 23 “vija e ujit që përdoret për vaditje; rendi i përcaktuar për ta marrë këtë vadë në një kohë të caktuar” (*vada /rendi i ujit/*).
- vad/e, -ja** 12 “koha (përkat. data a dita) e paracaktuar për të kryer një punë a një detyrim (si larje borxhi, marrja e një nuseje etj.); afat i paracaktuar” (*e kanë vaden*³⁴⁰ *në ditë që të mirret nusja*).
- váj (me bâ)** 70 “me u ankue” (*Dorzâni ka tager me bâ váj në katund*).
- vajza** (nen unazë) 13 “vajzë e zanun; vajzë për të cilën është dhënë shenji (unaza)” (*Vajza nen unazë nuk ka tager me lshue djalin*).
- vajzë** (e grabitne) 13 “vajzë e grabitur; që është marrë jashtë rregullave e normave të Kanunit” (*Vajza e grabitne a e hikne*).
- vajzë** (e hikne) 13 “që ka ikur nga shtëpia pa lejen e prindërve” (*Vajza e grabitne a e hikne*).
- vajzë** (e lidhun) 13 “vajza për të cilën është dhënë shenji i fejesës; pas kësaj vajza ‘jet e lidhun’, nuk mundet me u fejue më me dikë tjetër” (*Kah Kanûja, vajza jet e lidhun, e veç me lêje të dhandrrit*).
- vajzë** (e xânun) 13 “vajzë e fejuar (sipas zakonit)” (*me lshue vajzën e xânun*).
- vajzëni, -ja** 13 “femër e pamartuar; koha kur femra është ende në moshë të re dhe e pamartuar; *vajzëri-a*” (*me petka vajzënijet*).
- vajzënisht** 13 “ashtu si shkojnë vajzat; me sjellje vajzënore; *vajzërisht*” (*do të shkojë vajzënisht*).
- valanic/ë, -a** 47 “një farë mulliri me ujë që shërben për të shkelur shajakun; dërstilë” (*per me trajtue mulli a valanicë*).³⁴¹

³⁴⁰ Huazim nga turq. *vade-ja* (T. Dizdari *Fjalor* 1073).

³⁴¹ Huazim nga serb. *valjaonica* (E. Çabej SE VII 222; A. Omari *Marrëdhëniet* 304).

- val/ë, -a** 90 “në atë çast; në atë kohë; në atë moment; në kulmin e veprimit” (*po s’u vra n’at valë*).
- vang, -u** 85 “përdorim i figurshëm (me tejbajtje kuptimi) i *vangë* “vjegëzat a verigat e bëra prej së dredhmes, rreth e rrotull opangës, ku përshkohen nortat (gjalmat) që shtrëngojnë atë për këmbë” (*me ia gjetë vangun punës*).
- varz/ë, -a** 27 “trajta më *r* (*varzë*) është forma primitive e fjalës (e ruajtur në dialektin e gegërishtes)” (*varzat e plangut të shuem*).
- varr/ë, -a** 22 “plagë të shkaktuara kryesisht nga armë zjarri” (*nderen i a kerkon burri, varren e gjakun prindja*); 82 (*pa i pasë ky as gjak as varrë*).
- vath/ë, -a** 9 “vendi i thurur ku mbajmë dhentë” (*Ka tager me u prî gjobtarvet në vathë*).
- vathi** (i bletve) 34 “zgjoi i bletëve” (*Vathi i bletve kah Kanûja, i parazohet shpís së thyeme*).
- veçim, -i** 85 “dallim; përfundimi i veprimit të foljes *me veçue*” (*shtegun e veçimit*).
- vegsh, -i** 24 “vorbë” (*qëtha, vjedra /mjelca/, mtîj, vegsha, vorba, kuça*); 66 (*Me i luejtë rrasen e vegshit*).
- vejë (e)** 88 “gruaja së cilës i ka vdekur burri” (*grueja e vejë*).
- vendue (me)** 1 “i vë në vend të vet; i vë aty ku duhet” (*e me i vendue si t’a shofë vetë*).
- verbue (me)** 75 “dëmtimi që bën dhia ndër cungjet e hardhive në vreshtë” (*sá cûgj hardhije të ketë verbue*).
- verbuem (i)** 75 “që është pa sy; që është qorr”; këtu me përdorim të figurshëm për të përcaktuar gjendjen e një cunge hardhie, që e ka ngrënë a dëmtuar dhia e për të cilën i zoti i dhisë do të paguajë dëmin e shkaktuar” (*Cungu i hardhisë i verbuem*).
- vergâ, -ni** 79 “dash a cjaç i patredhur; vërgë” (*Ogiçi, hanori e vergâni*).
- verza-t** 76 “këtu fjala është përdorur me kuptim të figurshëm (a tejbajtje kuptimi) për trekëndëshin e drurit (kularin; kërrçabën), që i vihet derrit në qafë me qëllim që të mos

- dëmtojë a të thyej gardhiqet etj.” (*Po u gjet thiu në dam pa verza / kulár-krrabza /*).
- vêse-t** 37 “shumës i sing. i vend-e” (*vêset e kufijve*).
- vêst, -i** 41 “vresht-i” (*nder vêshta e nder pëmajë*).
- veshtak** 100 “njeri i heshtur, fjalëpak, që më tepër dëgjon se flet; që mendohet mirë para se të nisë me folë” (*t’urtë e veshtakë*).
- vetvrás, -i** 90 “ai që vret veten” (*shpija e vetvrasit*).
- vigâ, -ni** 39 “figurë mitologjike me trup jashtëzakonisht të madh dhe me fuqi të jashtëzakonshme; njeri i fuqishëm e me shtat shumë të madh” (*kanûne vigâjsh*).³⁴²
- vijnaj/ë, -a** 46 “shum. i vijë-a; tërësia e vijave të ujit a vijave që përdoren për vaditje” (*Vendet neper të cillat kalojn vijnajet*).
- virgjin, -a** 108 “vajzë e pamartuar, që nuk ka kryer ende marrëdhënie seksuale; virgjëreshë; murgeshë shtëpie; vajza që rri pa u martuar, banon te prindërit e vet, pret flokët dhe vishet si burrat” (*Virginat s’veçohen prej grash*).
- visar, -i** 36 “pasuria që përfshin kujria përbrenda saj” (*Visarin e kujrís s’mund e shesë*).
- vithna-t** 8 shum. i vath-i “vendi i thurur ku mbajmë dhentë; vathë-a” (*me ndreqë ... vithna*); 23 (*troje e vithna*).
- vjam/ë, -i** 15 “lënda e butë dhe e lyrshe e organizmit të frymorëve që nuk tretet në ujë; dhjamë” (*mish e vjamë*).
- vjed/ër, -ra** 24 “enë e drunjtë; kovë ku mjelet e mbahet qumështi” (*qêtha, vjedra*³⁴³ /mjelca/, mtîj, vegsha, vorba, kuça).
- vjedhní, -ja** 59 “vjedhja; të vjedhurit” (*per vjedhní e per ndo’i vrasë*); 77 (*Në vjedhní perfshiher*).

³⁴² G. Meyeri e bie nga serb. *viganj* “kudhër, farkë”, duke vënë në dukje perceptimin popullor të farkëtarit si qenie e mbinatyrshe, ka shprehur mendimin: “lidhja semantike mes fjalës sllave dhe huazimit në shqip nuk është krejt e qartë.” (shiko hollësitë te A. Omari *Marrëdhëniet* 310).

³⁴³ Huazim nga serb. /bullg. *vedro* “kovë” (A. Omari *Marrëdhëniet* 306).

vjeftj/e, -a 96 “vlerë” (*faqe kanunit s’ká vjeftje*).

vjellë (me) flakë 85 “të dalurit e flakës nga gryka e pushkës”; përdorim i figurshëm i fjalës (*me vjellë flakë grykëholla /pushka/*).

vjetull, -a 49 “shtazë me madhësi mesatare, me lëvizje shumë të shpejta, që e bën strofëllin brenda në dhë; *baldosë; dosëbalë; vjedull; vjedhull*” (*shqerth a vjetulla të ndjekuna*).

vllá i shpifun 27 “*Vllá i shpifun*, mbas Kanûnit, thirret njaj, i cilli i lén nanës me burrë të dytë.”³⁴⁴

vllá (me bâ) 36 “Me bâ vllá kend në katund, don me thënë me pelqye një shpí të flamurit të huej, qi të mundet me ardhë e me ngulë në katund të flamurit tjetër.”³⁴⁵

vllazen (dy nanash) 25 “vëllezër që kanë të përbashkët babain, që është martuar dy herë, me dy gra të ndryshme, me të cilat ka pasur dy fëmijë” (*vllazen dy nanash*).

vllazní, -ja 2 “vëllezër e motra; *term kanuni* njësi e vogël brenda fisi, të gjitha familjet që janë të një fisi (përkat. të një soji a rodi)” (*Në vorre të njëj vllaznije a të njëj fisi*); 7 (*dahen në vllazní*).

vllaznim, -i 71 “probatin-i; byrazer-i; veprimi që kryhet kur dy vetë bëhen probatina me njëri-tjetrin” (*Gjaku e gjinia, vllaznimi e kumbaria në Kanû të Malevet*).

vogjlí, -ja 5 “*term kanuni* që përfaqësonte popullin e vogël (përkat shtresat e ulta të popullsisë)” (*prej krenve e prej vogjlíjet*); 95 (*e me gjithë Vogjlí*).

vojvod/ë, -a 23 “kryetar i një fisi” (*Me kene derë Vojvodet*³⁴⁶).

³⁴⁴ KLD 27.

³⁴⁵ KLD 197.

³⁴⁶ Sipas K. Ulqinit (*Termat* 158): “**vojvodë**: (M. e Madhe) gjobar e më shpesh kryetar i një lagjeje. Në Nikaj-Mertur personi më i rëndësishëm pas bajraktarit. Përpara viteve 50 të shekullit të kaluar pat funksione gjygjësore në Malësi. Në Hot “plak kanuje”.

Huazim nga bullg. *vojvoda*, bullg. e vjetër *vojevoda* “komandant ushtrie” (A. Omari *Marrëdhëniet* 316).

- vorb/ë, -a** 24 “enë prej balte të pjekur, zakonisht me një vesh, që shërben për të zier gjellë” (*qêtha, vjedra /mjelca/, mtij, vegsha, vorba, kuça*).
- vorruë (me u)** 37 “me u futë në dhë”; këtu e përdorur në mënyrë të figurshme për papërdhokët, të cilët futen në dhë rreth e rreth gurit të kufinit” (*të cillt vorrohen nën dhë*).
- vozg/ë, -a** 24 “fuçi e madhe që merr njëqind okë verë e më lart” (*vozza, govixha, fuçija, sheka*).
- vra (e hup)** 105 “shprehje që përcakton personin që vret dhe përpiqet ta fshehë vrasjen; ta hupë atë” (*kush vret “vra e hup”*).
- vras/ë, -a** 29 “të vrarit shoq me shoq për punë gjaku a ndonjë shkaku tjetër” (*Po ndolli cubnija a vrasa në katund*); 59 (*Fjala emë në shkaktostë vrasë*).
- vrri, -ni** 1 “kullotë dimërore” (*në mal, në vrrë*).
- vrugnue (me u)** 68 “me u ra vrugu”; këtu e përdorur në mënyrë të figurshme (metaforë) (*ftyra t’u vrugnue*).
- vrugnue (me)** 94 “me errësue e me nxi (nderën e katundit)” (*qi e vrugnojnë nderen e katundit*).
- vrugnuem (i)** 58 “(fytyrë) e nxirë si të ishte me sëmundjen e vrugut” (*Ftyren e vrugnueme në daç laje, në daç zezoje edhe mâ*).

X

xân/ë, -a 8 “(vende; pjesë pylli a zabel) që janë zënë nga një njeri i fshatit për nevojat e tij vetjake” (*xâna*³⁴⁷ /ograje/).
xânë (me) 34 “me pickue gjarpri” (a e *xû* gjarpni).

³⁴⁷ Sipas K. Ulqinit (*Termat* 159): “**xana (të)**: (Mirditë) Ograjë, kullotë. Në Mat livadhi që kositet në verë e i ruhet bari që del pa u hëngër me bagëti deri në dimër.”

Z

zabel, -i 23 “një vend në pyll a një pjesë pylli, pronë private, që është lënë për të prerë dru për nevoja familjare; pjesë e vogël e një pylli e caktuar për të bërë dru për dimër” (*prozhme, zabele*).³⁴⁸

zâbuk/ë, -a 94 “pëlqim-i; lajm; të lajmëruarit a lajmërimi” (*qi t’u apin zâbuken të fjalisunt*); 95 (*Pengu i pelqimit a i zâbukës*).

zagar, -i 48 “qen gjahu; qen që është stërvitur për të gjuajtur (kafshë, shpend etj.)” (*me langoj e me zagare*).³⁴⁹

zâmê, -ja 16 “leje (për të kryer një punë etj.)” (*Zâmêja e të zot’t*); 23 (*pa zamê*³⁵⁰ të t’et s’mund të blejnë).

zatetë (me) 3 “ngulem në një vend e zë pozicion; përgatis vendin për luftim dhe ngulem në të; mbës në një vend pa lëvizur” (*do të ndiqet mje qi të zatesë kund*).

zemrak 63 “idhnak; që zemrohet shpejt; trim, guximtar” (*Po duel ndo’i burrë zemrak*).

³⁴⁸ G. Meyeri (EW 479) *zabel* të shqipes e trajton si fjalë sllave dhe (duke cituar Jireçekun “një pyll i rrethuar quhej *zabël* te sllavët e vjetër të gadishullit”) e krahason me serb. *zabijeliti* “zbardh, shënoj një pemë duke prerë lëkurën”. P. Skok shënon fjalën e vjetër *zabel* “pyll rezervat ku është ndaluar hyrja” në Kodin e Stefan Dushanit (1345), si postverbal i *zaběliti* > *zabijeliti* “shënoj duke prerë lëvoren e drurit për të treguar ndalim”; në serbishten e Kosovës *zabelj*, në shqipe *zabel* “pyll”. Shiko sa më lart te A. Omari *Marrëdhëniet* 320 v.

³⁴⁹ E. Çabej (SE VII 283) ka shprehur mendimin se *zagar* është fjalë me burim të diskutuar, e përhapur në shumicën e gjuhëve ballkanike. Ai mendon më tepër për një burim prej turq. *zagar* “qen gjahu”. T. Dizdari (*Fjalori* 1139) fjalën *zagar* do ta përfshijë në huazimet turke të shqipes.

³⁵⁰ T. Dizdari (*Fjalor* 1144), pasi bën një analizë të hollësishme të fjalës, kryesisht për përdorimin e saj në popull (*me u bâ zami* “me rá në ujdë me njëri-tjetrin”), duke u nisur nga kuptimi që ka kjo fjalë në një dorëshkrim të Gjeçovit, e gjithashtu në një shënim të Sh. Bardhit (që shprehet gjithsesi me dyshim), T. Dizdari mendon për një huazim prej turqishtes.

- zezue (me)** 58 “prish, rrenoj, vesh në të zeza; i bëj të mjerë” (*Ftyren e vrugnueme në daç laje, në daç zezoje edhe mâ*).
- zgav/ër, -ra** 49 “vrimë e madhe a golle e hapur brenda një shkëmbi a një druri të madh e të vjetër” (*zgaver lisi*).
- zgerdhî (me u)** 59 “zbardh dhëmbët; qesh dikë për ta tallur; zgërdheshem” (*rrî e zgerdhîhem*).
- zí, -ja** 110 “rrezik i madh, që shpeshherë shoqërohet me humbjen e jetës; mjerim; fatkeqësi” (*Zija per të dekun*).
- zjarmije-t** 24 “*shum.* i fjalës *zjarm*”; kjo e fundit me kuptimin “familje më vete” (*sa zjarmijesh të dahren*).
- zmojl/e, -ja** 105 “djerr-i; (tokë) e lënë pa punuar” (*do të jesë zmojle*).³⁵¹
- zoja (e)** 8 “gruaja që është caktuar për të bërë punët e shtëpisë”; ajo, sipas Kanunit, ka të drejta të veçanta gjithashtu edhe detyra, që duhet t’i plotësojë pa fjalë (*E zoja e shpís*).
- zoti (i) /i shpís/** 7 “ai që drejton punët e shtëpisë” (*Mbas kanûnit, sundimi i shpís i perket mâ të vjetrit nen kulm të shpís a se vllaut të parë*).
- zyr/e, -ja** 7 “detyrë e caktuar” (*per me krye ket zyre*).

³⁵¹ Sipas N. Joklit *zmojle* “djerr” vjen prej një latinishteje vulgare **exmulgia*, prejfoljor i *e(x)mulgeo* “mjel gjer në fund, shter, thaj” (shiko te E. Çabej SE VII 299).

ZH

zhargas 14 “rrëshqanë; duke e tërhequr zharg për tokë” (*nusen ... zhargas e rrshânas do t’a çojnë në shpí të dhandrit*).

zhdrivillim, -i 7 “të zhvilluarit (e shtatit); rritja normale e shtatit të njeriut; zhvillimi normal i trupit” (*kah zhdriwillimi i shtatit*).

zhgarkim, -i 59 “shkarkim: këtu me kuptimin e fajësimit për një rreng a punë të keqe (vjedhje, vrasje etj.) (*nuk mund t’i hypet në qafë qi të lajë, pasë e pa pasë, per çdo zhgarkim e shpifje*).

zhgulë (me u) 35 “Me u largue tërësisht prej katundit ku banon; me lëshue plangun përfundimisht” (*me u zhgulë fare prej katundit*).

zhgun, -i 53 “njëfarë tirkur i trashë prej leshi të bardhë, i punuar me dy liq e i shkelur në dërstilë; petku që veshin françeskanët, që është në ngjyrë kafeje të mbyllët (të murrme) e që shtrëngohet në bel me një litar në ngjyrë të bardhë me tri neje” (*Pashi i zhgunit*).

zhìb/ël, -la 11 “njollë a dangë që del në lëkurë a që e kanë disa njerëz që në lindje; njollë morale, veprim kundër normave morale të vendosura përgjithësisht; ashkël; grimcë; lëmnishte” (*me i rrogue pa zhìbla*).³⁵²

zhyt e mbyt 16 “në çfarëdo situatë; sido që të paraqitet gjendja; me të mirë e me të keq” (*zhyt e mbyt, aty do të kalojë shtektari*).

³⁵² Me dyshim nga serb. *šiba* “shufër, purtekë”; në trajtë zvogëluese *šibljika* “kaçube, shkurre”, Sipas E. Çabejt *shibël* është huazim më i ri me ruajtje të *b-së* (shiko hollësitë te A. Omari *Marrëdhëniet* 284). Në kanun është përdorur në mënyrë figurative me tejbajtje kuptimi.

SHPREHJE TË KANUNIT *(Frazelogji, fjalë të urta etj.)*

Duke gjykuar për pasurinë gjuhësore të Kanunit, shprehjet (frazelogji, fjalë të urta etj.) zënë një vend jo vetëm të rëndësishëm, por të padiskutueshëm. Shprehjet ngërthejnë në vetvete dy tipare kryesore.

E para, për të përmbyllur një shpjegim të një norme kanunore. Kemi në këtë rast një ngjeshje a homogjenitet të përkryer të mendimit, model i ndërtimit gjuhësor, që me pak fjalë (kurr më tepër se një fjali) përmbyll diskutimin, duke dhënë vendimin e prerë për një çështje. Kemi, pra, në këtë mes dy pjesë: *sqarimi me fjalë* dhe, pas tij, *shprehja*, që nuk lë asnjë shteg për diskutim.

Thuhet: “Pleqnija e re s’mundet me shkelë të vjetrën”, e fill prapa: “*Plak mbí plak kanûja s’bán.*”³⁵³

Thuhet: “Po t’u mbush mëndja me punue at tokë, neper te cillen âsht shtegu i katundit, punoje, porse shtegut do t’i gjëjsh vënd”, e fill vjen shprehja: “*Puna e luen shtegun.*”³⁵⁴

Thuhet: “Si t’a ndreqë pûnen, shka t’i ketë folë kush kuej, do t’i apë; sepse “*E folmja âsht në fund të kuletës.*”³⁵⁵

Kemi në vazhdimësi një vijë logjike të thukët, të qartë e të pakundërshtueshme. E kush nuk don t’u nënshtrohet këtyre rregullave: “*E bie në mend katundi!*”

E dyta, krahas këtij kodi logjik, shprehjet kanë edhe një kod tjetër, atë moralin, të cilin Frano Illia, mbledhësi i Kanunit të Skënderbeut, e quan “*ligji i fisnikisë*”, që tani

³⁵³ KLD 46.

³⁵⁴ KLD 43.

³⁵⁵ KLD 57.

ndërthuret edhe me kodin tjetër, atë të estetikës. Gjithçka në Kanun shprehet jo vetëm qartë, saktë, me fisnikëri por edhe bukur.

“E bukura e Kanunit asht vazhdimësia në frymën e vet, asht ligji i gjallë. Kanuni, posë ligjeve që rregullojnë jetën e përditshme të popullit me përpikmeni, ka edhe ligjet e fisnikisë deri në naltësitë ma mahnitëse, e deri në heroizëm: *Besë, nderë, urti, guxim, burrní, mikpritje, liri.*”³⁵⁶

*
* *

Shprehjet e Kanunit do të kërkonin një studim më vete, veçanërisht për klasifikimin e tyre, në njërën anë, por edhe për mënyrën sesi janë ndërtuar, detyrë që duhet ta kryejnë ata që merren me sintaksën historike. Diçka mund të thuhet këtu me siguri: gjuha e Kanunit është jo vetëm e pasur, por shpesh edhe gjedhe (model) i së bukurës. Përdorimi i mjeteve të gjuhës nga populli analfabet është i mahnitshëm.

Kemi shumë për të mësuar nga përmendoret e vjetra, aq më tepër kur gjuha shqipe sot, për fat të keq, “Po bdaret e po bastardhohet.”

Ne vazhdim kemi rreshtuar shprehje (frazelogji, fjalë të urta etj.), me qëllimin e mirë që t’i hapim rrugë studimit të tyre të mëtejshëm. Gjithashtu, kemi dhënë shpjegimet përkatëse për ato që nuk e njohin mirë dialektin e Veriut.

*
* *

... *do të bâj vâj (te i Pari i Fés)* (1)³⁵⁷ = Do të ankohet.

³⁵⁶ F. Luli, *Fjalor* 6.

³⁵⁷ Ndër kllapa shënohet numri i faqes ku del shprehja përkatëse në *Kanun*.

“Kisha shpatë e konop s’ká” (2) = Kisha nuk përdor forcën, si e tillë përjashtohet nga të gjitha detyrimet e Kanunit, që kanë lidhje me përdormin e forcës.

... e bjen në mend (famullija) (3) = (Ai) që nuk bindet me fjalë e në mënyrë të ndërgjegjshme, e detyron famullia që t’u nënshtrohet detyrimeve të përgjithshme.

... me i lypë arsye (3) = I kërkoj shpjegime, gjithsesi brenda arsyes, për veprime të kryera, të cilat i bien ndesh normave të Kanunit. Pra, para detyrimit, kërkohet diskutimi (arsyeja).

Kush vên gojë në Famullitár (3) = Kush flet pa doganë; kush lëshon fjalë të pavërteta; kush përgojon (Famullitarin).

... me e lypë nderen (3) = Me kërkue e me ngulë këmbë që nderi të vihet në vend me çdo kusht.

... çohet në bé (4) = Detyrohet që të betohet për të mbrojtur veten nga një akuzë e bërë kundër tij.

... me rá (Famullitari) nen gjobë (4) = Me u dënue me gjobë.

... me punue në shtek të vet (4) = Me punue në pronë të vet; punon për llogari të vet.

(Kush then kishen), âsht i djegun e i pjekun (5) = Është i shkatërruar krejtësisht; është i qitun faret, duke u dënuar sipas Kanunit.

... bâhet batare (prej Bajrakut) (5) = Pushkatohet nga një togë njerëzish të Bajrakut (për faje tepër të rënda).

Me vû kush dorë (në Meshtár) (6) = Me prekë (Meshtarin) me dorë; me rrahë (Meshtarin).

... ***kúr mos të hecin si e lypë e mara e shpís*** (8) = Kur punon në dëm të shtëpisë; kur punët e shtëpisë nuk shkojnë mirë për shkak të atij që e drejton.

... ***me mbajtë në frë gjinden e shpís*** (8) = Me i detyrue me të mirë a me të keq gjinden e shtëpisë, që të mos punojnë kundër normave të Kanunit.

Me mbajtë sý mbi tokët (8) = Me pasë nën kontroll tokat e shtëpisë, që të mos lihen pa punuar etj.

Mos me i a mbajtë krahin kuej (8) = Mos me përkrahë një njeri të shtëpisë më shumë se tjetrin; pra të gjithë do të jenë të barabartë në ushqim, në veshje etj.

Kuej t'i a njesë gishtin i zoti i shpís (9) = Kë të caktojë i zoti i shtëpisë për të kryer një punë a një veprim.

... ***i janë bâ shokë të deknit*** (16) = Kur kanë shkelë rregullat e udhëtimit të gjenazes, janë vrarë nga personi i dëmtuar.

... ***kanûja s'jau gjegjë vajin*** (17) = Kanuni nuk pranon ankimin për kërkesën a lutjen e bërë prej dikujt. Pra vendimi i Kanunit është i prerë.

... ***janë në detyrë*** (18) = Janë të detyruar.

... ***mikut i jet në dorë (Shêji)*** (18) = (Miku) është i detyruar të zbatojë detyrimet, sipas normës së “shenjtit”; pra mbetet i penguar.

“Gjaku shkon per gisht” (19) = Zakoni i marrjes së gjakut kërkon që të zbatohet vetëm tek ai që ka kryer vrasjen.

... ***nuk bje në faj*** (19) = Nuk fajësohet.

... *s'qet bimë mâ per të* (20) = Nuk merret më kush me të; nuk punon më kush për të; është punë e kryer njëherë e mirë, si e tillë nuk përsëritet.

... *me i pré thekun* (20) = Ndaj gruan.

... *me i rá mbrapa* (22) = Me vazhdue me kërkue zgjidhjen e një pune të nisur.

... *me marrë pré* (23) = Me pretue; me ra pré; me marrë një gjë sipas rregullave të presë.

... *me dalë fare* (26) = Me u zhdukë krejtësisht nga faqja e dheut me gjithë njerëz e pasuri.

“/Nip bije nuk mund/ *të varet në krrabë t'ungjve*.” = Nipi në vijë femërore nuk ka të drejtë trashëgimie në plangun e ungjit.

... *lang e plang* (27) = Krejtësisht; me gjithë pasurinë kryesore, që përcakton një shtëpi (plangun).

... *me t'eger e me të butë* (27) = Duke përdorur të dy mënyrat, arsyen dhe forcën.

... *do t'a bâje me dije* (31) = Do ta lajmërojë.

... *nuk do të pshtetet në të thurun a të pá thurun* (31) = Nuk pranohen për asnjë rast përligjjet (justifikimet) e atij që ka bërë një dëm, për të cilin do të përgjigjet sipas Kanunit.

“*Udha e madhe nuk lán gjâ*” (33) = Rruga është e të gjithëve, prandaj të gjithë banorët mund ta përdorin atë pa i penguar kush.

... *veç kur të gjindet me “mish në gojë”* (33) = Kur të gjendet në flagrancë; kur të gjendet me dorë në të.

Po i ra mohit (34) = Po nuk pranoi.

“Guri i kufinit ka dishmitarë mbrapa” (37) = Kufiri i një prone është i vendosur mirë, prandaj është shumë vështirë për ta ndërruar a për ta luajtur nga vendi.

“Ai më lypi pashtrakun, un i a ktheva hekurin e çarkun” (38) = Detyrimin a taksën e kërkuar nuk e pagova, sepse përdora armën (forcën).

“Ujët është gjaku i tokës” (40) = Uji për vaditje etj. është si gjaku për njeriun.

“Pûna luen shtegun” (43) = Shtegun i kalimit mund ta luajë puna. Në ndërgjegjen e njerëzvet të kohës së Kanunit, puna është mbi gjithçka.

“Shaterkazi e luen udhen” (43) = Vegla e punës ndërron udhën.

“Mullisi e perbûjsi do të flëjnë në njânin brryl” (45) = Mullisi e përbujtësi do të jenë gjithnjë në detyrë, edhe kur flejnë.

“Plak mbi plak kanûja s’bán” (46) = Në Kanun nuk pranohen gjyqe mbi gjyqe; për këtë ka rregulla të prera.

“Per një shpi s’lêhet m’u thá një katund” (46) = Interesi i përgjithshëm vihet gjithnjë mbi atë personalin.

“Vija e katundit të kalon rrâzë votret” (46) = Një punë që i shërben katundit (si p, sh. vija e ujit), po i ra udha për mjedis shtëpisë (votrës), ajo do të priset për t’u ndërtuar diku tjetër.

“Pushka e kali e kanë kûj mbë kûj” (53) = Po u var pushka (e blerë) në një kunj, ashtu edhe po u lidh kali i blerë diku në

një kunj, pazari quhet i kryer e nuk vazhdohet më. Kali e pushka i mbeten atij që i vari i pari në kunj.

“E folmja është në fund të kuletës” (57) = Po fole (po dhe fjalën) do të përgjigjesh një më një për sa je zotuar.

“Fala, s’t’a fala, Kanûja s’e kapë” (58) = Fjalët e thëna gjatë një bisede, Kanuni nuk i merr parasysht.

“Fjala mort s’bân” (59) = Fjala nuk vdes kënd; ajo nuk vret njeri.

“Shtriga në gjak nuk bjen” (59) = I keqi përgjithësisht nuk bie në gjak.

“Goja s’qet kend në gjak” (59) = Fjala e thënë pa përgjegjësi, nuk e qet në gjak atë që e thotë.

“Perte bén nuk shtÿhet mllëfi” (60) = Beja përligj çdo veprim të kryer. Pas kësaj çdo veprim tjetër është i tepërt dhe i papranueshëm.

“Bé e s’ka pertej” (60) = Për t’u përligjur për një problem a ndonjë çështje tjetër, beja është e fundit. Pas saj nuk ka tjetër; çështja mbyllet.

“Beja lán gjaqe” (60) = Beja mjafton për t’u përjashtuar edhe prej një gjaku, për të cilin akuzohet dikush.

“Gjânë e djerrun e gjaqet e hupuna i vên per udhë beja” (60) = Beja përligj qoftë një gjë që ka humbur (është vjedhur etj.), por edhe ato gjaqe të cilave nuk u dihet dorasi.

“A bén, a gjânë” (60) = Ose do të bëhet beja, ose gjëja, për të cilën përflitet dikush, shkon hupës.

“Mohi ka bén” (61) = Kur një njeri i bie mohit, ai detyrimisht duhet të betohet, përndryshe mohi nuk ka vlerë. Pra mohi shkon (përkat. shoqërohet) detyrimisht me benë.

“Mohuesit i bien beja” (61) = Ai që mohon, nuk ka të drejtë të betohet, sepse nuk i zihet besë, meqë ka konflikt interesi.

“Beja nuk merr” (61) = Ti mund të bësh bé, por kjo nuk mjafton që të marrësh atë që do duke u betuar, aq më tepër kur gjëja që kërkon është e jotja, sepse ke interes për atë çështje. Në këtë mes duhen poronikët (dëshmitarët).

“Marrsit s’i bjen beja” (61) = Ai që ka me marrë diçka, nuk mund të betohet, sepse detyrimisht do të mbajë anën e vet.

“Cubi është me bé mbë krah” (61) = Cubit nuk i zihet besë, sepse ai nuk e ka të vështirë të betohet në rrenë (pikërisht sepse është cub).

“Ujku e lpîn misht e vet, por të huejin e han” (61) = Ujku nuk i zihet besë pikërisht sepse ai nuk ha sojin e vet, por të huajt.

“Beja merr gjân e vet”. (61) = Beja e bërë sipas rregullave të Kanunit, merr gjënë e vet (atë që ka humbur, është vjedhur etj.).

“Mohin per të dekun kanûja s’e xên”. (61) = Nuk mund të mohojsh (apo te pohojsh) duke përmendur një njeri që ka vdekur. Për Kanunin ky mohim (a pohim) nuk ka vlerë.

“Shpirt per shpirt se duken e falë Zoti” (65) = Njerëzit para Kanunit janë të barabartë (përkat. gjykohen të barabartë), sepse shpirti është njëlloj si për njërin, ashtu edhe për tjetrin. Pamja e jashtme nuk peshon në Kanun.

“Del i miri prej të keqit e i keqi prej të mirit” (65) = Ky është kodi i barazisë së njerëzve para ligjit. Të gjithë janë të barabartë, pa asnjë dallim. Rasti më i veçantë për të drejtat e njeriut, të konsakruara që së lashti në Kanunin e Lekë Dukagjinit; mbase edhe para të drejtave që sanksionoi revolucioni frëng.

“Në kánder të vet se i cilli peshon katerqind derhëm” (65) = Barazia e detyrueshme para Kanunit si e të keqit, si të mirit, si atij me pozitë, si atij pa pozitë, duke gjykuar që të gjithë njerëzit janë të barabartë që në lindje të tyre. Ky është një rast emancipimi i tejskajshëm, që vlerëson tiparet e popullit tonë që së lashti.

“Ndera e marrun gjobë nuk ká” (65) = Fyerja e çdo lloji qoftë e sido që të shfaqet, është rreptësisht e ndaluar. Për këtë *ndera e marrun* nuk i nënshtrohet Kanunit. Kanuni nuk e ndalë të fyerin ta zgjidhë vetë mënyrën sesi do ta vërë në vend nderin e marrun. Kanuni vepron pasi të jetë kryer akti i vetëgjyqjesisë së atij që i është marrë ndera.

Burri i fortë merr gjoben vetë (65) = Burri i fortë kur fyhet (“i merret ndera”) e zgjidh vetë problemin, prandaj nuk i drejtohet fare Kanunit.

“Shpija e Shqyptarit ásh e Zotit e e mikut” (66) = Për këtë ka rregulla të prera sesi duhet pritur e përcjellur miku dhe kush përgjigjet për të.

“Miku don drû” (66) = E thënë me me dy kuptime. Së pari, sapo miku hyn në dhomën e pritjes, edhe korrik me qenë, duhet ndezur në votër një zjarr i vogël, qoftë edhe me karthia, si shenj nderimi. Së dyti, miku është “budalla”, ai nuk di si e tek është gjendja e atyre që e presin, prandaj duhet sajdisur.

“Bukë e krypë e zëmer” (66) = Kjo është thënia për të treguar bujarinë dhe mikpritjen e shqiptarit.

“Mikut të zëmrës i lshohet shpija” (66) = I besohet gjithçka, sepse trajtohet tashmë si njeri i shtëpisë.

“Buka e lán dâmin”. (67) = I dhunuari a i dëmtuari nuk e ndjek dëmin e bërë, por i troket në derë atij që u dha bukë atyre që kryen dhunimin. Ky që u dha bukë tani do të përgjigjet për dëmin e kryer.

“Dora e thatë, s’ka uratë” (71) = Dorëzania nuk përligjet me dorë të thatë. Ai që ka hyrë dorëzanë duhet të ndërhyjë (përkat. të përgjigjet) që të hollat të shkojnë te i zoti në kohën e caktuar.

“Nji dhí thán nji vrrí” (75) = Shprehja vlen për të përcaktuar dëmin që sjell dhia veçanërisht ndër vreshta.

... vaji nuk i gjegjet në kanû (76) = Ankesa nuk i pranohet.

“Gjurma e vûme, gjâja e gjetun” (78) = Vjedhja ndiqet nëpërmjet lënies së gjurmëve. Po u diktua gjurma, gjâja është e gjetur, sepse aty ku mbeti gjurma, aty edhe do të përgjigjet dikush për të.

“Shka të bâjn të mêtujt (mêcat), burrnimi i shpís do t’a lájñ” (78) = Për fajet e gabimet e të vegjëleve (fëmijëve) do të përgjigjen prindja e tyre.

“Udha e Zotit s’lân gjâ” (78) = Rruga e madhe nuk përgjigjet për veprimet që kryhen aty.

“Knduesi âsht herori (sahati) i të vorfnit” (80) = Kjo sentencë ka lindur nga një gjyq i bërë për vrasjen e një gjeli. Vrasjen e kishte kryer një i pasur; gjeli ishte i një të varfëri. Për

këtë rast gjyqi vendosi që i pasuri t'i japë të varfërit orën, duke e barazuar me gjelin.

“Ai qi prin, e merr gjakun mbi vedi” (81) = Kur dikush prin e aty krisë pushka e vritet ndokush, ai që prin e merr gjakun mbi vete.

“Kush e ep fishekun, gjakun e bân të ve’n” (81) = Kjo ka ndodhur kur nuses (së martuar kundër dëshirës së saj), i kanë dhënë në pajë edhe një fishek. Në qoftë se ajo do ta braktiste burrin, atëherë ai mund ta vriste me fishekun e pajës, pa rënë në gjak.

“Pushka e çon gjakun te shpija” (81) = Vrasja me armë e një njeriu merrej përsipër prej të gjithë robëve të shpisë, të cilët duhet të përgjigjeshin për këtë vrasje sipas Kanunit.

“Pushka të lshon në gjak” (81) = Përdorimi i armës kundër tjetrit të lëshonte në gjak.

... me u a rrudhun pêjt (91) = Me e detyrue me forcë.

“Plak mbi Plak, gjýgj mbi gjýgj e bé mbi bé kanûja nuk bân” (94) = Gjyqet në Kanun ndjekin radhen e vet. Kur një njeri është i pakënaqur nga vendimi i një gjyqi të përfunduar, nuk mund të nisë një tjetër (me po ata pleq).

“Mbas pengut shkojn opangat” (96) = Sipas vlerës së pengut, jepet edhe shpërblimi.

“Mbas gjâjet shkojn opangat” (96) = Si e sa të jetë gjëja që gjykohet, ashtu jepet edhe shpërblimi për gjykatësit

Adrian Deva, Lektor (Penny W. Stamps Shkolla e Artit dhe e Dizajnit, University of Michigan)

Arben Prendi, Profesor i Asociuem (Universiteti i Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’, Departamenti i Letërsisë)

Carrie Ann Morgan, Kandidate PhD (Departamenti i Antropologjisë/Departamenti i Gjuhësisë, University of Michigan)

Çezarin Toma, MA/Studiues i pavarun (Firence)

Eljon Doçe, Dr. (Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Letërsisë)

Erenestina Gjergji Halili, Dr. (Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Letërsisë)

Marsel Nilaj, Dr. (Universiteti i Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’, Departamenti i Historisë)

Michael Galaty, Profesor (Departamenti i Antropologjisë; Drejtor i Muzeut të Arkeologjisë Antropologjike, University of Michigan)

Adrian Deva, Lecturer (Penny W. Stamps School of Art & Design, University of Michigan)

Arben Prendi, Associate Professor (University of Shkodra ‘Luigj Gurakuqi’, Department of Literature)

Carrie Ann Morgan, PhD Candidate (Department of Anthropology/Department of Linguistics, University of Michigan)

Çezarin Toma, MA/Independent researcher (Florence)

Eljon Doçe, Dr. (University of Tirana, Faculty of History and Philology, Department of Literature)

Erenestina Gjergji Halili, Dr. (University of Tirana, Faculty of History and Philology, Department of Literature)

Marsel Nilaj, Dr. (University of Shkodra ‘Luigj Gurakuqi’, Department of History)

Michael Galaty, Professor (Department of Anthropology; Director of Museum of Anthropological Archeology, University of Michigan)

KÊNS - IV/2020

Revistë e përvitshme kritike

Kryeredaktore: Aristeia Kola;

Zv/kryeredaktor: Fra Censor Ambrozi

Michigan, korrik 2020

240 ff.; 16 cm x 24 cm

ISSN online: **2521-7348**

